



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EUROPIANE**



**TEMË DISERTACIONI
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”**

**“POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË E BASHKIMIT EUROPIAN.
MARRËDHËNIET NATO – BE”**

**KANDIDATI
MsC. YRFET SHKRELI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR
Prof. Dr. SKËNDER KAÇUPI**

TIRANË 2018



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EUROPIANE**



**Temë disertacioni e paraqitur
nga: MsC. Yrfet Shkreli
në kërkim të gradës shkencore “DOKTOR”
në Institutin e Studimeve Europiane**

“Politika e Jashtme dhe e Sigurisë e Bashkimit European. Marrëdhëniet NATO – BE”

Drejtimi: Legjislacion dhe Institucione Europiane

Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. Skënder Kaçupi

Mbrohet më datë...../...../..... përpara jurisë së përbërë nga:

1.Kryetar
2.Anëtar (Oponent)
3.Anëtar (Oponent)
4.Anëtar
5.Anëtar

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	iii
LISTA E FIGURAVE	v
LISTA E TABELAVE	vi
PARATHËNIE	vii
HYRJE	xv

KAPITULLI I

POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE E MBROJTJES PARA LISBONËS

1.1 Mbrojtja dhe Siguria në Traktatin e Mاستrihtit	1
1.2 Traktati i Amsterdimit dhe fillesat e Politikës Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes	5
1.3 Mbrojtja si komponent i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit European sipas Traktatit të Nicës	13
1.4 Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes në Projekt Kushtetutën e Bashkimit European	24

KAPITULLI II

POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE E MBROJTJES SË PËRBASHKËT NË TRAKTATIN E LISBONËS

2.1 Risitë në kuadrin institucional	31
2.2 Risi të tjera që kanë ndikim në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes	37
2.3 Bashkëpunimi NATO-BE pas Lisbonës	44

KAPITULLI III

STATUSI LIGJOR I BASHKIMIT EUROPIAN DHE ZBATUESHMËRIA E NORMAVE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

3.1 Ligji për Konfliktet e Armatosura dhe zbatueshmëria e tij në operacionet e ndërmarra nga Bashkimi European	56
3.2 Të drejtat e njeriut dhe natyra ekstraterritoriale e tyre	63
3.3 Zbatueshmëria e të drejtave të njeriut në operacionet e ndërmarra në kuadër të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët	70

KAPITULLI IV
GJENDJA JURIDIKE DHE KAPACITETET E POLITIKËS EUROPIANE TË
SIGURISË DHE TË MBROJTJES SË PËRBASHKËT

4.1 Instrumentat ligjorë në dispozicion të Bashkimit European	74
4.2 Aftësitë dhe kapacitetet mbrojtëse të Bashkimit European	79
4.3 Drejt krijimit të një ushtrie Europiane	89

KAPITULLI V
OPERACIONET DHE MISIONET E BASHKIMIT EUROPIAN. BASHKËPUNIMI
NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE NATO-s

5.1 Angazhimi i Bashkimit European dhe i NATO-s në ish Jugosllavi	102
5.2 Afganistani dhe bashkëpunimi në terren ndërmjet Bashkimit European dhe NATO-s	113
5.3 Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit European dhe NATO-s në Afrikë	116

KAPITULLI VI
BASHKËPUNIMI I BASHKIMIT EUROPIAN ME ORGANIZATA TË TJERA
NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

6.1 Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara	124
6.2 Bashkëpunimi me Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë	129
6.3 Bashkëpunimi me organizata rajonale në Afrikë	135
6.4 Bashkëpunimi me Shoqatën e Kombeve të Azisë Juglindore	140

KAPITULLI VII
SFIDAT E SË ARDHMES. NJË BASHKIM EUROPIAN I RI DHE NJË NATO E RE.

7.1 Bashkimi European si një aktor global	145
7.2 Sfidat e së ardhmes, të ndryshme dhe të palidhura	150
7.3 Siguria dhe mbrojtja Europine në Samitin e Varshavës	163
7.4 Siguria në kufinj të Bashkimit European	170
KONKLUZIONE	183
TABELA DHE FIGURA	193
LITERATURA	198

LISTA E SHKURTIMEVE

AEM	Agjencia Europiane e Mbrojtjes
BE	Bashkimi European
BEP	Bashkimi European Perëndimor
GJED	Gjykata Europiane e Drejtësisë
ISS	Instituti i Studimeve për Sigurinë
KACMK	Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave
KE	Këshilli i Europës
KEE	Komuniteti Ekonomik European
KEEA	Komuniteti European i Energjisë Atomike
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KEQÇ	Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut
KEM	Komuniteti European i Mbrojtjes
KPE	Komuniteti Politik European
KPS	Komiteti i Politikave dhe Sigurisë
KS	Këshilli i Sigurimit
KU	Komiteti Ushtarak
NATO	Aleanca e Atlantikut të Veriut
OMBP	Organizata e Mbrojtjes së Bashkimit Perëndimor
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OUA	Organizata e Unitetit Afrikan
PESM	Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

PESMP	Politika e Përbashkët Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes
PJSP	Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët
RDK	Republika Demokratike e Kongos
SES	Strategjia Europiane e Sigurisë
SHKAJL	Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore
SHVJ	Shërbimi për Veprimet me Jashtë
ShU	Shtabi Ushtarak
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Vendimmarrja në Politikën e Jashtme të Sigurisë së Përbashkët sipas Traktatit të Lisbonës	196
Figura 2. PJSP/PMSP dhe fusha të tjera të veprimeve të jashtme të Traktatit të Lisbonës	197

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Traktati i Lisbonës: Ndryshimet kryesore lidhur me Politikën Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët	193
Tabela 2. Shpenzimet në fushën e mbrojtjes për BE-në	194
Tabela 3. Shpenzimet në fushën e mbrojtjes për SHBA-në	194
Tabela 4. Përqindja e trupave të vëna në dispozicion nga shtetet e Europës Perëndimore në Misionet Paqeruajtëse të OKB-së	195
Tabela 5. Kontributi në trupa të Shteteve Anëtare të BE-së në operacionet e OKB-së	195

PARATHËNIE

Nuk është e lehtë të shkruash një libër apo një temë. Ndonjëherë është më e lehtë të diskutosh për diçka sesa të shkruash rreth saj. Ne mund të flasim për orë të tëra për një çështje, të shtrojmë problematika dhe të ofrojmë zgjidhje, por nuk mund t'a bëjmë të njëjtë gjë kur shkruajmë rreth saj. Në të shkruajtur duhet të jesh i saktë dhe preçiz. Për këtë arsye duhet të mendohemi dy herë para se të formulojmë frazat ose shprehjet. Nga ana tjetër, nuk është e mjaftueshme të dish diçka dhe t'a kesh atë të qartë në mendjen tënde, por është e rëndësishme të ndash me të tjerët njohjet e tua në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.

Idea për zgjedhjen e kësaj teme më ka lindur gjatë diskutimeve të realizuara nga profesorë të së drejtës ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në një nga orët e mësimit të zhvilluara në universitetin në të cilin unë ndiqja studimet master në të drejtë europiane. Qasja e këtyre profesorëve të së drejtës dhe çështjet e shtruarra për diskutim nxitën tek unë dëshirën për t'u thelluar më tej në kërkim dhe për të zgjeruar më tej fushën e studimit.

*Nga një vështrim i përgjithshëm i natyrës së studimeve të publikuara nga autorë të ndryshëm deri më sot mund të arrijmë në përfundimin se ato klasifikohen në tre kategori: **së pari**, në studime që trajtojnë përmbajtjen e politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së dhe hapat e bëra në drejtim të ndërtimit të një politike të mbrojtjes së përbashkët, duke u përqëndruar tek institucionet dhe natyrën e vendimmarrjes; **së dyti**, në studime që analizojnë rastet konkrete në të cilat ka gjetur zbatim politika e jashtme dhe e sigurisë, duke u përqëndruar në masat e parashikuara në aktet normative që cilat i mundësojnë BE-së të ndërhyjë, kryesisht civilisht, në një situatë konflikti; dhe **së treti**, në studime që analizojnë ndikimin e kësaj politike tek ato që e përfitojnë atë, të cilat përqëndrohen në efektet që kanë masat e natyrës civile në rivendosjen e paqes dhe të stabilitetit. Por në vend që t'i kushtojë rëndësi analizës së axhendës së Bashkimit në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, të mënyrës sesi janë hartuar aktet që rregullojnë politikën e jashtme në tërësi dhe atë të sigurisë dhe të mbrojtjes në veçanti dhe natyrës së vendimmarrjes në këtë fushë, ky punim shkon më tej dhe synon të analizojë dhe ndikimin që ka patur bashkëpunimi NATO-BE në forcimin më tej të rolit të Bashkimit si aktor global në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe në zbatimin në praktikë të kësaj politike në rast të një situatë konflikti.*

Ky punim nuk limitohet vetëm të përshkruajë politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së dhe mjetet në dispozicion të tij, por edhe të analizojë veprimet konkrete që ai ka ndërmarrë për rivendosjen e paqes dhe të sigurisë në kuadër të një mbrojtje të përbashkët, përfshirë këtu dhe rastet e bashkëpunimit me NATO-n, kuadrin ligjor mbi të cilat ai ka vepruar, aktet ligjore që rregullojnë bashkëpunimin në terren NATO-BE dhe sesi është garantuar respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë këtyre operacioneve dhe misioneve. Një studim do të ishte i plotë nëse do t'i përgjigjej jo vetëm pyetjeve “çfarë” dhe “si” por edhe “pse”.

Paralelizmi i bërë nga Uinston Çërcill gjatë diskutimeve për krijimin e Komunitetit European të Mbrojtjes, duke e krahasuar atë me një “amalgamë të fëlliqur”, gjen vend, me po

të njëjtën forcë, dhe për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, krahasim i cili shërben si kujtesë që progresi drejt bashkimit politik dhe ekonomik është një proces i vazhdueshëm. Megjithëse konteksti në të cilin merren sot vendimet mund të ketë ndryshuar, pas Luftës së Ftohtë dy kanë qenë çështjet që kanë dominuar debatet e zhvilluara në lidhje me sigurinë, **së pari**, cila do të jetë natyra dhe shtrirja e kontributit të Europës në drejtim të sigurisë dhe të mbrojtjes dhe **së dyti**, si mund të ruhet angazhimi i NATO-s në çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen në Europë.

Përfundimi i Luftës së Ftohtë, eliminoi jo vetëm dallimet ndërmjet lindjes dhe perëndimit, por edhe shumë nga vështirësitë e hasura nga vendet europiane në përpjekjet e vazhdueshme për të përfshirë një komponent të sigurisë në procesin e integritetit, duke e bërë të qartë faktin se Bashkimi European do të ishte i paplotë nëse një nga shtyllat e funksionimit të tij nuk do të kishte të bënte me çështje të sigurisë. Sfidat e reja me të cilat po përballëj siguria e Bashkimit, që nga ato që lidhen me mjedisin, pasurimin e armëve të shkatërrimit në masë, ekstremizmin fetar, piraterinë, trafikimin e qënieve njërzore dhe të lëndëve narkotike, ndryshimi i natyrës së konflikteve nga ato brenda shtetit në ato shtet me shtet, e bëri më të lehtë arritjen e një marrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare në këtë fushë, të cilat deri atëherë mendonin se çështjet që kishin të bënin me mbrojtjen dhe sigurinë ishin të lidhura ngushtë me sovranitetin e tyre. Tashmë paqja dhe siguria e Europës kërcënohej nga rreziqet, që ndonëse ishin të një niveli më të ulët ishin komplet të pamënaxhueshme, të cilat vinin nga mungesa e stabilitetit nga Ballkani deri në Afrikën e Veriut, nga Lindja e Mesme/Azia Qëndrore në Europën Lindore dhe Kaukaz.

Natyrë e këtyre sfidave, që jo domosdoshmërisht kërkonin një ndërhyrje ushtarake, ndikuan dhe në ndryshimin e konceptit të sigurisë, duke përfshirë në të dhe operacionet paqeruajtëse dhe ato për parandalimin e konflikteve, të cilat kërkonin jo vetëm shtimin e aseteve dhe të personelit civil dhe ushtarak të Bashkimit, por edhe një angazhim më të madh të Shteteve Anëtare. Ndërkohë që nga ana tjetër përpjekjet e Bashkimit European për të përfshirë në shtyllën e dytë detyra që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen kanë qenë të kujdesshme, për sa kohë që mbrojtja mbetet një çështje e karakterit ngushtësisht kombëtar dhe e drejta për t'u vetëmbrojtur nuk është vetëm një e drejtë e njohur ndërkombëtarisht, por se dhe fuqia ushtarake janë shpesh tregues të identitetit kombëtar.

Në përfundim, me gjithë përparimin e bërë në fusha të tjera të integritetit european, si bashkimi monetar, bashkëpunimi në çështjet e drejtësisë dhe të azilit, për sa kohë që integriteti në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes karakterizohet nga inate të hershme, dyshime dhe perceptime të gabuara, ideja e bashkimit të forcave kombëtare në një ushtri të vetme europiane, dhe së bashku me to dhe të industrive të mbrojtjes, është e parakohshme.

Niveli i angazhimit të NATO-s në çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen e Bashkimit European, ka qenë temë e diskutimeve të shumta. Edhe pse një prej detyrave që Bashkimi European Perëndimor i caktoi vetes së tij në 1995 ishte identifikimi i interesave të përbashkëta të Shteteve Anëtare, të rreziqeve dhe të kërcënimeve të mundshme që i kanosen sigurisë, forcimin e kapaciteteve autonome me qëllim të ruajtjes jo vetëm të sigurisë së saj por edhe të rendit botëror, që pas përfundimit të Luftës së Ftohtë një modus vivendi është krijuar

midis këtyre dy organizatave duke nxjerrë në pah domosdoshmërinë e ekzistencës të elementit european dhe atij transatlantik në garantimin e vazhdueshëm të sigurisë.

Miqësia ndërmjet Bashkimit European dhe NATO-s është shumë e “varfër”, të cilët megjithëse përbëhen nga pothuajse të njëjtat Shtete Anëtare me zorr “flasin” me njëri tjetrin. Pyetjet në lidhje me natyrën e marrëdhënies së tyre janë njëkohësisht të lehta dhe të vështira për t’iu përgjigjur. Janë të lehta sepse nga pikëpamja ligjore dhe institucionale marrëdhëniet ndërmjet tyre janë të formalizuara në marrëveshjet dypalëshe dhe në traktatet e themelimit të tyre, edhe pse në fakt marrëdhënia reale, në kuptimin institucional, ekziston me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Të komplikuar se ana formale është një pjesë shumë e vogël e tërësisë së kësaj marrëdhënie, ku historia ka treguar natyrën e vërtetë të saj.

Pavarësisht deklaratave të ardhura nga zyra për shtyp e këtyre organizatave, se të dyja dëshirojnë të vazhdojnë bashkëpunimin në fusha të interesit të përbashkët për arritjen e “multilateralizmit efektiv”, në fakt veprimet e tyre reflektojnë interesat e Shteteve Anëtare. Edhe pse numri më i madh i Shteteve Anëtare të Bashkimit janë njëkohësisht anëtare dhe në NATO, diferencat në anëtarësi janë më të rëndësishme se ngjashmëritë, duke e bërë që vetëm një nga këto organizata të konsiderohet si “superfuqi” botërore. Në lidhje me natyrën e këtyre organizatave mund të themi se, Bashkimi European ka natyrë ndërqeveritare dhe bazohet në arritjen e konsensusit përsa i përket politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, ndërsa NATO, edhe pse i kushton rëndësi arritjes së konsensusit, në disa raste mbështetet dhe në vendimmarrjen ndërsektoriale.

Ndërkohë që mbrojtja konsiderohej si një “tabu” në procesin e integritetit european, deri në vitet '90 ishte NATO institucioni kryesor përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e Europës. Ky realitet ndryshoi me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Traktatit të Mastroihti, i cili vendosi si objektiv të politikës së jashtme të Bashkimit European “mbrojtjen e identitetin e tij në arenën ndërkombëtare, në veçanti nëpërmjet zbatimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, përfshirë dhe krijimin e një kuadri ligjor dhe institucional për një politikë të përbashkët për mbrojtjen, e cila me kalimin e kohës do të na çojë drejt një mbrojtje të përbashkët”. Në vijim të forcimit të bashkëpunimit me NATO-n dhe në uljen e tensioneve ndërmjet këtyre organizatave, një hap të rëndësishëm dhe vendimtar shënoi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të Berlin Plus të cilat parashikonin: **së pari**, të drejtën e Bashkimit European për të pasur akses në kapacitetet planifikuese të NATO-s për përgatitjen dhe realizimin e operacioneve të menaxhimit të krizave; dhe **së dyti**, të drejtën e Bashkimit për të kërkuar dhe e NATO-s për të ofruar një komandë dypalëshe për operacionet e drejtura nga ai. Nga ana tjetër, nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve konfirmon supremacinë e NATO-s si organizata kryesore e angazhuar në çështje të sigurisë, në operacionet paqebërëse (hard power), dhe përpjekjet e Bashkimit European për t’u afirmuar si një aktor ndërkombëtar në çështje të tilla, i cili është angazhuar kryesisht në misionet paqeruajtëse dhe në ato për parandalimin e krizave (soft power).

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të evoluimit të aspekteve që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e integritetit european, ndonëse e pranoj se është pothuajse e

pamundur që në të të përmbliidhen pesëdhjetë vite debat të zhvilluar në lidhje me këto çështje. Për këtë arsye, struktura e këtij punimi është organizuar në shtatë kapituj kryesorë.

Kapitulli i parë trajton zhvillimin e politikës së jashtme në tërësi dhe asaj të sigurisë dhe të mbrojtjes të Bashkimit Europian, në veçanti. Këtu rëndësi merr dhe trajtimi i zhvillimit të dimensionit të sigurisë dhe të mbrojtjes si pjesë përbërëse e integritit europian për të arritur deri në Traktatin e Lisbonës. Gjithashtu, në drejtim të krijimit të idesë së një “Europe pa ndarje” rëndësi paraqet dhe kuptimi i ndryshëm për sigurinë që kanë Shtetet Anëtare.

Shtimi i përpjekjeve të shteteve Europiane drejt integritit dhe bashkëpunimit në çështje të sigurisë do të evidentohet vetëm pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, megjithëse rolin kryesor në Europë për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes vazhdon t’u luante Aleanca e Atlantikut të Veriut. Në kushtet kur në këto vite përparësi mori bashkëpunimi në çështje të natyrës ekonomike, politike dhe të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, do të ishte themelimi i Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut, i Komunitetit Ekonomik Europian dhe i Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, që do të nxiste zgjerimin e fushës së bashkëpunimit përtej asaj ekonomike nëpërmjet krijimit të mekanizmave të nevojshëm për bashkëpunim në çështje që kishin të bënin me politikën e jashtme dhe me zbatueshmërinë e ligjit.

Në këtë kapitull vëmendje e veçantë i është kushtuar problemeve të hasuara në praktikë që kanë të bëjnë me vendimmarrjen, natyrën e institucioneve të përfshira në çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen, buxhetin, industrinë e mbrojtjes, strukturat ndihmëse etj.

Kapitulli i dytë trajton risitë dhe ndryshimet që prezantoi Traktati i Lisbonës në drejtim të mbrojtjes dhe të sigurisë së përbashkët europiane. Që nga momenti i themelimit të Komunitetit Europian politikat që kishin të bënin me çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes së përbashkët janë karakterizuar nga natyra ndërqeveritare, ku pjesa me e madhe e vendimeve në këtë fushë janë marrë në mënyrë unanime dhe rolin më të rëndësishëm në procesin vendimmarrës e kishin Shtetet Anëtare, ndërsa politikat në çështjet që lidheshin me tregtinë, zgjerimin e BE-së dhe ndihmat humanitare janë karakterizuar nga një natyrë “europiane” (mbi kombëtare) vendimmarrje, në të cilën garantohej përfshirja e të gjitha institucioneve më të rëndësishme të BE-së.

Me qëllim forcimin e vendimmarrjes komunitare në çështje që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen, rritjen e efektshmërisë, të koherencës dhe të transparencës së politikave të jashtme të BE-së dhe forcimin e legjitimitetit të operacioneve dhe misioneve të saj, u pa e nevojshme rishikimi i dispozitave që kishin të bënin me PJSP-së në tërësi dhe me PESM-në në veçanti. Këto ndryshime, që synonin të ndreqnin pikat e dobëta të identifikuar në traktatet e mëparshme, u bënë pjesë e Traktatit të Lisbonës.

Një analizë e hollësishme e dispozitave që rregullojnë fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes synon t’i japë përgjigje disa pyetjeve si: A është ndryshimi i emërimit nga PESM në PESMP tregues i rritjes së ambicies së BE-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes? A krijojnë ndryshimet e prezantuara në Traktatin e Lisbonës terrenin e përshtatshëm për krijimin e një politike të përbashkët apo bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes do të vazhdojë të ketë karakter ndërqeveritar? A do të ndikojnë ndryshimet e prezantuara me Traktatin e Lisbonës

në rritjen e rëndësisë së politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së apo janë thjesht një reflektim i rëndësisë që ka sot kjo politikë?

Kapitulli i tretë është i fokusuar në analizën e bazës juridike dhe ligjore të operacioneve ose misioneve të ndërmarrë nga Bashkimi European. Rritja e numrit të tyre, ndonëse nga njëra anë është tregues i rritjes së fuqisë dhe të rolit të Bashkimit në drejtim të ruajtjes së sigurisë së rendit botëror, nga ana tjetër shtron problemin e ligjshmërisë së këtyre operacioneve në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, të qëllimit të këtyre operacioneve në kuadër të Traktatit të Bashkimit European dhe të normave juridike, si marrëveshjet për statusin e forcave dhe marrëveshjet për statusin e misionit, që rregullojnë zhvillimin e këtyre operacioneve. Edhe pse këto çështje të shtruara për diskutim janë të ngjashme me ato të ngritura në lidhje me organizata të tjera ndërkombëtare që veprojnë në fushën e sigurisë, përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe NATO (për shembull debati për ligjshmërinë e ndërhyrjes ushtarake në Kosovë në 1999), natyra juridike e veçantë e Bashkimit European dhe personaliteti i tij justifikojnë një trajtim të mëvetësishëm të këtyre çështjeve. Ky kapitull nuk ka si qëllim të trajtojë të gjitha problemet lidhur me ligjshmërinë e operacioneve në kuadër të PESM-së, por synon të trajtojë zbatueshmërinë e së drejtës ndërkombëtare në operacione e zhvilluara në kuadër të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Kapitulli i katërt analizon gjendjen e PJSP-së në tërësi dhe të PESMP-së në veçanti, duke i kushtuar një vend të veçantë analizës së aseteve dhe të mekanizmave që Bashkimi European ka në dispozicion për të realizuar objektivat e tij në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Për shkak se në vazhdimësi BE-ja është konsideruar si një fuqi civile, e cila i ka kushtuar rëndësi forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe politik dhe zgjidhjes diplomatike të konflikteve, platforma ku Shtetet Anëtare mund të diskutonin për çështje që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen ishte NATO, e cila ishte dhe përgjegjëse për realizimin e mbrojtjes kolektive. Problematika e krijuar gjatë Luftës së Ftohtë, paaftësia e BE-së për të ndërhyrë politikisht ose ushtarakisht gjatë konflikteve në Ballkan, ndryshimet gjeopolitike, shtimi i konflikteve në afërsi të kufinjve të Europës, shtimi i fluksit të emigrantëve nga zonat e konfliktit dhe terrorizmi xhihadist, nxjorri në pah urgjencën për të ndërmarrë hapa në drejtim të ndërtimit dhe të forcimit të kapaciteteve dhe aftësive të BE-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, jo vetëm ato civile por edhe ato ushtarake. Gjithashtu, në këtë kapitull rëndësi merr dhe analiza e përpjekjeve të BE-së për krijimin e një “ushtrie europiane”. Përgjigje synon t’i jepet pyetjes nëse krijimi i njësisive të veçanta të angazhimit të natyrës ushtarake si Grupet e Betejave, Trupat Europeanë dhe forcimi i kapaciteteve mbështetëse detare, ajrore dhe tokësore të Bashkimit European a po e çojnë atë drejt krijimit të një ushtrie europiane?

Kapitulli i pestë analizon rolin e NATO-s në sigurinë e Bashkimit European, duke marrë në analizë studimin e rasteve konkrete të bashkëpunimit të tyre në terren. Angazhimi i NATO-s në misionet e drejtuara nga Bashkimi apo përdorimi nga kjo e fundit të aseteve dhe të strukturave të saj, ka rezultuar në përfitim të ndërsjellë për të dy palët. Bashkimi European duhet t’i kushtojë më tepër rëndësi arritjes së një balance ndërmjet përfshirjes së NATO-s, dhe

nëpërmjet saj dhe Shteteve të Bashkuara, në sigurinë e saj dhe rritjes së përgjegjësisë në drejtimin e operacioneve.

Një ide më të qartë të gjendjes së PESMP-së, të pikëpyetjeve ligjore që kanë lindur gjatë operacioneve dhe misioneve në të cilat BE-ja është angazhuar dhe mënyra sesi ato janë zgjidhur mund t'a krijojmë vetëm duke analizuar misionet dhe operacionet në të cilat ajo është angazhuar.

Kapitulli i gjashtë trajton bashkëpunimin e Bashkimit European me organizata të tjera ndërkombëtare ose rajonale të angazhuara në çështje të sigurisë, në kushtet kur siguria nuk është thjesht një çështje që shtrihet deri në kufinj të tij. Në këtë kre rëndësi i kushtohet analizës së bazës ligjore që rregullon këtë bashkëpunim dhe fushave konkrete të bashkëpunimit me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe Unionin Afrikan. Për realizimin e objektivave në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes nga njëra anë Bashkimi European duhej të vepronte në bazë të një strategjie të mirëmenduar dhe të forconte kapacitetet dhe aftësitë e tij të pavaruara civile dhe ushtarake, nga ana tjetër ai do të duhej të vepronte në pajtim me parimet e Kartës së OKB-së dhe veprimet e ndërmarra në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes nuk do të mbivendoseshin me ato të ndërmarra nga organizata të tjera në këtë fushë. Krijimi i identitetit european nuk duhet të ishte në kundërshtim me parimet mbi të cilat bazohet bashkëpunimi me këto organizata.

Kapitulli i shtatë trajton të ardhmen politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit European dhe objektivat që ai vendosi pas Samitit të Varshavës. Në dallim nga vitet e para të krijimit të Bashkimit European, sot siguria kërcënohet nga rreziqe të reja si pasurimi i armëve të shkatërrimit në masë, pirateria, krimi kibernetik, trafikimi i qënieve njerëzore dhe terrorizmi. Për t'ju përgjigjur këtyre sfidave të reja me të cilat po përballet siguria e Bashkimit, para tij shtrohet nevoja e hartimit të strategjive konkrete dhe forcimit të bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet Shteteve Anëtare, por edhe ndërmjet tyre dhe shteteve të treta.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur mund të them se përdorimi i metodës kualitative të kërkimit i përshtatet më së miri objektit të studimit, sepse i mundëson autorit dhe lexuesit të kuptojë më qartë kuptimin e vendimeve të marra nga institucionet e Bashkimit European dhe të veprimeve të ndërmarra nga Bashkimi European në situata të caktuara dhe kontekstin ku këto evente janë zhvilluar. Metoda kualitative e kërkimit merr një rëndësi të veçantë sidomos në rast të analizës së një fenomeni nën spektrin e teorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e cila bazohet në kuptimin dhe në kontekstin ku kanë ndodhur ngjarjet.

Me qëllim për të provuar teorinë politike, studimi i rasteve praktike është i dobishëm për të arritur në një konkluzion dhe për të mbledhur prova, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të këtij punimi. Më konkretisht, në punim do të zbatohet interpretimin dhe analizimin e rasteve praktike të cilat “interpretojnë ose shpjegojnë një rast apo një ngjarje duke aplikuar një teori të njohur” në të.

Gjithashtu, në studimin e një rasti konkret do të zbatohet dhe teorinë konstruktiviste. Analizimi i zgjerimit të politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së dhe NATO-s pas Luftës së Ftohtë është një rast studimor ku teori si realizmi, liberalizmi dhe konstruktivizmi ofrojnë

parashikime dhe shpjegime të ndryshme. Këto parashikime, të cilat janë shumë të rëndësishme, i japin përparësi teorisë së konstruktivizmit në krahasim me dy të tjerat, me të cilat mund të arrijmë dhe në përfundime të gabuara në rast të marrjes në analizë të një rasti kaq gjithëpërfshirës dhe që ka sjellë ndikime të rëndësishme në arenën ndërkombëtare. Analiza e zgjerimit të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë të BE-së dhe NATO-s në këndvështrim të teorisë konstruktiviste i shërben forcimit edhe më shumë të teorisë.

Për shkak të ndërthurjes së elementit historik, akademik dhe atij juridik, natyra e materialeve të përdorura për realizimin e këtij punimi është e gjerë dhe gjithëpërfshirëse, e cila nis që nga librat dhe artikujt shkencorë të autorëve të ndryshim deri tek aktet ligjore dhe themeluese të Bashkimit Europian, thënë ndryshe e drejta primare, dhe aktet nënligjore dhe vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Për krijimin e një ideje të qartë për bashkëpunimin NATO-BE rëndësi paraqesin dhe aktet normative të miratuara nga institucionet e Aleancës. Ky punim ka ardhur si rezultat dhe i leximit të një game të gjerë materialesh të tjera të marra nga interneti, duke ju referuar jo vetëm adresave të institucioneve të Bashkimit europian por edhe çdo artikulli gazete që mund të ishte një vlerë e shtuar.

Falenderimet e mia të para shkojnë për udhëheqësin tim shkencor Prof. Dr. Skënder Kaçupi, për ndihmën e tij akademike dhe këshillat e çmuara të dhëna gjatë punimit të temës. Përkushtimi dhe përvoja e tij akademike dhe profesionale ishin një ndihmë e madhe për mua. Mendoj se, të dy realizuam një punë të mirë.

Mirënjohjen dhe falenderimet e mia dua t'ia shpreh dhe bashkëshortit dhe familjes sime, për ndihmën morale që më kanë dhënë gjatë gjithë këtyre viteve për t'u rritur profesionalisht.

HYRJJE

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore shënoi intensifikimin e përpjekjeve të shteteve Europiane drejt integrimit dhe bashkëpunimit në çështje të sigurisë. Integrimi i Gjermanisë në Europë do të ishte mënyra më e mirë për të eliminuar rrezikun që mund t'i kanosej fqinjëve të saj dhe sigurisë e paqes në Europë nga një riarmatim i mundshëm i saj. Arritja e parë në këtë drejtim u shënuar më 17 Mars 1948 me nënshkrimin në Bruksel të Traktatit të Bashkëpunimit Ekonomik, Social, Kulturor dhe të Vetëmbrojtjes Kolektive midis Belgjikës, Francës, Luksemburgut, Hollandës dhe Mbretërisë së Bashkuar (më tej Traktati i Brukselit 1948). Megjithatë u nënshkrua vetëm nga pesë shtete, ky traktat paraqet rëndësi të veçantë jo vetëm për sa i përket fushës së gjerë të bashkëpunimit, duke përfshirë çështje të natyrës ekonomike, sociale dhe kulturore, por edhe se shënoi hapin e parë në drejtim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, duke nisur adoptimin e një plani në funksion të një mbrojtje të përbashkët. Ky plan parashikonte krijimin e një ushtrie të përbashkët dhe të Organizatës së Mbrojtjes së Bashkimit Perëndimor (në vijim OMBP)¹. Megjithatë, rolin kryesor në Europë në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes vazhdonte t'a luante Aleanca e Atlantikut të Veriut (në vijim NATO), e themeluar më 4 Prill 1949.

Gjatë diskutimeve për Planin Shuman SHBA-ja propozoi krijimin e një strukture të integruar brenda Aleancës, në të cilën ushtria gjermane do të vepronte nën kontrollin direkt të saj, duke ia atribuar NATO-s rolin kryesor në mbrojtjen kolektive. Ky plan u refuzua nga Franca, e cila prezantoi planin Pleven sipas së cilit parashikohej krijimi i një ushtrie Europiane e cila do të ishte nën kontrollin e Ministrisë Europiane të Mbrojtjes dhe do të finançohej nga një buxhet i përbashkët².

Ekzistenca e strukturave paralele për çështjet e sigurisë solli dy pasoja të rëndësishme të cilat ishin: *së pari*, transferimi nga shtetet të cilat ishin njëkohësisht anëtare të NATO-s dhe të Traktatit të Brukselit të strukturave të tyre ushtarake nën komandën e NATO-s, dhe *së dyti*, propozimin e Francës për krijimin e Komunitetit Europian të Mbrojtjes (në vijim KEM) dhe të Komunitetit Politik Europian (në vijim KPE). Propozim i cili ishte i destinuar të dështonte, pasi dispozitat shumë të detajuara të traktatit të themelimit të KEM-së parashikonin krijimin e një organizate mbikombëtare, dhe jo thjesht një bashkëpunim ndërqeveritar, duke mos i garantuar liri veprimi Shteteve Anëtare, të cilat e shihnin atë si cënim të sovranitetit të tyre³.

Dështimi i projektit për krijimin e KEM-së, shtroi përsëri nevojën e arritjes së një marrëveshjeje në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes europiane, arritja e së cilës u bë e mundur

¹ *Origins of WEU*, <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit 02 Tetor 2014).

² <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2018).

³ E. Fursdon, *The European Defence Community: A History* (London and Basingstoke, MacMillan Press, 1980), fq. 150-188. Traktati i Komunitetit Europian të Mbrojtjes i cili u miratua nga parlamenti në Belgjikë, Gjermani, Luksemburg dhe Hollandë, u refuzua nga parlamenti francez dhe mbeti pezull në parlamentin Italian.

vetëm në vitin 1954, Marrëveshja e Parisit⁴. Kjo marrëveshje *inter alia* parashikonte anëtarësimin e Gjermanisë në NATO⁵ dhe ndryshimin e Traktatit të Brukselit me anë të Protokollit të nënshkruar në Paris më 23 Tetor 1954⁶. Ky protokoll i hapte rrugë krijimit të organizatës së Bashkimit European Perëndimor (në vijim BEP), e cila për çështjet e ushtarake do të këshillohej dhe do të merrte informacion nga Komanda Ushtarake e NATO-s⁷. Deri në vitet '70 kjo organizatë ishte pothuajse jo aktive në çështje të sigurisë, të cilat mbuloheshin nga NATO, përsa i përket sigurisë së vendeve të Europës Perëndimore, dhe nga Organizata e themeluar nga Traktati i Varshavës, për vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore.

Ndërkohë që problemi i riarmatimit të Gjermanisë vazhdonte të ishte i hapur dhe në vitet në vazhdim përparësi mori bashkëpunimi në çështje të natyrës ekonomike, politike dhe të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Do të ishte themelimi i Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (në vijim KEQÇ), të Komunitetit Ekonomik European (në vijim KEE), i cili kishte si qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shteteve Anëtare: Belgjikës, Luksemburgut, Hollandës, Italisë, Francës dhe Gjermanisë Perëndimore, dhe shmangien e konflikteve ndërmjet tyre. Ky komunitet sëbashku me Komunitetin European të Energjisë Atomike (në vijim KEEA) do të nxisnin zgjerimin e fushës së bashkëpunimit përtej asaj ekonomike nëpërmjet krijimit të mekanizmave të nevojshëm për bashkëpunim në çështje që kishin të bënin me politikën e jashtme dhe me zbatueshmërinë e ligjit. Pra, ajo që filloi më tepër si një bashkëpunim ekonomik u zgjerua dhe në fusha të tjera të politikës si: klima, mjedisi, shëndetësia, marrëdhëniet e jashtme, siguria, drejtësia dhe migrimi.

Themelimi i Komunitetit European do t'i mundësonte Europës të fliste dhe të vepronte si një e vetme dhe të luante plotësisht rolin e saj në arenën ndërkombëtare për çështje të natyrës ekonomike. Ndërsa në drejtim të politikës së jashtme, edhe pse nuk mund të bëhej fjalë për një politikë të mirëfilltë të jashtme dhe të sigurisë, traktati themelues i Komunitetit Ekonomik European përmbante dispozita të rëndësishme në drejtim të politikës së jashtme, të cilat shërbyen si bazë për vitet në vazhdim. Këto ishin: *së pari*, vendosja e tarifave të jashtme të përbashkëta; *së dyti*, mundësia e anëtarësimit të shteteve të tjera; *së treti*, krijimi i një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Francës, Belgjikës, Danimarkës dhe Italisë; *së katërti*, krijimi i Fondit European për Zhvillim (neni 131); *së pesti*, parashikimi i hartimit të politikave të tregtisë me shtetet e treta dhe organizatat ndërkombëtare (neni 110-116), ku rolin kryesor do ta luante Komisioni; *së gjashti*, njohja e personalitetit juridik të komunitetit (neni 210).

⁴ A. Bloed dhe R.A. Wessel, eds, *The Changing Functions of the Western European Union (WEU): Introduction and Basic Documents* (Dordrecht, Nijhoff, 1994), fq. 14-17, <http://www.nato.int/docu/basics.htm> (hyrë për herë të fundit më 03 Shkurt 2014).

⁵NATO, *Final Communiqué of the Meeting of the North Atlantic Council* (22 Tetor 1954), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

⁶ Protokollit i cili ndryshoi dhe plotësoi Traktatin e Brukselit hyri në fuqi më 06 Maj 1955, <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit 02 Tetor 2014).

⁷ A. Dumoulin & E. Remacle, fq. 14-44; Lord Ismay, *NATO the First Five Years 1949-1954, Part I*, Kapitulli "Origins of the North Atlantic Treaty" <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 12 Korrik 2014).

Pas krizës në Algjeri, në vjeshtë të vitit 1958 në Francë vjen në pushtet Charl de Gol, i cili mbajti një qëndrim kontradiktor për çështje që kishin të bënin me politikën e jashtme të Komunitetit Europian. Nga njëra anë ai kërkonte krijimin e një “Europe Europeane” e aftë të frenonte dhe të balancoje fuqinë e SHBA-së dhe të BRSS, dhe nga ana tjetër ishte i vendosur të ruante “Europën e Shteteve”, si komunitet ku secili shtet anëtar ruante sovranitetin e tij. Kjo mospërputhje që karakterizoi qëndrimin francez ndaj integritetit europian gjen pasqyrim akoma sot në politikën e jashtme të BE-së, i cili në të njëjtën kohë nxit integritetin Europian dhe kërkon një koordinim më të madh ndërmjet Shteteve Anëtare (atëhere gjashtë) për çështje të politikës së jashtme. Duke pasur këtë në mendje ai propozoi zhvillimin e mbledhjeve periodike ndërmjet ministrave të jashtëm të Komunitetit Ekonomik Europian.

Njohja e personalitetit juridik të Komunitetit Ekonomik Europian e pajisi atë me kapacitetet për të përfaqësuar anëtarët e tij në çështje që i përkisnin tregtisë, përfshirë këtu dhe Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë, e cila shënoi të parën marrëveshje ku gjashtë shtetet e tij anëtare përfaqësoheshin nga Komuniteti. Nga ana tjetër miratimi në 1962 të Aktit për Zgjerimin e Tregtisë, nën drejtimin e presidentit Xhon Kenedi, i mundësonte SHBA-së të vendoste tarifa më të ulta për familje produktesh në vend që të negocionte për secilin mall. Dy vjet më vonë u detyrua të pranonte parimin e “pjesëve të pabarabarta”, që parashikonte uljen e tarifave me 25% për shtetet anëtare të Komunitetit Ekonomik Europian dhe kjo shërbeu si testi i parë për Komunitetin dhe politikën e tij të jashtme, i cili synonte të pakësonte boshllëkun ekonomik me SHBA-në⁸.

Në vijim të përpjekjeve për forcimin e bashkëpunimit në çështje të politikës së jashtme rëndësi paraqet dhe samiti i Hagës i mbajtur në 1-2 Dhjetor 1968 i cili u përvijua nga tre parime: a.) plotësim - i projektit për krijimin e një tregu të përbashkët si një mundësi për të treguar një Europë të aftë dhe të bashkuar për të marrë përsipër përgjegjësi; b.) thellim - të Komunitetit në çështje që kishin të bënin me politikën ekonomike dhe monetare; dhe c.) zgjerim – të Komunitetit me Britaninë e Madhe dhe shtete të tjera, me parakushtin e miratimit nga Komuniteti të një qëndrimi të përbashkët përpara nisjes së negociatave.

Në drejtim të politikës së jashtme rëndësi paraqet raporti Davignon, i cili themelonte parimin e zhvillimit të mbledhjeve periodike ndërmjet ministrave të jashtëm, mundësinë e zhvillimit të mbledhjeve të herëpashershme ndërmjet kryetarëve të qeverive dhe konsultimet e vazhdueshme ndërmjet Shteteve Anëtare për çështje që preknin sigurinë. Ky raport shënoi krijimin e Bashkëpunimit Politik Europian⁹. Procedurat e detajuara dhe mekanizmat e tij u specifikuan më tej në Raportin e Kopenhagenit më 23 Korrik 1973¹⁰.

Në mbledhjen e rradhës të mbajtur në Shtutgart më 10 Qershor 1983 rëndësi për Bashkëpunimin Politik Europian paraqet zgjerimi i fushës së bashkëpunimit duke përfshirë dhe komponentin politik dhe ekonomik të sigurisë. Deklarata gjithashtu i referohej zhvillimi më tej dhe përcaktimit të qartë të kuptimit të parimeve dhe objektivave të përbashkëta, duke parashikuar

⁸ <https://www.brookings.edu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2018).

⁹ <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2018).

¹⁰ <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2018).

mundësinë e veprimeve të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme, të cilat duhet të karakterizoheshin nga qëndrueshmëria. Në drejtim të forcimit të bashkëpunimit politik në çështje të garantimit të zbatueshmërisë e ligjit dhe të rivendosjes së paqes në arenën ndërkombëtare ishte e nevojshme pakësimi i rasteve të përdorimit të vetos¹¹.

Si mekanizma të cilët luajtën një rol të rëndësishëm dhe në zhvillimin e PESM-së, në këtë periudhë ishin Bashkëpunimi Politik Europian, i cili merrej me çështje të politikës së jashtme dhe mbledhja e Ministrave të Brendshëm të Shteteve Anëtare, e cila merrej me çështje të zbatueshmërisë së ligjit dhe të rendit, e njohur si TREVI- Group.

Në shkurt të 1984, Parlamenti Europian miratoi një “draft traktat” i cili parashikonte njohjen e personalitetit juridik për Bashkimin Europian dhe pajisjen e Këshillit Europian me pushtetin për të shtrirë detyrën e tij të koordinimit të veprimeve në politikën e jashtme për çështje që kishin të bënin me mbrojtjen dhe tregtinë e armëve. Pavarësisht se ky draft hasi refuzimin e Shteteve Anëtare, ai i hapi rrugë miratimit të Aktit Unik Europian, i cili shënon dokumentin e parë që prezanton ndryshime rrënjësore të traktatit që themelonte Komunitetin Ekonomik Europian. Këto ndryshime preknin mënyrën e funksionimit të institucioneve europiane, zgjeronte kompetencat e Komunitetit në drejtim të kërkimit, mjedisit dhe politikën e jashtme të përbashkët. Më konkretisht përsa i përkiste politikës së jashtme dhe të sigurisë ky akt parashikonte: *së pari*, formalizimin e bashkëpunimit ndërqeveritar, por pa ndryshuar mënyrën e veprimit; *së dyti*, detyrimin e Shteteve Anëtare për t’u konsultuar ndërmjet tyre dhe për të informuar njëra tjetrën në rast të një qëndrimi të përbashkët ose të zbatimit të një veprimi të përbashkët; *së treti*, saktësimin e rolit të institucioneve ku Këshilli Europian kishte – rol drejtues, Komisioni Europian – rol asistues dhe Parlamenti – e drejta e informimit në kuadër të Bashkëpunimit Politik Europian; *së katërti*, krijimin e identitetit europian për çështje të politikës së jashtme.

Në forcimin e politikës së jashtme rëndësi paraqesin dhe përpjekjet për riaktivizimin e BEP-së, që u finalizuan në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më 27 Tetor 1987 dhe me miratimin e Platformës për Interesat e Sigurisë Europiane, e cila ndër të tjera u rikujtoi Shteteve Anëtare angazhimin “...për të ndërtuar një Bashkim Europian në përputhje me Aktin Unik Europian...dhe ndërtimi i një Europe të integruar do të mbetet i paplotë për aq kohë sa ai nuk përfshin sigurinë dhe mbrojtjen...”¹².

Si pasojë e këtyre ndryshimeve BEP-ja forcoi pozitën e saj në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, e cila u pasqyrua dhe në pjesëmarrjen e saj në operacionet detare për pastrimin e minave në Gjirin Persik në vitet 1987-1988, zbatimin e embargos që Organizata e Kombeve të Bashkuara (në vijim OKB)-së kishte vendosur ndaj Irakut pas pushtimit të Kuvajtit nga ana e tij në 1990 dhe në zbatimin e sanksioneve të vendosura gjatë konflikteve në ish-Jugosllavisë.

¹¹ <http://aei.pitt.edu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2018).

¹² Western European Union, *Platform on European Security Interests* (Hagë, 27 Tetor 1987), Preambula dhe Pjesën e III.a.2., <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit më 11 Prill 2017).

KAPITULL I

POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE E MBROJTJES PARA LISBONËS

1.1 Mbrojtja dhe siguria në Traktatin e Mastrohtit

Hyrja në fuqi e Traktatit të Mastrohtit më 01 Nëntor 1993 shënoi krijimin e strukturës me “tre shtylla”, të emërtuara si: i.) *Shtylla Komunitare*, e cila u krijua mbi bazën e tre Komuniteteve; ii.) *Shtylla e Politikës së Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët*, e cila zëvendësoi mekanizmat e krijuara deri atëherë, dhe iii.) *Shtylla e Drejtësisë dhe e Punëve të Brendshme*, në të cilën përfshihej bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore, për çështjet civile dhe penale dhe bashkëpunimi për çështje të emigracionit dhe azilit, me qëllim ofrimin ndaj qytetarëve europianë liri, siguri dhe drejtësi.

Përsa i përket sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, si objektiv kryesor ky Traktat vendoste krijimin e një identiteti europian në arenën ndërkombëtare, nëpërmjet zbatimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët dhe hedhjen e hapave në drejtim të krijimit të një politike të mbrojtjes, e cila në kohë mund të çonte drejt një mbrojtje të përbashkët, duke parashikuar se të gjitha këto fusha do të mbuloheshin nga shtylla e dytë e tij. Në mënyrë më të detajuar neni J.1(1) i Traktatit parashikonte këto objektiva për PJSP-së¹³:

- *Mbrojtja e vlerave të përbashkëta, interesave themelore dhe pavarësinë e BE-së;*
- *Forcimi në të gjitha mënyrat e mundshme të sigurisë së BE-së dhe të Shteteve Anëtare;*
- *Ruajtja e paqes dhe forcimi i sigurisë ndërkombëtare, në përputhje me parimet e parashikura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në Aktin Final të Helsinkit dhe objektivat e Kartës së Parisit;*
- *Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar;*
- *Zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*

Nga interpretimi në tërësi i dispozitave të traktatit që kanë të bëjnë me PJSP-në mund të themi se, roli vendimmarrës i Bashkimit ishte mjaft i kufizuar dhe e drejta e “fjalës së fundit” i përkiste Shteteve Anëtare. E drejta për të marrë dhe zbatuar vendime në fushën e mbrojtjes i përkiste BEP-së dhe politikave të BE-së në këtë fushë nuk duhet të paragjykonin politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes së çdo Shteti Anëtar dhe detyrimet e tyre në kudër të NATO-s. Pra, ky Traktat i atribuonte BEP-së një rol kyç në ndërtimin e arkitekturës së sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, duke e konsideruar atë si pjesë integrale e PJSP-së, dhe objektivi për një “mbrojtje të përbashkët” ishte vetëm një “mundësi për të ardhmen”¹⁴.

Përveç sa më sipër, ky Traktat dhe akte të tjera të miratuara në kuadër të tij, e përcaktonin BEP-në si identiteti europian në NATO, e cila nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit, rolit,

¹³ https://europa.eu/european-union/law/treaties_en (hyrë për herë të fundit më 21 Mars 2017).

¹⁴ C. Zanghi, “La difesa europea: dall’UEO a Maastricht”, *Rivista di diritto europeo*, 33(2), 1993, fq. 211-222, <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 12 Shtator 2014).

kontributit dhe përgjegjësisë së saj do të synonte forcimin e shtyllës europiane në NATO. Nga ana tjetër realizimi i këtyre objektivave, shtronte nevojën për zgjerimin e kapaciteteve të saj operacionale dhe të strukturave ushtarake, duke përfshirë dhe ngritjen e një Qendre Satelitore.

Në funksion të bashkëpunimit ushtarak parashikohej dhe ngritja e mekanizmave të ndryshëm si brenda strukturës së BE-së, siç ishte Programi i Grupit European të Pavarur i themeluar më 1976 ndërmjet shteteve europiane anëtare të NATO-s të cilat ishin të përfshira në Grupin e Armatimeve të Europës Perëndimore dhe në Organizatën e Armatimeve për Europën Perëndimore si një njësi kërkimore, ashtu edhe jashtë saj, siç ishte Organizata për Bashkëpunim në Armatimet e Përbashkëta. Gjithashtu, secili Shtet Anëtar duhet të krijonte strukturat institucionale dhe të përcaktonte numrin e forcave ushtarake, të cilat do të vihehin në dispozicion të operacioneve e drejtuara nga BEP-ja, duke qenë njëkohësisht dhe në dispozicion të NATO-s. Një shembull i tillë ishte Eurocorps¹⁵.

Roli i BEP-së në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, përveç se në dispozitat e Traktatit, paraqitet më i detajuar në Deklaratën e Mاستrihtit, e cila u shtua si shtojcë e Traktatit të Mاستrihtit. Ndër të tjera në deklaratë thuhej se¹⁶:

- *Shtetet Anëtare të BEP-së bien dakord mbi nevojën për të zhvilluar një identitet europian në çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes dhe rritjen e përgjegjësisë së BE-së në këto çështje. BEP-ja do të jetë pjesë e rëndësishme e procesit të zhvillimit të BE-së dhe do të kontribuojë në forcimin e solidaritetit brenda NATO-s. Shtetet Anëtare bien dakord për të forcuar rolin e BEP-së, në funksion të arritjes së një politike mbrojtje të përbashkët në kuadër të BE-së, e cila mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët, në përputhje me atë të NATO-s.*
- *BEP-ja do të zhvillohet si pjesë përbërëse e BE-së dhe do të shërbejë si mjet për të forcuar shtyllën europiane në NATO. Për këtë qëllim, ajo do të hartojë politikën europiane të mbrojtjes së përbashkët dhe do të ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e saj nëpërmjet zhvillimit të rolit operacional.*
- *Krijimi i BEP-së si pjesë përbërëse e mbrojtjes së BE-së do të realizohet në faza dhe për arritjen e këtij qëllimi me kërkesë të BE-së, ajo do të përpunojë dhe do të zbatojë vendimet dhe veprimet që BE-ja do të ndërmarrë në këtë fushë.*
- *Objektivi është që BEP-ja të zhvillohet dhe të shërbejë si mjet për të forcuar shtyllën europiane në NATO, duke forcuar më tej bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe duke rritur rolin, përgjegjësitë dhe kontributin e saj. BEP-ja do të ruajë identitetin europian në NATO dhe do të veprojë në pajtim me qëndrimet e adoptuara nga kjo e fundit.*
- *Roli operacional i BEP-së do të forcohet, duke shqyrtuar dhe përcaktuar paraprakisht se cilat misione janë të përshtatshme si dhe duke përcaktuar mjetet dhe strukturat. Marrëveshjet e lidhura për këtë qëllim do të jenë plotësisht në përputhje me dispozitat e mbrojtjes kolektive të të gjithë Aleatëve.*

¹⁵ <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Shtator 2014).

¹⁶ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Shtator 2014).

Sfidat e reja me të cilat po përballej siguria e Bashkimit, që nga ato që lidheshin me mjedisin, pasurimin e armëve të shkatërrimit në masë, ekstremizmin fetar, piraterinë, trafikimin e qenieve njërzore dhe të lëndëve narkotike, të cilat për nga natyra e tyre jo domosdoshmërisht kërkonin një ndërhyrje ushtarake, ndikuan dhe në ndryshimin e konceptit për sigurinë. Për këtë qëllim më 12 Qershor 1992 në Deklaratën Ministeriale të Bonit u miratuan “Detyrat e Petersbergut” (Petersberg tasks), të cilat parashikonin se përveç kontributit në mbrojtjen e përbashkët, në përputhje me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit dhe Nenit V të Traktatit të Brukselit të ndryshuar, njësitë ushtarake të Shteteve Anëtare të BEP-së, nën komandën e kësaj të fundit, do të mund përdoreshin: a.) në misionet humanitare dhe të shpëtimit; b.) në veprimet paqeruajtëse (peacekeeping); dhe c.) si forca luftarake për menaxhimin e krizave, duke përfshirë dhe operacionet për vendosjen e paqes (peacemaking). Nga njëra anë, nëpërmjet miratimit të këtyre detyrave, Shtetet Anëtare pranuan të angazhonin trupat dhe asetet e tyre nën autoritetin e BEP-së dhe nga ana tjetër ato u bënë pjesë integrale e PESM-së, duke luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e shtyllës së dytë të BE-së, atë të PJSP-së.

Vitet në vazhdim shënuan forcimin e pozitive të BEP-së në fushën e mbrojtjes dhe intensifikimin e marrëdhënieve ndërmjet saj dhe NATO-s, ku kjo e fundit filloi të pranonte idenë e ekzistencës së Identitetit European të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (në vijim IESM). Ky qëndrim i NATO-s, i cili gjen shprehje dhe në deklaratën finale të mbledhjes së Këshillit të Atlantikut të Veriut të mbajtur më 6-7 Qershor 1991, në të cilën parashikohej “...Një Aleancë Atlantike e transformuar përbën një element thelbësor në arkitekturën e re të Europës së Bashkuar... Një element i rëndësishëm i këtij transformimi është marrëveshja e të gjithë Aleatëve për të rritur rolin dhe përgjegjësinë e shteteve Europiane. Ne mirëpresim çdo përpjekje të bërë nga Komuniteti European për forcimin e nivelit të sigurisë dhe njohim përparimin e bërë për arritjen e një bashkimi politik, përfshirë këtu dhe zhvillimin e një politike të përbashkët në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Zhvillimi i identitetit european në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, i cili gjen pasqyrim në forcimin e “Shtyllës Europiane” brenda Aleancës, do të ndikojë në forcimin e integritetit dhe në rritjen e efektivitetit të Aleancës së Atlantikut.

Duke pranuar se, i përket Aleatëve Europianë për të vendosur se cilat marrëveshje do t'i shërbejnë zgjerimit të politikës europiane në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe të rolit të saj, më tej biem dakort që, [...], ne do të përmirësojmë praktikat për të siguruar transparencën e nevojshme dhe përputhshmërinë midis identitetit european në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, si pjesë e Komunitetit dhe BEP-së, dhe Aleancës. Do të jetë e nevojshme që të [...] sigurohet që, Shtetet Aleate të cilat aktualisht nuk janë të përfshira në procesin e zhvillimit të identitetit european në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes duhet të përfshihen në një mënyrë të përshtatshme në vendimmarrje të cilat, mund të ndikojnë në sigurinë e tyre... ”¹⁷.

Ky dokument parashikonte si element thelbësor të IESM-së: *së pari*, përfshirjen e NATO-s në operacionet e drejtuara nga BEP-ja, duke identifikuar kapacitetet dhe asetet e secilës prej tyre, por jo duke i ndarë ato; dhe *së dyti*, ngritjen e një komande europiane në kuadër të

¹⁷ Press Communiqué M-1(91)44, (Kopenhagen 6-7 Qershor 1991), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 16 Shtator 2014).

NATO-s, me qëllim përgatitjen, mbështetjen, drejtimin dhe ndërmarrjen e këtyre operacioneve. Në këtë mënyrë, BEP-ja u shndërrua në pjesë përbërëse të politikës të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së dhe “Shtylla Europiane” në NATO.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, ndërmjet NATO-s dhe BEP-së marrëveshja e parë u arrit në mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut më 11 Janar 1994. Me anë të kësaj marrëveshjeje palët ranë dakort për krijimin e një Task Force të Kombinuar dhe të Përbashkët (Combined Joint Task Forces), e cila përbëhej nga kontributi i shteteve të ndryshme nëpërmjet përfshirjes së elementëve tokësore, detare dhe ajrore. Aleanca shprehu mbështetjen e saj për vënien e aseteve të saj në dispozicion të BEP-së me qëllim realizimin e operacioneve që kjo e fundit do të ndërmerre në kuadër të PJSP-së, duke nxitur në të njëjtën kohë dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve individuale, por jo të pavaruara, të secilit Shtet Anëtar, në përgjigje të kërkesave të BE-së¹⁸.

Në vijim të angazhimit të NATO-s në forcimin e stabilitetit dhe të sigurisë në të gjithë zonën euro-atlantike, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve individuale, por jo të pavarura, dhe të IESM-së, rëndësi të veçantë marrin takimet e Këshillit të NATO-s të zhvilluara më 03 Qershor dhe 10 Dhjetor të 1996, në të cilat ajo ka vlerësuar hapat e marrë në këtë drejtim, që janë¹⁹:

- *Vendimet e marra në lidhje me përpilimin e marrëveshjeve që rregullojnë komandën europiane brenda NATO-s, të cilat i shërbejnë përgatitjes dhe zbatimit të operacioneve të udhëhequra nga BEP-ja;*
- *Vendimet për marrjen e masave me qëllim identifikimin e kapaciteteve dhe aseteve të NATO-s, të cilat do të mund të vihen në dispozicion BEP-së për operacionet e udhëhequra nga ajo;*
- *Marrëveshjet e arritura për monitorimin dhe kthimin e aseteve dhe kapaciteteve që i përkasin NATO-s;*
- *Vendimet për përcaktimin e modaliteteve të bashkëpunimit me BEP-në;*
- *Progresin e bërë në lidhje me planifikimin dhe kryerjen e ushtrimeve ushtarake, duke i shoqëruar ato me profile ilustruese për misionet e udhëhequra nga BEP-ja.”*

Në kuadër të këtyre objektivave të parashtruara më lart dhe ndodhur para situatës të rritjes së numrit të operacioneve të drejtuara nga BE-ja (BEP-ja si një komponent i PJSP-së ishte e angazhuar në çështje të mbrojtjes), u pa e rëndësishme arritja e marrëveshjeve për përcaktimin e modaliteteve të bashkëpunimit. Tërësia e këtyre marrëveshjeve të arritura, të cilat u quajtën me një emër të vetëm “Marrëveshjet e Berlin Pus”, mbulonin këto elementë të bashkëpunimit: *Së pari*, aksesin në aftësitë planifikuese të NATO-s në momentin që BE-ja do të ishte duke vlerësuar mundësinë e ndërmarrjes së një operacioni; *Së dyti*, përdorimin e komandës së NATO-s në operacionet ushtarake të udhëhequra nga BE-ja; dhe *Së treti*, përdorimin e aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s në misionet dhe operacionet e udhëhequra nga BE-ja. Ndonëse këto

¹⁸ <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 16 Shtator 2014).

¹⁹ NATO, *Press Communiqué M-NAC-2 (96)165*, (Bruksel, 10 Dhjetor 1996), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 16 Shtator 2014).

marrëveshje shënuan një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe NATO-s, për zbatimin e tyre, përveç testimit gjatë një ushtrimi të përbashkët në vitin 2000, do të duhej të kalonin vite, pasi BE-ja ishte e “zënë” duke bërë pjesë të së drejtës së saj të brendshme *aquis-in* e BEP-së dhe duke ndryshuar traktatet themeluese të saj²⁰.

1.2 Traktati i Amsterdimit dhe fillesat e Politikës Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes

Traktati i Amsterdimit, i cili hyri në fuqi më 01 Maj 1999, erdhi si kundërpërgjigje e nevojës për krijimin e një strukture të re institucionale, e cila do të mund të përballonte me sukses anëtarësimin në të të shteteve të reja. Përveç ndryshimeve në Traktatin ekzistues, ndryshimit të numërimit të dispozitave dhe të konsolidimit të Traktatit të BE-së dhe të Traktatit të Komunitetit Ekonomik Europian, ky Traktat shënoi fillesën e themelimit të PESM-së. Në drejtim të mbrojtjes dhe të sigurisë risitë që solli ky Traktat ishin:

- ***Së pari***, futi konceptin e strategjisë së përbashkët, pasi deri në atë kohë njiheshin veprimet e përbashkëta, qëndrimet e përbashkëta, ku dhe këto u përcaktuan më qartë²¹.
- ***Së dyti***, krijoi postin e Përfaqësuesit të Lartë për PJSP-në, i cili do të ishte në të njëjtën kohë dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, duke i njohur të drejtën për të emëruar përfaqësues të veçantë, të drejtën për të vendosur për planifikimin e politikave dhe ngritjen e një njësie paralajmërimi të parakohshëm (early warning unit), e cila do të vepronte nën komandën e tij.
- ***Së treti***, ndryshimi i mënyrës së votimit me qëllim rritjen e transparencës dhe shtimin e rasteve të bashkëvendimmarrjes në votim. Në këtë drejtim Traktati kufizoi vendimmarrjen me shumicë absolute në rastin e zbatimit të vendimeve (neni 13.2), në lidhje me traktatet në fushën e PJSP-së (neni 24) dhe në shtimin e shpenzimeve për PJSP-në të përcaktuara në buxhetin e BE-së (neni 28(3)).
- ***Së katërti***, njohja e së drejtës së abstenimit konstruktiv të Përfaqësuesit të Lartë për vendimet që kishin të bënin me PJSP-në. Sipas Deklaratës për votimin në fushën e PJSP, Shtetet Anëtare duhet të shmangnin ushtrimin e së drejtës së veto-s në rast se ekzistonte një shumicë absolute në favor të një vendimi.
- ***Së pesti***, ngarkimin e Këshillit Europian me kompetencën për ngritjen e një mbrojtje të përbashkët, që mund të rezultojë më pas si një mundësi për hartimin e një politike të përbashkët të mbrojtjes, e cila duhet të ishte në përputhje me parimet kushtetuese të Shteteve Anëtare (neni 17(1)).
- ***Së gjashti***, përfshirja e “Detyrave të Petërsbergut”, të miratuara nga BEP-ja, në kompetencat e BE-së. Konkretisht në nenin 17 paragrafi 2 parashikohet se: “...ky nen do të përfshijë detyrat në fushën humanitare dhe të shpëtimit, detyrat paqeruajtëse dhe detyrën për ndërhyrje ushtarake në rastet e menaxhimit të krizave, përfshirë dhe operacionet për vendosjen e paqes...”.

²⁰ <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 16 Shtator 2014).

²¹ Neni 12 (ish neni J.2) të Traktatit të BE-së.

- **Së shtati**, shtimi i detyrave të reja, të cilat kishin më pak lidhje me fushën e mbrojtjes si: ruajtja e integritetit të BE-së, ruajtja e paqes dhe forcimi i sigurisë ndërkombëtare (neni 11).

Një vend të veçantë në Traktatin e Amsterdimit zinin dhe dispozitat që rregullonin marrëdhëniet midis BE-së dhe BEP-së. Në nenet 17(1) paragrafi i dytë dhe 17(3) parashikohej se BEP-ja, e cila sikurse trajtuam më lart ishte pjesë integrale e PJSP-së, luante një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Bashkimit, duke e mbështetur atë në përcaktimin e aspekteve mbrojtëse të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët. Ky Traktat i njihte BEP-së të drejtën për zbatimin e vendimeve dhe veprimeve që kishin efekt mbi mbrojtjen. Për zhvillimin e operacioneve ushtarake BE-ja do të duhej t'i drejtohej asaj për vënien në dispozicion të kapaciteteve të nevojshme, duke e njohur në këtë mënyrë BEP-në si pjesë përbërëse të mbrojtjes së Bashkimit.

- **Samiti i Saint Malos dhe Samiti i Këlnit**

Traktati i Amsterdimit përbënte bazën për kryerjen e veprimeve operacionale nga ana e BE-së. Me qëllim që kjo e fundit të luante plotësisht rolin e saj në arenën ndërkombëtare ishte e domosdoshme hartimi i një politike të mbrojtjes së përbashkët, detyrë e cila i përkiste Këshillit European. Ky qëndrim u përforcua fillimisht në Samitin Franko – Anglez të Saint – Malo-s, më 04 Dhjetor 1998²² dhe më pas, në nivel europian, në mbledhjen e Këshillit European të zhvilluar në Këln më 3-4 Qershor 1999²³. Në të dy këto samite u ra dakort se Këshilli, në zbatim të PJSP-së dhe në funksion të hartimit të një politike të mbrojtjes së përbashkët, duhet të kishte të gjitha mundësitë që në përputhje me “Detyrat e Petersbergut” të merrte vendime si në rastet e operacioneve për parandalimin e krizave dhe të atyre për menaxhimin e tyre. Vetëm duke pasur të gjitha kapacitetet e nevojshme për të vepruar në mënyrë të pavarur, përfshirë dhe përdorimin e forcave ushtarake, të cilat duhet të ishin në gadishmëri në rast reagimi ndaj një konflikti ndërkombëtar, BE-ja do të mund të kontribuonte efektivisht në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, në përputhje me parimet e Kartës së OKB-së.

Më tej, në funksion të garantimit të një kontrolli politik dhe strategjik të operacioneve të drejtuara nga BE-ja, Shtetet Anëtare vlerësuan se ajo duhet të kishte në dispozicion të saj strukturat dhe kapacitetet e nevojshme për analizimin e një situatë rreziku, duke krijuar dhe shërbimet e saj të inteligjencës. Realizimi i një gjëje të tillë kërkonte zhvillimin e mbledhjeve të rregullta ose *ad hoc* të Këshillit të Punëve të Përgjithshme, krijimin e një Komiteti të Përhershëm të Politikës dhe Sigurisë, i cili në përbërje të tij të kishte ekspertë të fushës politike dhe asaj ushtarake, dhe krijimin e strukturave të nevojshme për hartimin e planeve strategjike të veprimit. Në të njëjtën kohë BE-ja duhet të mbante parasysh dhe asetet e BEP-së, me qëllim shmangien e

²² <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Shkurt 2018).

²³ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Shkurt 2018).

mbivendosjeve dhe respektimin e detyrimeve që shtetet e saj anëtare kishin në kuadër të BEP-së dhe NATO-s²⁴.

Nga sa më lart, mund të themi se këto samite, shënuan një hap të rëndësishëm në marrjen e vendimit nga ana e BE-së për të zhvilluar një Politikë të Përbashkët Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (në vijim PESMP), e cila do t'i krijonte mundësinë asaj për të zbatuar “Detyrat e Petërsbergut”, me ose pa përdorimin e aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s. Krijimi i PESM-së do të sillte dy pasoja në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes: *së pari*, domosdoshmërinë për krijimin e strukturave të përshtatshme vendimmarrëse, ngritjen e grupeve të ekspertëve, zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme, forcimin e industrisë ushtarake nëpërmjet investimeve në teknologji, dhe *së dyti*, përthithjen nga ana e saj të funksioneve të menaxhimit të krizave, që deri në atë kohë i përkisnin BEP-së, por pa e bërë këtë të fundit pjesë integrale të BE-së, e cila mbetej pothuajse pa funksione në kushtet kur mbrojtja e përbashkët realizohej në kuadër të Aleancës dhe bashkëpunimi në fushën e armatimeve ishte pjesë e BE-së²⁵.

- **Samiti i Helsinkit**

Rekomandimet e dhëna gjatë Samitit të Këlnit, për forcimin e PESM-së, u konsideruan si prioritete dhe puna e nisur duhet të çohet më tej si për sa i përket zhvillimit të kapaciteteve ushtarake dhe atyre civile për menaxhimin e krizave. Hapi i radhës në këtë drejtim u shënuar në Mbledhjen e Këshillit Europian në Helsinki, të mbajtur më 10-11 Dhjetor 1999, në të cilën u miratuan dy progres raporte, plotësues të njëri tjetrit. Këto raporte përmbanin propozime për masat konkrete dhe udhëzime në lidhje me vendimet që duheshin marrë, deri në fund të vitit 2000, me qëllim vënien në zbatim të objektivave të vendosura në Samitin e Këln-it.

Në këtë samit Shtetet Anëtare konfirmuan edhe një herë faktin se ndonëse zhvillimi i PESM-së do të ndihmonte në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, Bashkimi do të duhej të vepronte në pajtim me parimet e Kartës së OKB-së dhe veprimet e ndërmarra në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes nuk duhej të mbivendoseshin me ato të ndërmarra nga organizata të tjera në këtë fushë. Zhvillimi i PPESM-së do të realizohej pa qenë në kundërshtim me angazhimet e marra nën Nenin 5 të Traktatit të Washingtonit dhe Nenit V të Traktatit të Brukselit, i cili do të kishte përparësi për Shtetet Anëtare të këtyre Traktateve. Madje zhvillimi i PPESM-së nuk do të ishte në kundërshtim as me politikat e sigurisë dhe të mbrojtjes të Shteteve Anëtare. Hapa të mëtejshme do të ndërmerreshin për të garantuar një bashkëpunim, koordinim dhe transparencë në marrëdhëniet NATO-BE. Bashkimi do të kontribuonte në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në përputhje me parimet e Kartës së OKB-së duke pranuar se Këshilli i Sigurimit të OKB-së do të luajante rolin parësor dhe kryesor në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

Në zbatim të parimeve dhe objektivave Kartës për Sigurinë Europiane të Organiztës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), BE-ja do të bashkëpunonte me OKB-në, OSBE-në,

²⁴ Cologne European Council, “Conclusion of the Presidency”, *Annex III: European Council Declaration on Strengthening the Common European Policy on Security and Defence* <http://aei.pitt.edu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Shtator 2014).

²⁵ R.A. Wessel, *Afscheid van de West-Europese Unie* (28 Transaktie 1999), fq. 559-568.

Këshillin e Europës dhe çdo organizatë tjetër ndërkombëtare me qëllimin e përbashkët për të forcuar stabilitetin, reagimin e menjëhershëm, parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe rindërtimin e vendit pas konfliktit²⁶.

Madje në Deklaratën e Presidencës, në kushtet kur NATO do të vazhdonte të mbetej themeluesja e mbrojtjes kolektive dhe të luante rolin parësor në menaxhimin e krizave, BE-ja pranonte se për të qenë një aktor ndërkombëtar në çështjet e sigurisë dhe për t'iu përgjigjur sfidave dhe rreziqeve me të cilat po përballlej siguria ndërkombëtare ishte e domosdoshme zhvillimi i kapaciteteve të pavarura, që do t'i mundësonin marrjen e vendimeve dhe drejtimin e operacioneve në rastin e krizave, edhe pa mbështetjen e NATO-s, ndonëse rolin kryesor në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare do të vazhdonte t'a luante Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Një gjë e tillë nuk nënkuptonte krijimin e një ushtrie europiane.

Me qëllim përmbushjen e udhëzimeve të vendosura gjatë mbledhjes së Këshillit European në Këln, të cilat ishin pjesë e Raporteve të Presidencës, në mbledhjen e rradhës Shtetet Anëtare ranë dakort për këto çështje²⁷:

- *Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare në kuadër të operacioneve të drejtuara nga BE-ja dhe rritjen e kapaciteteve, duke synuar që brenda vitit 2003 ato të ishin në gjendje të mobilizonin brenda 60 ditëve, 50000 – 60000 forca ushtarake, të afta për t'u angazhuar në të gjitha llojet e operacioneve ushtarake, sipas “Detyrave të Petërsbergut.*
- *Krijimin e strukturave të reja politike dhe ushtarake brenda Këshillit, me qëllim për t'i garantuar BE-së të gjithë udhëheqjen e nevojshme politike dhe strategjike në drejtimin e operacioneve, duke ruajtur në të njëjtën kohë dhe strukturën institucionale. Vendosshmëria për të realizuar detyrat e Petërsbergut shtronte para Shteteve Anëtare detyrën për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre ushtarake, të cilat në të njëjtën kohë do të ndikonin dhe në forcimin e kapaciteteve të NATO-s dhe në rritjen e efektivitetit të Partneritetit për Paqe (PpP) në kuadër të promovimit të sigurisë europiane. Rëndësi paraqet dhe krijimi i një strukture që do të mund të reagojë menjëherë. Këto masa duhet të ishin në mbështetje të PPESM-së dhe do të shërbenin për forcimin dhe zgjerimin e rolit të BE-së në arenën ndërkombëtare. Me rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe civile të reagimit ndaj krizave, BE-ja do t'a kishte të mundur të përdorte një shumëllojshmëri instrumentesh si ndërhyrjet diplomatike, ndihmën humanitare, sanksionet ekonomike dhe operacionet ushtarake të menaxhimit të krizave.*
- *Krijimin e një mekanizmi për menaxhimin e konflikteve civile, me qëllim koordinimin dhe rritjen e efektivitetit të kapaciteteve civile, paralelisht me ato ushtarake.*
- *Përcaktimi i modaliteteve të veprimit të cilat do të ishin objekt konsultimesh dhe bashkëpunimi në mënyrë transparente me NATO-n, duke marrë parasysh nevojat e*

²⁶ Presidency Conclusions, Annex IV “Presidency Reports to the Helsinki European Council on “Strengthenin the Common European Policy on Security and Defence” and on “Non- Military Crisis Management of thë European Union”.

²⁷ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Prill 2018).

Shteteve Anëtare, por njëkohësisht duke respektuar dhe autonominë vendimmarrëse të BE-së.

- *Këshilli do të kishte të drejtën e vendimmarrjes për çdo politikë të përfshirjes së BE-së në të gjitha fazat dhe aspektet e menaxhimit të krizave, përfshirë këtu dhe vendimet për zbatimin e “Detyrave të Petërsbergut” në pajtim me Nenin 23 të Traktatit të BE-së.*

Për realizimin e detyrave të përcaktuara më lart do të ngarkohej Shteti Anëtar, i cili do të mbante Presidencën e rradhës dhe Sekretari i Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë. Zbatimi i këtyre rekomandimeve duhej të niste në Mars të vitit 2000 dhe shteti që do të kishte Presidencën do të përgatiste një progres raport, për mbledhjen e rradhës të Këshillit Europian në Feira, për masat e ndërmarra dhe nëse ishte e domosdoshme bërja e ndryshimeve në tekstin e Traktatit.

Në lidhje me arritjet e realizuara për forcimin e PESMP-së në këtë progresraport të paraqitur evidentohet fakti se ishte punuar si në aspektet ushtarake dhe ato civile të menaxhimit të krizave dhe progres ishte bërë veçanërisht në identifikimin e marrëveshjeve të duhura për pjesëmarrjen e vendeve të treta në menaxhimin e krizave ushtarake të BE-së. Gjithashtu progres ishte bërë dhe në lidhje me parimet dhe modalitetet për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve NATO – BE, në krijimin e Komitetit për Menaxhimin e Aspekteve Civile të Krizave, si një mekanizëm koordinues në Këshillin e Sekretariatit, i cili bashkëvepronte plotësisht me shërbimet e Komisionit.

Siç u tha më lart, rëndësi për realizimin e PESM-së ka edhe krijimi i strukturës së nevojshme institucionale, e cila do të ofronte ndihmën e saj si për çështje ushtarake dhe për ato civile. Për këtë arsye në raportin “Për Forcimin e Politikës së Përbashkët Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes” parashikohej ngritja e këtyre strukturave politike dhe ushtarake, të përhershme²⁸:

- (i) **Komiteti i Politikave dhe i Sigurisë** (në vijim KPS), i cili do të përbëhej nga përfaqësues të lartë/ambasadorë të Shteteve Anëtare dhe do të merrej me të gjitha aspektet e PJSP-së, përfshirë dhe PESM-në, duke vepruar në përputhje me dispozitat e Traktatit të BE-së dhe duke respektuar kompetencat që i përkisnin Komunitetit. Qëllimi i krijimit të KPS-s ishte garantimi i një vendimmarrje sa më të shpejtë dhe efikase, në fund të së cilës do t’i dërgonte Komitetit Ushtarak udhëzimet përkatëse.
- (ii) **Komiteti Ushtarak** (në vijim KU), i cili do të përbëhej nga Ministrat e Mbrojtjes, të përfaqësuar nga delegatët e tyre ushtarakë. KU-ja kishte si funksion dhënien e këshillave në fushën ushtarake, bërjen e rekomandimeve për KPS-në si dhe sigurimin e drejtimit të Shtabit Ushtarak. Kryetari i KU-së kishte të drejtë të merrte pjesë në mbledhjet e Këshillit në rast kur duhet të merreshin vendime në lidhje me mbrojtjen.
- (iii) **Shtabi Ushtarak** (në vijim ShU), i cili do të vepronte brenda strukturave të Këshillit dhe do të ofronte ekspertizë në fushën ushtarake dhe mbështetje për PESM-në, duke përfshirë

²⁸ European Council, *Presidency Conclusions*, “Annex 1 to Annex 4 “Presidency Progress report to the Helsinki European Council on Strengthening the Common European Policy on Security and Defence”, Military capabilities for Petersberg tasks”, <https://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014).

dhe drejtimin e operacioneve për menaxhimin e krizave të udhëhequra nga BE-ja. Gjithashtu, Shtabi Ushtarak si funksion të tij kishte dhe paralajmërimin e hershëm, vlerësimin e situatës dhe planifikimin strategjik për “Detyrat Petersbergut”, duke përfshirë dhe identifikimin e forcave kombëtare dhe shumëkombëshe.

Në funksion të planifikimit dhe të drejtimit strategjik të operacioneve raporti parashikonte dhe ngritjen e disa strukturave ndihmëse, të cilat do të ishin pjesë e strukturës institucionale të BE-së si:

- a) **Qendra Satelitore e BE-së** (Eu SatCen), si i vetmi institucion që e shtrinte veprimtarinë e tij në hapësirë, nëpërmjet imazheve satelitore dhe mbledhjes së të dhënave do të siguronte mbështetje për vendimmarrjen e BE-së. Ky institucion do të ndihmonte Shtetet Anëtare dhe BE-në gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake. Gjithashtu, gjatë përbushjes së detyrave të saj Qendra Stelitore do të bashkëpunonte dhe me Shërbimet e Veprimeve me Jashtë, Komisionin Europian, shtetet e treta dhe orgnizatrat ndërkombëtare.
- b) **Instituti i Studimeve për Sigurinë** (në vijim ISS), i cili mbështet zhvillimin e PESM-së nëpërmjet mendimeve të ekspertëve. ISS-ja si një agjenci e pavaruar, e cila fillimisht u krijua në kuadër të BEP-së, nga njëra do të fokusohet në realizimin e kërkimeve shkencore në fusha që paraqesnin rëndësi për BE-në dhe nga ana tjetër do të shërbente si platformë për nxitjen e debatit në shërbim të zhvillimit të PESM-së. Ai gjithashtu ishte ngarkuar me detyrën për zhvillimin e kërkimeve shkencore, analizën e politikave, organizimin e seminareve, sigurimin dhe komunikimin e informacionit të mbledhur në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke vepruar në përputhje me Strategjinë Europiane për Sigurinë²⁹.
- c) **Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave** (në vijim KACMK), cili do të vepronte si një organ këshillimor për anën civile të menaxhimit të krizave. Ky institucion do të vepronte nën urdhërat dhe do të raportonte në Komitetin e Politikave dhe të Sigurisë³⁰.

- **Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake dhe civile**

Mbledhjet e mëparshme të Këshillit Europian kishin hedhur bazat për ngritjen e strukturave ushtarake dhe civile, që do të ndihmonin BE-në në arritjen e kapaciteteve të nevojshme me qëllim përbushjen në mënyrë efektive të “Detyrave të Petersbergut”. Hapat konkrete në këtë drejtim do të shënoheshin në mbledhjen e Këshillit Europian në Santa Maria da Feira, të mbajtur 19-20 Qershor 2000, në të cilën Shtetet Anëtare ranë dakort për krijimin e mekanizmit të reagimit të menjëhershëm, i cili do t’i mundësonte BE-së që në situata krizash ose të një rreziku të mundshëm konflikti të rivendoste stabilitetin dhe t’a ruante atë, me qëllim zbatimin e programit të ndihmave që ajo do të ofronte në një rast të tillë.

Nëpërmjet këtij mekanizmi BE-ja synonte të lehtësonte krizën nëpërmjet veprimeve si: shpërndarja e ndihmave humanitare, monitorimin e zgjedhjeve, ndërtimin e institucioneve

²⁹ <http://www.iss.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 27 Shtator 2014).

³⁰ <http://library.fes.de/> (hyrë për herë të fundit më 27 Shtator 2014).

ligjore, garantimin e lirisë së mediave, administrimin e kufinjve, ndërmarrjen e misioneve humanitare, trajnimin e forcave policore, rehabilitimin, rindërtimin dhe zhvillimin e bisedimeve dhe ndërmjetësimeve për rivendosjen e paqes³¹. Do të ishte Komisioni ai që do të garantonte që këto veprime të ndërmerreshin pas një koordinimi efektiv midis Shteteve Anëtare, përfshirë edhe ato në terren. Veprimet duhe të ishin në pajtim me njëra tjetrën, plotësuese dhe efektive. Gjithashtu, ai duhej të promovonte bashkëpunimin me organizata rajonale dhe ndërkombëtare dhe të vlerësonte veprimet e ndërmarra, me qëllim për të përcaktuar nëse objektivat e vendosura ishin realizuar plotësisht.

Ndonëse ky mekanizëm do t'i mundësonte BE-së të reagoje menjëherë, në mënyrë efikase dhe me fleksibilitet në raste krizash, veprimi i tij ishte i kufizuar në dy aspekte: *së pari*, ai do të vihej në veprim vetëm në raste të ngutshme për të cilat nuk ishte e mundur respektimi i afateve kohore të parashikuara në aktet e tjera ligjore, *së dyti*, kohëzgjatja e veprimit duhet të ishte e kufizuar në kohë³², dhe *së treti*, objekt i veprimitarisë së tij nuk do të ishin veprimet e ndërmarra në kuadër të rregullores “Për ndihmat humanitare”³³, derisa Komisioni të vendoste ndryshe.

Me miratimin e Rregullores Nr. 1717/2006 ky mekanizëm u zëvendësua nga Instrumenti për Stabilitet” (në vijim IpS), i cili kishte në të njëjtën kohë karakter politik dhe financiar. Njëpërmjet këtij instrumenti BE-ja synonte: ***Së pari***, të reagoje në mënyrë të menjëhershme në raste krizash të shkaktuara si pasojë e destabilitetit politik ose nga katastrofat natyrore; ***Së dyti***, krijimin e kushteve për vendosjen e një stabiliteti afatgjatë, duke i kushtuar rëndësi kërcënimeve dhe rreziqeve që janë pengesë për sigurinë politike dhe zhvillimin ekonomik, të tilla si: terrorizmi, krimi i organizuar, trafik i paligjshëm, armët kimike, biologjike dhe bërthamore, por edhe formave të reja të rrezikut si pandemitë, krimi kibernetik dhe ndryshimet klimaterike; dhe ***Së treti***, pjesëmarrjen në menaxhimin e krizave, duke ndihmuar PESHM-në në operacionet e zhvilluara nga ajo me qëllim rivendosjen e stabilitetit pas një situatë konflikti ose krize³⁴.

Hapi i radhës ishte në Konferencën e 20 Nëntorit 2000, në Bruksel, ku u miratua dhe Deklarata për “Angazhim në zhvillimin e aftësive ushtarake”, e cila përcaktonte detyrimet që duhej të përmbushte secili Shtet Anëtar me qëllim arritjen e kapaciteteve ushtarake të vendosura në Këshillin Europian të Helsinkit dhe fushat në të cilat duhet të shtoheshin përpjekjet në funksion të përmirësimit të aseteve ekzistuese dhe rritjen e investimeve në fushën e industrisë së mbrojtjes³⁵. Ndërkohë që kjo deklaratë vendoste objektiva të përgjithshme do të ishte

³¹ <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014).

³² Rregullore e Këshillit (EC) Nr. 381/2001, *Për Krijimin e Mekanizmit të Reagimit të Shpejtë* (26 Shkurt 2001),

<http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014). Kjo rregullore u zëvendësua nga Rregullorja (EC) No 1717/2006 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, *Për Krijimin e Instrumentit për Stabilitet*, <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014).

³³ Rregullore e Këshillit Nr. 1257/96, e ndryshuar (datë 20 Qershor 1996), <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014).

³⁴ <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 24 Shtator 2014).

³⁵ *Military Capabilities Commitment Declaration*,

<http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 10 Prill 2017).

“Planveprimi i Aftësive Europiane, i cili do të parashikonte në mënyrë të detajuar masat konkrete dhe nivelin e investimeve me qëllim përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese dhe zhvillimin gradual të kapaciteteve të reja. Përveç rritjes së numrit të forcave ushtarake, përmirësimin të infrastrukturës dhe logjistikës ushtarake, krijimit të njësisve mbështetëse, rëndësi në këtë drejtim do të kishte dhe rritja e investimeve në industrinë e rëndë (të armatimeve) dhe harmonizimi i legjislacionit në këtë fushë³⁶. Vënia në zbatim e këtij plani do të niste nga Shtetet Anëtare dhe monitorimi i zbatimit të tij do të realizohej nga Mekanizmi për Zhvillimin e Aftësive³⁷.”

Për krijimin e këtij mekanizmi i cili do të monitoronte dhe do të vlerësonte arritjet e bëra në forcimin e kapaciteteve ushtarake, në përputhje me konkluzionet e Presidencës së Nicës dhe që do të kishte për qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së masave të marra për të zhvilluar më tej kapacitetet e BE-së, Shtetet Anëtare ranë dakort në mbledhjen e Këshillit European në Gutenberg, 15 – 16 Qershor 2001. Me qëllim për të mënjeluar çdo mbivendosje të panevojshme, ky mekanizëm do të kishte parasysh proceset e planifikimit të mbrojtjes të NATO-s dhe procesin e planifikimit dhe të rishikimit të Partneritetit për Paqe.

Parimet kryesore mbi të cilat ishte ndërtuar ky planveprimi ishin³⁸:

- a) *Rritja e efikasitetit* - Bashkëpunimi midis Shteteve Anëtare ose midis grupeve të tyre do të ndihmonte në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të tyre në krijimin e kapaciteteve ushtarake.
- b) *Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes në nivel vertikal* - Përmbushja e angazhimeve nga Shtetet Anëtare do të bëhej bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në pajtim me vendimmarrjen kombëtare. Realizimi i aftësive ushtarake do të bëhej nëpërmjet zbatimit të projekteve ekzistuese dhe hartimit të projekteve të reja për plotësimin e boshllëqeve të mbetura.
- c) *Bashkëpunimi midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe NATO-s*. Ky parim synonte shmangien e mbivendosjeve dhe ndërtimin marrëdhënies transparente bashkëpunimi me NATO-n.
- d) *Përkrahja nga një publik i gjerë* - Shtetasit e BE-së kanë të drejtën e informimit në lidhje me veprimet e ndërmarra në kuadër PJSP-s për arritjen e objektivave dhe për rezultatet e arritura. Zbatimi i planit në transparencë të plotë do të ndikonte në efektshmërinë e tij dhe në garantimin e mbështetjes së duhur politike.

Në përfundim mund të themi se, tërësia e mekanizmave të krijuar dhe planet e hartuara kishin si objektiv të vetëm zhvillimin e PJSP-së dhe bërjen operacionale të PESM-së, objektiv ky i cili u konfirmua dhe në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit më 21 Shtator 2001. Megjithë ndryshimet e miratuara hap pas hapi, PESM-ja, ndonëse në mënyrë të kufizuar, mundi të ishte

³⁶ Mbledhja e Këshillit të Punëve të Përgjithshme, *Statemet on Improving European Military Capability* (Bruksel, 19 – 20 Nëntor 2001), <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Shtator 2014).

³⁷ *Statement on improving European Military Capabilities* (Bruksel, 19 – 20 Nëntor 2001), pika 8, <http://consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Shtator 2014).

³⁸ European Commission, *Capability Improvement Conference* (Bruksel, 19 – 20 Nëntor 2001), pika 10 “Principles of the European Capability Action Plan”, <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Shtator 2014).

aktive vetëm në Mbledhjen e Këshillit Europian në Laken, në të cilin Shtetet Anëtare u shprehën se: “...Nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të PESM-së, duke forcuar aftësitë si në fushën ushtarake dhe në atë civile dhe ngritjen e një strukture institucionale të përshtatshme...BE-ja është tani e gatshme të drejtojë disa lloj operacionesh për menaxhimin e krizave. Finalizimi i marrëveshjeve me NATO-n do të forcojnë më tej aftësinë e BE-së të ndërmmarrë operacione në rastet e menaxhimit të krizave në pajtim me “Detyrat e Petersbergut”...Zhvillimi më tej i mjeteve dhe kapaciteteve në dispozicion të BE-së do të ndikojë në shtimin e numrit të operacioneve...”³⁹.

1.3 Mbrojtja si komponent i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Europian sipas Traktatit të Nicës

Traktati i Nicës i cili hyri në fuqi më 01 Shkurt 2003, riafirmoi dhe konsolidoi edhe më tej vendimet e marra dhe të zbatuara më parë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Përsa i përket ndryshimeve që sollli ky traktat në lidhje me PESM-në, ato mund t’i kategorizojmë në këto drejtime kryesore:

Së pari, sipas traktatit të Nicës, PMSP-ja do të ishte pjesë e PJSP-së dhe qëllimi kryesor i saj do të ishte hartimi i një politike të përbashkët mbrojtje, e cila nuk duhej të ishte në kundërshtim me natyrën e veçantë të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë të Shteteve Anëtare dhe duhej të respektonte parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe rolin parësor vendimmarrës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për çështje që kishin të bënin me mbrojtjen kolektive. Neni 11(1) i TBE-së parashikonte se: “... objektivat për ruajtjen e vlerave të përbashkëta, interesat thelbësorë, pavarësinë dhe integritetin e Bashkimit duhet të realizohen në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara...dhe objektivat për ruajtjen e paqes dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare duhet gjithashtu të realizohen në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, parimet e Aktit Final të Helsinkit dhe objektivat e Kartës së Parisit, përfshirë dhe ato për kufinj të jashtëm...”⁴⁰.

Përsa i përkiste angazhimit të saj operacional, përfshirë dhe operacionet për menaxhimin e krizave, BE-ja e cila tashmë kishte zhvilluar kapacitetet e saj ushtarake dhe civile, do të mund të vepronte në mënyrë autonome ose duke përdorur asetet e Aleancës⁴¹, por vetëm atëherë kur

³⁹ Mbledhja e Këshillit Europian, *Presidency Conclusion*, “Annex II” (Laken, 14 -15 Dhjetor 2001), <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Shtator 2014).

⁴⁰ Neni 11(1) i TBE, https://europa.eu/european-union/law/treaties_en (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁴¹ Sipas paragrafit të 1-rë të Deklaratës së Këlnit dhe Raportit të Presidencës për “Forcimin e Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët”, 3-4 Qershor 1999 (Presidency conclusions, Annex III), “...BE-ja duhet të ketë aftësitë e nevojshme për të ndërmarrë veprime të pavarura...”. Ndërsa në paragrafin 4 të Raportit të Presidencës “...BE-ja duhet të përcaktojë, në përputhje me kërkesat e çështjes, nëse do të drejtojë operacionin duke përdorur asetet dhe kapacitetet e NATO-s ose do të udhëheqë operacionin pa iu drejtuar kapaciteteve dhe aseteve të NATO-s...”.

kjo e fundit nuk do të ishte e angazhuar⁴² (misione të cilat kanë ngjallur dyshime për mbivendosje janë AMIS II, EUJUST LEX dhe misioni trajnues i NATO-s në Irak).

Së dyti, Traktati i Nicës shënoi themelimin e tre institucioneve të përhershme ushtarake dhe politike: a.) Komiteti i Politikave dhe i Sigurisë, b.) Komitetit Ushtarak dhe c.) Shtabi Ushtarak.

Së treti, zgjerimin e rasteve të zbatimit të veprimeve ose qëndrimeve të përbashkëta edhe në çështjet që nuk kanë implikime të drejtpërdrejta në fushën ushtarake ose në atë të mbrojtjes, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në kuadër të PJSP-së ndërmjet Shteteve Anëtare⁴³. Forcimi i bashkëpunimit në Shtyllën e Dytë duhet të garantonte ruajtjen e vlerave dhe mbrojtjen e interesave të BE-së, të respektonte parimet dhe udhëzimet e përgjithshme të PJSP-së në veçanti dhe të *acquis communautaire*, në tërësi, dhe të siguronte vazhdimësinë e politikave dhe veprimeve të BE-së në arenën ndërkombëtare. Pra, forcimi i bashkëpunimit duhet të ishte “brenda kufinjve të pushtetit të BE-së” (Neni 43 (d) i Traktatit të BE-së).

Së katërti, parashikimi i formave të reja të bashkëpunimit, duke prezantuar konceptin e “bashkëpunimit të përforcuar” midis Shteteve Anëtare, i cili duhej të plotësonte këto kushte: *i.)* numri minimal i Shteteve Anëtare që do të bashkëpunonin të ishte tetë; *ii.)* nuk përfshinte bashkëpunimin në çështje që kishin të bënin me politikën e BE-së, Shengenin, tregun e përbashkët, mbrojtjen dhe industrinë e rëndë; dhe *iii.)* të përdorej si mundësi e fundit në ato raste kur Këshilli nuk kishte arritur në një vendimarrje dhe kishte arritur në përfundimin se objektivat nuk mund të arriheshin brenda një afati të arsyeshëm (neni 43a i Traktatit të Bashkimit Europian). Arsyeja e vendosjes së kufizimeve të tilla ishte që ky lloj bashkëpunimi të mos shndërrohej në një formë e ndryshimeve *de facto* të Traktatit.

Por si do të realizohej ky bashkëpunim? Mundet që instrumentat juridikë të përdorura nga PJSP-ja si udhëzimet e përgjithshme, strategjitë e përbashkëta, veprimet e përbashkëta, qëndrimet e përbashkëta, vendimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të përdoren dhe nga Shtetet Anëtare në rast të bashkëpunimit të përforcuar? Nëpërmjet adoptimit të një rregullore ose direktive sipas modelit të BE-së, por që bie jashtë kufinjve të pushtetit të saj?

Në përgjigje të pyetjeve të ngritura mund të themi se, neni 43 i Traktatit të Bashkimit Europian (në vijim TBE), lejon përdorimin e institucioneve, procedurave, instrumentave dhe mekanizmave të parashikuara në të edhe në rastet e bashkëpunimit të përforcuar në kuadër të PJSP-së. Në dallim nga të gjitha instrumentat dhe mekanizmat e parashikuara nga Traktati, një problematikë të veçantë paraqesin marrëveshjet ndërkombëtare pasi në kushtet kur sipas nenit 24 të TBE-së ato nënshkruhen në emër të BE-së dhe janë të detyrueshme për të gjitha institucionet e saj, moszbatimi i tyre mund të krijojë probleme me përgjegjësinë ndërkombëtare të BE-së. Për të

⁴² Këshilli Europian, *Presidency Report* (Këln, 3-4 Qershor 1999), par. 3 “... në lidhje me aftësitë ushtarake, Shtetet Anëtare duhet të rrisin më tej numrin e forcave (përfshirë dhe zyrat qendrore) të cilat janë të përshtatshme për operacionet e menaxhimit të krizave, duke mënjanuar çdo mbivendosje...”; Këshilli Europian, *Presidency Conclusions*, (Helsinki, 10-11 Dhjetor 1999), pg. 27: “...ky proces synon mënjanimin e çdo mbivendosjeje dhe nuk nënkupton krijimin e një ushtrie Europiane...”.

⁴³ A. Missiroli, “CFSP, Defence and Flexibility”, *Chaillot Paper No. 38*, February 2000, fq. 5-15, <http://www.iss-eu.org/chaillot/chaill38e.pdf> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

shmangur këtë përplasje, duket se vetë Traktati i ka dhënë një zgjidhje duke parashikuar se çdo marrëveshje duhet të arrihet në zbatim të veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta, për të cilat BE-ja ka rënë dakort dhe të nënshkruara nga të gjithë Shtetet Anëtare⁴⁴.

Në lidhje me fushën e veprimit të masave të miratuara në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar dhe të natyrës juridike të tyre, mund të themi se ato do të jenë të detyrueshme vetëm për Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, ku ato jo pjesëmarrëse nuk do të mund të pengojnë zbatimin e tyre. Pavarësisht formës së instrumentit me të cilën ishin miratuar, ato nuk cilësohen si pjesë e *acquis communautaire*, në kuptim të nenit 44 (1) të TBE-së.

Përsa i përket procedurën që duhet të ndiqej nga Shtetet Anëtare për realizimin e një bashkëpunimi të tillë, Traktatit parashikonte që fillimisht ato duhej t'i drejtonin një kërkesë Këshillit, i cili më pas duhej të miratonte me shumicë të cilësuar opinionin e dhënë nga Komisioni, ku ky i fundit më parë duhet të kishte informuar Parlamentin. Opinioni i dhënë nga Komisioni do të vlerësonte nëse ky bashkëpunim ishte apo jo në pajtim me politikën e BE-së. Megjithatë, bazuar në nenin 27 (c) Shtetet Anëtare gëzonin të drejtën që t'i kërkonin Këshillit European që votimi të bëhej me unanimitet, duke ruajtur në këtë mënyrë dhe të drejtën e vetos⁴⁵.

Nga njëra anë, mendoj se një parashikim i tillë ishte i domosdoshëm për t'i dhënë më tepër fleksibilitet BE-së dhe ndikonte në forcimin e integritit të Shteteve Anëtare, në situatën kur BE-ja në atë periudhë po bëhej shumë heterogjene, por nga ana tjetër shkaktonte një largim nga ideja e BE-së si një bashkim i të barabartëve dhe krijonte një ndarje ndërmjet Shteteve Anëtare, në të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme.

Së pesti, zgjerimi i rasteve të votimit me shumicë të cilësuar ndaj atij në mënyrë unanime, i cili ndikoi në forcimin e pozitave të BE-së, në bërjen e çdo vendimmarje politike më eficiente, dinamike dhe pakësimin e sovranitetin kombëtar të Shteteve Anëtare.

Së gjashti, rritja e kapaciteve dhe aftësive të BE-së dhe zgjerimi i kufinjve gjeografikë të mobilizimit të forcave të saj. Pas përpilimit të “Katalogut të Forcave” më 2002, i cili përcaktonte forcat detare, ajrore dhe tokësore që do të ishin në dispozicion të BE-së në vitet në vazhdim, me qëllim zbatimin e objektivave të parashikuara në Traktat u mbajt Konferenca për Zhvillimit e Aftësive. Fokusi i kësaj konference ishte përcaktimi i fushave në të cilat Shtetet Anëtare duhej të rrisnin më tej kapacitetet dhe asetet e tyre ose të përmirësonin ato ekzistueset, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë çështjeve që kishin të bënin me planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e operacioneve, transportin strategjik dhe shërbimet e inteligjencës. Në lidhje me kufinj të gjeografikë brenda së cilëve mund të mobilizoheshin forcat e BE-së nuk u vendosën limite, duke prezumuar se të paktën në teori ato mund të mobilizoheshin kudo⁴⁶.

⁴⁴ T. Jaeger, “Enhanced Cooperation in the Treaty of Nice and Flexibility in the Common Foreign and Security Policy”, *European Foreign Affairs Review* 297, 2002.

⁴⁵ <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

⁴⁶ Military Capabilities Commitment Declaration,

<http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014). Në Konferencë ministri francez i mbrojtjes u shpreh se “...meqënëse ne do të jemi të angazhuar të veprojmë shumë larg nga territoret tona, shpesh në një mjedis mjaft të rrezikshëm, si në mbrojtje të interesave tonë të sigurisë edhe në mbështetje të vendimeve të OKB-së...”, *Atlantic News*, 22 November 2000.

Së shtati, krijimi i një mekanizmi, i cili do të vlerësonte shkallën e arritjes së objektivave të vendosura nga BE-ja në lidhje me kapacitetet ushtarake. Një mekanizëm i tillë kishte si qëllim: a). monitorimin e progresit, cilësor dhe sasior, të bërë nga Shtetet Anëtare; b). vlerësimin, nëse është e domosdoshme dhe rishikimin e objektivave pasi rrethanat mund të kenë ndryshuar nga momenti i fillimit, me qëllim përmbushjen e “Detyrave të Petërsbergut”; c). të ndihmonte në vendosjen e një balance ndërmjet angazhimeve në kuadër të BE-së dhe të përmbushjes së objektivave në kuadër të NATO-s ose të Partneritetit për Paqe. Ky mekanizëm vlerësimi çdo gjatë muaj do të raportonte në Këshillin Europian, në lidhje me progresin e bërë në arritjen e objektivave të vendosura⁴⁷.

Së teti, rritja e kapaciteteve civile të menaxhimit të krizave, duke i dhënë prioritet policisë, mbrojtjes civile, forcimit të shtetit të së drejtës dhe të administratës civile. Për të ndihmuar në arritjen e objektivave në këto fusha nga ana e KACMK-ja u krijua një metodologji, e cila përbëhej nga katër hapa kryesorë:

- *Përgatitja e planeve të përgjithshme dhe identifikimi i rezultateve të misioneve.*
- *Përcaktimi i kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e misioneve të përcaktuara.*
- *Thirrje për kontribut nga Shtetet Anëtare dhe identifikimi i kapaciteteve të ofruara nga secili prej tyre.*
- *Përcaktimi i masave që duheshin marrë për të siguruar përmbushjen e objektivave konkrete⁴⁸.*

Së nënti, ndryshimi i mënyrës së financimit të operacioneve ushtarake. Neni 28 të TBE-së parashikonte se shpenzimet nuk do të mbulohehin nga buxheti i BE-së, por nga Shtetet Anëtare. Në lidhje me këtë çështje, Shtetet Anëtare arritën një marrëveshje që kostot e përbashkëta do të mbulohehin nga një mekanizëm i posaçëm, Athena, i cili parashikonte dhe mundësinë e përfshirjes në të dhe të shteteve të treta që do të merrnin pjesë në operacionet të drejtuara nga BE-ja, ndërsa të tjerat “do të lireshin aty ku ishin” dhe do të mbulohehin nga ato Shtete Anëtare që i kishin bërë⁴⁹. Gjithashtu mund të themi se, me futjen e “Instrumentit për Stabilitet”, BE-ja rihoroi mekanizmin e financimit të operacioneve.

Traktati i Nicës dhe ndryshimet që ai solli do të hynin në fuqi vetëm nëse do të ratifikoheshin nga të gjithë Shtetet Anëtare. Traktati u ratifikua nga parlamentet e të gjitha Shteteve Anëtare, me përjashtim të Irlandës ku qeveria vendosi se ishte e nevojshme bërja e ndryshimeve kushtetuese. Disa vite më parë Gjykata Supreme në Irlandë, në çështjen *Crotty v. An Taoiseach*, u shpreh se: “...është e nevojshme bërja e amendamenteve në qëllimet dhe objektivat e rëndësishëm të Komuniteteve Europinë, por pa e përcaktuar se si...”⁵⁰.

⁴⁷ <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

⁴⁸ Presidency Conclusions – “Presidency Report on the European Security and Defence Policy”, 4 Dhjetor 2000, fq. 1. <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

⁴⁹ Council Decision (2004/197/CFSP), “Establishing a mechanism to administer the financing of the common costs of European Union operations having military or defence implications”, 23 Shkurt 2004, i ndryshuar.

⁵⁰ <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 28 Prill 2018).

Në referendumin e zhvilluar në Qershor të 2001 qytetarët votuan kundër duke refuzuar hyrjen në fuqi të Traktatit të Nicës. Arsyet e votimit kundra ishin disa por si më kryesorja ishte ndikimi që do të kishin dispozitat e reja të Traktatit në neutralitetin e Irlandës, pasi Traktati i Nicës forconte më tej pozitën e BE-së ndaj Shteteve Anëtare duke rritur fushat të cilat kishin karakter mbikombëtar.

Ndodhur para kësaj situatë në Mbledhjen e Këshillit Europian në Sevilje, më 21 – 22 Qershor 2001, ndër dokumentet që iu bashkangjiten Konkluzioneve të Presidencës ishte edhe Deklarata Kombëtare e Irlandës dhe Deklarata e Këshillit Europian. Në Deklaratën Kombëtare Irlanda bëri të qartë qëndrimin e saj se pjesëmarrja në politikën e përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së nuk do të paragjykonte politikën e saj të neutralitetit në fushën ushtarake. Në pajtim me këtë politikë Irlanda nuk është e detyruar nga asnjë angazhim në mbrojtjen e përbashkët.

Gjithashtu nuk është në angazhimet e Irlandës të marrë pjesë në asnjë plan për krijimin e një ushtrie europine. Çdo vendim i BE-së për krijimin e një mbrojtjeje të përbashkët ose çdo vendim tjetër ose traktat që e largon Irlandën nga politika e saj neutrale do të votohet në referendum. Pjesëmarrja e forcave të ushtrisë irlandeze në operacionet përtej detit, përfshirë dhe ato të ndërmarra në kuadër të PESM-së, kërkonte autorizimin për operacionin nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Këto ndryshime të rëndësishme të propozuara nga Irlanda, të miratuara nga Këshilli Europian në Deklaratën e tij, ishin vendimtare për suksesin e referendunit të dytë të mbajtur në Nëntor të vitit 2002.

a. Bashkëpunimi BE – NATO në kuadër të Traktatit të Nicës

Pavarësisht përpjekjeve, arritja e një marrëveshjeje që nga njëra anë të kënaqte interesat e shteteve europiane anëtare të NATO-s, jo anëtare të BE-së, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të tyre në operacionet të drejtuara nga BE-ja dhe nga ana të tjetër të garantonte të drejtën e aksesit të BE-së në kapacitetet dhe asetet e Aleancës duke mos cënuar parimin e autonomisë në vendimmarrje të BE-së, sidomos të drejtën e Këshillit për të diskutuar dhe për të vendosur për politikën që duhej të ndiqej, paraqitej e vështirë.

Pas negociimesh të shumta, finalizimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis BE-së dhe NATO-s, krijimi i strukturave të përshtatshme politike dhe ushtarake dhe miratimi i procedurave që do të zbatoheshin në operacionet për menaxhimin e krizave u bë e mundur vetëm në vitin 2003. Në mbledhjen e mbajtur më 19 – 20 Maj 2003 në Bruksel, Këshilli i Ministrave mirëpriti implementimin e marrëveshjeve të përhershme midis BE-së dhe NATO-s, të cilat do të ndikonin në rritjen e aftësive operacionale të BE-së dhe të efektivitetit të ndërhyrjeve të NATO-s dhe BE-së në rastet e menaxhimit të krizave, duke krijuar në këtë mënyrë një bazë të qëndrueshme për bashkëpunim. Po në këtë mbledhje Shtetet Anëtare u shprehën se tashmë PESM-ja ishte plotësisht operacionale dhe se, pavarësisht disa mangësive që kishin të bënin me kohën e

mobilizimit të forcave, ajo zotëronte aftësitë e përshtatshme operative për të gjithë gamën e “Detyrave Petersbergut”⁵¹.

Efektet e këtyre marrëveshjeve filluan të ndiheshin shpejt dhe në vitin 2003 BE-ja ndërmori operacionet e saj të para civile dhe ushtarake, ku mund të përmendim operacionin Concordia në Maqedoni, Artemis në Republikën Demokratike të Kongos (në vijim RDK), SFOR në Bosnje dhe Hercegovinë, KFOR në Kosovë dhe operacioni ushtarak në Irak, në të cilin Shtetet Anëtare mobilizuan më shumë forca ushtarake se SHBA-ja në operacione të tjera. Megjithë ndikimin pozitiv që patën për forcimin e pozitës së BE-së si një aktor global për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë, këto operacione nxorën në pah disa karakteristika:

- *Intensiteti i ulët* - Pjesa më e madhe e operacioneve ishin kryesisht të natyrës paqeruajtëse dhe kishin të bënin me menaxhimin e situatës së pas luftës nëpërmjet projekteve për rindërtimin e vendit. Përjashtim mund të bëjë operacioni Artemis në RDK, i cili u shoqërua dhe me ndërhyrje ushtarake të forcave të BE-së, por kjo në funksion të një misioni paqeruajtës.
- *Mangësi në logjistikë* – Pjesa më e madhe e forcës ushtarake përbehej nga ajo tokësore, ndërsa ndërhyrja nga deti dhe ajri ishte e kufizuar.
- *Mungesa e një komande të unifikuar* - Forcat ushtarake të BE-së përbëheshin prej forcave të vëna në dispozicion nga Shtetet Anëtare, të cilat pavarësisht se shërbenin nën flamurin dhe logon e BE-së ishin nën komandën e shtetit të cilit i përkisnin.

b. Miratimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë

Gjatë viteve ‘90, problemi kryesor me të cilën përballëj BE-së ishte mungesa e koherencës dhe e qëndrueshmërisë së politikës së saj të jashtme, e cila vinte si pasojë e mungesës së një strategjie të qartë dhe të mirëpërcaktuar. Në vitin 1992 Traktati i Mastroitit, neni J8, afirmoi të drejtën e Këshillit Europian për të përcaktuar parimet dhe udhëzimet e përgjithshme për një politikë të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, ku termi “strategjik” përdorej shpesh gjatë diskutimeve. Në vitet në vazhdim Këshilli miratoi një sërë dokumentash ku në titullin e tyre kishte termin “strategjik” si: ai për anëtarësimin e vendeve të Europës Lindore dhe Qëndrore (Mbledhja e Këshillit Europian në Esen, 9 – 10 Dhjetor 1994), për marrëdhëniet BE – Rusi (Mbledhja e Këshillit Europian në Madrid, 15 – 16 Dhjetor 1995) dhe për detin Baltik (Mbledhja e Këshillit Europian në Firence, 21 – 22 Qershor 1996) dhe Pakti i Stabilitetit për Europën Qëndrore dhe Lindore, i miratuar në Maj 1994 Paris, i cili edhe pse nuk kishte në titull termin “strategji” në të vërtetë nga ana e përmbajtjes dhe e qëllimit ishte i tillë.

Traktati i Amsterdimit, neni J 3.2 (neni 13 i Traktatit të Konsoliduar), futi nocionin “strategji të përbashkëta”, si instrument i PJSP-së, përveç atyre që tashmë ishin si “veprime të përbashkëta” dhe “qëndrime të përbashkëta”⁵².

⁵¹ Mbledhja e Këshillit të Punëve të Përgjithshme 19 – 20 Maj 2003, Bruksel, “European Union Defence Policy”, Conclusions, pika 5 dhe 11, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Tetor 2014).

⁵² <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Në mbledhjen e Këshillit Europian në Helsinki, BE-ja filloi të ndërtonte kapacitetet e saj ushtarake dhe civile për menaxhimin e krizave, por pa përcaktuar më parë një strategji të qartë për veprimet e saj në arenën ndërkombëtare.

Neni 11 i TBE-së parashikonte objektivat e PJSP-së, të cilat më tepër se objektiva mund të konsideroheshin si parime të përgjithshme dhe që ishin tepër të përgjithshme për të shërbyer si bazë për vendimmarrjet e përditshme. Në lidhje me instrumentat që do të përdreshin TBE-ja parashikonte natyrën e operacioneve që BE-ja mund të ndërmerre, si misionet e shpëtimit dhe ato humanitare, misionet paqeruajtëse, ndërhyrjet ushtarake në raste të menaxhimit të krizave dhe misionet paqebërëse, por ai nuk parashikonte udhëzime në lidhje me rrethanat kur do të ishte e mundur përdorimi i instrumenteve të tillë⁵³.

Mungesa e një strategjie të përbashkët nuk do të ishte problem nëse të gjithë aktorët pjesëmarrës në politikëbërje do të ndanin të njëjtat ide. Por situata ndryshon kur bëhet fjalë për politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, ku pa një strategji të qartë ajo nuk do të ishte në gjendje të promovonte prioritetet e politikës së saj, përse i përket objektivave edhe instrumentave, dhe të luante një rol aktiv në arenën ndërkombëtare. Miratimi i një strategjie për BE-në do të sillte këto pasoja të rëndësishme: *së pari*, do të siguronte një kornizë të qartë për vendimmarrjen, duke vështirësuar ndërmarrjen e veprimeve të njëanshme nga Shtetet Anëtare, *së dyti*, do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe të legjitimitetit të veprimeve të BE-së në situata konflikti; dhe *së treti*, do të ndikonte në ndërtimin e një BE-je më aktive, më koherente dhe më të aftë për të garantuar një botë më të sigurtë dhe më të bashkuar.

Domosdoshmëria për hartimin e një strategjie europiane të sigurisë u bë më e qartë në rastin e krizës në Irak, ku mungesa e arritjes së një konsensusi, nxorri në pah pamundësinë e BE-së për të reaguuar, megjithëse dispononte të gjitha mjetet dhe instrumentat e duhura. Ndonëse menjëherë pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit, Shtetet Anëtare mbajtën qëndrimin për rëndësinë e zhvillimit të një dialogu politik me shtetet dhe rajonet e botës të prekura nga aktet terroriste, me qëllim integrimin e tyre në një sistem ndërkombëtar sigurie, realiteti ishte krejt ndryshe dhe vendimmarrja e BE-së karakterizohej nga mungesa e konsensusit. Deklarata e Uashingtonit në luftën ndaj terrorizmit dhe pushtimi i Irakut nga SHBA-ja, nxorri në pah përçarjen midis Shteteve Anëtare, ku disa iu bashkuan koalicionit për pushtimin e Irakut, të udhëhequr nga Britania e Madhe, Spanja dhe Polonia, dhe të tjerat që iu kundërvunë përdorimit të forcës në mungesë të një mandati të mjaftueshëm nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe mosezaurimit më parë të të gjitha mundësive, të udhëhequra nga Belgjika, Franca dhe Gjermania.

Miratimi i një Strategjie Europiane të Sigurisë (në vijim SES) u bë e mundur në mbledhjen e Këshillit Europian në Dhjetor të 2003 dhe u quajt “Një Europë e Sigurtë në një Botë më të Mirë”. Ky dokument, në të cilin për herë të parë, përcaktoheshin parimet dhe vendoseshin objektiva të qarta që do avanconin më tej interesat e BE-së në fushën e sigurisë në pajtim me vlerat e saj, shënoi dhe plotësimin e kuadrit strategjik të operacioneve që do të ndërmerre BE-ja.

⁵³ <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Në lidhje me natyrën e kësaj strategjie mund të themi se, ajo kishte një natyrë gjithëpërfshirëse të sigurisë, e cila nuk përbëhej vetëm nga komponenti ushtarak por edhe nga ai politik, social-ekonomik, ekologjik, kulturor dhe energjistik, duke iu përshtatur sfidave dhe rreziqeve të reja me të cilat përballëj siguria europiane si terrorizmi, pasurimi armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, krimi i organizuar dhe mosfunksionimi i shtetit të së drejtës dhe demokracisë, të cilat në dallim nga rreziqet e pas Luftës së Dytë Botërore, nuk kërkonin thjesht një ndërhyrje ushtarake⁵⁴.

SES-ja i kushton rëndësi edhe bashkëpunimit parandalues me qëllim shmangien e krizave dhe të konflikteve të reja, duke pasur parasysh forcimin e sigurisë rreth BE-së (Ballkan, Mesdhe dhe në Kaukazin Jugor), ku si objektiva kryesorë të politikës së fqinjësisë ajo parashikonte: 1.) parandalimin e konflikteve në rrethinat e BE-së dhe i akteve të agresionit ndaj tij; 2.) zgjidhjen e konflikteve dhe çështjeve që janë në vazhdim; 3.) vendosjen e një bashkëpunimi politik dhe ekonomik bazuar në vlerat e përbashkëta, prosperitet dhe siguri; 4.) kontrollin e emigracionit dhe trafikut të jashtëligjshëm në drejtim të BE-së; dhe 5.) Mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve të BE-së. të cilët jetojnë jashtë⁵⁵

Më gjithë ndikimin pozitiv që ka patur SES-ja për politikën e jashtme të sigurisë të BE-së, në krahasim me dokumente të tjerë të ngjashëm si Strategjia Kombëtare e Sigurisë e SHBA-së (në vijim SKS), ajo kishte edhe disa mangësi si⁵⁶:

- **Së pari**, SES-ja ishte më e shkurtër, më analitike dhe shumë e përgjithshme, ku pjesën më të madhe të dokumentit e zinte pjesa hyrëse dhe trajtimi teorik i natyrës së rreziqeve me të cilat do të përballëj në të ardhmen siguria europiane, duke mos i analizuar ato. Ky fakt tregon shqetësimin e madh që kishte BE-ja për të justifikuar veprimet e saj ndaj provokimeve të jashtme.
- **Së dyti**, përshkrimi i politikave në SES-së kishte karakter të përgjithshëm dhe mungonin udhëzimet konkrete për zbatimin e tyre.
- **Së treti**, SES-ja nuk ishte pajisur me instrumentat e duhura ligjore për të krijuar fuqi detyruese tek Shtetet Anëtare.
- **Së katërti**, gjuha e përdorur në SES-në, në dallim nga SKS-së në të cilën përcaktoheshin qartë rreziqet që i kanosen interesave kombëtare, duke i cilësuar ato si “armiç”, ishte më diplomatike.
- **Së pesti**, SES-ja minimizon rolin e BE-së si një aktor kyç në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë, duke ia atribuar këtë pozicion NATO-s.
- **Së gjashti**, sipas SES-së mbrojtja më e mirë për të ruajtur sigurinë dhe forcimin e rendit botëror do të ishte ndërtimi i shteteve demokratike, nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, mbështetjes së reformave politike dhe sociale, lufta kundër korrupsionit dhe

⁵⁴ <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁵⁵ Commission of the European Communities, *Wider Europe — Neighbourhood: A New Framework for Relations with our Eastern and Southern Neighbours* (Bruksel, 11 Mars 2003), <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 02 Prill 2017).

⁵⁶ *The National Security Strategy of USA* (Shtator 2002), <http://www.state.gov/> (hyrë për herë të fundit më 02 Prill 2017).

garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndërsa ndërhyrja ushtarake do të ruhej si mundësia e fundit në rast se tërësia e masave civile nuk do të ishin të mjaftueshme. Për këtë shkak ajo nuk parashikonte kushtet kur BE-ja mund të ndërhyjë ushtarakisht, por mjaftohej vetëm me faktin se ndërhyrja ushtarake duhet të realizohet vetëm pas një analize të tërësisë së rrethanave dhe bazuar në dispozitat ligjore.

Si përfundim mund të themi se, SES-ja është i pari dokument strategjik i cili mbulonte të gjithë politikën e jashtme të BE-së, që nga tregëtia dhe ndihmat shtetërore deri tek diplomacia dhe ndërhyrjet ushtarake. Miratimi i SES-së ishte një arritje për PJSP-në, pasi përcaktoi një axhendë të përbashkët për të gjitha Shtetet Anëtare përsa i përket veprimeve të jashtme dhe unifikoi qëndrimet edhe vetë brenda BE-së. SES-ja do të shërbejë si një instrument i fuqishëm për forcimin e pozitës së BE-së, duke i krijuar mundësi për vënien në zbatim të të gjithë kapaciteteve dhe instrumentave të saj, si në nivel global dhe në atë rajonal. Është e rëndësishme që të kemi parashysh që SES-ja nuk përfshin vetëm sigurinë ushtarake, në kuptimin e ngushtë, por ajo mbulon të gjitha dimensionet e veprimeve të jashtme të BE-së. Nëse traktatet e BE-së mund të cilësohen si *finalité intérieure*, atëherë parashikimet e SES-së janë *finalité extérieure*, të cilat nuk ka të bëjnë vetëm me çështje të sigurisë por edhe me çështje që lidhen me identitetin, vlerat dhe filozofinë politike të BE-së⁵⁷.

c. Themelimi i Agjencisë Europiane të Mbrojtjes

BE-ja dhe NATO ndajnë interesa strategjike dhe vlera të përbashkëta në fushën e mbrojtjes kolektive. Ato bashkëpunojnë së bashku në çështje të interesit të përbashkët si në operacionet për menaxhimin e krizave, në zhvillimin e kapaciteteve, në luftën kundër krimin kompjuterik, në zhvillimin e dialogut politik për parandalimin e rreziqeve që mund t'i kanosen paqes dhe sigurisë, në krijimin e strukturave të nevojshme për realizimin e misioneve dhe operacioneve të përbashkëta dhe në ruajtjen e sigurisë në det.

Një nga fushat më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi është edhe forcimi i kapaciteteve dhe i aseteve në dispozicion të BE-së, ku megjithë instrumentat dhe mekanizmat e krijuara, rëndësi të veçantë ka grupi i përbashkët i punës BE-NATO i krijuar në Maj të 2003 me qëllim harmonizimin dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve, ka akoma vend për përmirësim. Ndonëse në pjesën më të madhe objektivat e vendosura nga BE-ja për forcimin e kapaciteteve dhe aseteve të saj civile dhe ushtarake janë arritur, përveç rritjes së numrit të forcave ushtarake dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe logjistikës ushtarake, duke krijuar njësi mbështetëse, mësimet e nxjerra nga misionet e deritanishme kanë nxjerrë në pah dhe rëndësinë që ka rritja e investimeve në industrinë e rëndë (të armatimeve) dhe harmonizimi i legjislacionit të Shteteve Anëtare në fushën e mbrojtjes.

Më 12 Korrik 2004, u krijua Agjencia Europiane e Mbrojtjes (në vijim AEM), si një agjenci autonome e cila gëzonte personalitet juridik nën supervizionin e Këshillit dhe vepronte në përputhje me orientimet e dhëna nga ai. Njëpërmjet krijimit të kësaj agjencie Bashkimi synonte të nxiste qeveritë e Shteteve Anëtare të rrisnin investimet për të përmbushur sfidat e së ardhmes

⁵⁷ S. Biscop, *The ABC of European Union Strategy: Ambition, Benchmark, Culture*, "Egmont Paper" 16 (Tetor 2007), fq.9, <http://www.ies.be/> (hyrë për herë të fundit më 12 Prill 2017).

dhe t'i ndihmonte ato në përcaktimin e nevojave të përbashkëta me qëllim gjetjen dhe të zgjidhjeve të përbashkëta⁵⁸.

Në aktin e themelimit të AEM-së parashikohej se ajo do të vepronte në katër fusha kryesore: (a). Zhvillimin e aftësive mbrojtëse për menaxhimin e krizave; (b). Nxitjen e bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare në fushën e armatimeve, me qëllim forcimin e kapaciteteve ushtarake dhe ristrukturimin e industrisë europiane të mbrojtjes; (c). Krijimin e një mbrojtje europiane nëpërmjet ndërtimit të një tregu të përbashkët për pajisjet ushtarake dhe të mbrojtjes bazuar në konkurrencën e lirë; dhe (d). Promovimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e teknologjisë në fushën e mbrojtjes⁵⁹.

Për plotësimin e objektivave të saj, AEM-ja ndihmohej nga një strukturë e qartë institucionale, e përbërë nga pesë drejtori dhe dy njësi speciale të cilat ishin⁶⁰: i.) Drejtoria e Aftësive, ii.) Drejtoria e Kërkimit dhe e Teknologjisë, iii.) Drejtoria e Armatimeve, iv.) Drejtoria e Industrisë dhe e Tregut, v.) Drejtoria e Shërbimeve, vi.) Njësia e Planifikimit dhe e Politikave dhe vii.) Njësia e Medias dhe e Komunikacionit.

Megjithëse krijimi i AEM-së do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive mbrojtëse të PESM-së dhe në rritjen e kapaciteteve të BE-së për drejtimin e operacioneve ushtarake, dispozitat aktuale të TBE-së, të cilat nuk e parashikojnë atë si pjesë të PJSP-së, krijonin disa vështirësi në funksionimin e saj. Konkretisht, në këtë punim do të trajtohen efektet që sjell neni 296 i Traktatit Themelues të Komunitetit European dhe natyra kombëtare e çështjeve që kishin të bënin me mbrojtjen, në bashkëpunimin e Bashkimit me Aleancën.

- *Neni 296 i Traktatit Themelues të Komunitetit European*

Neni 296 (ish-neni 223) i Traktatit Themelues të Komunitetit European e konsideronte politikën e armatimeve si çështje të Shteteve Anëtare dhe jo një kompetencë komunitare, duke i legjitimuar ato të ruanin kontrollin e tyre kombëtar në fushën e armatimeve. Ai i njëjti të drejtën çdo Shteti Anëtar që për arsye të rëndësishme të sigurisë kombëtare të mund të mënjanohej nga zbatimi i politikave të përbashkëta komunitare. Kjo dispozitë e linte bashkëpunimin në fushën e armatimeve jashtë procesit të integritit european. Por megjithëatë, ky traktat e linte të hapur mundësinë që në raste urgjente Shtetet Anëtare të mund të bashkëpunonin për krijimin e një politike të përbashkët mbrojtje në fushën e armatimeve, në mënyrën që ato do e çmonin të përshtatshme (neni 17(1)). Konkretisht ky nen parashikonte se: “...1. *Dispozitat e këtij Traktati përjashtojnë zbatimin e rregullave të mëposhtme: a) asnjë Shtet Anëtar nuk do të jetë i detyruar të japë informacion zbulimi i të cilit është në kundërshtim me interesat thelbësore të sigurisë së tij; b) çdo Shtet Anëtar mund të marrë masa që ai i konsideron të domosdoshme për mbrojtjen e interesave thelbësore të sigurisë së tij, në lidhje me prodhimin dhe/ose tregëtinë e armëve,*

⁵⁸ Këshilli European, *Council Joint Action 2004/551/CFSP* (12 Korrik 2004), <https://www.eda.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2017); <http://www.eda.europa.eu/Aboutus> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2017).

⁵⁹ Këshilli European, *Council Joint Action 2004/551/CFSP* (12 Korrik 2004), <https://www.eda.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2017).

⁶⁰ Po aty.

municioneve dhe materialeve të luftës, masa të tilla nuk duhet të ndikojnë negativisht konkurrencën në tregun e përbashët për produkte të cilat nuk janë të destinuara posaçërisht për qëllime ushtarake. 2. Këshilli unanimisht dhe bazuar në propozimin e Komisionit mund të bëjë ndryshime në listën, të cilën e përpiloi në Prill të 1958, për produktet për të cilat zbatohen dispozitat e paragrafit të 1 b)...”⁶¹.

Në funksion të kufizimit të zbatimit të nenit 296 janë ndërmarrë disa iniciatiava nga ana e BE-së si:

- Vendosja e një regjimi, më 1 Korrik 2006, me qëllim për të rritur transparencën dhe konkurrencën në tregun evropian të pajisjeve të mbrojtjes, fushë e cila mbulohej nga neni 296. Ky regjim kishte karakter ndër qeveritar, menaxhohej nga AEM-ja dhe rregullohej nga dy akte, Kodi i Sjelljes për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes, i miratuar nga Ministrat e Mbrojtjes në Nëntor 2005, dhe Kodi i Praktikave të Mira për Furnizimet Zinxhir, i miratuar në Maj 2006⁶².
- Botimi nga Komisioni Evropian i Letrës së Gjellbër mbi Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes më 23 Shtator 2004, në vazhdim të iniciativave të mëparshme si Komunikata për Çështjet e Industrisë dhe të Tregut Evropian të Mbrojtjes – “Drejt një Politike të BE-së për Pajisjet e Mbrojtjes”⁶³.
- Miratimi në vitin 2006 nga Komisioni Evropian i Komunikatës Interpretuese “Për zbatimin e nenit 296 të Traktatit në fushën e prokurimeve”⁶⁴.
- Propozimi i Komisionit Evropian, në Dhjetor të 2007, për miratimin e një direktive “Mbi transfertat brenda BE-së të produkteve të mbrojtjes” dhe të një tjetre për “Prokurimet në fushën e mbrojtjes”⁶⁵.

Pavarësisht ndryshimeve që solli Traktati i Nicës në shtyllën e dytë, mbrojtja vazhdoi të mbetej një çështje kombëtare ku rolin kryesor në fushën e armatimeve e luanin Shtetet Anëtare, pasi ato ishin blerësit dhe investitorët më të mëdhenj të pajisjeve ushtarake. Në situatën kur janë qeveritë e Shteteve Anëtare që kushtëzojnë politikëbërjen dhe reformat në industrinë e armatimeve, sukcesi i AEM-së varet nga vullneti politik i tyre. Tregues i mungesës së vullnetit të Shteteve Anëtare për të përmirësuar aftësitë ushtarake ishite: *së pari*, ulja e shpenzimeve të parashikuara në buxhet për mbrojtjen, dhe *së dyti*, shkalla e ulët e investimeve për kërkim dhe zhvillim⁶⁶.

⁶¹ https://europa.eu/european-union/law/treaties_en (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁶² <http://www.eda.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2017).

⁶³ COM (2003) 113 final (11 March 2003), <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2016).

⁶⁴ Po aty, pg. 9.

⁶⁵ <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 09 Mars 2016).

⁶⁶ Fu-chang Chang, *EU as Military Actor—The Role of the European Defence Agency*, “European Foreign affairs Review”, Volumi 16, (Kluwer Law International, 2011).

1.4 Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes në Projekt Kushtetutën e Bashkimit European

Në vijim të idesë së krijimit të një Federate Europiane, presidenti Zhak Shirak, i mbështetur nga Gjermania, në Samitin e Nicës insistoi që pasardhësi i tij Giscard d'Estaing të ngarkohej me detyrën e presidentit që do të udhëhiqte punën për hartimin e projekt kushtetutës Europiane. Ky projekt fillimisht hasi me refuzimin e menjëhershëm të Spanjës dhe Polonisë, sidomos në lidhje me ndryshimin e sistemit të miratimit të ligjeve në bazë të numrit të popullsisë, pasi në këtë mënyrë do të pakësohej “vlera” e votës së tyre. Sulmet terroriste të 2004 në Madrid ndikuan në ndryshimin e qëndrimit të Spanjës. Ndërsa Polonia e mbetur e vetme u detyrua “të bindej”. Një kushtetutë për Bashkimin do t’a bënte atë më efektiv, më transparent, më demokratik dhe do t’i shërbente forcimit të bashkëpunimit ndërmjet e Shteteve Anëtare. Ajo, e cila do të zëvendësonte traktatet ekzistues, nga njëra anë duhej të përcaktonte qartë vlerat, objektivat themelore, fushat e veprimit të BE-së dhe kompetencat e secilit prej institucioneve dhe nga ana tjetër të vendoste kufinj të përtej të cilëve Bashkimi nuk mund të vepronte.

Hapi i parë në këtë drejtim u hodh në Këshillin European të Laeken 14 – 15 Dhjetor 2001, në të cilin u vendos organizimi i Konventës që do të bashkonte sëbashku të gjithë faktorët kryesorë të interesuar për të ardhmen e BE-së. Qëllimi i kësaj Konvente ishte përgatitja për mbledhjen e ardhshme ndërqeveritare, të cilës do t’i adresoheshin këto çështje kryesore në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të BE-së: *së pari*, ndarje më të mirë të kompetencave; *së dyti*, rritja e demokracisë, transparencës dhe efikasitetit; dhe *së treti*, hartimi i një kushtetute për qytetarët Europeanë. Kjo Konventë synonte të adresonte problemin e mungesës së demokracisë në BE dhe t’a sjellë atë më pranë qytetarëve, duke ulur nivelin e centralizimit të institucioneve të saj.

Në vazhdim të këtij angazhimi në Konventën për të ardhmen e Europës u miratua drafti i Traktatit për Kushtetutën e Europës, i cili u nënshkrua në Romë më 29 Tetor 2004 dhe parashikohej se do të hynte në fuqi më 1 Nëntor 2006, pas ratifikimit nga të gjitha Shtetet Anëtare. Përsa i përket PJSP-së, parimet kryesore janë të përfshira në Pjesën e I-rë, Nenet I-16, I-40 dhe I-41, dhe janë trajtuar me hollësi në Titullin V të Pjesës së III-të të Kushtetutës të BE-së, e cila trajton marrëdhëniet e jashtme të BE-së. Bashkimi në një titull të vetëm të të gjitha dispozitave që kanë lidhje me marrëdhëniet e jashtme, është pasojë e përpjekjes së BE-së për njohjen e personalitetit juridik të saj dhe shkrirjen e strukturës me tre shtylla⁶⁷.

Megjithëse objektivat e PMSP-së nuk janë të përqendruara më vete, ato mund të nxirren nga Neni I-41(1) i Projekt Kushtetutës (në vijim Kushtetuta) në të cilin parashikohej se: *“...PMSP-ja do t’i garantojë BE-së kapacitetet e duhura operationale në lidhje me asetet civile dhe ushtarake të përcaktuara më parë. Bashkimi mund t’i përdorë ato në misionet jashtë tij për arsye paqeruajtëse, për parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare, në pajtim me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara...”*⁶⁸.

⁶⁷ Neni IV-438(1) dhe Neni I-7 të Kushtetutës të BE-së.

⁶⁸ <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Duke patur parasysh se PMSP-ja do të ishte pjesë integrale e PJSP-së (Neni I-41(1)), objektiva të tjera do të mund t'i gjejmë edhe tek objektivat e PJSP dhe tek pjesa e traktatit që i referohet marrëdhënieve të jashtme të BE-së (Nenet I-3(4) dhe III-292). Konkretisht Neni I-3(4) parashikonte se në lidhje me marrëdhëniet e jashtme “...*BE-ja duhet të ruajë dhe të promovojë vlerat dhe interesat e saj. Ajo duhet të kontribuojë në paqen, sigurinë, zhvillimin e qëndrueshëm, solidaritetin dhe respektin reciprok midis njerëzve, tregëtinë e drejtë dhe të barabartë, çrrënjosjen e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtat e fëmijëve, gjithashtu edhe mbikqyrjen e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare dhe zhvillimin më tej të saj, përfshirë dhe respektimin e parimeve të Kartës së OKB-së...*”⁶⁹.

Më me hollësi këto objektiva ishin të trajtuara në Nenin III- 292 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se veprimet e BE-së në arenën ndërkombëtare duhet të udhëhiqeshin nga parimet të cilat frymëzuan krijimin e tij, zhvillimin dhe zgjerimin, dhe të cilat ai do që t'i shpërndajë më tej si: demokracia, shteti i së drejtës, karakteri universal dhe pandashmëria e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respekti për dinjitetin njerëzor, parimet e barazisë dhe të solidaritetit. Përsa i përkiste marrëdhëniet me shtetet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, rajonale ose globale, me të cilat Bashkimi ndan të njëjtat vlera dhe parime ky nen parashikonte se ai duhej të nxiste bashkëpunimin e përbashkët për zgjidhjen e probleme të përbashkëta, duke vepruar nën mandatin e OKB-së.

Nëpërmjet zbatimit të politikave dhe veprime të përbashkëta ai duhej të punonte për nxitjen e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare me qëllim: (a) ruajtjen e vlerave, interesave themelore, sigurinë, pavarësinë dhe integritetin; (b) konsolidimin dhe ruajtjen e demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe të parimeve të së drejtës ndërkombëtare; (c) ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve, forcimin e sigurisë ndërkombëtare, në përputhje me parimet dhe qëllimet e Kartës së OKB-së, me parimet e Aktit Final të Helsinkit dhe objektivat e Kartës së Parisit, përfshirë dhe ato që lidhen me kufinj të jashtëm; (h) promovimi i një sistemi ndërkombëtar bazuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në sistemin e mirëqeverisjes globale.

Risite që solli projekt Kushtetuta në drejtim të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë mund t'i përmbledhim në⁷⁰:

Së pari, zgjerimi i natyrës së operacioneve dhe misioneve në të cilat mund të angazhohej. Përsa i përkiste natyrës së misioneve dhe operacioneve në të cilat mund të angazhohej BE-ja, në dallim nga Neni 17(2) i Traktatit të BE-së, në Kushtetutë ato përkruhen më me hollësi. Përveç atyre me karakter vetëmbrojtës, neni I-41(1) autorizonte BE-në në përdorimin e aftësive operacionale të PMSP-së për misione jashtë BE-së si ato paqeruajtëse, për parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare në përputhje me parimet e Kartës së OKB-së. Ndërsa neni III-309(1) parashikonte dhe “...*misionet e përbashkëta për çarmatimin, misionet e shpëtimit dhe ato humanitare, të këshillimit ushtarak dhe detyrat ndihmëse, parandalimin e konflikteve dhe detyrat paqeruajtëse, ndërhyrjet ushtarake në raste të menaxhimit të krizave,*

⁶⁹ <https://europa.eu/> (hyrë poër herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁷⁰ Po aty.

përfshirë dhe ato paqebërëse dhe vendosjen e stabilitetit pas konfliktit...’’⁷¹. Përveç misionëve të sipërpërmendura, nga Nenet I-41(6) dhe III-312 të Kushtetutës, njihet mundësia që BE-ja mund të thërritet nga OKB-ja për të asistuar në zbatimin e misionëve të ndërmarra nën Kapitujt VI dhe VII të Kartës së OKB-së, të cilt lënë të kuptohet që në misionet e BE-së mund të përfshihen dhe ato për forcimin e paqes.

***Së dyti**, përfshirja e klauzolës së ndihmës së përbashkët ku në nenin I-41(7)) parashikohej se: “...Nëse një nga Shtetet Anëtare është viktimë e një sulmi të armatosur ndaj territorit të saj, Shtetet Anëtare të tjera kanë detyrimin për ndihmë dhe asistencë të përbashkët me të gjitha mejetet në dispozicion të tyre, në përputhje me Nenin 51 të Kartës së OKB-së. Kjo nuk duhet të jetë në kundërshtim me cilësitë specifike të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë të ndonjë Shteti Anëtar⁷². Angazhimi dhe bashkëpunimi në këtë fushë do të jetë në pajtueshmëri me angazhimet në kuadër të NATO-s, e cila për Shtetet që janë anëtare të saj është organizata ku programohet dhe zbatohet mbrojtja e përbashkët...’’.*

Rëndësi për të ardhmen e PSMP-në paraqet dhe përfshirja në Nenin I-43 të klauzolës së solidaritetit. Ashtu si klauzola për ndihmë të përbashkët, edhe kjo klauzolë nuk do të kishte ndikim në të drejtën që kanë Shtetet Anëtare për të zgjedhur masat më të përshtatshme në përputhje me obligimet e tyre⁷³.

***Së treti**, zgjerimi i rasteve të votimit me shumicë të cilësuar. Kushtetuta parashikonte se Këshilli European do të votojë në unanimitet në rastin e përcaktimit të interesave strategjikë të BE-së, përcaktimit të objektivave të PJSP-së dhe PSMP-së dhe përcaktimin e udhëzimeve të përgjithshme për PJSP-në , përfshirë dhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Këto udhëzime të miratuara nga Këshilli do të shërbenin si bazë për vendimmarrjen e tij në zbatimin e tyre (Nenet I-40(2), III-293 dhe III-295).*

Votimi me shumicë të cilësuar do të shtrihej në rast kur Këshilli vendoste në lidhje me një veprim ose pozicion të BE-së, mbi bazën e propozimit të Ministrit të Punëve të Jashtme të BE-së, me anë të të cilit ai i ka paraqatur një kërkesë specifike Këshillit. Më tej, votimi me shumicë të cilësuar do të ishte i mundur dhe në rastet të përcaktuara shprehimisht në një vendim të Këshillit të votuar në unanimitet. Në rast se një Shtet Anëtar deklaronte se është kundër, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, një vendimi që merret me shumicë të cilësuar, vota e tij nuk do të merrej parasysh. Në rast të mosarritjes të një zgjidhje të kuaqshme çështja do t’i referohej Këshillit, i cili do të vendoste unanimisht (Neni III-300(2)). Megjithatë, në fushën e PMSP-së, vendimmarrja me shumicë të cilësuar përjashtohet nga Neni

⁷¹ Një dispropozitë e tillë është më e detajuar se Neni 17(2) i Traktatit të BE-së, i cili parashikonte se misionet e BE-së do të përfshijnë misionet e shpëtimit dhe ato humanitare, detyrat paqeruajtëse, ndërhyrjet ushtarake në rastet e menaxhimit të krizave, përfshirë dhe ato paqebërëse.

⁷² Një parashikim i tillë është i mundur për shkak se klauzola e ndihmës së përbashkët është në kundërshtim me neutralitetin e disa Shteteve Anëtare. Klauzolat që përbajnë detyrime të tilla në fushën e sigurisë mund të jenë në pajtueshmëri me politikën e tyre kombëtare të sigurisë ose me dispropozitat kushtetuese. (Rasti i Danimarkës, Irlandës)

⁷³ Declaration by the Conference on Articles I-43 and III-329 of the Constitution, [http://eur-lex.europa.eu/\(hyrë_për_herë_të_fundit_më_10_Tetor_2014\)](http://eur-lex.europa.eu/(hyrë_për_herë_të_fundit_më_10_Tetor_2014)).

III-300(4), për vendime që kanë lidhje me ushtrinë ose me mbrojtjen, dhe nga Neni I-41(4) për PMSP-në në përgjithësi.

Së katërti, përfshirja e Parlamentit në çështje që kishin të bënim me mbrojtjen dhe sigurinë. Sipas neneve I-40(8) dhe I-41(8) i njëjti drejta Parlamentit Europian të merrte pjesë në konsultime për çështje të rëndësishme dhe vendimmarje që lidhen me PJSP-në dhe PMSP-në dhe të jetë i informuar, sidomos nga MPJ i BE-së, për zhvillimin e mëtejshëm. Parlamenti mund t'i drejtohe pyetje Këshillit ose MPJ të BE-së ose të paraqiste rekomandime dhe të zhvillonte një seancë dëgjimore për progresin e bërë në zbatimin e PJSP-së dhe PMSP, dy herë në vit (Neni III-300(2)).

Së pesti, zëvendësimi i termave “veprime të përbashkëta” dhe “qëndrime të përbashkëta” me një term më të përgjithshëm “Vendimet Europiane”⁷⁴.

Së gjashti, forcimi i aftësive ushtarake dhe civile të BE-së. Kushtetuta e BE-së i kushtoi rëndësi dhe aftësive ushtarake dhe civile të BE-së, ku Shtetet Anëtare duhet të merrnin masa gjithnjë e në rritje për të përmirësuar aftësitë e tyre ushtarake dhe t'i vënë në dispozicion të BE-së për zbatimin e PMSP-së (Neni I-41(3)). Një gjë e tillë ishte e domosdoshme përderisa operacionet për menaxhimin e krizave do të ndërmerreshin duke përdorur aftësitë e vëna në dispozicion nga Shtetet Anëtare (Neni I-41(3)).

Në drejtim të forcimit të aftësive operacionale të BE-së, Kushtetuta solli tri risi: a.) Krijimi i Agjencisë Europiane të Mbrojtjes; b.) Krijimi i një mekanizmi që do të kontrollonte përmbushjen e operacioneve të ndërmarra nga BE-ja; dhe c.) Krijimin e një sistemi të ri për financimin e operacioneve të PMSP-së⁷⁵.

Pjesë e Kushtetutës së BE-së, Neni I-41(3), ishte dhe Agjencia Europiane të Mbrojtjes, e cila kishte mandat “...për të identifikuar nevojat operacionale, promovimin e mjeteve për përmbushjen e këtyre nevojave, të kontribuonte në identifikimin dhe, nëse është e domosdoshme, zbatimin e çfarëdo mase të domosdoshme për forcimin e anës industriale dhe teknologjike të sektorit të mbrojtjes, të marrë pjesë në hartimin e politikës europiane në lidhje me aftësitë dhe armatimet, dhe të asistonte Këshillin në vlerësimin e aftësive ushtarake...”.

Ajo që në binte në sy në Kushtetutën e BE-së, që ndërsa ajo i kushtonte rëndësi bashkëpunimit me BEP-në, Këshillin e Europës, OKB-në dhe agjencitë e saj, OSBE-në, në asnjë dispozitë të saj nuk përmendej shprehimisht bashkëpunimi me NATO-n. Fakt i cili është i dyshimtë duke pasur parasysh bashkëpunimin e ngushtë midis NATO-s dhe BE-së në fushën e menaxhimit të krizave. Por edhe pse jo shprehimisht e përcaktur, Neni III-327 nuk përjashtonte mundësinë e bashkëpunimit të BE-së dhe me organizata të tjera ndërkombëtare. Gjithashtu në Kushtetutë nuk trajtohet dhe pjesëmarrja e shteteve të treta në misionet e BE-së për menaxhimin e krizave⁷⁶.

⁷⁴ Neni I-33(1). Vendimet janë ekuivalente me veprimet e përbashkëta, Neni 14 i TBE-së, dhe me qëndrimet e përbashkëta Neni 15 i TBE-së.

⁷⁵ <http://www.esil-sedi.eu/>(hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2014).

⁷⁶ Frederik Naert, “European Security and Defence in the EU Constitutional Treaty”, 10 Journal of Conflict & Security Law 2005/2 (Oxford Univ. Press).

Në pajtim me personalitetin juridik të BE-së, Kapitulli VI i Titullit V, Pjesa III e Kushtetutës parashikonte procedurën e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë edhe ato që kishin të bënin me çështje të mbrojtjes dhe të sigurisë, ndërmjet BE-së dhe shteteve të treta ose organizatave ndërkombëtare. Shtetet Anëtare, Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni kishin të drejtë t'i kërkonin Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED) opinion në lidhje me pajtueshmërinë e marrëveshjes me Kushtetutën. Në rast papajtueshmërie, marrëveshja e nënshkruar nuk do të hynte në fuqi në rast se ajo nuk ndryshohej ose të amendohej (Neni III-323(11)). Një dispozitë e tillë i njihte GJED-së të drejtën për të ndërhyrë në çështje që kishin të bëjnë me politikën e mbrojtjes dhe të sigurisë⁷⁷.

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës së BE-së do të ndikonte në forcimin e rolit të Bashkimit si një aktor në arenën ndërkombëtare, do të rriste efektivitetin e politikave të miratuara dhe të zbatuara, do të forconte demokracinë në institucionet e Bashkimit dhe llogaridhënien e tyre dhe do t'i njihte më shumë të drejta qytetarëve europianë. Në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, dispozitat e Kushtetutës të BE-së reflektonin vendosshmërinë e BE-së drejt një politike të përbashkët europiane të sigurisë dhe të mbrojtjes. Angazhimi në mbrojtjen e përbashkët, klauzola e mbrojtjes së përbashkët dhe klauzola e solidaritetit, zgjerimi i rrethit të operacioneve të menaxhimit të krizave të BE-së, bashkëpunimi i përforcuar dhe dhënia e të drejtës të disa Shteteve Anëtare për të ekzekutuar një mision, angazhimi për të përmirësuar aftësitë, bashkëpunimi i strukturuar dhe krijimi i figurës së MPJ të BE-së, janë zhvillimet më domethënëse dhe tregues mjaft i qartë i ambicies së BE-së në arenën ndërkombëtare, duke synuar qënien e një aktori kyç. Megjithatë Traktati Kushtetues e ruan natyrën ndërqeveritare të PSMP-së dhe sovranitetin e Shteteve Anëtare për të përcaktuar objektivat e aspekteve të caktuara të kësaj politike, si edhe shkallën e angazhimit për çdo mision.

Në përfundim mund të themi se pavarësisht elementëve pozitivë, ideja për një Kushtetutë Europiane ishte e destinuar të dështonte, pasi Traktati Themelues i saj nuk synonte vetëm thjeshtimin dhe shkrirjen e traktatave ekzistuese në një të vetëm, por ai i hapte rrugë ndryshimit të natyrës së Bashkimit, duke marrë tiparet e një shteti federal, pa ndryshuar emërtimin e tij, në të cilin Shtetet Anëtare dhe qytetarët e tyre humbisnin pavarësinë e tyre dhe do të kishin një statusin e një rajoni.

Gjatë gjithë këtyre viteve integrimi europian është realizuar nëpërmjet traktateve, të cilat më shumë se pasqyrim i ndryshimeve të dëshiruara nga qytetarët europianë, u shërbenin Shteteve Anëtare për të justifikuar politikat e tyre dhe masat e ndërmarra në arenën ndërkombëtare. Populli ka qenë në padijeni të qëllimit politik që fshihej pas këtyre traktateve. Demokracia është si shëndeti. Ashtu si vlera e tij kuptohet vetëm kur sëmuremi edhe rëndësia e demokracisë kuptohet vetëm kur e humbasim atë. Atëhere do të na duhet një kohë e gjatë për t'a rifituar atë. E njëjta logjikë vlen edhe për Traktatin Themelues të Kushtetutës së BE-së, e cila në thelb i privon qytetarët europianë nga demokracia e tyre. Për të kuptuar se çfarë ndryshimet sjell Kushtetuta për BE-në, fillimisht duhet të kuptojmë sesi ai ka funksionuar deri më tani dhe se çfarë ndryshimesh do të sillte ajo. Hyrja në fuqi e Kushtetutës nuk mund të reduktohet në një

⁷⁷ <https://europa.eu/> (hyrë poër herë të fundit më 23 Prill 2018).

çështje “thjeshtëzimi”, “shkrirje” apo “rregullimi” të traktateve ekzistuese, por ajo prezanton një ndryshim rrënjësor të tyre dhe do të funksionimit politikdhe ligjor të Shteteve Anëtare dhe të qytetarëve të tyre.

BE-ja është i organizuar dhe funksionon mbi bazën e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare, sikurse është parashikuar në Neni A të Traktatit të Mastrohtit. Një nga këto forma bashkëpunimi është edhe Komuniteti Europian, i cili ka një personalitet juridik të pavaruar nga shtetet e tij. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe GJED-ja në jurisprudencën e saj, e cila është shprehur se në rast konflikti e drejta komunitare ka përparësi mbi atë kombëtare, pavarësisht se një parashikim i tillë nuk është pasqyruar në traktat. Komuniteti Europian i cili mbulon kryesisht çështje të natyrës ekonomike dhe të tregut të përbashkët, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me monedhën e përbashkët, përbën shtyllën e parë të BE-së, atë komunitare, në të cilën mbizotëron votimi me shumicë të cilësuar. Ndërsa për çështje që i përkasin dy shtyllave të tjera, Shtetet Anëtare kanë ruajtur sovranitetin e tyre duke u mbështetur në bashkëpunimin ndërqeveritar.

Ndërkohë Traktati Kushtetues e pajis BE-në me mekanizmat e nevojshjeve për të pasur një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Ndërsa BE-ja sot ndërthur elementin mbikombëtar, për çështje të shtyllës së parë, me atë ndërqeveritar për çështje të shtyllës së dytë dhe të tretë, Kushtetuta shkrin strukturën me tre shtylla në një të vetme, e cila do të karakterizohet nga natyra mbikombëtare.

KAPITULLI II

POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE E MBROJTJES SË PËRBASHKËT NË TRAKTATIN E LISBONËS

Projektimi dhe formulimi i politikave që kanë të bëjnë me çështje të shtyllës së dytë, që nga hyrja në fuqi të Traktatit të Mastrohtit, ka kaluar nëpër dy procese të ndryshme institucionale. Nga njëra anë, politikat që kishin të bënin me çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes së përbashkët janë karakterizuar nga natyra ndërqeveritare, ku pjesa më e madhe e vendimeve në këtë fushë janë marrë në mënyrë unanime dhe rolin më të rëndësishëm në procesin vendimmarrës e kishin Këshilli Europian dhe Këshilli i BE-së. Nga ana tjetër, politikat në çështjet që lidheshin me tregtinë, zgjerimin e BE-së dhe ndihmat humanitare janë karakterizuar nga një natyrë “europiane” (mbi kombëtare) vendimmarrje, në të cilën garantohej përfshirja e të gjitha institucioneve më të rëndësishme të BE-së, së bashku me Komisionin dhe Parlamentin. Për këtë arsye, me qëllim forcimin e vendimmarrjes komunitare në çështje që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen, rritjen e efektshmërisë, të koherencës dhe të transparencës së politikave të jashtme të BE-së dhe forcimin e legjitimitetit të operacioneve dhe misioneve të saj, u pa e nevojshme rishikimi i dispozitave që kishin të bënin me PJSP-së në tërësi dhe me PESM-në në veçanti. Këto ndryshime, që synonin të ndreqnin pikat e dobëta të identifikuar në traktatet e mëparshme, u bënë pjesë e Traktatit të Lisbonës, i cili hyri në fuqi më 01 Dhjetor 2009. Reformat e prezantuara në Traktatin e Lisbonës, me përjashtim të disa ndryshimeve të vogla, ishin pothuajse identike me ato të Projekt Traktatit Kushtetues (shiko tabelën 1).

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës PESM-ja u riemërtua PESMP dhe u bë pjesë integrale e PJSP-së. Ajo konsiderohej si një politikë e veçantë e BE-së dhe ishte e ndarë nga fushat e tjera të marrëdhënieve me jashtë, ku ndërsa këto rregulloheshin nga dispozitat e Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (në vijim TFBE), PJSP-ja dhe PESMP-ja rregulloheshin nga dispozitat e TBE-së. Traktati i Lisbonës shtoi numrin e dispozitave që rregullonin veprimtarinë e PESMP-së, duke i përfshirë ato në një seksion më vete, dhe parashikoi se dispozitat që lidheshin me PJSP-në do të kishin efekt edhe për të.

A është ndryshimi i emërimit nga PESM në PESMP tregues i rritjes së ambicies së BE-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes? A krijojnë ndryshimet e prezantuara në Traktatin e Lisbonës terrenin e përshtatshëm për krijimin e një politike të përbashkët apo bashëpunimi në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes do të vazhdojë të ketë karakter ndërqeveritar? A do të ndikojnë ndryshimet e prezantuara me Traktatin e Lisbonës në rritjen e rëndësisë së politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së apo janë thjesht një reflektim i rëndësisë që ka sot kjo politikë? Një përgjigje e këtyre pyetjeve mund të jepet vetëm pas një analize të hollësishme të ndryshimeve institucionale dhe risive të tjera të që solli Traktati i Lisbonës.

2.1 Risitë në kuadrin institucional

Deri me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, kompetencat e BE-së në fushën e marrëdhënieve me jashtë ishin të ndara midis Komunitetit European dhe institucioneve të tjera me karakter ndërqeveritar, duke shkaktuar në këtë mënyrë paqartësi përsa i përket dhe ndarjes së përgjegjësiave. Në kushtet kur mungesa e transparencës, niveli i lartë i burokracisë dhe konkurrenca midis këtyre institucioneve përbënin pengesë për hartimin e një politike të jashtme koherente për BE-në, ky Traktat jo vetëm që solli ndryshime në kuadrin ekzistues institucional, por edhe prezantoi krijimin e dy posteve të reja, atë të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së dhe atë të Presidentit të Këshillit European. Me ruajtjen e strukturës së “tre shtyllave”, sipas së cilës PJSP-ja ishte më vete, dhe roli i institucioneve të BE-së në çështje që kishin të bënin me politikën e jashtme dhe të sigurisë ishte i kufizuar.

a. Krijimi i postit të Përfaqësuesit të Lartë

Krijimi i postit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (në vijim Përfaqësuesi i Lartë) shërbën si një urë për të lidhur dhe koordinuar shtyllën “ndërqeveritare” dhe atë të “komunitare” të politikës së jashtme të BE-së. Ndonëse një post i tillë parashikohej edhe në Traktatin e Amsterdimit, analiza e rolit të tij paraqet rëndësi jo vetëm për faktin se me Traktatin e Lisbonës janë shtuar përgjegjësitë dhe është zgjeruar pushteti i tij, por edhe për faktin se tashmë ai/ajo vepron në një kuadër të ri institucional. Me Traktatin e Lisbonës posti i Përfaqësuesit të Lartë u shkri me atë të Komisionerit European për Marrëdhëniet me Jashtë⁷⁸.

Në kuadër të Traktatit të Lisbonës, bazuar në nenet 18 dhe 27 të TBE-së, i ndryshuar, detyrat e Përfaqësuesit të Lartë për çështje që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së janë⁷⁹:

- Drejton i politikën e jashtme dhe të sigurisë nëpërmjet mbledhjeve të Këshillit të Punëve të Jashtme.
- Kontribuon nëpërmjet propozimeve në zhvillimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, dhe garanton zbatimin e vendimeve të marra në këtë fushë, në përputhje me udhëzimet e Këshillit.
- Garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e veprimeve të jashtme të Bashkimit dhe koordinon aspekte të tjera të tyre që kanë të bëjnë me tregtinë, doganat dhe kontrollin kufitar.
- Përfaqëson BE-në në çështje që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, drejton dialogun politik me palët e treta për çështje në interes të Bashkimit dhe shpreh qëndrimin e tij në organizata dhe konferenca ndërkombëtare. Në këtë drejtim rëndësi merr neni 34, në të cilin parashikohet detyrimi që kanë Shtetet Anëtare, që janë

⁷⁸ Këshilli i BE-së, *The High Representative for Foreign Affairs and Security Policy / The European External Action Service* (Nëntor 2009), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 17 Prill 2017).

⁷⁹ <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

dhe anëtare të Këshillit të Sigurimit, të mbajnë të informuar shtetet e tjera jo anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë dhe të mbrojnë qëndrimet dhe interesat e BE-së, por pa paragjykuar përgjegjësitë e tyre të parashikuara në dispozitat e Kartës së OKB-së. Në lidhje me rolin e BE-së në organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e sigurisë, mund të themi se ai është i kufizuar pasi në NATO ajo nuk gëzon të drejta pjesëmarrëse dhe në disa të tjera ka statusin e vëzhguesit.

- Kontrollon veprimtarinë e Shërbimit Europian të Veprimeve me Jashtë dhe të delegacioneve të BE-së në vendet e treta dhe në organizata ndërkombëtare.
- Raporton në Parlament për çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në.
- Shërben si “roje” për të garantuar zbatimin nga Shtetet Anëtare të detyrimeve që burojnë jo vetëm nga Traktatet por edhe nga normat ligjore të miratuara nga vetë ata.
- Nuk ka të drejtë të iniciojë çështje para Gjykatës Europiane të Drejtësisë për mospërbushje nga Shtetet Anëtare të detyrimeve që burojnë nga Traktatet.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Përfaqësuesit i Lartë mbështetet nga Shërbimi për Veprimet me Jashtë (në vijm SHVJ). Ky mekanizëm *sui generis* ndihmon Përfaqësuesin e Lartë në këto drejtime: *së pari*, në arritjen dhe në zbatimin e konsensusit të arritur për çështje që lidhen me BE-në, *së dyti*, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe zbatimin e politikës së jashtme të BE-së dhe *së treti*, nëpërmjet përgatitjes së propozimeve për Këshillin për çështje që lidhen me politikën e jashtme dhe të sigurisë⁸⁰.

Pjesë e këtij shërbimi do të jenë dhe strukturat e BE-së për menaxhimin e krizave, të cilat do të ruajnë karakterin specifik të funksionimit të tyre⁸¹. Përveç SHVJ-së, Traktati i Lisbonës parashikonte dhe krijimin e një strukture të përbashkët për planifikimin dhe zhvillimin e aftësive ushtarake dhe civile, pasi më parë procesi për planifikimin e komponentëve civilë dhe ushtarakë për një mision të caktuar zhvillohej në mënyrë të ndarë nga KACMK-ja dhe ShU i BE-së, e cila do të vepronte nën autoritetin e drejtpërdrejtë dhe nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit të Lartë, pa përcaktuar me qartësi mënyrën e funksionimit të kësaj strukture⁸².

A mundet Përfaqësuesi i Lartë të nxisë bashkëpunimin dhe konsensusin midis Shteteve Anëtare për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të tyre në fushën e PESMP-së?

Bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Traktatit të Lisbonës, Përfaqësuesi i Lartë është anëtar i Bordit Drejtues të AEM-së dhe merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Punëve të Jashtme, funksione nëpërmjet të cilave ai mund të nxisë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe të ndihmojë në arritjen e konsensusit për çështje që i përkasin mbrojtjes europiane. Si pjesëmarrës në mbledhjet e Këshillit të Punëve të Jashtme ai mund të ndikojë në hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të PESMP-së, ndërsa si anëtar i Bordit Drejtues të AEM-së ai mbështet Shtetet Anëtare dhe Këshillin në përpjekjet e tyre për përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse të BE-së për menaxhimin e krizave.

⁸⁰ Këshilli i BE-së, *Presidency Report to the European Council on the European External Action Service* (Bruksel, Tetor 2009) <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

⁸¹ <http://consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 13 Prill 2015).

⁸² Julian Tupay, *CFSP After Lisbon: comprehensive Security for Small States?*, (International Centre for Defence Studies, Nëntor 2011), fq. 11.

Si përfundim, nisur nga disa funksione të Përfaqësuesit të Lartë mund të themi se ai luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e një PJSP-jë më koherente, pavarësisht faktit se vendimet e tij nuk kanë fuqi detyruese për institucionet e tjera të BE-së, për Shtetet Anëtare dhe zbatueshmëria e tyre nuk është objekt kontrolli gjyqësor nga ana e Gjykatës Europiane të Drejtësisë⁸³. Gjithashtu, Përfaqësuesi i Lartë nëpërmjet “nominimit”, “turpërimin” dhe “fajësimin” të atyre që çënojnë normat komunitare si dhe duke i bërë “të besueshme” angazhimet e përbashkëta, luan rolin e “ndërgjegjes” duke u përpjekur të ruajë disiplinën ndërmjet Shteteve Anëtare, të cilët duhet të veprojnë në interes të përgjithshëm të BE-së⁸⁴.

b. Presidenti i Këshillit European

Parashikimi në Traktat të funksionit të Presidentit të Këshillit European i shërben garantimit të vazhdimësisë së politikave europiane në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Me rolin e tij nga njëra anë ai duhet të jetë në gjendje të nxisë konsensusin ndërmjet kryetarëve të shteteve dhe të qeverive dhe nga ana tjetër ai duhet të ndikojë në “drejtimin” e BE-së dhe të garantojë përmbushjen e angazhimeve që Shtetet Anëtare kanë marrë në kuadër të PESMP-së. Pra, detyrat e Presidentit të Këshillit European variojnë nga ato të natyrës koordinuese, detyra të cilat i ushtron së bashku me Presidentin e Komisionit (neni 15(6) i TBE-së), në ato të një “Presidenti të Europës”, në rastet kur mban detyra përfaqësuese⁸⁵.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në fushën e PESMP-së janë të parashikuara në nenin 15(6) të TBE-së, i ndryshuar dhe ato janë: *Së pari*, të përfaqësojë BE-në në çështje që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët. Nisur nga fakti që kjo kompetencë e tij është e ngjashme me atë të Përfaqësuesit të Lartë, mendoj se ekziston rreziku i shmangies nga përgjegjësitë në fushën e përfaqësimit të jashtëm të BE-së. Secili prej tyre mund të argumentojë që Traktati ngarkon palën tjetër në përmbushjen e një detyre të tillë ose në të kundërt të dy institucionet mund të shprehen për çështjen në fjalë, gjë që mund të krijojë dhe përplasje. *Së dyti*, të informojë Parlamentin European në lidhje me rezultatet e mbledhjeve në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në.

Në përfundim, nga analiza në tërësi e dispozitave të Traktatit të Lisbonës, mund të themi se roli i Presidentit të Këshillit European është pak më tepër se ai i një koordinatori me funksione përfaqësimi dhe më pak se ai i një Presidenti të fuqishëm i cili përfaqëson BE-në në arenën ndërkombëtare për çështje që lidhen me PESMP-në. Në lidhje me PESMP-në roli ryesor i është dhënë Përfaqësuesit të Lartë dhe jo Presidentit të Këshillit European.

Gjithashtu, edhe në autorë të ndryshëm ekzistojnë dy qëndrime në lidhje me rolin e Presidentit të Këshillit për çështje që kanë të bëjnë me PESMP-së, ku disa prej tyre mendojnë se roli i mundshëm i Presidentit paraqet një rëndësi të madhe, por detyrat dhe funksionet e tij nuk

⁸³ Antonio Missiroli, *The Impact of the Lisbon Treaty on ESDP* (European Parliament, 2008), fq. 9, www.statewatch.org/ (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

⁸⁴ Nicole Alecu De Flers, “The Provisions on CFSP and CSDP in the Lisbon Reform Treaty: Stumbling blocks or Milestones?”, Hebrew University International Law Research Paper, Nr. 08-08 (2008), fq. 12, <http://papers.ssrn.com/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

⁸⁵ Wessel Wolfgang dhe Andreas Hofmann, “Der Vertrag von Lissabon – eine tragfähige und abschliessende Antwort auf konstitutionelle Grundfragen”, *Integration*, Vol 31, Nr. 1 (2008), fq. 4-20.

janë të përcaktura qartë, dhe të tjerë janë të mendimit që efektiviteti i rolit të Presidentit varet pjesërisht nga personaliteti i tij dhe nga shkalla në të cilën Shtetet Anëtare i lejojnë atij të ndërmarrë iniciativa.

c. Parlamenti Europian

Ndërhyrja e Parlamentit në çështje që kishin të bënin me PESMP-në ndodh në tre nivele, nëpërmjet Parlamentit Europian, Parlamenteve Kombëtare të Shteteve Anëtare dhe të Asamblesë Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes/Asambleja e BEP-së.

Megjithëse, edhe në Traktatin e Lisbonës për çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në Parlamenti Europian (në vijim Parlamenti) ruan rolin e tij mbikqyrës dhe këshillues, risitë që ai solli ish-in: **Së pari**, mundësia e kontrollit ndaj Përfaqësuesit të Lartë, i cili realizohej nëpërmjet dhënies së pëlqimit për emërimin e anëtarëve dhe të votimit të mocionit të mosbesimit mbi të gjithë Komisionin, përfshirë dhe Përfaqësuesin e Lartë si zëvendës President të tij (neni 17(7) i TBE, i ndryshuar). **Së dyti**, detyrimi i Përfaqësuesit të Lartë për t'u konsultuar me Parlamentin dhe të marrë parasysh pikëpamjet e tij për çështje që lidhen me PESMP-në (neni 36(1) i TBE, i ndryshuar). **Së treti**, detyrimi i Presidentit të Këshillit për t'i raportuar Parlamentit, për çështjet e diskutuara në mbledhjet e tij, përfshirë edhe për ato çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në⁸⁶. **Së katërti**, e drejta e Parlamentit për t'i drejtuar pyetje dhe t'i bëjë rekomandime Këshillit, përfshirë këtu dhe Përfaqësuesin e Lartë⁸⁷. **Së pesti**, zgjerimi i natyrës së çështjeve që mund të jenë objekt diskutimi në Parlament, duke përfshirë jo vetëm çështje të natyrës së përgjithshme që kanë të bëjnë me PJSP-në por, edhe në çështje që lidhen me PESMP-në dhe me progresin e bërë në zbatimin e kësaj politike⁸⁸. **Së gjashti**, e drejta e Parlamentit për të kontrolluar shpenzimet në lidhje me misionet civile të ndërmarra nga BE-ja. Neni 41(2) i Traktatit përjashton nga buxheti i BE-së vetëm ato shpenzimet që lidhen me operacionet ushtarake dhe nga interpretimi *a contrario* shpenzimet që lidhen me aspektet civile të PESMP-së do të jenë pjesë e tij.

Rritja e rolit të Parlamentit në PJSP dhe të PESM ndikoi dhe në forcimin e ligjshmërisë së veprimeve të Bashkimit në arenën ndërkombëtare. Në zbatim në nenit 21.a të Traktatit ai do të luajë një rol më aktiv dhe më të dukshëm në promovimin dhe në pasjen e një PESM më efektive.

Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, shënoi dhe zgjerimin e kompetencave të Parlamenteve Kombëtare, duke patur parasysh natyrën “ndërqeveritare” të PESMP-së dhe faktin që debati për çështje që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë realizohet fillimisht në nivel kombëtar. Ky Traktat parashikonte organizimin e një konference të Komiteteve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit, e cila *inter alia* do të organizonte dhe mbajtjen e konferencave ndërparlamentare për të diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me politikën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Këto konferenca do të shërbenin si një panel

⁸⁶ Neni 15(6d) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

⁸⁷ Neni 36 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

⁸⁸ Neni 36(2) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

diskutimesh dhe nuk do të kishin ndonjë ndikim real mbi PESMP-në⁸⁹. Gjithashtu, Traktati i Lisbonës u njohu Parlamenteve Kombëtare mundësinë për të kundërshtuar projektligje të cilat ishin në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit, e drejtë e cila nuk gjente zbatim në rastin e PESMP-së⁹⁰.

Ndikim në PESMP-në ka edhe Asambleja Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes (dikur Asambleja e BEP-së). Kjo asamble, e cila përbëhet nga përfaqësues të parlamenteve kombëtare dhe që është nën mbikqyrjen e Këshillit, ka kontroll mbi çështje që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen europiane. Ajo është një institucion konsultativ dhe nuk gëzon të drejtën e vetos për vendime që merr Këshilli i BEP-së.

d. Këshilli Europian

Traktati i Lisbonës ruajti hierarkinë ekzistuese institucionale në fushën e PESMP-së dhe ndryshimet që ai solli në rolin e Këshillit të Europian, i cili vazhdoi të kishte si funksion kryesor përcaktimin e objektivave të PESMP-së, ishin të pakta. Nëpërmjet vendimeve të miratuara në mënyrë unanime, ai përcakton udhëzimet e përgjithshme, identifikon interesat strategjikë të BE-së dhe përcakton objektivat e PESMP-së (neni 26(1) i TBE, i ndryshuar). Gjithashtu, atij i njihet e drejta të emërojë dhe të shkarkojë nga detyra Përfaqësuesin e Lartë (neni 18(1) i TBE, i ndryshuar).

Nga analiza në tërësi të dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e Këshillit Europian, mund të themi se, me Traktatin e Lisbonës ai i ruan kompetencat e tij në fushën e PESMP-së. Madje disa autorë mendojnë se kompetencat e tij janë “forcuar” më tej në krahasim me ato në Traktatin e Nicës. Gjithësesi, Këshilli Europian nuk është aktori kryesor i PESMP-së, krahasuar me Këshillin e Ministrave. Natyra e përgjithshme e vendimeve të tij, pasi është e vështirë për një institucion që takohet disa herë në vit të diskutojë për probleme specifike, numri i paktë i takimeve që ai zhvillon dhe moseficienta e mekanizmit vendimmarrës, pasi vendimet merren në unanimitet, janë faktorë që ndikojnë në një vendimarrje joefektive, e cila nuk i përgjigjet në kohë situatave të konfliktit.

e. Këshilli i Ministrave/Këshilli i Punëve të Jashtme

Përsa i përket detyrave të Këshillit të Punëve të Jashtme, Traktati i Lisbonës nuk solli ndonjë ndryshim rrenjësor dhe ai vazhdon të ruajë kompetencën e tij për përpunimin e veprimeve të jashtme të BE-së, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me PESMP-në (neni 16(6)), dhe të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Europian në të cilat diskutohen çështje që i përkasin sigurisë dhe mbrojtjes europiane. Në lidhje me strukturën organizative, ndryshimi që solli Traktati i Lisbonës ishte njohja e rolit të Përfaqësuesit të Lartë për drejtimin e mbledhjeve të Këshillit të Punëve të Jashtme. Me tej, Komiteti i Politikave dhe i Sigurisë, i cili tashmë mund të vihej në lëvizje me kërkesë të Këshillit dhe të Përfaqësuesit të Lartë, do të ushtronte kontrollin politik dhe drejtimin

⁸⁹ Protokollit Nr. 1 “Mbi rolin e parlamenteve kombëtare në BE”, <http://www.google.al/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

⁹⁰ Nenet 24(1) dhe 31(1) i TBE-së, të ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

strategjik të operacioneve për menaxhimin e krizave nën përgjegjësinë e të dy këtyre institucioneve⁹¹.

f. Komisioni

Me krijimin e figurës së Përfaqësuesit të Lartë, të cilit Traktati i Lisbonës i njohu kompetencat kryesore në PESMP-në, roli i Komisionit në këtë drejtim është zbehur pasi: *së pari*, e drejta për të mbikëqyrur punën e bërë në kuadër të PESMP-së tashmë i përket Përfaqësuesit të Lartë dhe jo Komisionit; *së dyti*, Komisioni nuk gëzon më të drejtën t'i drejtojë pyetje apo t'i bëjë propozime Këshillit për çështje që lidhen me PESMP-në por, vetëm të mbështesë Përfaqësuesin e Lartë në rast kur ai paraqet nisma ose propozime (neni 30); *së treti*, e drejta për të përfaqësuar BE-në për çështje që lidhen me PESMP-në tashmë i përket Përfaqësuesit të Lartë (neni 17(1)); *së katërti*, Komisioni nuk është plotësisht i përfshirë në zbatimin e vendimeve të marra në kuadër të PESMP-së. Por, megjithatë kontrolli që Komisioni mund të ushtrojë mbi Përfaqësuesin e Lartë si Zëvendës President i tij, të paktën në teori mundet të kufizojë në një shkallë të caktuar lirinë e veprimit të Përfaqësuesit të Lartë si Kryetar i Këshillit të Punëve të Jashtme.

g. Gjykata Europiane e Drejtësisë

Dispozitat e Traktatit të Lisbonës nuk parashikojnë shtrirje të juridiksionit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (në vijim GJED) mbi çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në dhe Shtetet Anëtare nuk mund t'i paraqesin asaj çështje që lidhen me moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktati. Megjithatë, Neni 24(1) i Traktatit të Lisbonës dhe Neni 275 i TFBE-së parashikojnë dy përjashtime nga rregulli i mësipërm; *së pari*, GJED-ja ka të drejtë të monitorojë zbatimin e Nenit 40 të TBE-së, i cili përcakton kufirin midis PESMP-së dhe fushave të tjera të politikës së BE-së në lidhje me kompetencat vendimmarrëse dhe shtrirjen e pushteteve; dhe *së dyti*, çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të kundërshtojë masat kufizuese të adoptuara në kuadër të PESMP-së, e drejtë e cila nuk do të shtrihet në rastin e drejtimit të operacioneve ushtarake dhe të misioneve civile. Si një institucion që garanton pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga BE-ja me Traktatet, GJED-ja ka të drejtë të japë opinion dhe për ato marrëveshje që kanë implikime në fushën ushtarake ose në atë tëmbrojtjes (neni 218 (11) i TFBE)⁹².

Në lidhje me dy përjashtimet mund të themi se, rasti i parë është tregues i dështimit të BE-së për heqjen e strukturës së “tre shtyllave” dhe ka si qëllim që të ruajë një ndarje të qartë midis PJSP-së dhe fushave të tjera të politikës së BE-së, ndërsa përjashtimi i dytë nuk zbatohet në rastin e operacioneve ushtarake dhe misioneve civile, të cilat janë fushat kryesore të PESMP-së.

⁹¹Neni 38 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁹² <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

2.2 Risi të tjera që kanë ndikim në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes

a. Vendimmarrja dhe procedura legjislative

Rritja e numrit të Shteteve Anëtare të BE-së u shoqërua me rritjen e vështirësisë së arritjes së një konsensusi për çështje të rëndësishme të politikës së saj, për shkak të mbizotërimit të vendimmarrjes në unanimitet. Për këtë arsye ishte e nevojshme të përfshiheshin në Traktat ndryshime në lidhje me procedurën legjislative që do të ndikonin në shtimin e rasteve të votimit me shumicë të cilësuar, sidomos në ato fusha ku vendimmarrja ishte e bllokuar.

Siç rezultoi më vonë, edhe pse Traktati i Lisbonës zgjeroi fushat e politikës së BE-së në të cilat vendimet do të mund të merreshin me shumicë të cilësuar, përsa i përket PJSP-së, përfshirë këtu dhe PESMP-në, kryesisht u ruajt votimi unanimitet pas neni 24(1), paragrafi i dytë i TBE-së, i ndryshuar parashikonte se: *“...politika e jashtme dhe e sigurisë së përbashkët është subjekt i rregullave dhe procedurave të specifike. Ajo do të përcaktohet dhe do të zbatohet nga Këshilli Europian dhe Këshilli, në unanimitet, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga Traktati. Përjashtohet miratimi i akteve ligjore...”*⁹³.

Vendimmarrja me shumicë të cilësuar lejohej: *i.)* për marrjen e një vendimi në lidhje me miratimin e një veprimi ose një qëndrimi të përbashkët të BE-së, që prek interesat strategjike ose objektivat e saj. Referuar nenit 22.1 të TBE-së, i ndryshuar mund të themi se në përputhje me parimet dhe objektivat e përcaktuara në nenin 21, Këshilli Europian do të identifikojë interesat strategjike dhe objektivat e Bashkimit. Vendimet e Këshilit Europian në lidhje me interesat strategjike dhe objektivat e Bashkimit duhet të kenë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të sigurisë të përbashkët dhe me fusha të tjera të veprimtarisë së jashtme të Bashkimit. Këto vendime mund të kenë të bëjnë me marrëdhëniet e Bashkimit me një shtet ose rajon të caktuar ose të kenë të bëjnë me çështje në përgjithësi. Këto vendime duhet të përcaktojnë kohëzgjatjen dhe mjetet më të cilat do të vihen në zbatim nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare; *ii.)* për marrjen e një vendimi i cili përcakton një veprim ose një qëndrim të përbashkët të BE-së, i cili është propozuar nga Përfaqësuesi i Lartë, pas kërkesës së bërë nga Këshilli Europian; *iii.)* për marrjen e një vendimi në funksion të zbatimit të një veprimi ose qëndrimi të përbashkët të BE-së; dhe *iv)* për emërimin, shkarkimin dhe zgjatjen e mandatit të përfaqësuesve specialë.⁹⁴

Gjithashtu, Traktati i Lisbonës zgjeroi dhe rastet në të cilat Këshilli mund të vendoste me shumicë të cilësuar, si: a.) vendimet që kanë të bëjnë me krijimin e mekanizmit të bashkëpunimi të përhershëm të strukturuar dhe të përcaktimit të listës së Shteteve Anëtare pjesëmarrëse (neni 46 (2) i TBE-së i ndryshuar), b.) vendimet për krijimin, mënyrën e financimit, administrimit dhe kontrollit të “fondit bazë”, i caktuar për financimin e misionëve në fushën e mbrojtjes (neni 41(3) i TBE-së i ndryshuar, c.) vendimet në lidhje me miratimin e statutit të AEM-së, të rregullave për funksionimin e saj dhe të numrit të vendeve për anëtarësim (neni 45(2) i TBE-së, i ndryshuar).

Me qëllim forcimin e kapaciteteve vendimmarrëse të BE-së, Traktati i Lisbonës solli ndryshime dhe përsa i përket procedurës legjislative, që parashikonte procedurën e zakonshme

⁹³ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

⁹⁴ Po aty.

dhe atë të veçantë, duke përfshirë konceptin e “klauzolës kalimtare”. Nëpërmjet “klauzolës kalimtare” BE-ja synonte shtrirjen e procedurës së zakonshme dhe për ato çështje që kishin të bënin me politikën e jashtme dhe të sigurisë, që deri atëherë miratoheshin me unanimitet, duke qenë se, kjo procedurë, e cila parashikonte përfshirjen e Këshillit, të Parlamentit dhe votimin me shumicë të cilësuar, garantonte një vendimarrje më demokratike.

Traktati parashikonte dy lloj “klauzolash kalimtare”, atë të përgjithshme, e cila do të zbatohet për të gjitha politikatat e BE-së, pas autorizimit të miratuar në unanimitet nga Këshilli, dhe atë të veçantë, e cila do të mund të zbatohet në disa fusha specifike të politikës së BE-së, përfshirë këtu edhe PJSP-së, me përjashtim të rasteve që kishin implikime në fushën ushtarake dhe atë të mbrojtjes (neni 31 dhe 48.7 i TBE-së). Nga analiza *a contrario* e këtyre neneve mund të themi se votimi me shumicë të cilësuar do të zbatohet në rastin e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me komponentët civilë të PESMP-së (neni 42 dhe 43 i TBE-së)⁹⁵.

Nga ana tjetër, për të shmangur abuzimin me përdorimin e “klauzolës kalimtare” dhe për të vendosur një balancë ndaj të gjithave rasteve përjashtimore nga votimi unanim, Traktati i Lisbonës parashikoi dhe një mekanizëm mbrojtës që u quajt “frenat e emergjencës”. Ky mekanizëm pengonte votimin me shumicë të cilësuar për një çështje, në rast se një Shtet Anëtar i Këshillit do të paraqiste një arsye që ka rëndësi jetësore për shtetin dhe politikën e tij kombëtare⁹⁶. Ndonëse e drejta për të përcaktuar se çfarë çështjesh do të konsideroheshin jetësore për interesat e shtetit mbetet në diskrecionin e secilit prej tyre, ato ishin të detyruar që bazuar në parimin e besnikërisë për të paraqitur vetëm ato arsye që ishin me të vërtetë thelbësore (shiko figurën 1).

Në përfundim mund të themi se, votimi me unanimitet, së bashku me të drejtën e abstenimit të Shteteve Anëtare, përbën rregullin e përgjithshëm për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me PJSP-në në tërësi dhe me PESMP-në në veçanti. Mbizotërimi i votimit unanim konfirmon edhe një herë hipotezën se, kur Shtetet Anëtare duhet të vendosin midis sovranitetit të tyre kombëtar dhe efikasitetit në vendimarrje, preferojnë të ruajnë sovranitetin e tyre, duke bërë që PJSP-ja të ruajë natyrën e saj “ndërqeveritare”. Neni 31 (2) i njeh të drejtën një anëtarit të Këshillit të deklarojë se ka qëllim të kundërshtojë miratimin e një vendimi që do të merret me shumicë të cilësuar për arsye të rëndësishme që kanë të bëjnë me politikatat kombëtare dhe vota e tij nuk do të merret parasysh. Përfaqësuesi i Lartë, pas një diskutimi me shtetin e përfshirë, do të kërkojë për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme. Në rast mospasë, Këshilli me shumicë të cilësuar mund të kërkojë që çështja t’i referohet Këshillit Europian, i cili do votojë në unanimitet. Nga ana tjetër, shtimi i numrit të rasteve në të cilat Këshilli vendos me shumicë të cilësuar dhe parashikimi i “klauzolës kalimtare”, tregon ambicien e BE-së për t’i dhënë çështjeve që kanë të bëjnë me PJSP-në, përfshirë këtu edhe PESMP-në, një karakter “komunitar” dhe të rrisë efektivitetin e vendimarrjes në këtë fushë.

⁹⁵ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

⁹⁶ Neni 31.2 nënparagrafi katërt i TBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

b. Format e reja të bashkëpunimit

Në situatën kur për çështje që kishin të bënin me PESMP-në mbizotëronte votimi në unanimitet dhe arritja e një konsensusi ndërmjet Shteteve Anëtare paraqitej e vështirë, u pa e domosdoshme parashikimi i mekanizmave të rinj të bashkëpunimit, të cilët do t'i ofronin më tepër fleksibilitet veprimi BE-së. Gjithashtu, anëtarësimi i shteteve të reja në BE solli edhe rritjen e shumëllojshmërisë së qëndrimeve brenda saj, duke ndikuar në minimin e efikasitetit të vendimmarrjes së saj në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe në mbizotërimin e interesave kombëtarë, mbi ato komunitarë. Mekanizmat e rinj të bashkëpunimit të prezantuar nga Traktati i Lisbonës ishin: i.) bashkëpunimi i përforcuar, ii.) bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar, iii.) kualicioni i të aftëve dhe të gatshmeve dhe iv.) klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë dhe e solidaritetit.

- *Bashkëpunimi i përforcuar*

Mekanizmi i “bashkëpunimit të përforcuar” i jep mundësi forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare në të gjitha ato fusha të veprimtarisë së BE-së, që nuk janë kompetencë ekskluzive e kësaj të fundit, duke synuar zhvillimin më tej të objektivave të vendosura nga Bashkimi, mbrojtjen e interesave të tij dhe forcimin e procesit të integritetit. Në dallim nga Traktati i Nicës, i cili nuk lejonte bashkëpunimin për zbatimin e veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta për çështje që kanë të bëjnë me PESM-në dhe që kishin implikime në çështje ushtarake dhe të mbrojtjes, në Traktatin e Lisbonës një kufizim i tillë nuk është parashikuar. Gjithashtu, të drejtën për të realizuar një bashkëpunim të tillë e gëzonte çdo Shtet Anëtar (neni 328 i TFBE-së), me kufizimin e vetëm që numri minimal i shteteve të ishte nëntë. Ky lloj bashkëpunimi mund të realizohej vetëm nëse Këshilli vendoste se objektivat e parashikuara nga Shtetet Anëtare nuk mund të realizoheshin nga vetë BE-ja, brenda një afati të arsyeshëm. Aktet e miratuara në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar do të ishin të detyrueshme vetëm për Shtetet Anëtare pjesëmarrëse në të (neni 20 i TBE-së, i ndryshuar)⁹⁷.

- *Bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar*

Bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar kishte si qëllim të thellonte bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare për aspekte që lidhen me mbrojtjen si rritja e aftësive dhe kapaciteteve, operacionet, trajnimet, logjistika dhe blerjet e përbashkëta, duke synuar vetëm zhvillimin e aftësive ushtarake dhe jo të atyre civile (neni 42(6) i TBE-së, i ndryshuar)⁹⁸. Për shkak se ky lloj bashkëpunimi synonte vetëm në zhvillimin e aftësive operacionale, Shtetet Anëtare nuk janë të autorizuar të ndërmarrin operacione ushtarake ose të mobilizojnë forcat e tyre në realizim të mbrojtjes së përbashkët (neni 42(5) i TBE-së i ndryshuar)⁹⁹.

Në dallim nga bashkëpunimi i përforcuar, bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar është i organizuar sipas një procedure të caktuar dhe në funksion të realizimit të një qëllimi dhe

⁹⁷ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

⁹⁸ Neni 42(6) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

⁹⁹ Po aty.

objektivi të përcaktuar¹⁰⁰. Ndonëse për krijimin e tij nuk kërkohet një numër minimal shtetesh pjesëmarrëse, ky lloj bashkëpunimi mund të vendoset vetëm midis atyre Shteteve Anëtare aftësitë ushtarake të të cilave plotësojnë “kriteret e larta” dhe që kanë marrë pjesë në “misione të një rëndësie të lartë” (neni 42(6) i TBE-së). Shpjegimet për këto koncepte jepen nga neni 1 i Protokollit 10 “Mbi bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar (në vijim Protokollit 10) dhe sipas këtij neni Shtetet Anëtare të cilat dëshirojnë të jenë pjesë e bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar duhet¹⁰¹:

- *Të arrijnë objektivat e miratuara në lidhje me shpenzimet në investime dhe në pajisje për mbrojtjen;*
- *Të përafrojnë aparatin e tyre të mbrojtjes, sa më shumë të jetë e mundur, përmes harmonizimit, bashkimit dhe, aty ku është e përshtatshme, nëpërmjet specializimit të mjeteve të mbrojtjes dhe të aftësive, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në trajnime dhe logjistikë;*
- *Të marrin masa konkrete për të rritur disponueshmërinë, ndërveprimin, fleksibilitetin dhe kohën e dislokimit të forcave të tyre, duke i kushtuar rëndësi të veçantë identifikimit të objektivave të përbashkëta dhe rishikimit të procedurave kombëtare të vendimmarrjes;*
- *Të plotësojnë mungesat e identifikuara në kuadër të "Mekanizmit për Zhvillimin e Aftësive", por pa paragjykuar veprimet e ndërmarra në kuadër të NATO-s;*

Si përfundim mund të themi se, bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar është një mekanizëm i cili nxit forcimin e aftësive ushtarake të BE-së dhe motivon Shtetet Anëtare në plotësimin e objektivave të Helsinkit 2010. Mendoj se, kriteret e vendosura për realizimin e një bashkëpunimi të tillë, nga njëra ndikojnë në forcimin e aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të Shteteve Anëtare dhe nga ana tjetër ky lloj bashkëpunimi rrezikon krijimin e “dy shpejtësive” brenda BE-së, ku Shtetet Anëtare “më të vogla” për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore dhe financiare nuk do të jenë në gjendje të arrijnë objektivat e nevojshme për anëtarësim.

¹⁰⁰ Sophie Dagand, “The Impact of the Lisbon Treaty on ESDP”, *European Security Review*, Nr. 37 (Mars 2008),

<https://eclass.aueb.gr/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

¹⁰¹ Neni 1 i Protokollit 10 parashikon se: “*Bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar, siç referohet në Nenin 42(6) të TBE-së, do të jetë i hapur për çdo shtet anëtar, i cili angazhohet, që nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, të: (a) procedojë më intensivisht në zhvillimin e aftësive mbrojtëse nëpërmjet shtimit të kontributit kombëtar dhe pjesëmarrjes, kur është e përshtatshme, dhe në forca shumëkombëshe, në programet më të rëndësishme Europiane, dhe në aktivitetin e Agjencisë në fushën e zhvillimit të aftësive mbrojtëse, në kërkim shkencor, blerje dhe armatime; dhe (b) dhe të ketë kapacitetin të ofrojë deri në 2010, ose në nivel kombëtar ose në përbërje të forcave shumëkombëshe, njësi luftimi për misionet e planifikuara, të organizuara si grup luftimi, të shoqëruara me elementët mbështetës përfshirë transport dhe logjistikën e përshtatshme, të afta për të përmbushur detyrat e përcaktuara në Nenin 43 të TBE-së, brenda një periudhe kohore nga 5 në 30 ditë, në veçanti ndaj kërkesës së OKB-së, dhe që mund të zgjasin fillimisht për një periudhë 30 ditore dhe të shtyhen zgjaten më tej për të paktën 120 ditë”.*

- *Kualicioni i të aftëve dhe të gatshmëve*

Një mekanizëm tjetër bashkëpunimi, i cili nxit integrimin ushtarak të BE-së, është kualicioni i të aftëve dhe të gatshmëve (neni 42(5) të TBE-së)¹⁰². Ndonëse ky mekanizëm është përdorur edhe më parë në praktikë, parashikimi dhe rregullimi tij nga dispozitat e Traktatit garanton transparencën dhe legjitimitetin e tij, duke mënjanuar kundërshtimet.

Bazuar në këtë mekanizëm bashkëpunimi, Shtetet Anëtare që zotërojnë kapacitetet dhe aftësitë e duhura ushtarake dhe janë të gatshme për të përmbushur detyrat që u ngarkohen, janë përgjegjëse për ekzekutimin e tyre. Edhe pse misioni drejtohet nga Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, ato veprojnë në emër dhe për llogari të BE-së.

- *Klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë dhe ajo e solidaritetit*

Një tjetër risi e Traktatit të Lisbonës, e cila solli ndikim në PESMP-së, ishte përfshirja në të të “klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë”¹⁰³ dhe “klauzolës së solidaritetit”. Këto klauzola u hartuan në zbatim të dy parimeve të rëndësishme mbi të cilat ishte ndërtuar dhe funksiononte dhe vetë BE-ja, atë të solidaritetit dhe të ndihmës së ndërsjelltë midis Shteteve Anëtare.

Sipas “klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë”, Shtetet Anëtare kanë detyrimin të ndihmojnë çdo shtet tjetër anëtar i cili është viktimë e një sulmi të armatosur në territorin e tij, duke përdorur të gjitha mënyrat në dispozicion të tyre, përfshirë dhe përdorimin e forcave ushtarake nëse do të jetë e nevojshme. Megjithëse, përcaktimi i llojit të ndihmës dhe mbulimi i saj i përket shteteve dhe jo BE-së, autorë të ndryshëm mendojnë se ajo duhet të përbëjë një nga format e lejuara nga e drejta e tyre kombëtare¹⁰⁴.

¹⁰² Neni 42(5) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës parashikon se: “Këshilli mund të ngarkojë me përmbushjen e një detyre, brenda Bashkimit, një grup shtetesh anëtare me qëllim mbrojtjen e vlerave të bashkimit dhe t’i shërbejë interesve të tij. përmbushja e një detyre të tillë do të rregullohet nga mui 44...”. Ndërsa Neni 44 parashikon se: “...1. Brenda kuadrit të vendimit të marrë në pajtim me Nenin 43, Këshilli mund t’ia besojë zbatimin e një detyre një grupi Shtetesh Anëtare, të cilat janë të gatshme dhe kanë aftësitë e domosdoshme për përmbushjen e kësaj detyre. Shtet në bashkëpunim me përfaqësuesin e Lartë, do të bien dakort midis tyre për mënyrën e menaxhimit të detyrave. 2. Shtetet Anëtare pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrës kanë detyrimin, me iniciativën e tyre ose me kërkesë të ndonjë shteti anëtar, të mbajnë të informuar rregullisht Këshillin për progresin e bërë. Shtetet pjesëmarrëse duhet të informojnë menjëherë Këshillin nëse përmbushja e detyrës do të ketë pasoja të rëndësishme ose është e domosdoshme ndryshimi i objektivave, qëllimit ose të kushteve të përcaktuara, në vendimet e paragrafit 1. Në një rast të tillë Këshilli do të marrë vendimet e nevojshme...”.

¹⁰³ Klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë është pasuese e Nenit V të Traktatit të BEP-së, por në krahasim me të dhe me klauzolën e përfshirë në Draftin për Traktatin Kushtetues të cilat të dyja janë identike, klauzola e përfshirë në Traktatin e Lisbonës duket se është më pak detyruese. Traktati i Lisbonës përdor shprehjen “...Shtetet Anëtare të tjera do të kenë detyrimin për ndihmë dhe asistencë...”, ndërsa në Draft Kushtetutën dhe në Nenin V të Traktatit të BEP-së përdoret shprehja “...Shtetet Anëtare të tjera asistojnë...”. Gjithashtu në Nenin V të Traktatit të BEP-së Shtetet Anëtare do të ndihmojnë Shtetin e sulmuar ushtarakisht dhe me çdo mjet tjetër në dispozicion të tyre. Termi “ushtarakisht” nuk është pjesë e dispozitës në Traktatin e Lisbonës.

¹⁰⁴ Patrick Keatinge dhe Ben Tonra, “European, Security and Defence Policy and the Lisbon Treaty”, *The Institute of International and European Affairs* (2009), fq.17, <http://www.iea.com/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

Vënia në zbatim e klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë, karakterizohet nga dy kufizime: *së pari*, ndihma e ofruar në një rast të tillë duhet të ishte në pajtim me Nenin 51 të Kartës së OKB-së dhe me karakteristikat e veçanta të politikës të sigurisë dhe të mbrojtjes të Shteteve Anëtare¹⁰⁵, *së dyti*, mungesa e detyrueshmërisë së zbatimit të saj, e cila buron nga fakti që neni 24 i TBE-së ngarkonte Përfaqësuesin e Lartë me përgjegjësinë për të garantuar zbatimin e politikave që lidheshin me PESMP-në, i cili vetëm mund të ushtronte presion publik ndaj shteteve të cilat i shmangeshin detyrimeve të ndërmarra nën klauzolën e mbrojtjes së ndërsjelltë, dhe nga mungesa e juridiksionit të GJED-së në çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në, e cila e bën të pamundur që ky institucion të vërë në zbatim një detyrim në kuadër të klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë¹⁰⁶.

Sipas klauzolës së solidaritetit, BE-ja dhe Shtetet Anëtare duhet të veprojnë së bashku, në rast se një shtet tjetër anëtar është objekt i një sulmi terrorist ose viktimë e një katastrofe të shkaktuar nga njeriu, duke mobilizuar të gjitha instrumentet në dispozicion të tyre, përfshirë edhe forcat ushtarake¹⁰⁷. Pyetja që shtrohet në këtë rast është nëse tog fjalëshi “sulum terrorist” a përfshihet në kategorinë e “sulmit të armatosur” në kuptim të klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë? Dhe nëse po, cila klauzolë do të zbatohet në një rast të tillë?

Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, fillimisht duhet të kemi parasysh kontekstin historik në të cilin u përfshi klauzola e solidaritetit, i cili ishte ai i pas sulmeve terroriste në Madrid¹⁰⁸. Nëse hartuesit e Traktateve do të pranonin që klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë do të zbatohet edhe në rastin e një sulmi terrorist, me shumë mundësi klauzola e solidaritetit nuk do të përfshihej në Traktat. Për këtë arsye klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë, pasuese e klauzolës së mbrojtjes të parashikuar në Traktatin e BEP-së, do të gjejë zbatim vetëm në rastin e një agresioni të armatosur të ardhur nga shtete.

Vënia në zbatim e klauzolës së solidaritetit do të jetë e mundur vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: *së pari*, Ekzistenca e kërkesës së autoriteteve politike të shtetit anëtar të cënuar. *Së dyti*, ndërhyrja të realizohet për të parandaluar një sulm terrorist, për mbrojtjen e institucioneve demokratike dhe të popullsisë civile nga çdo sulm terrorist dhe për të asistuar në territorin e tij një Shtet Anëtar të prekur nga një sulm terrorist ose nga një katastrofë të shkaktuar nga njeriu.

Ashtu si në rastin e klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë, edhe në rastin e klauzolës së solidaritetit gjen zbatim Neni 24(1) i TBE-së dhe në të nuk parashikohet asnjë mjet ligjor që i

¹⁰⁵ Në momentin e zhvillimit të negociimeve hartuesit e Traktatit të Lisbonës u ndeshën me tre grupe Shtetesh Anëtare: a. ato të cilat ishin pro përfshirjes së klauzolës së mbrojtjes reciproke, b. ato të cilët përpiqeshin të ruanin pozicionin e tyre neutral dhe c. ato të cilët përpiqeshin që përfshirja e një klauzole të tillë të mos ndikonte në rolin e NATO-s, pasi shprehja “...në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n...” mungonte në tekstin e Traktatit.

¹⁰⁶ Michael J. Austin, “Style or Substance? An Analysis of the Major Reforms to CFSP by the Treaty of Lisbon”, *Working Papers*, Nr. 1 (2011), <http://law.stanford.edu/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

¹⁰⁷ Neni 222(1) TFBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018)..

¹⁰⁸ *Declaration of the European Council on combating terrorism* (Bruksel, 25 Mars 2004), fq. 18, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).

detyron Shtetet Anëtare të përmbushin angazhimet e tyre. Kjo mungesë detyrueshmërie paraqitet më problematike në rastin e klauzolës së solidaritetit për dy arsye: *së pari*, mungesa e një kufizimi të qartë të termit “asistim” të përdorur në nenin 222(2) të TFBE-së e zgjeron së tepërmi natyrën e ndihmave që mund të ofrojnë Shtetet Anëtare, që nga ato të karakterit ekonomik, në burime njerëzore deri në ato të natyrës ushtarake; dhe *Së dyti*, mospërcaktimi në Traktat se cilat veprime do të konsiderohen sulm terrorist lë vend për abuzime, duke justifikuar çdo ndërhyrje të Shteteve Anëtare në zbatim të klauzolës së solidaritetit.

c. Buxheti i BE-së dhe krijimi i “fondit bazë”

Në lidhje me financimin e misioneve dhe të operacioneve të ndërmarra në kuadër të PESMP-së, Traktati i Lisbonës ruajti procedurën normale, e cila do të garantonte një akses më të shpejtë në buxhetin e BE-së në rastin e financimit të aktiviteteve përgatitore të misioneve civile për realizimin e detyrave të përcaktuara në Nenin 42(1)¹⁰⁹ dhe 43 të TBE-së¹¹⁰. Ndërsa për ato aktivitete financimi i të cilave nuk do t'i ngarkoheshin buxhetit të BE-së, Neni 41(3) parashikon krijimin e një “fondi bazë” të përbërë nga kontributet e Shteteve Anëtare¹¹¹. Ky mekanizëm do të gjejë zbatim si për mbulimin e shpenzimeve ushtarake dhe për ato civile, që do të realizohen për përmbushjen e detyrave të përcaktuara nga nenet 42(1) dhe 43 të TBE-së. Pra, ai është i kufizuar vetëm në rastin e veprimeve të ngutshme që kanë të bëjnë me planifikimin dhe nisjen e operacioneve, duke mos mbuluar aktivitetet e mëtejshme.

Parashikimi i një mekanizmi të tillë financimi (neni 41 i TBE-së, i ndryshuar), i cili krijohet nga kontributet e Shteteve Anëtare dhe që është jashtë kontrollit të Parlamentit European, do të garantonte një akses më të shpejtë për financimin e veprimeve përgatitore të misioneve dhe operacioneve të PESMP-së dhe rritjen e fleksibilitetit të veprimit të BE-së në raste emergjente. Por nga ana tjetër, ky fond do të jetë objekt i kontrollit nga parlamentet kombëtare, duke qenë se këto fundit do të ushtrojnë kontroll mbi qeveritë e Shteteve Anëtare që e financojnë atë.

Për sa më lart, mendoj se, ndonëse Parlamenti European nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë mbi fondin bazë, si një institucion që kontrollon shpenzimet e BE-së, ai gëzon të drejtën e konsultimit, bazuar në nenin 41(3) dhe nga ana tjetër, edhe pse parlamentet kombëtare mund të

¹⁰⁹ 1. Neni 42 (1) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funksit më 23 Prill 2018).

¹¹⁰ Neni 43 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës parashikon se: “1. Detyrat e përcaktuara në Nenin 42(1), gjatë të cilave Bashkimi mund të përdorë mjete ushtarake dhe civile, përfshijnë operacionet e përbashkëta të çarmatimit, detyrat humanitare dhe të shpëtimit, këshillim ushtarak dhe detyra asistuese, parandalimin e konflikteve dhe ato paqeruajtëse, operacione ushtarake gjatë menaxhimit të krizave, përfshirë dhe misionet paqebërëse, dhe stabilizimin e situatës pas konfliktit. Të gjitha këto detyra mund të kontribuojnë në luftën kundër terrorizmit, përfshirë dhe mbështetjen e shteteve të treta në luftën kundër terrorizmit në territoret e tyre.”.

¹¹¹ Neni 41(3) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës parashikon se : “...3. Këshilli do të miratojë vendimet që do të përcaktojnë procedurat për të garantuar akses të shpejtë në buxhetin e Bashkimit për financimin e iniciativave në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, dhe në veçanti për veprimet përgatitore në lidhje me detyrat e përcaktuara nga Neni 42(1) dhe Neni 43. Ai do të veprojë pas konsultimit me Parlamentin European. Veprimet përgatitore të cilat nuk janë në ngarkim të buxhetit do të financohen nga një fond bazë i krijuar me kontributet e Shteteve Anëtare.”.

kontrollojnë qeveritë e Shteteve Anëtare ato nuk kanë ndonjë pushtet real mbi këtë fond. Për këto arsye, duke qenë se, as Parlamenti Europian dhe as parlamentet kombëtare nuk kanë mundësi efektive kontrolli mbi fondin që financon veprimet përgatitore, ligjshmëria e tij vihet në dyshim.

d. Agjencia Europiane e Mbrojtjes

Me Traktatin e Lisbonës AEM-ja bëhet pjesë të tij, duke u konsideruar si një institucion *sui generis* i BE-së dhe baza ligjore për funksionimin e saj do të ishte vetë traktati. Ky Traktat zgjeron më tej kompetencat e AEM-së duke e angazhuar atë në zbatimin e bashkëpunimit të përhershëm të përforcuar, nëpërmjet vlerësimit të performancës së Shteteve Anëtare pjesëmarrëse, bazuar në aftësitë e tyre¹¹². Gjithashtu, bazuar në nenet 42(3) dhe 45(1) të TBE-së AEM-ja ka për detyrë: a.) të përcaktojë kërkesat operacionale dhe të promovojë marrjen e masave për realizimin e tyre, b.) të kontribuojë në identifikimin, dhe kur është e përshatshme, në zbatimin e çdo mase të nevojshme për forcimin e industrisë dhe të teknologjisë në sektorin e mbrojtjes dhe të përmirësimit të efektshmërisë së shpenzimeve ushtarake, c.) të marrë pjesë në përcaktimin e aftësive dhe kapaciteteve Europiane, d.) të hartojë një politikë për armatimet, e.) të asistojë Këshillin në procesin e vlerësimit të përparimit të bërë në përmirësimin e aftësive ushtarake, dhe f.) të mbështesë dhe të koordinojë kërkimin në fushën e teknologjisë së mbrojtjes¹¹³.

Në lidhje me pjesëmarrjen dhe të mënyrës së organizimit të saj, mund të themi ajo është e hapur për të gjitha Shtetet Anëtare (neni 45(2) i TBE-së, i ndryshuar), të cilat mund të krijojnë nën grupe brenda saj me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta. Për arsye se përbëhet nga Shtetet Anëtare, AEM-ja ka karakter ndërqeveritar.

2.3 Bashkëpunimi NATO-BE pas Lisbonës

BE-ja dhe NATO janë themeluar dhe funksionojnë mbi të njëjtat vlera dhe interesa strategjike, sidomos përse i përket çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë, mbrojtjen dhe menaxhimin e krizave. Forcimi i PESMP-së të BE-së është në interes edhe të NATO-s, në kuadër të ruajtjes së sigurisë së përbashkët. Pas ndryshimeve të bëra në Traktatet e BE-së, miratimit të mekanizmave që rrisin kapacitetet dhe asetet e BE-së dhe forcojnë bashkëpunimin me NATO-n, marrëdhënia e tyre pas Lisbonës mund të përmblihet në këto karakteristika: bashkëpunim më i ngushtë, transparencë më e madhe, efikasitet dhe autonomi i vazhdueshme.

Pas Luftës së Ftohtë dhe rënies së Bashkimit Sovjetik, interpretimi i zgjeruar i nenit 2 dhe 4 të Traktatit të Uashingtonit, i cili parashikonte se palët do të konsultohen së bashku në rast se, sipas mendimit të tyre, tërësia territoriale, pavarësia politike ose siguria e ndonjë prej tyre vihet në rrezik, i shërbyen NATO-s për të justifikuar zgjerimin e rolit të saj ushtarak dhe civil dhe ndërhyrjen në fusha të tjera veprimi si: siguria, menaxhimi i krizave dhe kontrolli i armëve¹¹⁴. Në

¹¹² Neni 3 i Protokollit 10.

¹¹³ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

¹¹⁴ NATO, *The North Atlantic Treaty* (04 Prill 1949), Nenet 2 dhe 4, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

përshtatje të ambicieve të reja të NATO-s, në Nëntor 2010 ajo adoptoi Konceptin e Ri Strategjik sipas së cilit, një nga detyrat më të rëndësishme të Aleancës do të ishte ruajtja dhe mbrojtja e territorit dhe e popullsisë së saj nga çdo sulm i mundshëm.

Të gjitha këto masa, bënë që NATO të lëvizte nga një organizatë e angazhuar në mbrojtjen kolektive të anëtarëve të saj, në një organizatë të angazhuar në sigurinë ndërkombëtare. Ndërkohë, nga ana tjetër BE-ja i kushton më tepër rëndësi mjeteve diplomatike për zgjidhjen e konflikteve sesa zhvillimit të një politike të sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët dhe ruajtjes së tërësisë territoriale saj. Pra, duket sikur komponenti ushtarak i NATO-s, e cila vepron si një aleancë ushtarake, dhe ai civil i BE-së, e cila për zgjidhjen dhe menaxhimin e situatave të krizave përdor diplomacinë dhe misionet e saj civile *par excellence*, plotësojnë njëri tjetrin duke i dhënë mbrojtjes ndërkombëtare një dimension më të plotë.

Fuqia ushtarake e vendeve të NATO-s, ndonëse luan një rol të rëndësishëm në rastin e ndërhyrjeve të Alencës dhe garanton arritjen e rezultateve më të shpejta dhe efektive, jo gjithmonë përbën avantazh. *Së pari*, në menaxhimin me sukses të një situatë krize nuk ka rëndësi vetëm komponenti ushtarak, duke maksimizuar rezultatin e përdorimit të forcës ushtarake, të resurseve dhe të ekspertizës së duhur ushtarake, por edhe ai civil, i cili reflektohet në aftësinë për të ekzekutuar detyra delikate si mbrojtja e të drejtave të njeriut, sigurimi i kufinjve dhe i civilëve, ndërmarrja e operacioneve humanitare, garantimi i aseteve dhe infrastrukturës të domosdoshme për vazhdimin e aktivitetit, parandalimi i konflikteve dhe stabilizimi i situatës pas konfliktit. Detyra, të cilat mund të themi se janë fusha e veprimtarisë së BE-së. *Së dyti*, financuesi më i madh i operacioneve të NATO-s është SHBA-ja, angazhimi i së cilës ka dy anët e saj të medaljes. Nga njëra anë, teknologjia dhe forcat ushtarake të vëna në dispozicion nga SHBA-ja i japin NATO-s një rol të rëndësishëm parandalues dhe mbrojtës dhe nga ana tjetër vetëm disa nga aletatët, për shkak të papajtueshmërisë në teknologji dhe mungesës së ndërveprimit, mund të bashkëpunojnë me të. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e aleatëve janë shndërruar në mbështetës të operacioneve të drejtuara nga superfuqia amerikane, operacione të cilat reflektojnë kryesisht interesat e Uashingtonit. *Së treti*, pamundësia ekonomike dhe politike e aleatëve për të përballuar shpenzimet në fushën e mbrojtjes¹¹⁵.

Duke iu rikthyer, rolit të NATO-së në sigurinë dhe mbrojtjen europiane, mund të themi se që nga themelimi i PESM-së, ajo i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dhe marrëdhënive me Aleancën, duke përfshirë dhe Traktatin e Lisbonës. Risitë e prezantuara me Traktatin e Lisbonës ndikuan jo vetëm në forcimin e PESMP-së por, edhe në marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe NATO-s.

Parashikimi i klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë, në nenin 42(7) të TBE-së, duket se krijon mundësinë e një mbivendosje me rolin e NATO-s për të garantuar një mbrojtje të përbashkët për shtetet anëtare të saj, që janë njëkohëshit dhe anëtare të BE-së. Por në fakt mundësia që BE-ja të garantojë një mbrojtje të përbashkët për këto shtete është mjaft e vështirë për arsye se, në Traktatin e Lisbonës është përcaktuar qartësisht se angazhimet dhe bashkëpunimi

¹¹⁵ Simon Duke, "The EU, NATO and the Lisbon Treaty: still divided within a common city", *The European Union Studies Association Conference*, 3-5 Mars 2011 Boston, Massachusetts.

në fushën e PESMP-së do të realizohet në pajtim me angazhimet që disa Shtete Anëtare të saj kanë në kuadër të NATO-s, për të cilat kjo e fundit luan rolin kryesor në hartimin dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes në kuadër të realizimit të mbrojtjes kolektive.

Arsye tjetër është edhe neutraliteti i deklaruar nga disa Shtete Anëtare, të cilat nuk kanë asnjë qëllim që të ndryshojnë politikat e tyre kombëtare të mbrojtjes për të garantuar marrjen pjesë në realizimin e objektivave të PESMP-në. Kjo do të thotë që, BE-ja nuk zotëron aftësitë e duhura për të mobilizuar forcat e saj në angazhime për mbrojtjen territoriale. Por, në disa raste mbivendosja ka qenë domosdoshmëri.

Risia tjetër që solli Traktati i Lisbonës ishte dhe zgjerimi i “Detyrave të Petërsbergut”, duke përfshirë në to këshillimin ushtarak, asistencën ushtarake dhe parandalimin e konflikteve, detyra të cilat që nga 1994 përmbusheshin nga NATO në kuadër të programit të Partneritetit për Paqe. Megjithatë, kjo mbivendosje jo domosdoshmërisht mund të nxisë konkurrencën midis këtyre dy organizatave, për arsye se sipas “Marrëveshjeve të Berlin Plus”, BE-ja do të drejtojë operacionet në ato raste kur NATO nuk do të marrë pjesë. Në këtë drejtim misionet e drejtuara nga BE-ja pa mbështetjen e NATO-s, si Concordia në Maqedoni, Eufor Althea në Bosnje dhe Atemis në RDK, janë shembull i suksesit të zbatimit të këtyre marrëveshjeve. Por, këto marrëveshje nuk rezultuan aq të suksesshme në rastin e konfliktit në Sudanin Perëndimor, ku për shkak të argumentave të dhëna nga SHBA-ja dhe Franca të dyja organizatat ishin në mëdyshje se kush duhet të drejtonte menaxhimin e krizës¹¹⁶. Pra, zgjerimi i “Detyrave të Petërsbergut” në vetvete as nuk nxiti bashkëpunimin midis dy organizatave dhe as nuk e rrit konkurrencën midis tyre, pasi përmbushja e çdo detyre do të varet nga bashkëbisedimi dhe konsultimi ndërmjet BE-së dhe NATO-s.

Dispozitat e Traktatit të Lisbonës i kushtojnë rëndësi bashkëpunimit BE-NATO në kuadër të PESMP-së, duke afirmuar dhe detyrimin e saj për të respektuar angazhimet që Shtetet Anëtare kanë në kuadër të NATO, sidomos përsa i përket mbrojtjes së përbashkët ndonëse natyra e këtij bashkëpunimi mbetet e pa detajuar. Për këtë arsye dhe për të krijuar një ide në lidhje me natyrën e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe NATO-s duhet t’i referohemi dokumentave të tjerë, siç janë strategjitë e sigurisë të hartuara nga këto dy organizata, konkretisht SES-së të miratuar nga BE-ja në 2003 dhe Konceptit të Ri Strategjik (në vijim KRS) të miratuar në 2010 nga NATO.

Referuar këtyre dy dokumentave, në lidhje me natyrën e çështjeve që mbulojnë këto dy organizata, pavarësisht ndryshimeve të vogla, “konceptet e sigurisë” janë të ngjashme. Si rreziqe të së ardhmes që i kanosen paqes dhe sigurisë botërore të dy këto strategji kanë parashikuar terrorizmin, pasurimin e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, mosfunksionimin e shtetit të së drejtës dhe të demoracisë, krimin e organizuar, piraterinë, ndryshimet klimaterike dhe çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimin kompjuterik, duke i bërë në këtë mënyrë të dy organizatat kompetente për të ndërhyrë në çështje të tilla. Për sa

¹¹⁶ Major Andreas Winter and Dr. David A. Anderson, “Implications of the Lisbon Treaty on the European Union’s Common Security Defense Policy and the Emerging Strategic Partnership Between NATO and the EU”, Volume 10, Issue 3, 2011.

i përket mënyrës sesi do të realizohej koordinimi i veprimeve të tyre dhe cila organizatë do të luante rolin drejtues, këto dokumente nuk kanë parashikuar asgjë duke ia lënë në dorë diskutimeve të së ardhmes¹¹⁷.

Të dy strategjitë theksojnë rëndësinë që ka bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe NATO-s në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë, ku SES-ja i kushton rëndësi rolit që kanë marrëdhëniet transatlantike në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë globale, dhe jo vetëm interesave dypalëshe, ndërsa KRS-ja e vlerëson si strategjik partneritetin NATO-BE dhe cilëson faktin se të dy organizatat luajnë një rol plotësues dhe të përbashkët në forcimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Gjithashtu, KRS-ja njerr në pah dhe vendosshmërinë e NATO-s për të qenë aktor në sigurinë ndërkombëtare nëpërmjet zhvillimit të partneritetit me shtete dhe organizata ndërkombëtare nën logon e “siguri bashkëpunuese” dhe rikonfirmon rolin e saj në mbrojtjen kolektive.

Në përfundim mund të themi se, përsa i përket anës strategjike si BE-ja ashtu edhe NATO janë duke zhvilluar fusha veprimi të cilat janë të ngjashme, për të cilat ato mund të jenë dhe në konkurrencë me njëra tjetrën, sidomos përsa i përket ndërhyrjeve civile dhe diplomatike. Por praktika ka treguar se, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë të dyja organizatat kanë arritur të jenë partnerë dhe të udhëheqin misione plotësuese. Ndërsa interesi i BE-së paraqitet kryesisht në misionet civile, të cilat nuk janë në fushën e interesit të NATO-s, misionet e kësaj të fundit kanë qenë kryesisht të natyrës ushtarake në kuadër të klauzolës së mbrojtjes kolektive. Gjithashtu, BE-ja ka ndërmarrë misione në ato raste kur NATO nuk ka qenë e angazhuar (shiko tabelën 3).

Përmirësimi i strukturës institucionale dhe krijimi i mekanizmave që do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare nuk janë të mjaftueshëm për zhvillimin e PESMP-së, nëse ajo nuk do të jetë e ndërtuar mbi parime dhe vlera të gjithëpranuara. Përsa i përket vlerave mbi të cilat bazohet politika e jashtme e BE-së, neni 21 i Traktatit parashikon si të tilla demokracinë, shtetin e së drejtës, universalitetin dhe pandashmërinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimin e dinjitetit njerëzor, parimet e barazisë dhe solidaritetit dhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të së drejtës ndërkombëtare. Vetëm parashikimi në teori i tyre nuk është i mjaftueshëm, por këto vlera, ide dhe praktika duhet të pasqyrohen edhe në mënyrën sesi misionet do të planifikohen dhe realizohen, duke krijuar një kulturë për një strategji të përbashkët¹¹⁸.

Pavarësisht vlerave të pasqyruara në Traktat, në të vërtetë veprimet e BE-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes janë karakterizuar nga:

- **Një axhendë humanitare “përzgjedhëse”** - Në kuadër të PESM-së BE-ja ka ndërmarrë misione duke ndërhyrë në raste konfliktesh ose duke kontribuar në stabilizimin e situatës së pas konfliktit. Duke marrë në analizë këto misione arrijmë në konkluzionin se si shkak për realizimin e këtyre ndërhyrjeve humanitare ose ka qenë frika e BE-së se kriza mund

¹¹⁷ Simon Duke, “The EU, NATO and the Lisbon Treaty: still divided within a common city”, *The European Union Studies Association Conference* (3-5 Mars 2011 Boston, Massachusetts), fq 8.

¹¹⁸ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

të përbënte rrezik për sigurinë e saj, siç ishte rasti i ndërhyrjes në Bosnje Hercegovinë dhe Kosovë, ose politika këmbëngulëse e ndonjë prej shteteve anëtare, si psh, rasti i Francës për misionin në Afrikë. Madje jo të paktat kanë qenë rastet, kur BE-ja ka vendosur të ndërhyjë në çështjet e brendshme të shteteve të treta, edhe pse në kundërshtim me sovranitetin e këtyre shteteve.

- **Një zhvillim i ngadaltë i instrumentave civile të menaxhimit të krizave** – Ndonëse numrin më të madh të misioneve të ndërmarra nga BE-ja e zënë ato të natyrës civile krahasuar me ato ushtarake, investimet e bëra nga Shtetet Anëtare për arritjen e objektivave civile janë të pakta. Në kushtet kur ato i kanë kushtuar më tepër rëndësi rritjes së aftësive dhe kapaciteteve ushtarake dhe forcimit të mbrojtjes së tyre kombëtare, progresi në drejtim të forcimit të aftësive dhe kapaciteteve civile ka qenë i ngadaltë.
- **Mungesa e interesave të qarta dhe të mirëpërcaktura për BE-në** - Dështimi në hartimin e një SES-je në kohërecë me zhvillimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, është një tregues i mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme të Shteteve Anëtare në fushën e gjeopolitikës. Interesat kombëtare të Shteteve Anëtare kanë përparësi mbi interesat e BE-së dhe disa prej tyre ndërmarrin misione në mënyrë të njëanshme bazuar në interesat e tyre gjeopolitike. Por megjithatë, zhvillimet e fundit tregojnë se sfidat e të reja me të cilat po përballet siguria europiane si pirateria, ndryshimet klimaterike, pasurimi i armëve të shkatërrimit në masë, krimi kibernetik dhe trafikimi i qenieve njerëzore, mund të ndikojnë në afrimin e tyre për ndërtimin e një strategjie të bazuar mbi vlerat dhe parimet e përbashkëta¹¹⁹.
- **Intresat e Shteteve Anëtare në zona të ndryshme gjeografike** – Angazhimi në Ballkanin Perëndimor në kuadër të PMSP-së mund të përbëjë një nga rastet e pakta ku Shtetet Anëtare kanë arritur shkallën më të lartë të konsensusit, pasi ndërhyrjet e BE-së janë karakterizuar, kryesisht, nga interesat e Shteteve Anëtare në zona të ndryshme gjeografike, siç ishte rasti i Francës në Afrikë. Ndërmarrja e misioneve në rajonet më të largëta varet më tepër nga bashkëpunimi *ad hoc* midis grupeve të Shteteve Anëtare që kanë interes në një rast të tillë dhe nga vullneti i shteteve të “mëdha”, të cilat disponojnë pjesën më të madhe të aseteve dhe kapaciteteve, sesa janë të bazuara në një strategji të mirëpërcaktuar europiane. Për këtë arsye, BE-ja është larg të qënurit një aktor global.
- **Bashkëpunimi me aktorët ndërkombëtarë** – Ndonëse BE-ja e ka lënë të hapur mundësinë e pjesëmarrjes së shteteve të treta në misionet e ndërmarra në kuadër të PESMP-së, si: Asosacioni i Shteteve të Azisë Juglindore, Unioni Afrikan, OKB-ja dhe NATO, jo në çdo rast bashkëpunimi me to paraqitet i lehtë, duke pasur parasysh faktin që instiucionet dhe prioritetet e këtyre shteteve ose organizatave nuk janë gjithmonë të ngjashme me ato të BE-së.
- **Mungesa e mandatit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së** – Për BE-në është akoma e rëndësishme që misionet të ndërmarra në kuadër të PESMP-së të jenë në pajtim me të

¹¹⁹ Jeffrey S. Lantis, “Strategic Culture: from Clausewitz to Constructivism”, *Strategic Insights*, Vol. IV, Nr. 10 (Tetor 2005), fq. 1-13, <http://jeffreylantis.com/> (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

drejtën ndërkombëtare dhe të shoqëruara me mandatin e Këshilli të Sigurimit të OKB-së (në vijim KS), i cili do të garantonte legjitimitetin politik dhe publik të tyre. Madje për disa Shtete Anëtare ky mandat përbën parakusht për të marrë pjesë në misione, ndërsa për të tjera është më pak i rëndësishëm. Për këtë arsye, për të shmangur ndonjë bllokim të mundshëm Traktati i Lisbonës parashikoi një mekanizëm të ri bashkëpunimi, kualicionin e të aftëve dhe të gatshmeve, që garanton mundësinë e realizimit të interesave strategjike të disa shteteve edhe në mungesë të mandatit nga KS të OKB-së¹²⁰.

¹²⁰Vasilis Margaras, “Common Security and Defence Policy and the Lisbon Treaty Fudge: No common strategic culture, no major progress”, *Working Paper*, Nr. 28 (Qershor 2010), fq.9, <https://www.ceps.eu/> (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

KAPITULLI III

STATUSI LIGJOR I BASHKIMIT EUROPIAN DHE ZBATUESHMËRIA E NORMAVE TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Pas shekullit të 17' rolin kryesor në arenën ndërkombëtare e luanin shtetet kombëtare. Nevoja për bashkëpunim në çështje të cilat nuk mund të adresoheshin vetëm në nivel kombëtar si ato që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen, mjedisin dhe ekonominë, solli grupimin e shteteve në struktura, të cilat kishin institucione të pavaruara nga shtetet që bënin pjesë në to dhe që karakterizoheshin nga bashkëpunimi ndërqeveritar. Fillesat e këtyre organizatave ndërkombëtare i gjejmë gjatë shekullit të 19' në formën e konferencave dhe të kongreseve ndërkombëtare të cilat ishin të natyrës politike, ekonomike, diplomatike ose teknike. Me krijimin e strukturave të qarta dhe organeve drejtuese të përhershme ato kanë marrë tiparet e një organizate ndërkombëtare.

Togfjalëshi "Bashkim Europian" filloi të qarkullonte në Europë kryesisht në mesin e viteve '70, kur kryeministrit Belg, Leo Tindemans, u ngarkua me detyrën e hartimit të një draft raporti në lidhje me këtë koncept, të cilin ai e përshkroi si një fazë të re të unifikimit të Europës, që do të arrihej nëpërmjet "*ndryshimeve cilësore*" të lidhura me forcimin e institucioneve të Bashkimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërqeveritar në çështjet komunitare¹²¹. Me Traktatin e Mastrihtit ky koncept që u bë pjesë e rendit juridik europian, parashikonte krijimin e BE-së si një proces i cili do të afronte më shumë Bashkimin me qytetarët europiane (Neni A), duke vendosur si objektiv konfirmimin e identitetit të tij në arenën ndërkombëtare nëpërmjet zbatimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët (neni B).

Për realizimin e kësaj objektivie ishte e domosdoshme që ai të ishte i pajisur me personalitet juridik dhe të shfaqej si një subjekt i së drejtës ndërkombëtare i aftë për të vepruar dhe për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me organizata ndërkombëtare ose aktorë të tjerë. Në lidhje me mundësinë e pajisjes me personalitet juridik të BE-së, disa arsyetuan se ajo do të rrezikonte ruajtjen e sovranitetin kombëtar në çështjet e politikës së jashtme, ndërsa të tjerë se do të ndikonte në personalitetin e Komunitetit, duke mos arritur në një konsensus.

Në lidhje me Traktatin e Amsterdimit, mund të themi se, edhe pse ai shprehimisht nuk e njihte personalitetin juridik të BE-së, ai i njohu kësaj të fundit të drejtën e përfundimit të marrëveshjeve në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë dhe në atë të bashkëpunimit policor dhe në drejtësi. Për arsye se, këto marrëveshje do të negociroheshin nga Presidenca e Bashkimit dhe do të nënshkruheshin nga Këshilli, i cili ishte një insitucion "komunitar", efekti detyrues i tyre shtrihej mbi BE-në dhe jo mbi tërësinë e Shteteve Anëtare që e përbënin atë¹²². Pra, edhe pse Traktati nuk e njihte shprehimisht personalitetin juridik të BE-së, pasi në të parashikohej se Shtetet Anëtare ruanin të drejtën të kërkonin ratifikimin e marrëveshjes nga

¹²¹ Leo Tindemans, "European Union", *Bulletin of the European Communities*, Supplement 1/76, fq. 12

¹²² R. Passos dhe S. Marquardt, *Genesis and Destiny of the European Constitution* (Bruylant, Bruksel, 2007), fq. 883.

parlamentet kombëtare, mendoj se njohja e së drejtës së Bashkimit për të përfunduar marrëveshje ndërkombëtare është një nga karakteristikat kryesore të personalitetit juridik ndërkombëtar.

Situata bëhet akoma më e paqartë me Traktatin e Nicës, ku ndërsa neni 24 paragrafi 3 i tij parashikonte se marrëveshjet do të miratoheshin nga Këshilli me shumicë të cilësuar, paragrafi 6 i po këtij neni parashikonte se marrëveshjet janë të detyrueshme për institucionet e Bashkimit. Të dy këto paragrafë nuk mund të shpjegohen pa nënkuptuar ekzistencën e një identiteti të pajisur me personalitet juridik dhe i aftë të nënshkruajë marrëveshje, të cilat do të jenë të detyrueshme për institucionet e tij dhe për Shtetet Anëtare që kanë votuar kundër¹²³.

Do të ishte hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës që do të shënonte shkrirjen e strukturës së “tre shtyllave” dhe njohjen e një personaliteti të vetëm juridik për BE-në, i cili do t’i mundësonte asaj nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare. Duke vepruar si një entitet i vetëm i pajisur me personalitet juridik, Bashkimi do të mund të mbajë një qëndrim të tijin dhe të ndërmarrë veprime në arenën ndërkombëtare¹²⁴. Por, ky Traktat nuk jep sqarime se çfarë do të kuptohet me personalitet juridik të BE-së dhe nëse ai do të shtrihet edhe në fushën e PJSP-së. Për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve dhe për të krijuar një ide më të qartë se çdo të përfshijë “personaliteti juridik”, fillimisht do të ndalem në sqarimin e kuptimit të personalitetit juridik dhe më pas sesi ai gjen zbatim në rastin e BE-së.

Personaliteti juridik i një organizate ndërkombëtare, i cili karakterizohet nga aftësia e saj për të nënshkruar marrëveshje me organizata të tjera ndërkombëtare ose aktorë ndërkombëtarë dhe për të vendosur marrëdhënie dypalëshe bashkëpunimi me to, mund të burojë nga aktet themeluese të saj ose se t’i njihet nga normat e së drejtës ndërkombëtare publike, siç ishte rasti i OKB-së. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (në vijim GJND), në çështjen për shpërblimin e dëmeve ndaj agjentëve të OKB-së në detyrë, pas analizës së përmbajtjes së akteve themeluese, të praktikës së veprimtarisë dhe të drejtave dhe detyrimeve të OKB-së, u shpreh se shtetet anëtare duke i njohur asaj disa funksione, së bashku me të drejtat dhe përgjegjësitë që i shoqërojnë ato, e kanë veshur atë me kompetencat e nevojshme që do t’i mundësojnë përmbushjen e tyre.

Në vijim të analizës së këtij opinionimi këshillimor rezulton se, tre janë kriteret të cilat përcaktojnë personalitetin juridik të një organizate¹²⁵:

- Ekzistenca e një bashkimi të qëndrueshëm shtetesh i pajisur me strukturën e duhur institucionale.
- Një ndarje e qartë e kompetencave dhe e qëllimeve të organizatës nga ato të shteteve anëtare.
- E drejta për të ushtruar kompetenca legjislative në arenën ndërkombëtare.

Duke iu rikthyer rastit të BE-së, në lidhje me plotësimin e këtyre tre kriterëve konstatoj se:

¹²³ G. Milton dhe J. Keller-Noëllet, *The European Constitution* (John Harper Publishing, 2005), fq. 22.

¹²⁴ Neni 47 i TBE-së, i ndryshuar.

¹²⁵ International Court of Justice, *Reparation for Injuries Suffered in the Service of the United Nations*, *International Court of Justice* (11 Prill 1949), <http://www.icj-cij.org/docket/files/4/1837.pdf> (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

Së pari, neni 37 i TBE-së, i ndryshuar, i njeh BE-së të drejtën e nënshkrimit të marrëveshjeve në fushën e PJSP-së dhe të PESMP-së, si pjesë përbërëse e saj, me një ose disa shtete të treta ose organizata ndërkombëtare (marrëveshjet e nënshkruara me Bosnje Hercegovinën, Maqedoninë, RDK etj në rastin e misioneve për menaxhimin e krizave dhe me shtetet e treta si Zvicra, Kili, Maroku dhe Zelanda e Re, si shtete që morën pjesë në operacionet paqeruajtëse të udhëhequra nga BE-ja). Këto marrëveshje duhet të jenë në përputhje me politikën e BE-së dhe mund të nënshkruhen vetëm atëherë kur janë të domosdoshme për arritjen e ndonjë nga objektivat e parashikuara në Traktat, kur detyrueshmëria për nënshkrimin e tyre buron nga një akt ligjor i detyrueshëm për Bashkimin dhe në rast se nënshkrimi i tyre do të ketë efekt mbi rregullat e përbashkëta ose të ndryshojë qëllimin e tyre. Marrëveshje të tilla, të nënshkruara nga BE-ja, do të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar jo vetëm nga institucionet e saj por edhe nga Shtetet Anëtare¹²⁶. Në lidhje me objektin e këtyre marrëveshjeve, mund të themi se ato mund të përfshijnë marrjen përsipër të të drejtave dhe detyrimeve reciproke, ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta ose zbatimin e një procedure speciale¹²⁷. Procedura që do të zbatohet për negociimin dhe nënshkrimin e tyre gjen rregullim në nenet 218 dhe 219 të TFBE-së.

Së dyti, në përmbyllje të detyrave të saj, në kuadër të operacioneve dhe misioneve në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, BE-ja gëzon disa imunitete dhe privilegje, të cilat ushtrohen në përputhje me rregullat e parashikuara në Protokollin Nr. 7 “Mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Bashkimit Europian”¹²⁸. Një parashikim i tillë në Traktatin e Lisbonës, i cili nuk ishte përfshirë as në Traktatin e Mاستrihtit, Amsterdamit apo të Nicës, është tregues i faktin se më parë BE-ja nuk gëzonte personalitetin juridik. Në Traktatin e Mاستrihtit imunitetet zbatoheshin vetëm për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që merrnin pjesë në punën e institucioneve të Komuniteteve, të këshilltarëve të tyre dhe ekspertëve teknikë¹²⁹.

Së treti, nisur nga statusi i operacioneve të PESMP-së, mund të arrijmë në konkluzionin se BE-ja gëzon personalitetin juridik edhe në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Marrëveshja për Statusin e Misionit (në vijim MSM) dhe Marrëveshja për Statusin e Forcave (në vijim MSF), të nënshkruara nga BE-ja, parashikojnë të drejta dhe detyrime për palët në operacion, personelin, asetet e tyre dhe për shtetet e treta, në rast të angazhimit të tyre. Pra, këto të drejta dhe detyrime i ngarkohen operacionit si të tillë, të ndërmarrë nga BE-ja, dhe jo Shteteve Anëtare që marrin pjesë në të, forcave ose personelit të tyre¹³⁰.

Një përfundim i tillë arrihet duke pasur parasysh disa elementë: *i.*) Në rast se të drejtat dhe detyrimet do t'i atribuoheshin Shteteve Anëtare, forcave dhe personelit të tyre dhe jo të operacionit në tërësi, kjo do të parashikohej shprehimisht në këto marrëveshje; *ii.*) Në rastin e operacioneve civile personeli punësohet ose emërohet nga BE-ja dhe/ose nga Shtetet Anëtare për

¹²⁶ Neni 216 i TFBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

¹²⁷ Neni 217 i TFBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

¹²⁸ Neni 343 i TFBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të funsit më 23 Prill 2018).

¹²⁹ Neni 11 i Traktatit të Mاستrihtit, <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018),

¹³⁰ Frederik Naert, *International Law Aspects of the EU's Security and Defence Policy: With a Particular focus on the Law of Armed Conflicts and Human Rights*, Catholic University of Leuven (2008), fq. 222.

interes të Bashkimit dhe sipas procedurave të përcaktuara qartësisht nga aktet ligjore¹³¹. Situata paraqitet më pak e qartë në rastin e operacioneve ushtarake, pasi në to mund të marrin pjesë edhe forca të vëna në dispozicion nga Shtetet Anëtare, të cilat nuk dihet nëse do të angazhohen në emër të Bashkimit ose të shtetit anëtar¹³²; *iii.*) Nëse do t'i referohemi dispozitave që rregullojnë pretendimet për dëmshpërblim nga të tretët, si entitet përgjegjës paraqitet Bashkimi dhe jo Shtetet Anëtare¹³³; *iv.*) Operacioni Althea në Bosnje Hercegovinë, i ndërmarrë nga BE-ja, është cilësuar nga KS i OKB-së si pasues i ligjshëm i misionit SFOR, duke njohur në këtë mënyrë dhe personalitetin juridik të tij¹³⁴.

Së katërti, në çështjen *AETR*, GJED-ja duke u shprehur se Komuniteti zotëron aftësinë për të vendosur marrëdhënie kontraktuale me shtetet e treta për të gjithë gamën e objektivave të parashikuara në Traktat, i ka njohur personalitetin juridik BE-së edhe në fushën e PESH-së. Ndër të tjera në këtë çështje, gjykata është shprehur se kur Komuniteti, në kuadër të zbatimit të një politike të përbashkët të parashikuar në Traktat, adopton dispozita që përcaktojnë rregulla të përbashkëta, pavarësisht nga forma që mund të kenë, Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë, që në mënyrë individuale ose kolektive, të ndërmarrin detyrime me këto shtete të treta që mund të ndikojnë në zbatimin e kësaj marrëveshje ose të ndryshojnë qëllimin e saj¹³⁵.

Së pesti, BE-ja ka të zgjedhur dy përfaqësues të saj në OKB, ndërsa në organizata të tjera ajo ka rolin e vëzhguesit. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga operacionet ose misionet e saj ajo ka emëruar dhe përfaqësuesit e saj specialë, të cilët raportojnë tek Përfaqësuesi i Lartë.

Nga sa më lart, mund të themi se personaliteti juridik i BE-së i plotëson kriteret e përcaktuara nga normat e së drejtës dhe i jep mundësinë asaj, që në pajtim me natyrën e veprimtarisë së saj, të shfaqet si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime, të ndryshme nga ato të shteteve të saj anëtare, edhe në fusha që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen¹³⁶. Një përfundim i tillë bazohet edhe në qëndrimin e mbajtur nga GJND-ja dhe GJED-ja. Në lidhje me zbatueshmërinë e së drejtës ndërkombëtare GJND-ja është shprehur se, organizatat ndërkombëtare janë subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe si të tilla janë të lidhura nga të gjitha detyrimet që rrjedhin nga e normat ndërkombëtare, nga kushtetutat e tyre ose nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ato janë palë¹³⁷. Ndërsa nëpërmjet jurisprudencës

¹³¹ Council of European Union, *Council Joint Action 2008/229/CFSP "Amending Joint Action 2007/369/CFSP on the establishment of the European Union Police Mission in Afghanistan (EUPOL AFGHANISTAN)"* (17 Mars 2008) <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

¹³² Frederik Naert, fq.223.

¹³³ Po aty.

¹³⁴ Rezoluta 1575, 22 Nëntor 2004, pg. 10, <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

¹³⁵ Vendim i GJED-së 31 Mars 1971, *Commission of the European Communities v Council of the European Communities*, pg. 22-70, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

¹³⁶ D. Verwey, *The European Community, the European Union and the Law of Treaties* (The Hague, TMC Asser Press, 2004), fq. 96.

¹³⁷ ICJ, *Interpretation of the agreement of 25 March 1951 between the WHO and Egypt* (20 Dhjetor 1980), pg. 37, <http://www.icj-cij.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

së saj GJED-ja është shprehur se, Komuniteti Europian duhet të respektojë të drejtën ndërkombëtare në ushtrim të pushteteve të tij¹³⁸.

Në lidhje me frikën e Shteteve Anëtare se personaliteti juridik i BE-së do të çenojë sovranitetin e tyre kombëtar, është e rëndësishme të vëmë në dukje disa elementë: *së pari*, njohja e personalitetit juridik të BE-së nuk mund të quhet si një hap drejt krijimit të një “super shteti”; *së dyti*, personaliteti juridik nuk ndikon në kompetencat që Bashkimi ka, të cilat rrjedhin nga aktet themeluese të tij; dhe *së treti*, personaliteti juridik nuk ka lidhje me natyrën “ndërqeveritare” apo “mbikombëtare” të organizatës, pasi ajo ose është e tillë ose nuk është.

Si një organizatë ndërkombëtare e pajisur me personalitet juridik për BE-në lind detyrimi për të zbatuar:

- *Traktatet e nënshkruara nga ajo, të cilat sjellin efekte si përta i përket politikës së brendshme dhe asaj të jashtme të Bashkimit*¹³⁹;
- *Veprimet e njëanshme të ndërmarrë nga ajo, të cilat krijojnë detyrime si brenda dhe jashtë BE-së*¹⁴⁰;
- *Instrumentet e saj ligjorë dhe rregullat e përcaktuara në to;*
- *Marrëveshjet e nënshkruara nga Shtetet Anëtare, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe parashikojnë detyrime edhe për BE-në*¹⁴¹;
- *Vendimet gjyqësore dhe dispozitat e instrumentave të tjerë ndërkombëtarë të miratuar nga organizatat ndërkombëtare në të cilat ajo merr pjesë;*
- *Të drejtën ndërkombëtare zakonore për çështje brenda kompetencave të BE-së*¹⁴²;

¹³⁸ Ky mendim është krijuar nga studimi i jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, *Çështja C-286/90 Anklagemyndigheden kundër Peter Michael Poulsen dhe Diva Navigation Corp* (24 Nëntor 1992), pg. 9, *Çështja C-308/06 International Association of Independent Tanker Owners (Intertanko) and Others* (3 Qershor 2008), pg. 51, *çështjet C-402/05 P and C-415/05 P, Yassin Abdullah Kadi and Al Barakaat International Foundation v. Council of the European Union and Commission of the European Communities* (3 Shtator 2008), pg. 291, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

¹³⁹ GJED, *çështja 104/81 Hauptzollamt Mainz v C.A. Kupferberg & Cie KG a.A.* (26 Tetor 1982), pg. 13, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017). Në këtë çështje GJED-ja është shprehur se : “...në zbatim të angazhimeve që rrjedhin nga një marrëveshje e nënshkruar nga institucionet e Komunitetit, shtetet anëtare përmbushin një detyrim jo vetëm ndaj shteteve jo anëtare, në lidhje me përgjegjësinë të ndërmarrë nga Komuniteti për zbatimin e kësaj marrëveshje...”.

¹⁴⁰ Disa raste janë të qarta si psh. kur Këshilli Politik dhe Social ose Këshilli merr një vendim me të cilin lejon ose pranon pjesëmarrjen e një Shteti të tretë në një operacion të PMSP, por raste të tjera mund të jenë më të ndërlikuara si psh. nëse Bashkimi ka marrë një vendim për të financuar disa iniciativa në shtete të treta, edhe pse ky vendim mund të jetë publikuar në Fletoren Zyrtare, ai nuk e legjitimon palën e tretë për të pretenduar të drejta.

¹⁴¹ Neni 6 i TBE-së i ndryshuar, ngarkon Bashkimin me përgjegjësinë për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nenet 21 dhe 42 të TBE-së, i ndryshuar vendos para Bashkimit detyrimin që operacionet e PJSP –së të ndërmerren duke respektuar parimet e Kartës së OKB-së. Neni 78 i TBE-së, i ndryshuar, parashikon se masat që do të marrë Bashkimi në lidhje me azilin, duhet të jenë në përputhje me Konventën e Gjenevës të 28 Korrik 1951 dhe të Protokollit të 31 Janarit 1967 në lidhje me statusin e refugjatit dhe të traktateve të tjera të rëndësishme.

¹⁴² A. Gianelli, *Unione Europea e diritto internazionale consuetudinario* (Giappichelli, 2004).

- *Parimet e përgjithshme të së drejtës, të cilat janë pjesë e së drejtës ndërkombëtare*¹⁴³;
- *Parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së, të cilat mund të përfshijnë parime që rrjedhin nga rendi i saj juridik, nga e drejta e brendshme e ndonjë Shteti Anëtar ose nga detyrimet që Shtetet Anëtare kanë marrë në kuadër të një marrëveshje ndërkombëtare*¹⁴⁴;
- *Ius cogens*¹⁴⁵;
- *Dispozitat e traktateve të përfunduara nga një ose disa prej shteteve të saj anëtare, në rast se janë plotësuar kushtet për “zëvendësim”*¹⁴⁶.

Në rastin e një operacioni për menaxhimin e krizës të ndërmarrë në kuadër të PESMP-së, do të gjejnë zbatim si normat e së drejtës së brendshme ashtu edhe normat e së drejtës ndërkombëtare. E drejta e brendshme do të përbëhet nga tërësia e normave që rregullojnë dërgimin e trupave në një rajon të caktuar dhe normat e së drejtës së brendshme të shtetit ku këto trupa do të mobilizohen, përfshirë edhe dispozitat që parashikojnë veprat penale në situata konflikti. Zbatimi i këtyre të fundit mund të jetë objekt kufizimesh për shkak se: a.) MSF-ja ose marrëveshje të tjera mund të përmbajnë përjashtime që konsiderohen si të domosdoshme për të arritur qëllimin e operacionit; b.) Operacionet ndërkombëtare dhe stafi i tyre mund të jenë subjekt i privilegjeve dhe imuniteteve në shtetin pritës¹⁴⁷; dhe c.) Situata e konfliktit në shtetin pritës ka sjellë si pasojë mosfunksionimin e shtetit të së drejtës dhe të institucioneve ligjzbatuese¹⁴⁸.

¹⁴³ Parimet e përgjithshme të së drejtës janë të njëjta me të drejtën zakonore.

¹⁴⁴ GJED-ja nëpërmjet vendimeve të saj ka zhvilluar një jurisprudencë të rëndësishme në lidhje me parimet e përgjithshme që udhëheqin të drejtën e BE-së Çështja C-46/93 dhe C-48/93, *Brasserie du Pêcheur SA v Bundesrepublik Deutschland and The Queen v Secretary of State for Transport, ex parte: Factortame Ltd and others* (5 Mars 1996), pg. 27, ku Gjykata është shprehur se: “...meqënëse Traktati nuk përmban dispozita të cilat specifikisht dhe në mënyrë të shprehur rregullojnë pasojat e cënimit të ligjit të Komunitetit nga Shtetet Anëtare, i përket Gjykatës që në përmbushje të detyrës të parashikuar nga Neni 164 i Traktatit të garantojë interpretimin dhe zbatimin e Traktatit, dhe të vendosë në një situatë të tillë në përputhje me metodat të gjithëpranuara të interpretimit, duke iu referuar parimeve themelore të sistemit ligjor të Komunitetit dhe kur është e domosdoshme dhe në parimet e përgjithshme të përbashkëta për Shtetet Anëtare...”.

¹⁴⁵ Mendim i krijuar nga studimi i jurisprudencës së Gjykatës së Shkallës së Parë, çështja T-306/01 *Yusuf and Al Barakaat International Foundation v. Council and Commission*, pg. 231-259 dhe 277-282; çështja T-315/01 *Kadi v. Council and Commission*, pg. 181-208 dhe 226-231, <http://curia.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

¹⁴⁶ Marrëveshja e GATT ku palë nënshkruese ishin shtetet anëtare dhe jo BE-ja. GJED, çështja 21-24/72, *International Fruit Company NV and others v Produktschap voor Groenten en Fruit* (12 Dhjetor 1972), pg. 10-18, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017), në të cilën Gjykata ka mbajtur qëndrim se Komuniteti Europian ka marrë vendin e Shteteve Anëtare.

¹⁴⁷ GJEDNJ, çështja Nr. Aplikimi 31253/96, *McElhinney v. Ireland; Fogarty v. U.K. and Al-Adsani v. U.K.* (21 Nëntor 2001), pg. 25 - 26 dhe pg. 48, <http://hudoc.echr.coe>. (hyrë për herë të fundit më 21 Prill 2017).

¹⁴⁸ Në *Draft Guidelines for criminal procedure in Crisis Management Operations*, seksionin 1 të saj parashikohet se: “...Stafi ndërkombëtar i vendosur për të forcuar shtetin e së drejtës, në kuadër të aspekteve civile të menaxhimit të krizave nën mandatin ndërkombëtar të OKB-së, në parim do të zbatojë të drejtën vendase dhe parimet e saj...1.2 Kur ligji kombëtar i cili aplikohet në një procedurë penale ose çdo dispozitë, e cila i njeh individëve standarte më të ulta mbrojtjeje, në kundërshtim ose në papajtueshmëri me mandatin që i është dhënë misionit, me çdo rregullore tjetër të OKB-së për misionin

Përsa i përket normave të së drejtës ndërkombëtare që do të gjejnë zbatim mund të përmendim: Ligjin e Konfliktëve të Armatosura (në vijim LKA) dhe protokollet shtesë të tij, në varësi të natyrës së operacionit, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në vijim PNDKP), Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të Tjera Çnjerëzore, Poshtëruese dhe Degraduese (në vijim Konventa kundër Torturës). Gjithashtu zbatim do të gjejnë dhe akte të organizatave rajonale si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut, Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit, parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe normat e së drejtës zakonore.

Duke pasur parasysh gamën e gjerë të akteve ndërkombëtare që gjejnë zbatim në rastet e situatave të krizave, përfshirë edhe ato të drejtura nga BE-ja, në këtë punim do të trajtohet zbatueshmëria e normave të Ligjit të Konfliktëve të Armatosura dhe aktet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

3.1 Ligji për Konfliktet e Armatosura dhe zbatueshmëria e tij në operacionet e ndërmarra nga Bashkimi Europian

Ligji për Konfliktet e Armatosura (në vijim LKA), me përjashtim të disa dispozitave të tij që gjejnë zbatim dhe në kohë paqe, gjen zbatim në rast të një konflikti të armatosur ose pushtimi, sikurse rezulton dhe nga neni 2 i Konventës së Gjenevës, i cili parashikon se: “...*Përveç dispozitave që do të zbatohen në kohë paqe, kjo Konventë do të zbatohet për të gjitha rastet kur është deklaruar luftë apo të çdo konflikti tjetër të armatosur që mund të lindë ndërmjet dy ose më shumë prej palëve kontraktuese, edhe në qoftë se gjendja e luftës nuk është njohur nga asnjëra prej tyre. Konventa gjithashtu do të zbatohet për të gjitha rastet e pushtimit të pjesshëm apo të plotë të territorit të një pale kontraktuese, edhe në rast se pushtimi në fjalë nuk has në asnjë rezistencë të armatosur...*”. Gjithashtu ky ligj do të gjejë zbatim edhe në rastet e konflikteve të armatosura, ku popujt luftojnë kundër dominimit kolonial, pushtimit nga një shtet i huaj ose në ushtrim të së drejtës së tyre për vetëvendosje¹⁴⁹.

Çfarë do të konsiderohet konflikt i armatosur në kuptim të LKA-së?

Konventa e Gjenevës dhe protokollet shtesë të saj nuk japim përkufizimin e termit “konflikt i armatosur”, por vetëm bëjnë dallimin midis konfliktit të armatosur ndërkombëtar dhe atij të brendshëm. Në kuptim të këtyre akteve, do të ndodhemi para konfliktit të armatosur ndërkombëtar nëse në të janë të përfshirë dy ose më shumë shtete kontraktuese, pavarësisht nëse asnjë nga këto shtete nuk ka deklaruar gjëndjen e luftës. Konflikti i armatosur do të jetë i natyrës kombëtare në rast se ai zhvillohet në territorin e një shteti kontraktues, ndërmjet forcave të tij të armatosura dhe forcave disidente të grupeve të tjera të armatosura, të cilat ushtrojnë kontroll në

në lidhje me administratën civile ndërkombëtare, me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të gjithëpranuara, ose me udhëzimet e përcaktuara, stafit ndërkombëtar i vendosur nën një mandat ndërkombëtar do të zbatohet, rast pas rasti, këto të fundit...”.

¹⁴⁹ Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (08 Korrik 1977), <https://www.icrc.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

një pjesë të territorit të vendit¹⁵⁰. Sipas qëndrimit të mbajtur nga Tribunali Ndërkombëtar për Krimet në ish-Jugosllavi, në çështjen Tadiç, një konflikt i brendshëm mund të shndërrohet në ndërkombëtar, në rast se trupat ushtarake të një shteti tjetër ndërhyjnë në konflikt ose disa grupe pjesëmarrëse në konfliktin e brendshëm veprojnë në interes të një shteti tjetër¹⁵¹.

Në mungesë të një përkufizimi, për të arritur në konkluzionin nëse në një rast konkret ndodhemi para një konflikti të armatosur, duhet që rast pas rasti të marrim në analizë natyrën e konfliktit dhe statusin e viktimave. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh dhe dallimin që ekziston ndërmjet konfliktit të armatosur dhe trazirave të brendshme të shoqëruara me akte dhune ose akte të tjera të një natyre të ngjashme¹⁵².

A gjen zbatim LKA-ja ndaj forcave paqeruajtëse të angazhuara në shtetin pritës ku ndodh konflikti i armatosur, por që për shkak të mandatit të tyre të kufizuar nuk marrin pjesë në luftime?

Në Buletinin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së “Për Respektimin nga Forcat e Kombeve të Bashkuara e të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare”, në seksionin 1.1 të tij parashikohet se: “...Parimet themelore dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, të parashikuara në këtë buletin, janë të zbatueshme edhe për forcat e Kombeve të Bashkuara, të angazhuara në situatat e konfliktit të armatosur në mënyrë aktive, si luftëtarë ...”. Po të njëjtën qëndrim ka mbajtur dhe BE-ja në Deklaratën e Presidencës në Salamanka, ku ndër të tjera thuhet se, në operacionet e drejtuara nga BE-ja është e rëndësishme që në rastin e një konflikti të armatosur në të cilin ajo është palë forcat e saj të respektojnë normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Bazuar në këto dy deklarata, në lidhje me zbatueshmërinë e dispozitave të LKA-së, mund të themi se ato nuk do të gjejnë zbatim: *i.)* për forcat paqeruajtëse të cilat veprojnë në një situatë konflikti të armatosur dhe nuk janë pjesëmarrëse aktive në luftim; *ii.)* në rastin e forcave të angazhuara në operacione paqeruajtëse, ku pavarësisht se fillimisht nuk kanë qenë pjesëmarrëse në luftime, konflikti përshkallëzohet në një nivel të ngjashëm me konfliktin e armatosur; dhe *iii.)* për forcat paqeruajtëse kur veprojnë në kushtet e vetëmbrojtjes ndaj një sulmi të mundshëm¹⁵³.

¹⁵⁰ Përsa i përket rasteve të konflikteve të armatosura jo ndërkombëtare praktika ka filluar të jetë më e unifikuar, duke mos bërë ndarje në raste. Përkufizimi i dhënë për konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare nga Manuali i Sanremos për Konfliktet e Armatosura jo Ndërkombëtare është: “...përplasje të armatosura që ndodhin brenda territorit të një shteti të vetëm dhe ku forcat e asnjë shteti tjetër nuk janë të angazhuara kundër qeverisë qëndrore...”. M. Schmitt et.al, *The Manual on the Law of Non-International Armed Conflict: With Commentary* (International Institute of Humanitarian Law, Sanremo 2006), pg. 1.1.1, <http://www.michaelschmitt.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁵¹ Tribunali Ndërkombëtar për Krimet në ish Jugosllavinë, çështja IT-94-1-A, *Prokurori k. Dusko Tadic* (5 Korrik 1999), pg. 80-97, <http://www.icty.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

¹⁵² Neni 1(2) i Protokollit II (08 Qershor 1977), <https://www.icrc.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).

¹⁵³ OKB-ja në Buletinin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara “Për Respektimin nga Forcat e Kombeve të Bashkuara e të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare”, ka mbajtur qëndrimin se përgjatë kohës së cilës forcat paqeruajtëse janë të angazhuara rregullat dhe principet e së drejtës humanitare do të zbatohen edhe në rastin e operacioneve paqeruajtëse ku përdorimi i forcës është i lejueshëm në rast vetëmbrojtjeje.

Ndërsa përsa i përket statusit të forcave paqeruajtëse ushtarake, të cilat janë të angazhuara në situatat e konfliktit por që nuk marrin pjesë në luftime, mendoj se ato do të konsiderohen si civilë në kuptim të LKA-së, për dy arsye se: *së pari*, ato nuk konsiderohen si forca luftuese në kuptim të nenit 43 të Protokollit I¹⁵⁴ dhe nenit 4 të Konventës së Gjenevës III¹⁵⁵, të cilët i referohen vetëm forcave luftuese dhe forcave të tjera që i përkasin shteteve pjesëmarrëse në konflikt; dhe *së dyti*, nenet 8(2)(b)iii dhe (e)iii të Statutit të GjND-së i cilësojnë si krime sulmet e drejtuara ndaj personelit, instalimeve, materialeve, njërive ose mjeteve të përfshira në misionet paqeruajtëse, për aq sa ato gëzojnë të njëjtën mbrojtje që u njihet dhe civilëve ose objekteve të tyre sipas LKA-së.

A do të konsiderohen forca pushtuese në kuptim të nenit 2 të Konventës së Gjenevës I, forcat paqeruajtëse të cilat ushtrojnë pushtet në një pjesë ose në të gjithë territorin e një shteti të tretë, pa pëlqimin e tij?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet t'i referohemi Rregullores për “Zbatimin e Ligjeve dhe Zakoneve të Luftës në Tokë”, e miratuar më 18 Tetor 1907, dhe Konventave I dhe IV të Gjenevës. Përkufizimi se çfarë do të kuptojmë me pushtim jepet në nenin 42 të Rregullores, i cili parashikon se: “...Një territor do të konsiderohet i pushtuar kur ai ndodhet nën autoritetin e një ushtrie pushtuese. Pushtimi do të shtrihet vetëm në territorin ku një autoritet i tillë është vendosur dhe ushtrohet...”¹⁵⁶. Ndërsa sipas Konventave rasti i pushtimit përfshin ato situata ku territori i një pale kontraktuese pushtohet plotësisht ose pjesërisht, pavarësisht nëse forcat pushtuese hasin ose jo në rezistencë.

Nga sa më lart mund të themi se operacionet e forcave paqeruajtëse do të konsiderohen si pushtuese në rast se ato ushtrojnë autoritet real në një pjesë ose në të gjithë territorin e një shteti të tretë, pa pëlqimin e këtij të fundit, duke qenë subjekt i LKA-së. Pavarësisht teorisë, qëndrimi i mbajtur në praktikë nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ka qenë mohues edhe pse në disa raste plotësoheshin kushtet për të qenë para një pushtimi dhe pushteti i ushtuar nga forcat paqeruajtëse ka qenë i madh¹⁵⁷.

¹⁵⁴ Neni 43 i Protokollit I parashikon se: “1. Forcat e armatosura të një Pale në konflikt konsistojnë në...” dhe “2. Anëtarët e forcave të armatosura të një Pale në konflikt (përveç personelit mjekësor dhe të rasteve të mbuluara nga neni 33 i Konventës së III) janë forca luftuese”, <https://www.icrc.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁵⁵ Në këtë nen janë përcatuar rastet se kush do të konsiderohet i burgosur lufte, duke njerrë në mënyrë indirekte dhe se cilat do të konsiderohen forca luftuese.

¹⁵⁶ Mendim i krijuar nga studimi i jurisprudencës *On the Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory* (09 Korrik 2004), pg. 89, <http://www.icj-cij.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017); Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e në ish Jugosllavi, çështja IT-95-14/2 *Prokuroria k. Dario Kordic dhe Mario Cerkez* (26 Shkurt 2001), pg. 338, çështja IT-98-34-T *Prokuroria k. Mladen Naletilic and Vinko Martinovic* (31 Mars 2003), pg. 215-217, çështja IT-95-14 *Prokuroria k. Timohir Blaskic* (29 Korrik 2004), pg. 149-150, çështja IT-95-12-R61 *Prosecutor v. Ivica Rajic a/k/a/ Viktor Andric* (13 Shtator 1996), pg. 39-42, <http://www.icty.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁵⁷ UN, *Resolution 794* (3 Dhjetor 1992), pg. 10, <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

A mundet që Këshilli i Sigurimit i OKB-së të autorizojë shmangien nga zbatimi i normave të LKA-së dhe nga normat e së drejtës zakonore?

Si rregull, shtetet që marrin pjesë në një konflikt të armatosur kanë detyrimin të respektojnë LKA-në, detyrimet që burojnë nga dispozitat e tij dhe nga zakonet ndërkombëtare humanitare. Detyrueshmëria për zbatimin të tyre mund të burojë nga Konventat e Gjenevës dhe Protokollet shtesë në të cilat një shtet është palë ose nga detyrimet që ka marrë organizata ndërkombëtare nën komandën e së cilës ai vepron. Por, nga rregulli ka dhe përjashtime dhe KS i OKB-së mund të autorizojë shmangien nga zbatimi i këtyre detyrimeve, me përjashtim të rastit kur këto detyrime kanë fituar statusin e *ius cogens*¹⁵⁸.

Kur BE-ja ndërmer operacione në kuadër të PESMP-së, ajo është njëkohësisht edhe autoriteti që ushtron drejtimin efektiv të forcave ushtarake, të cilin e realizon nëpërmjet Këshillit, KPS-së dhe drejtuesve ushtarakë të operacionit. Për këtë arsye, BE-ja ka detyrimin për të zbatuar në operacionet e saj dispozitat e LKA-së, detyrim i cili mund të burojë nga traktatet e nënshkruara nga ajo, nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose nga drejta zakonore¹⁵⁹. Në vijim do të trajtoj disa prej tyre.

a. Traktatet e nënshkruara nga BE-ja

Personaliteti juridik i BE-së, i ndryshëm nga ai i Shteteve Anëtare, i mundëson asaj nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime. Në rast të angazhimit të saj në konflikte të armatosura, ndonëse nuk është një nga palët nënshkruese të Konventave të Gjenevës, BE-ja ka nënshkruar marrëveshje në lidhje me statusin e forcave të angazhuara në mision dhe në lidhje me të drejtat dhe privilegjet që do t'i njihen atyre (si për shembull marrëveshja për Misionin Mbështetës AMIS dhe për misionin EUROFOR në RDK), të cilat ndër të tjera mund të përmbajnë dhe dispozita që lidhen me LKA-në. Gjithashtu, në rast anëtarësimi të saj në Këshillin e Europës (në vijim KE), dispozitat e LKA-së që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut, mund të bëhen pjesë e së drejtës së saj. Por përveç këtyre rasteve, për shkak se BE-ja nuk është një nga palët nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe të Protokolleve të saj, për të nuk buron asnjë detyrim për zbatimin e tyre. Mungesa e një parashikimi të tillë është dhe në kundërshtim me rekomandimin e bërë nga Shoqata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila është shprehur se: “...organizatat ndërkombëtare duhet të përfshijnë në Rregulloret e Forcave, në marrëveshjet e nënshkruara midis tyre dhe shteteve që kontribuojnë me forca ushtarake dhe me ato që i pranojnë këto forca, detyrimin për të garantuar respektimin e parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare...”¹⁶⁰.

¹⁵⁸ GJND, Opinioni i gjyqtarit Judge Lauterpacht në çështjen Bosnia dhe Hercegovina k Serbisë dhe Malit të Zi, pg. 99-104, <http://www.icj-cij.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁵⁹ Frederik Naert, “The Application of Human Rights and International Humanitarian Law in Drafting EU Missions Mandates and Rules of Engagement”, *Institute for International Law*, Working Paper Nr. 151 (Tetor 2011), fq.7 – 12.

¹⁶⁰ International Law Association, *Final Report on the Accountability of International Organisations* (2004), fq. 23, <http://www.ila-hq.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Mars 2014).

b. Akte të njëanshme të detyrueshme

Ndër aktet ligjore të detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e BE-së nuk gjendet asnjë i tillë që të bëjë fjalë për detyrimin e saj për të respektuar të drejtën humanitare ndërkombëtare në operacionet ushtarake të ndërmarra nga ajo. Por, një dokument i ngjashëm me to mund të jetë “Udhëzimet për BE-në për promovimin e zbatimit të së drejtës humanitare ndërkombëtare”. Ky dokument përveç se thekson rëndësinë që ka respektimi nga shtetet e treta të detyrimeve që burojnë nga LKA-ja, ai shtrun si domosdoshmëri dhe marrjen e masave nga BE-ja dhe shtetet e saj anëtare për të garantuar pajtueshmërinë e normave të së drejtës që rregullojnë operacionet ushtarake me ato të së drejtës ndërkombëtare humanitare¹⁶¹. Por, për shkak të natyrës së përgjithshme të tij, ky dokument nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga Bashkimi.

Megjithatë, janë shënuar disa përpjekje për të përfshirë respektimin e LKA-së në operacionet e drejtuara nga BE-ja, ku rasti i parë ishte në mbledhjen e Këshillit në Salamanka, por që rezultoi e pasuksesshme. Në deklaratën e Presidencës ndër të tjera thuhej se: “...Në rast të drejtimit të operacioneve sipas nenit 17, paragrafi 2 të Traktatit të Bashkimit Europian, forcat pjesëmarrëse në operacionet e drejtuara nga BE-ja duhet të respektojnë dhe të zbatojnë të drejtën ndërkombëtare, përfshirë dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare, sipas rastit...strukturat politike dhe ushtarake të Bashkimit, të ndihmuara nga ekspertët e së drejtës ndërkombëtare, duhet të sigurojnë që në ushtrimin e drejtimit strategjik dhe kontrollit politik, rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare, të merren parasysh. Pjesëmarrësit ranë dakord se edhe pse Bashkimi nuk është palë, në veçanti në Konventat e Gjenevës dhe në Protokollet shtesë të saj, të gjitha masat duhet të merren në mënyrë për të siguruar që forcat e drejtuara nga BE-ja të jenë në një pozitë për të respektuar dhe për të garantuar respektimin e dispozitave përkatëse të së drejtës ndërkombëtare...1. Respektimi i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare është e rëndësishme në operacionet e drejtuara nga BE-ja kur situata në të cilën ato janë duke operuar dhe janë palë përbën një konflikt të armatosur...2. Përgjegjësia për të vepruar në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, në rastet kur ajo zbatohet, në një operacion të udhëhequr nga BE-ja, i përket në rradhë të parë shtetit të cilit i përkasin trupat. Në ushtrimin e drejtimit strategjik dhe kontrollit politik, BE-ja do të sigurojë që të gjitha rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë dhe të drejtën humanitare, të merren parasysh...”¹⁶². Ndërsa në mbledhjen e Këshillit Europian në Selanik, ndër të tjera palët pjesëmarrëse ranë dakort për rëndësinë që ka zbatimi i së drejtës humanitare nga forcat e armatosura të Shteteve Anëtare dhe zhvillimi i dialogut me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq¹⁶³.

¹⁶¹ “European Union Guidelines on promoting compliance with international humanitarian law (IHL)”, *Official Journal of European Union*, 2005/C 327/04 (23 Dhjetor 2005), <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁶² <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁶³ Këshilli Europian, Konkluzionet e Presidencës (Selanik, 19 – 20 Qershor 2003), pg. 74, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

c. *Acquis communautaire* dhe instrumenta të tjerë ligjorë

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore (në vijim Karta) u konsiderua me të njëjtën vlerë si edhe Traktatet, dhe të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të, të cilat janë dhe pjesë e legjislacionit të Shteteve Anëtare, do të shërbenin si parime të përgjithshme që do të drejtonin veprimtarinë e BE-së. Edhe pse neni 6 i referohet vetëm të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mendoj se ky nen mund të zbatohet edhe për të mbuluar detyrimet që rrjedhin nga LKA-ja, pasi në rast të një konflikti të armatosur ekziston një lidhje e rëndësishme midis të drejtave të njeriut dhe LKA-së. Si për shembull, një nga të drejtat më të rëndësishme të parashikuara nga Karta është e drejta e jetës, e cila sipas nenit 15(2) të saj nuk mund të hiqet dorë, përveçse në rast vdekje të shkaktuar nga aktet e luftës.

Një qëndrim i tillë gjen mbështetje dhe në nenin 21 të TBE-së, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *"...Aktet e Bashkimit në arenën ndërkombëtare do të udhëhiqen nga parime të cilat kanë frymëzuar vetë krijimin e tij, zhvillimin dhe zgjerimin, dhe të cilat ai kërkon t'i zgjerojë më tej si: demokracia, sundimi i ligjit, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, respekti për dinjitetin njerëzor, parimi i barazisë dhe i solidaritetit dhe respektimi i parimeve të Kartës së Kombeve dhe të së drejtës ndërkombëtare..."*¹⁶⁴.

Detyrimi për të respektuar të drejtën ndërkombëtare humanitare rrjedh edhe nga akte të tjera ligjore të Bashkimit, të cilat e kanë konsideruar LKA-në si pjesë e të drejtave të njeriut. Si shembull mund të sjellim rregulloren e Këshillit Nr. 975/1999, datë 29 Prill 1999, e cila përcakton kushtet për zbatimin e operacioneve në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar që kontribuojnë në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut¹⁶⁵. Ndërsa në rregulloren Nr. 976/1999, datë 29 Prill 1999, përcaktohen kushtet për zbatimin e operacioneve të Komunitetit, të cilat kontribuojnë në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës dhe të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore në vendet e treta¹⁶⁶. Të dyja këto rregullore theksojnë, që përveç respektimit të të drejtave të njeriut, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare duhet të respektojnë dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë Konventës së Gjenevës të 1949 dhe Protokolleve shtesë të saj, Konventës së Gjenevës në lidhje me Statusin e Refugjatit të 1951, Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit dhe të drejtës zakonore.

Në përfundim mund të themi se, edhe pse BE-ja nuk është nënshkruese e Traktateve të Gjenevës dhe Protokolleve shtesë të tyre, për sa kohë ato janë ratifikuar nga Shtetet Anëtare, të cilat i kanë bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm, zbatimi i detyrimeve që burojnë nga këto akte do të shtrihet edhe në rastin e operacioneve të drejtuara nga Bashkimi. I njëjti arsyetim vlen edhe për Statutin e GJND-së, i cili ka kriminalizuar një numër krimesh lufte, ku përveç detyrimit për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare që e kanë nënshkruar atë, ai do të zbatohet në mënyrë indirekte dhe nga BE-ja.

¹⁶⁴ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁶⁵ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁶⁶ <https://publications.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

d. E drejta zakonore

Me kalimin e viteve normat e përfshira në LKA kanë arritur të marrin statusin e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Ky status i është njohur edhe nga BE-ja, e cila ka mbajtur qëndrimin se shumica e dispozitave të parashikuara në Konventat e Gjenevës dhe në Protokollin janë e drejtë zakonore¹⁶⁷. Në parim, sikurse u trajtua më lart, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe e drejta zakonore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga BE-ja në marrëdhëniet e saj të jashtme¹⁶⁸. Por, në zbatimin e tyre BE-ja duhet të ketë parasysh natyrën e konflikteve dhe të operacioneve për të cilat normat e LKA-së do të gjejnë zbatim.

Në lidhje me përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga LKA-ja ato mund të klasifikohen në:

- *Përgjegjësia që buron nga marrëveshjet*: Shtetet Anëtare si palë nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe të Protokolleve shtesë të tyre kanë detyrimin dhe përgjegjësinë t'i respektojnë ato, si në rastin kur marrin pjesë në operacionet e drejtuara nga BE-ja edhe kur veprojnë nën mandatin e saj.
- *Përgjegjësia që buron nga vendimmarrja*: Pjesëmarrja në votimin e një vendimi në lidhje me mandatin e operacionit, planin e veprimit ose rregullat e mobilizimit i ngarkon Shtetet Anëtare me përgjegjësinë që në një vendimarrje të tillë të respektojnë detyrimet në kuadër të LKA-së.
- *Përgjegjësia që buron nga zbatimi i një vendimi*: Në rast të vendimeve të marra në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare, Shtetet Anëtare duhen të përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Ato do të përjashtohen nga përgjegjësia në rast se një vendim i tillë i shërben realizimit të një interesi të përbashkët, nëse marrja e tij nuk mund të realizohet ndryshe dhe nëse cënimi është në proporcion me rëndësinë që ka operacioni¹⁶⁹.
- *Detyrimi për të respektuar dhe për të garantuar respektimin*: Bazuar në nenin 1 të Konventës së Gjenevës të 1949 dhe nenin 1(1) të Protokollit 1, Shtetet Anëtare, të cilat janë palë në to, kanë detyrimin për të respektuar LKA-në dhe të garantojnë respektimin e normave të saj në çfarëdolloj situatë. Detyrimi për të respektuar dhe për të garantuar respektimin e LKA-së është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe si i tillë do të gjejë zbatim edhe në konfliktet të natyrës jo ndërkombëtare. Pra, shteti anëtar përveç se ka detyrimin të respektojë angazhimet që shteti i tij ka marrë në kuadër të LKA-së, ai duhet të kërkojë dhe të garantojë zbatimin e saj edhe nga shtetet e treta që marrin pjesë në operacion, ku këto të fundit kanë përgjegjësinë të respektojnë detyrimet e shtetit të tyre¹⁷⁰.

¹⁶⁷ Frederik Naert, fq. 348.

¹⁶⁸ Marte Zwanenburg, "Legal Interoperability in Multinational Forces: A Military Necessity", *International Review of the Red Cross* (2013), <https://www.icrc.org/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

¹⁶⁹ C. Greenwood, "Scope of Application of Humanitarian Law", në *The Handbook of Humanitarian Law in Armed Conflict*, ed. D. Fleck (Oxford, Oxford University Press, 1995), fq. 46.

¹⁷⁰ Salamanca Presidency Declaration.

Në lidhje me detyrimin e shteteve të treta që marrin pjesë në operacionet e PESMP-së për të zbatuar normat e LKA-së, mund të themi se ai është i njëjtë me atë të Shteteve Anëtare. Në këtë rast BE-ja ka përgjegjësinë të garantojë respektimin nga ana e këtyre forcave të të gjitha detyrimeve që ajo ka në kuadër të LKA-së. Në rast se forcat e shteteve të treta nuk janë nën komandën e BE-së, kjo e fundit nuk do të mbajë përgjegjësi në arenën ndërkombëtare për veprimet e ndërmarra nga ato, por duhet të sigurojë që këto forca të respektojnë detyrimet që kanë shtetet e tyre dërguese në kuadër të LKA-së¹⁷¹. Pra, ndonëse shtetet e treta janë në një pozicion të ndryshëm nga Shtetet Anëtare dhe ato nuk kanë përgjegjësi që burojnë nga anëtarësimi në BE, në rast të angazhimit të tyre në operacionet e ndërmarra në kuadër të PESMP-së ato e kanë transferuar autoritetin për drejtimin e tyre tek BE-ja dhe për këtë arsye do të jenë përgjegjëse për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga LKA-ja, njësoj si Shtetet Anëtare.

3.2 Të drejtat e njeriut dhe natyra ekstraterritoriale e tyre

a. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim Konventa) parashikon se: “*Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente.*”¹⁷². Në lidhje me termin “juridiksion” dhe nëse ai do të nënkuptojë vetëm territorin brenda kufinjve kombëtarë, jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) nuk ka qenë e konsoliduar, duke mbajtur qëndrime të ndryshme. Në çështjen *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata u shpreh se neni 1 i Konventës vendos kufizime territoriale për shtetet, të cilat kanë detyrimin që brenda territorit të tyre të garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në të, duke mos pasur pushtetin dhe mjetet e duhura që këto standarte t’ia imponojnë edhe shteteve të tjera¹⁷³. Të njëjtin qëndrim ajo ka mbajtur dhe në çështjen *Banković*, në të cilën togfjalëshit “brenda juridiksionit” i dha kuptimin brenda territorit të shtetit kontraktues, i cili nuk mund të shtrihej në një shtet tjetër në mungesë të një pëlqimi, ftese apo pranimi të heshtur të këtij të fundit, me përjashtim të rastit kur ai ishte pushtues¹⁷⁴.

Ndërsa në çështjen *Drozd dhe Janousek k. Francës dhe Spanjës*, Gjykata e zgjeroi më tej kuptimin e termit “juridiksion”, duke përfshirë në të jo vetëm territorin brenda kufinjve të një shteti, por edhe atë në të cilin aktet e këtij shteti prodhojnë efekte¹⁷⁵. Ky qëndrim u mbajt edhe në çështjen *Loizidou kundër Turqisë*, në të cilën Gjykata rikonfirmoi faktin se shtetet nënshkruese

¹⁷¹ Neni 1(1) i Protokollit 1.

¹⁷² <https://www.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 14 Mars 2017).

¹⁷³ GJEDNJ, *Çështja Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. Aplikimi 14038/88 (datë 07 Korrik 1989), pg. 86,

<http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁷⁴ GJEDNJ, *Çështja Banković dhe të tjerë k. Belgjikës, Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë etj.*, Nr. Aplikimi 52207/99 (datë 12 Dhjetor 2001), pg. 59 – 82, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁷⁵ GJEDNJ, *Çështja Drozd dhe Janousek k. Francës*, Nr. Aplikim 12747/87 (datë 26 Qershor 1992), pg. 91, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

kanë detyrimin të garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive edhe në një territor jashtë kufinjve të tyre ku si pasojë e veprimeve ushtarake, të ligjshme apo të paligjshme, ato ushtrojnë kontroll efektiv dhe të drejtpërdrejtë, nëpërmjet forcave ushtarake ose një administrate lokale¹⁷⁶.

Referuar vendimeve të mësipërme, duket sikur Gjykata bën një ndarje midis konceptit që një veprim i kryer bie në juridiksionin e një shteti dhe të konceptit që një individ është viktimë e një veprimi që i atribuohet një shteti, qëndrim me të cilin nuk jam dakort duke pasur parasysh që forcat ushtarake ose agjentët e një shteti gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ato shfaqin dhe një pjesë të juridiksionit të shtetit që ata përfaqësojnë. Termi “juridiksion”, sipas nenit 1 të Konventës, duhet të nënkuptojë që shteti palë në konventë do të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ndaj kujtdo që preket nga një veprim, i cili përbën ushtrim të autoritetit të këtij shteti, të ligjshëm ose të paligjshëm, në cilindo vend të botës¹⁷⁷. Madje, edhe në rastin kur një shtet është në pamundësi për të ushtruar autoritetin e tij në të gjithë territorin, *de facto*, kjo nuk do të nënkuptojë që ai nuk ka juridiksion në kuptim të nenit 1 të Konventës edhe në atë pjesë të territorit e cila është përkohësisht nën autoritetin e një shteti tjetër ose të forcave protestuese. Megjithatë në një situatë të tillë juridiksioni që do të mund të ushtrojë shteti është i kufizuar vetëm në përmbushjen e detyrimeve pozitive, ky shtet duhet të përpiqet me të gjitha mjetet diplomatike dhe ligjore në dispozicion të tij, për të vazhduar garantimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë¹⁷⁸.

A gjen zbatim KEDNJ-ja në rastin e operacioneve të drejtuara nga BE-ja dhe të ekzekutuara nga Shtetet Anëtare, duke qenë se vetë BE-ja nuk është një nga nënshkrueset e Konventës?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje i referohem çështjeve Behrami kundër Francës dhe Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë, në të cilat Gjykata ka mbajtur qëndrimin se veprimet e komandës dhe mosveprimet e brigadës përgjegjëse do t'i atribuohen OKB-së, pasi në të dyja rastet është vepruar nën mandatin e deleguar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe se ajo nuk është kompetente për të gjykuar veprimet e Shteteve të ndërmarra në emër të OKB-së¹⁷⁹. Nisur nga ky qëndrim i Gjykatës, mendoj se ai mund të gjejë zbatim dhe në rastin e operacioneve të drejtuara nga BE-ja, për të cilat përgjegjësia i përket asaj dhe jo Shteteve Anëtare. Çështja nëse dispozitat e KEDNJ-së do të kenë efekt edhe ndaj BE-së do të trajtohet në vijim të këtij punimi.

Nga sa më lart mund të themi se, KEDNJ-ja i nënshtrohet parimit të ekstraterritorialitetit, pasi ajo nuk gjen zbatim vetëm brenda kufinjve territorialë të shtetit nënshkrues, por edhe në ato

¹⁷⁶ GJEDNJ, *çështja Loizidou k. Turqisë*, Nr. Aplikimi 15318/89 (datë 23 Mars 1995), pg. 62, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁷⁷ GJEDNJ, *Çështja Assanidze k. Gjeorgjisë*, Aplikim Nr. 71503/01 (datë 08 Prill 2004), pg. 137-138, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁷⁸ GJEDNJ, *Çështja Ilascu dhe të tjerë k. Moldavisë dhe Federatës Ruse*, Aplikim Nr. 48787/99 (datë 08 Korrik 2004), pg. 311=319, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁷⁹ GJEDNJ, *Çështja Behrami dhe Behrami k. Francës dhe Saramati k. Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*, Aplikim Nr. 71412/01 dhe 78166/01, pg. 68-71, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

teritore ku ai ushtron efektivisht autoritetin e tij, ku ai mban të burgosur ose nën kujdestari njerëz, qofshin këto veprime të kryera në pajtim ose jo me të drejtën ndërkombëtare.

b. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Në nenin 2(1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në vijim Pakti) parashikohet se: “...Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrëfarë dallimi...”¹⁸⁰. Nisur nga mënyra sesi është formuluar ky nen mund të themi se, zbatimi i Paktit kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të dy kushteve: *së pari*, individët ndaj të cilëve ai do të zbatohet duhet të ndodhen në territorin e një shteti palë; dhe *së dyti*, individët duhet të jenë nën juridiksionin e këtij shteti.

Mendoj se, vendosja e këtyre dy kushteve e kufizon së tepërmi fushën e zbatimit të Paktit dhe një interpretim i drejtë i këtij neni do të ishte që Pakti do të zbatohet ndaj individëve që ndodhen në territorin e një shteti palë dhe atyre që ndodhen nën juridiksionin e tij¹⁸¹. Një qëndrim i tillë është në pajtim dhe me atë të mbajtur nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe GJND-ja. Jurisprudenca e të parit e ka cilësuar interpretimin literal të nenit 2(1) të Paktit si të papërgjegjshëm dhe absurd, duke u shprehur se: “...Shtetet Palë në zbatim të nenit 2 paragrafi 1, kanë detyrimin për të respektuar dhe për t’i garantuar të drejtat e përfshira në Pakt të gjithë individëve të cilët mund të jenë në territorin e tyre dhe të gjithë individëve të cilët janë subjekt i juridiksionit të tyre. Kjo nënkupton që një shtet palë duhet të respektojë dhe t’i garantojë të drejtat e parashikuara në këtë Pakt çdokujt, i cili ndodhet nën pushtetin ose kontrollin efektiv të atij shteti, edhe nëse nuk ndodhet në territorin e tij...”¹⁸². Ndërsa ajo e të dytit në Opinionin Këshillimor mbi “Pasojat ligjore të ndërtimit të murit në territorin e pushtuar Palestinez” është shprehur se: “...Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është i zbatueshëm ndaj veprimeve të kryera nga një shtet në ushtrim të juridiksionit të tij edhe jashtë territorit të tij...”¹⁸³.

Zbatimi në praktikë i këtij interpretimi të zgjeruar ka hasur kundërshtime, sidomos në rastin e operacioneve paqeruajtëse të zhvilluara jashtë territorit të shtetit palë, por nën komandën e tij¹⁸⁴. Në disa raste të tjera Pakti është zbatuar jo vetëm ndaj individëve që ndodhen brenda

¹⁸⁰ <http://www.ohchr.org/> (hyrë për herë të fundit më 17 Mars 2017).

¹⁸¹ D. McGoldrick, “Extraterritorial Application of the International Covenant on Civil and Political Rights”, në *Extraterritorial Application of Human Rights Treaties*, ed. F. Coomans dhe T. Kamminga (Antwerp, Intersentia, 2004), fq. 790 – 806.

¹⁸² Komiteti i të Drejtave të Njeriut, *López Burgos k. Uruguajit*, Komunikata Nr 52/1979 (29 Korrik 1981), pg. 12.1-12.3, <http://www1.umn.edu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁸³ Kyle Bradley, “A Mending Wall: a Critical Look at the International Court of Justice’s Analysis in its Advisory Opinion on the Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory”, *Temple International and Comparative Law Journal*, Volumi 19 (2005), Nr. 2, fq. 419-448; 2004”; Oxford Public Interest Lawyers, *Legal Consequences of Israel’s Construction of a Separation Barrier in the Occupied Territories* (Oxford, Shkurt 2004), <http://www.law.ox.ac.uk/> (hyrë për herë të fundit më 16 Tetor 2015).

¹⁸⁴ UN, *Concluding observations of the Human Rights Committee* (29 Prill 2003), <http://ccprcentre.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

territorit të një shteti, por edhe ndaj atyre që ndodhen nën juridiksionin e tij, edhe në rastin e operacioneve ushtarake¹⁸⁵.

Në përfundim mund të themi se, në dallim nga Konventa, mënyra e formulimit të nenit 2(1) të Paktit krijon më pak hapësira për interpretim. Nëse neni 1 i Konventës parashikon “*nën juridiksionin e Palëve të Larta Kontraktuese*”, neni 2(1) i Paktit parashikon “*në territorin dhe juridiksionin e Shteteve Palë*”, duke krijuar në këtë mënyrë një hapësirë më të ngushtë për zbatimin ekstraterritorial të këtij të fundit. Edhe jurisprudenca e Komitetit për të Drejtat e Njeriut nuk ka mbajtur qëndrime konsistente në lidhje me zbatimimin ekstraterritorial të Paktit, duke i njohur atij një zbatim të kufizuar¹⁸⁶.

c. Akte të tjera në fushën e të drejtave të njeriut

Si akte të tjera të rëndësishme në fushën e të drejtave të njeriut mund të përmendim Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, në të cilat nuk parashikohet asnjë dispozitë në lidhje me kufinj të territorialë apo juridiksionalë të zbatueshmërisë së tyre. Por, edhe në këtë rast Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe GJND-ja, nëpërmjet jurisprudencës së tyre kanë pranuar që edhe këto akte mund të gjejë zbatim dhe jashtë territorit të shteteve palë¹⁸⁷.

Nga sa më lart mund të themi se, pavarësisht rëndësisë që këto akte kanë në garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë operacioneve paqeruajtëse ose në ato të natyrës ushtarake, organizatat ndërkombëtare, përfshirë dhe BE-në, duke mos qenë palë nënshkruese të tyre nuk kanë asnjë detyrim për zbatimin e urdhërimeve të parashikuara në to. Ndërsa në lidhje me të drejtën zakonore në fushën e të drejtave të njeriut mund të themi se ajo ka karakter rajonal dhe kjo ndodh për disa arsye: *së pari*, numri i shteteve që kanë ratifikuar këto traktate ose pakte është më i ulët se ai i shteteve që kanë ratifikuar Konventat e Gjenezës dhe Protokollet shtesë të saj; *së dyti*, aktet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut kanë karakter lokal si psh. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Afrikane për të Drejtat e Njerëzve dhe të Popujve, Karta Amerikane e të Drejtave të Njeriut etj; dhe *së treti*, të drejtat e njeriut janë bërë pjesë e së drejtës së brendshme të shteteve.

A ka derogime nga zbatimi i të drejtave të njeriut në situata luftimesh dhe emergjencash?

Për nga natyra e tyre, aktet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut gjejnë zbatim kryesisht në kohë paqe, duke parashikuar dhe derogime në rastet e situatave të konflikteve. Pra, të drejtat e njeriut nuk kanë karakter absolut dhe ato mund të jenë objekt derogimesh, të cilat: *i.)* duhet të parashikojnë qartësisht rrethanat kur ato lejohen; *ii.)* duhet të bëhen publike dhe të njoftohen zyrtarisht¹⁸⁸; *iii.)* jo çdo e drejtë mund të jetë objekt derogimesh si e drejta e jetës¹⁸⁹,

¹⁸⁵ Belgjika pranoi natyrën ekstraterritoriale të PNDKP-së në lidhje me misionin e OKB-së në Somali. UN, *Concluding Observations: Belgium* (19 Nëntor 1998), pika 14, <http://www.refworld.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁸⁶ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, çështja *Ibrahim Gueye et al. K. Francës*, Kommunikata Nr. 196/1985 (6 Prill 1989), pika 9.4, <http://www1.umn.edu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁸⁷ GJND, *Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory* (09 Korrik 2004), pika 112-113, <http://www.icj-cij.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁸⁸ Neni 15(3) i KEDNJ-së, neni 4(3) i PNDKP.

ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerezor dhe poshtërues¹⁹⁰, skllavëria¹⁹¹, mosdënimi pa ligj etj¹⁹²; iv.) duhet të jenë proporcionale¹⁹³; dhe v.) nuk e përjashtojnë shtetin nga përmbushja e detyrime që rrjedhin nga akte të tjera ndërkombëtare, si LKA-ja nëse është i zbatueshëm¹⁹⁴.

Konkretisht, nëse i referohemi KEDNJ-së, neni 15 i saj i njeh mundësinë shteteve të parashikojnë derogime nga zbatimi i të drejtave dhe lirive të sanksionuara në të, të cilat duhet të plotësojnë disa kritere:

Së pari, derogimet janë të lejueshme në rast lufte ose çdo rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit. Në mungesë të një përkufizimi në Konventë, mendoj se termi “luftë” i referohet çdo lloj konflikti të armatosur në kuptim të LKA-së, duke mos përfshirë në to rastet e tjera të përdorimit të forcës vdekjeprurëse (neni 2.2/c i Konventës). Ndërsa me togfjalëshin “çdo situatë rrezu që i kanoset jetës së kombit” do të kuptojmë çdo situatë të jashtëzakonshme krize ose emergjence, e cila ka ndikim mbi të gjithë popullsinë dhe përbën rrezik për rendin shoqëror të saj. Në kategorinë e veprimeve që vënë në rrezik jetesën e kombit përfshihet dhe sulmi terrorist¹⁹⁵. Diskrecioni për të vlerësuar se cila situatë përbën rrezik për jetën e kombit i përket Shteteve Anëtare. Gjithashtu, këto situata rreziku mund të jenë të kufizuara dhe në një rajon të caktuar gjeografik¹⁹⁶.

Pyetja që lind në këtë rast është nëse zbatimi i LKA-së a autorizon automatikisht derogimin apo ai, në kuptim të Konventës, duhet të zbatohet vetëm nëse ekziston një kërcënim ndaj shtetit dhe nëse justifikohet nga situata?

Në lidhje me këtë pyetje, mendoj se bazuar në nenin 15 të Konventës derogimi është i lejueshëm vetëm në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, nëse justifikohet nga situata, dhe jo në çdo rast kur zbatohet LKA-ja¹⁹⁷. Megjithatë, disa nga dispozitat e LKA-së duket se bien në kundërshtim me përfundimin e mësipërm, si psh. dispozita e cila lejon marrjen e të burgosurve të luftës dhe mbajtjen e tyre për të parandaluar pjesëmarrjen e mëtejshme të tyre në luftime, madje edhe në raste të konflikteve të armatosura ndërkombëtare të një rëndësie të vogël, të cilat nuk vënë në rrezik sigurinë e kombit. Gjithashtu, Komisioni

¹⁸⁹ Neni 15(2) juncto 2 i KEDNJ dhe neni 6 juncto 4(2) i PNDCP.

¹⁹⁰ Nenin 15(2) juncto 3 të KEDNJ-së dhe neni 7 juncto 4(2) i PNDCP.

¹⁹¹ Nenin 15(2) juncto 4(1) të KEDNJ-së dhe nenin 8(1) juncto 4(2) të PNDCP.

¹⁹² Nenin 15(2) juncto 7 të KEDNJ-së dhe nenin 15 juncto 4(2) të PNDCP.

¹⁹³ Joan F. Hartman, *Derogation from Human Rights Treaties in Public Emergencies - A Critique of Implementation by the European Commission and Court of Human Rights and the Human Rights Committee of the United Nations* (Harvard I.L.J. 1980), fq. 3.

¹⁹⁴ UN, *General Comment No. 29: State of Emergency (Article 4)* (31 Gusht 2001), pika 9, <http://www.nichibenren.or.jp/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

¹⁹⁵ GJEDNJ, *çështja Lawless k. Irlandës*, Aplikim Nr. 332/57 (datë 01 Korrik 1961), pg. 28-30, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 prill 2017).

¹⁹⁶ GJEDNJ, *çështja Aksoy k. Turqisë*, Aplikim Nr. 21987/93 (datë 18 Dhjetor 1996), pg. 70-77, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

¹⁹⁷ H. Montealegre, *The Compatibility of a State Party's Derogation under Human Rights Conventions with Its Obligations under Protocol II and Common Article 3*, (1983), fq. 43-44.

European dhe Gjykata në disa raste që kishin të bënin me të drejtën e jetës kanë zbatuar *de facto* LKA-në, edhe pse në mungesë të një derogimi të shprehur¹⁹⁸.

Së dyti, rastet e derogimeve nga zbatimi i të drejtave të njeriut duhet të jenë të qarta dhe të paralajmëruara. Shtetet nuk kanë pushtet të pakufizuar, pasi për çdo rast ato duhet të njoftojnë pa vonesë Sekretarin e Përgjithshëm të KE-së në lidhje me masat e marra dhe arsyet mbi të cilat ato janë bazuar¹⁹⁹.

Së treti, jo çdo e drejtë mund të jetë objekt derogimesh. Neni 15 i Konventës nuk lejon derogime nga e drejta e jetës, me përjashtim të vdekjeve të shkaktuara nga veprime të ligjshme luftarake, nga ndalimi i torturës, nga ndalimi i skllavërisë dhe mosdënimi pa ligj.

Së katërti, Gjykata nuk ka mbajtur një qëndrim të unifikuar në lidhje me natyrën ekstraterritoriale të nenit 15 të Konventës²⁰⁰. Por, në rast se do të pranohej që parimi i ekstraterritorialitetit do të gjente zbatim edhe ndaj nenit 15 të Konventës, kjo gjë do të shkaktonte probleme në praktikë, pasi vlerësimi nëse një situatë do të konsiderohet si rrezik publik për rendin shoqëror do të ishte i ndryshëm nga secili shtet dhe për situata të ngjashme do të kishim zbatime të ndryshme të tij.

Përveç Konventës, e drejta e derogimit njihet edhe nga PNPC-ja dhe konkretisht neni 4 i tij i njeh të drejtën shteteve palë të devijojnë nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga Pakti vetëm në rast të situatave që përbëjnë rrezik publik të jashtëzakonshëm dhe që kërcënojnë ekzistencën e kombit, duke përjashtuar, ndonëse jo në mënyrë të shprehur, situatat e luftës²⁰¹. Gjithashtu, nisur nga ngjashmëritë në formulim me nenin 15 të Konventës, mund të themi se të njëjtat përfundime do të jenë të zbatueshme edhe në këtë rast, si: *i.*) situatat e rrezikut mund të jenë të kufizuara dhe në një rajon të caktuar gjeografik²⁰²; *ii.*) situatat e konfliktit nuk duhet të jenë të një natyre të tillë që të mund të klasifikohen si konflikte të armatosura në kuptim të LKA-së²⁰³; dhe *iii.*) masat që do të merren nga shtetet palë duhet të mos jenë në kundërshtim me

¹⁹⁸ GJEDNJ, *çështja Qipro k. Turqisë*, Aplikim Nr. 6780/74 dhe 6950/75 (datë 10 Korrik 1976), <http://www.kypros.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017). Në këtë çështje Komisioni u shpreh se: "...zbatimi i LKA-së justifikonte derogimin nga disa dispozita të KEDNJ-së, edhe pse në mungesë të një derogimi të shprehur për Qipron Veriore...".

¹⁹⁹ GJEDNJ, *çështja Aksoy k. Turqisë*, pg. 68.

²⁰⁰ Çështja Qipro k. Turqisë, pg. 76.

²⁰¹ Neni 4 i PNDKP parashikon se: "Në kohën kur një rrezik publik i jashtëzakonshëm kërcënon ekzistencën e kombit dhe shpallet zyrtarisht si i tillë, shtetet palë të këtij Pakti mund të marrin masa me të cilat shmangin detyrimet e parashikuara në këtë Pakt, në vëllimin përpikërisht të caktuar sipas kërkesave të situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në kundërshtim me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të mos shkaktojnë diskriminim mbi baza racore, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar ose origjine sociale. 2. Asnjë shmangie nga nenet 6, 7, 8 (paragrafi 1 dhe 2), 11, 15, 16 dhe 18 nuk mund të bëhet në zbatim të kësaj dispozite. 3. Shtetet palë të këtij Pakti që shfrytëzojnë të drejtën e derogimit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i njoftojnë menjëherë shtetet e tjera palë të këtij Pakti lidhur me dispozitat nga të cilat ato janë shmangur si dhe lidhur me arsyet që i kanë shtyrë të bëjnë këto shmangie...".

²⁰² Human Rights Committee, *General Comment No. 29: States of Emergency (Article 4)*, pg. 3, <http://www1.umn.edu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²⁰³ Po aty. "Gjatë një konflikti të armatosur, ndërkombëtar ose jo ndërkombëtar, normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare janë të zbatueshme dhe ndihmojnë... në parandalimin e abuzimit të një shteti

detyrime të tjera që këto shtete kanë në lidhje me akte të tjera të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë dhe ato në kuadër të LKA-së²⁰⁴.

Në dallim nga Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, Komiteti për të Drejtat e Njeriut nuk ka pranuar se zbatimi i LKA-së në rastin e një konflikti të armatosur, legjitimon automatikisht Shtetet Anëtare që të zbatojnë dispozitën e derogimit dhe përcaktimi se cila situatë do të konsiderohet rrezik nuk varet nga vlerësimi i shteteve rast pas rasti, por ajo duhet të shpallet publikisht si e tillë²⁰⁵. Ndonëse në rastin e Konventës detyrimi për të njoftuar masat që do të ndërmerren nuk buron nga neni 15, por nga jurisprudenca e Gjykatës, në rastin e Paktit është neni 4 i tij i cili parashikon shprehimisht detyrimin që kanë shtetet palë për njoftim nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Zbatimi ose jo i detyrimit për njoftim nga shtetet nuk ndikon në ligjshmërinë e derogimit, përse kohë ai plotëson kriteret e parashikuara në nenin 4²⁰⁶. Shembujt në praktikë kanë qenë të ndryshëm, psh. SHBA-ja pas 11 Shtatorit pretendoi se ndodhej në një situatë emergjence dhe nuk njoftoi derogimin sipas nenit 4 të Paktit²⁰⁷, ndërsa Britania e Madhe njoftoi si derogimin ashtu edhe heqjen e masave.

Në lidhje me kategorinë e të drejtave për të cilat nuk lejohet derogimi, mund të themi se në rastin e Paktit ajo është më e zgjeruar se ajo e nenit 15 të Konventës. Përveç, të drejtave të përfshira në nenin 15 të Konventës, Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka shtuar dhe elementë të të drejtave të tjera²⁰⁸.

3.3 Zbatueshmëria e të drejtave të njeriut në operacionet e ndërmarra në kuadër të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët

a. Detyrimet e Shteteve Anëtare

Përgjegjësia e një shteti në arenën ndërkombëtare mund të rezultojë: *së pari*, nga veprimet e kryera nga një organizatë ndërkombëtare në të cilën ai është anëtar, me përjashtim kur

me të drejtën për të përcaktuar situatat e emergjencës. Pakti kërkon që edhe gjatë një konflikti të armatosur masat deroguese janë të lejueshme vetëm në rast se situata e caktuar përbën një kërcënim për jetën e kombit...”.

²⁰⁴ General Comment, pg. 9.

²⁰⁵ General Comment 29, pg. 2 parashikon se: “...Kushti i fundit është i rëndësishëm për ruajtjen e parimit të ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës në ato raste kur ato janë më të domosdoshme. Kur deklarohet një situatë emergjence, e shoqëruar me pasojat se mund të shkaktoje derogim nga secila dispozitë e Paktit, Shtetet duhet të veprojnë në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe norma të tjera ligjore që rregullojnë një situatë të tillë dhe ushtrimin e këtyre pushteteve. Është detyrë e Komitetit të monitorojë ligjet në fjalë nëse ato garantojnë dhe sigurojnë pajtueshmërinë me nenin 4”.

²⁰⁶ General Comment 29, pg. 17. Komiteti u shpreh se: “Detyra e Komitetit për të monitoruar pajtueshmërinë me nenin 4 të ligjit dhe praktikës së Shtetit palë nuk varet nga fakti nëse ai ka paraqitur apo jo një njoftim...”. Kjo nënkupton se mund të ketë derogim edhe pse njoftimi mungon”.

²⁰⁷ *Declaration of National Emergency by Reason of Certain Terrorist Attacks by the President of the United*

States of America, (14 Shtator 2001, <http://www.presidency.ucsb.edu/ws/?pid=61760> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017)

²⁰⁸ General Comment 29, pg. 13 – 16.

veprimi kryhet në interes të përgjithshëm; *së dyti*, nga pjesëmarrja në votimin e një vendimi, ku vetë pjesëmarrja përbën çënim të një detyrimi ndërkombëtar të atij shteti; dhe *së treti*, nga zbatimi i një vendimi, i cili është në kundërshtim me një detyrim ndërkombëtar, me përjashtim të rastit kur ai ka ofruar një mbrojtje ekuivalente, si nga ana substanciale dhe ajo procedurale²⁰⁹, në rast se kryhet për realizimin e një interesi të përbashkët, kur nuk ka asnjë diskrecion në zbatimin e atij vendimi dhe nëse shkalla e çënitimit është në proporcion me rëndësinë që ka bashkëpunimi ndërkombëtar.

Problematike shfaqet në praktikë, në rastin e BE-së, ofrimi i një mbrojtje ekuivalente në atë shkallë që ofron vetë Konventa, si përsa i përket garancive substanciale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të mekanizmave që kontrollojnë zbatimin e tyre. Mungesa e një mekanizimi që mund të kontrollojë veprimet e Shteteve Anëtare në kuadër të operacioneve të PESMP-së, pasi GJED-ja nuk e shtrin juridiksionin e saj në këto çështje, është konsideruar se BE-ja nuk mund të ofrojë një mbrojtje ekuivalente si nga ana substanciale edhe nga ana procedurale²¹⁰. Gjithashtu, duke iu referuar çështjes Saramati dhe Berhami, nëse Shtetet Anëtare transferojnë kompetencat në një organizatë ndërkombëtare, e cila më pas ushtron juridiksion mbi individët dhe territorin të cilët më parë nuk ishte nën juridiksionin e shtetit të cilit i transferoi këto kompetenca, ato nuk kanë detyrimin të ofrojnë një mbrojtje ekuivalente, detyrim të cilin tashmë e ka organizata. Por, shteti nuk përjashtohet nga përgjegjësia për veprimet e kryera nga ai, të cilat nuk i janë transferuar organizatës, sidomos përsa i përket vendimmarrjes dhe masave që merr për zbatimin e tyre²¹¹. Ndërsa, në lidhje me PESMP-në, Shtetet Anëtare të cilat marrin pjesë në operacione të drejtuara nga BE-ja janë të detyruara që në çdo rast të respektojnë të drejtat e njeriut, të cilat tashmë janë pjesë e së drejtës së saj²¹².

²⁰⁹ GJEDNJ, *çështja Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi k. Irlandës*, Aplikim nr. 45036/98 (datë 30 qershor 2005), pg. 155, <http://hudoc.echr.coe.int/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017). Në këtë çështje Gjykata është shprehur se: “...*Veprimet e shteteve të ndërmarra në pajtim me detyrimet ligjore që burojnë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të cilave u kanë transferuar sovranitetin e tij, janë të justifikuar për aq kohë sa organizata i kushton rëndësi mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si përsa i përket ofrimit të garancive substanciale edhe krijimit të mekanizmave që kontrollojnë zbatimin e tyre, në atë shkallë e cila mund të konsiderohet ekuivalente me ato që ofron vetë Konventa...Megjithatë, çdo fakt në lidhje me ekuivalencën nuk është përfundimtar dhe do të jetë objekt rishikimi në rast të ndryshimeve thelbësore përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut...”.*

²¹⁰ GJED, *çështja C-354/04 P Gestoras Pro Amnistía dhe të tjerë k. Këshillit*, Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi (datë 26 Tetor 2006), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²¹¹ Frederik Naert, fq. 423.

²¹² *Gestoras Pro Amnistía dhe të tjerë k. Këshillit*, pg. 49-57 Gjykata në këtë çështje u shpreh se: “*Institucionet janë subjekt i rishikimit të pajtueshmërisë së akteve të tyre me parimet e përgjithshme të së drejtës, ashtu si edhe Shtetet Anëtare kur zbatojnë të drejtën e Bashkimit...dhe i përket Shteteve Anëtare, dhe sidomos gjykatave të tyre, të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat procedurale kombëtare të cilat rregullojnë ushtrimin e të drejtave të veprimit, në atë formë që t'i mundësojnë personave fizikë dhe juridikë të kundërshtojnë para gjykatave ligjshmërinë e çdo veprimi ose masave të tjera kombëtare, që merren në zbatim të një akti të BE-së ose të zbatimit të tyre dhe të shikojnë mundësinë e kompensimit të çdo humbje të shkaktuar...”.*

b. Respektimi nga BE-ja i të drejtave e njeriut

Personaliteti juridik i BE-së, i pavaruar nga ai i Shteteve Anëtare, i mundëson asaj që të mbajë përgjegjësi në arenën ndërkombëtare për veprimet të kryera nga vetë ajo, përfshirë dhe veprimet e kryera në kuadër të operacioneve të PESMP-së. Në rastin e operacioneve të drejtuara nga BE-ja, forcat e vëna në dispozicion nga Shtetet Anëtare janë në komandën dhe kontrollin e institucioneve të Bashkimit dhe veprojnë për emër dhe llogari të tij. Për këtë arsye, përveç detyrimit të Shteteve Anëtare për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, edhe BE-ja në rastin e operacioneve të drejtuara nga ajo ka detyrimin për të respektuar aktet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut²¹³.

Në situatën kur aktet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut vendosin kufinj territorialë ose juridiksionalë për zbatueshmërinë e tyre, problemi që shfaqet në praktikë është se çfarë do të konsiderohet territor në rastin e një organizate ndërkombëtare, siç është dhe BE-ja. Në lidhje me këtë çështje ekzistojnë tre hipoteza: *i.)* territori i një organizate ndërkombëtare është ai i Shteteve Anëtare të saj; *ii.)* territori i një organizate ndërkombëtare është ai i shtetit pritës ku zhvillohet operacioni; dhe *iii.)* në rastin e një operacioni, territori do të zëvendësohet me territorin ku organizata ushtron juridiksion efektiv. Në kushtet kur, gjatë një operacioni, një territor i caktuar mund të jetë nën kontrollin e disa organizatave ndërkombëtare, ku secila prej tyre ushtron kontroll efektiv vetëm në një pjesë të caktuar të tërësisë, mendoj se hipoteza e juridiksionit efektiv është më e përshtatshme në rastin e një organizate ndërkombëtare²¹⁴.

Detyrimi i BE-së për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut gjatë operacioneve të saj mund të burojë nga Traktatet Themelues të Bashkimit, nga marrëveshjet e nënshkruara nga ai, nga aktet e miratuara nga institucionet e tij, nga jurisprudenca e GJED-së, nga e drejta zakonore ndërkombëtare ose nga parimet e përgjithshme të së drejtës²¹⁵.

i. Traktatet e Bashkimit si burim

Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës u shoqërua dhe me rritjen e rëndësisë që Bashkimi i kushton respektimit të të drejtave të njeriut. Që në hyrje të tij, në nenin 2 të TBE-së, i ndryshuar, parashikohet respektimi i të drejtave të njeriut si një nga vlerat mbi të cilat funksionon vetë

²¹³ GJND, *Çështja C-105/03 Maria Pupino* (datë 16 Qershor 2005), pg. 58, <http://curia.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017). Në këtë çështje GJND-ja u shpreh se: “...në zbatim të nenit 6(2) të TBE-së, Bashkimi duhet të respektojë të drejtat themelore..., si parime të përgjithshme të së drejtës ...”; çështja *Gestoras Pro Amnistia dhe të tjerë K. Këshillit*, pg. 49-57, në të cilën Gjykata u shpreh se: “...Institucionet janë subjekt i rishikimeve të pajtueshmërisë së akteve të tyre me traktatet dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, ashtu si edhe Shtetet Anëtare kur zbatojnë të drejtën e Bashkimit..”.

²¹⁴ Psh. roli i BE-së në Kosovë dhe timorin Lindor ishte pothuajse ai i një administratori dhe pushtetet ishin ndarë ndërmjet disa organizatave. Shiko edhe M. Brand, “Institution-Building and Human Rights Protection in Kosovo in the Light of UNMIK Legislation”, *Nordic Journal of International Law*, Volume 70, Issue 4 (2001), fq. 461-488.

²¹⁵ ILA’s 2004 Final Report “*On the Accountability of International Organisations*”, fq. 22: (...Detyrimet ndaj të drejtave të njeriut, të cilat janë një shprehje e traditës kushtetuese të Shteteve, mund të jenë të detyrueshme për zbatim dhe ndaj organizatave ndërkombëtare në mënyra të ndryshme: nëpërmjet instrumenteve themelues të tyre, nëpërmjet të drejtës zakonore ndërkombëtare, nëpërmjet parimeve të përgjithshme të së drejtës ose nëse organizata bëhet anëtare e një traktati në fushën e të drejtave të njeriut...”).

Bashkimi. Gjithashtu, neni 6(3) i TBE-së, i ndryshuar i ka dhënë të drejtave themelore të përfshira në Kartën e të Drejtave Themelore, dhe të njohura nga tradita kushtetuese e Shteteve Anëtare, statusin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Gjithashtu, duke i dhënë Kartës të së Drejtave Themelore të njëjtën vlerë me Traktatet, Bashkimi jo vetëm njeh të drejtat, liritë dhe parimet të parashikuara në këtë Kartë por dhe e bën atë drejtpërdrejtë të zbatueshme nga institucionet, zyrat, agjensitë, strukturat e ndryshme të BE-së dhe nga Shtetet Anëtare kur këto zbatohen të drejtën komunitare²¹⁶. Kontrolli i zbatimit të kësaj Karte është nën juridiksionin e GJED-së, kur ajo vlerëson nëse veprimet e ndërmarra nga Shtetet Anëtare janë apo jo në përputhje me normat e së drejtës komunitare²¹⁷.

Detyrimi për të respektuar të drejtat themelore në veprimet e jashtme të Bashkimit, përfshirë dhe ato në kuadër të PMSP, buron edhe nga neni 21 i TBE-së, i cili parashikon se BE-ja në veprimet e jashtme do të udhëhiqet nga parime si: demokracia, shteti ligjor, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimi i dinjitetit njerëzor dhe respektimi i parimeve të Kartës së OKB-së dhe parimeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë dhe ato të zhvilluara nga GJEDNJ-ja nëpërmjet jurisprudencës së saj. Në dallim nga neni 11 i Traktatit të Mastrihtit, ky nen jo vetëm që parashikon detyrimin e Bashkimit për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut si një nga parimet themelore të tij, por ai i vendos ato si udhërrëfyes të veprimeve të jashtme të ndërmarra nga BE-ja.

ii. Marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga BE-ja

Personaliteti juridik i BE-ja, i njohur nga Traktati i Lisbonës, i mundëson BE-së të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare me organizata dhe të anëtarësohet në to. Përsa i përket oraganizatave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, Bashkimi nuk është palë nënshkruese e asnjë marrëveshje, megjithë përpjekjet në rritje për anëtarësimin e tij në KEDNJ (neni 59 paragrafi i dytë i TBE-së). Sipas draft marrëveshjes së përpiluar nga palët, BE-ja do të ketë detyrimin për të respektuar Konventën dhe Protokollet shtesë të saj vetëm përsa i përket akteve, masave, mosveprimeve të institucioneve të saj, të zyrave, të strukturave, të agjencive dhe personave që veprojnë në emër dhe për interes të saj. Në asnjë rast Bashkimi nuk do të jetë i detyruar të kryejë një veprim ose të adoptojë një masë për të cilën ai nuk është kompetent sipas ligjit komunitar. Gjithashtu, në draft parashikohet se në rast veprimesh ose masash të ndërmarra nga institucionet e Shtetit Anëtar ose nga persona që veprojnë në emër dhe në interes të tij përgjegjësia i përket atij, edhe nëse një veprim i tillë ndodh kur ai është duke zbatuar të drejtën e komunitare²¹⁸.

Në kategorinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, gjithashtu përfshihen dhe ato të nënshkruara me shtetet e treta dhe që përcaktojnë rregulla për misionet, të tilla si marrëveshjet për statusin e forcave dhe për statusin e misionit, pavarësisht se bazuar në përmbajtjen e marrëveshjeve tashmë të përfunduara, në to nuk gjenden dispozita, të cilat u referohen të drejtave

²¹⁶ Neni 6 i TBE-së, i ndryshuar.

²¹⁷ Neni 51(1) i Kartës së të Drejtave Themelore <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²¹⁸ *Accession of EU to ECHR Draft Agreement: Finally Finalised*, (datë 08 Prill 2013), <http://echrblog.blogspot.com/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

të njeriut. Marrëveshjet në lidhje me statusin e forcave zakonisht përmbajnë dispozita që përcaktojnë privilegjet dhe imunitetet që shteti pritës u njeh forcave të misionit, por nuk përmbajnë dispozita që vendosin detyrime në lidhje me të drejtat e njeriut²¹⁹. Një mangësi e tillë, mund të jetë pasojë e natyrës së operacioneve të ndërmarra deri më tani nga BE-ja, të cilat nuk karakterizohen nga pjesëmarrja aktive në konflikte të armatosura²²⁰.

iii. Deklarata ose akte të njëanshme të miratuara nga BE-ja

Në fushën e të drejtave të njeriut BE-ja nuk ka bërë ndonjë deklaratë apo të ketë miratur ndonjë një akt të njëanshëm, i cili e ngarkon atë me detyrimin për të respektuar të drejtat e njeriut gjatë operacioneve në kuadër të PESMP-së²²¹. Në këtë drejtim BE-ja ka publikuar disa udhëzues, të cilët ndonëse theksojnë rëndësinë që ka respektimi i të drejtave të njeriut në veprimet e saj në kuadër të PJSP-së, madje dhe të PESMP-së, ato nuk përcaktojnë mekanizmat nëpërmjet të cilave BE-ja do t'i realizojë ato²²². Gjithashtu, këto udhëzues nuk kanë asnjë fuqi detyruese për BE-në ose shtetet e saj anëtare²²³.

iv. Parime të përgjithshme të së drejtës komunitare

Një rol të rëndësishëm në përcaktimin e detyrimeve që BE-ja ka në fushën e të drejtave të njeriut ka luajtur dhe GJED-ja, e cila nëpërmjet jurisprudencës së saj e ka cilësuar Konventën dokument të një rëndësie të veçantë²²⁴ dhe ka përdorur dispozitat e saj si parime udhërrëfyese që e ndihmojnë atë në vendimmarrje²²⁵. Gjithashtu, përsa kohë të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në KEDNJ gëzojnë statusit e parimeve të përgjithshme të së drejtës (neni 6 i TBE-së), BE-ja ka detyrimin që kur vepron në zbatim të së drejtës komunitare të mos i cënojë ato dhe të garantojë mbrojtjen e tyre nga veprimet e saj²²⁶.

Megjithatë, mungesa e juridiksionit të GJED-së në çështje që kanë të bëjnë me shtyllën e tretë, dhe veçanërisht me PESMP-në²²⁷, ka krijuar mangësi në ekzistencën e një mekanizmi që do të mund të gjykonte ankimet e paraqitura për çënime të të drejtave të njeriut gjatë operacioneve ose misioneve të ndërmarra nga BE-ja. Kjo mungesë juridiksioni është bërë shkak, që ndonëse neni 340(2) i TFBE-së parashikon detyrimin që ka Bashkimi për të kompensuar çdo

²¹⁹ Marrëveshja ndërmjet BE-së dhe Republikës së Somalisë në lidhje me statusin e forcave detare të Bashkimit në kuadër të operacionit Atlanta, OJ 2009 L 10/29, neni 3 dhe 5.

²²⁰ Frederik Naert, fq. 425.

²²¹ CVCE, *Joint Declaration by the European Parliament, the Council and the Commission* (datë 5 Prill 1977), fq. 1,

<http://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²²² Council of European Union, *Generic Standart Behaviour for ESDP Operatins* (datë 18 Maj 2005), <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 26 Prill 2017).

²²³ Council of the European Union, *Draft guidelines on protection of civilians in EU-led crisis management operations* (14 Nëntor 2003).

²²⁴ GJND, *çështja 4-73 J. Nold, Kohlen- und Baustoffgroßhandlung k. Komisionit të Komuniteteve* (datë 14 Maj 1974), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²²⁵ GJND, *çështja C-413/99 Baumbast and R. k. Sekretarit të Shtetit* (17 Shtator 2002), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²²⁶ GJND, *çështja 46/87 dhe 227/88 Hoescht k. Komisionit* (21 Shtator 1989), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²²⁷ Neni 24(2) i TBE-së dhe neni 275 i TFBE-së.

dëm që i shkaktohet individëve nga institucionet ose nënpunësit e tij gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, në GJED nuk rezulton të jenë paraqitur për shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me kompensimeve të dëmeve të shkaktuara gjatë misioneve të drejtuara nga BE-ja.

KAPITULLI IV

GJENDJA JURIDIKE DHE KAPACITETET E POLITIKËS EUROPIANE TË SIGURISË DHE TË MBROJTJES SË PËRBASHKËT

4.1 Instrumentat ligjore në dispozicion të Bashkimit Europian

Që nga momenti i themelimit, BE-ja është përpjekur të forcojë rolin e saj në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke krijuar dhe aftësitë e nevojshme. Përpjekja e parë konkrete në këtë drejtim ishte hartimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë në 2003, në të cilën identifikoheshin jo vetëm rreziqet që i kanoseshin sigurisë europiane, si terrorizmi ndërkombëtar, armët e shkatërrimit në masë, mosfunksionimi i shteteve, konfliktet rajonale, krimi i organizuar, por edhe mënyrat për luftimin e tyre. Me përpilimin e raportin për “Zbatimin e Strategjisë Europiane të Sigurisë”, gama e këtyre rreziqeve u shtua duke përfshirë dhe terrorizmin kibernetik, piraterinë, ndryshimet klimaterike dhe sigurinë në fushën energjitike.

Ndërkohë që instrumentat dhe mekanizmat e tjerë, i kishin garantuar BE-së aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë operacione në mënyrë autonome në përgjigje të krizave ndërkombëtare, e mbështetur nga forcat e saj ushtarake, të cilat ndonëse vepronin nën logon dhe flamurin e saj nuk mund të konsideroheshin si një ushtri europiane, pasi kishin natyrë shumëkombëshe dhe ishin nën komandën e Shtetit Anëtar i cili i kishte vënë në dispozicion²²⁸. Gjithashtu, mësimet e nxjerra nga misionet dhe operacionet e ndërmarra që nga viti 2003, ndikuan në përmirësimin e kapaciteteve civile dhe ushtarake dhe në shndërrimin e profilit të saj nga një konsumator i sigurisë të garantuar nga NATO dhe SHBA-ja, në një ofrues të saj.

Në vazhdim të masave të marra për forcimin e kapaciteteve dhe të aftësive, ndërsa Traktati i Nicës i mëshonte vetëm bashkëpunimit në fushën e armatimeve, ai i Lisbonës e zgjeroi më tej atë duke përfshirë dhe çështje që kishin të bënin me logjistikën ushtarake, shërbimet e inteligjencës dhe përmirësimin e kohës së dislokimit të forcave ushtarake. Përveç rritjes së angazhimit të Shteteve Anëtare për përmirësimin e aftësive të tyre ushtarake, ky Traktat solli dy risi për arritjen e këtyre objektivave: *së pari*, koordinimi i përpjekjeve të Shteteve Anëtare për zhvillimin e aftësive ushtarake iu ngarkua AEM-së, dhe *së dyti*, krijimi i mekanizmit të përhershëm për bashkëpunimin e strukturuar. Megjithatë, angazhimi për zhvillimin më tej të aftësive ishte i kufizuar vetëm përsa i përket komponentëve ushtarakë të PESMP-së dhe jo atyre civilë si policia, forcimi i shtetit të së drejtës, administrata civile dhe misionet e mbrojtjes me natyrë civile, duke mos parashikuar dhe krijimin e ndonjë mekanizmi të posaçëm për këtë qëllim.

²²⁸ Neni 42 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

a. Zgjerimi i “Detyrave të Petërsbergut”

Risia tjetër që solli Traktati i Lisbonës ishte dhe zgjerimi i të ashtuquajturave “Detyrat e Petërsbergut”, të cilat fillimisht u parashikuan në Deklaratën e Petërsbergut dhe më vonë u bënë pjesë e TBE-së nëpërmjet Traktatit të Amsterdimit. Ndërsa fillimisht këto detyra përfshinin misionet humanitare dhe ato të shpëtimit, detyrat paqeruajtëse dhe ndërhyrjet ushtarake në rastet e menaxhimit të krizave, përfshirë dhe ato paqebërëse, me Traktatin e Lisbonës ato përfshinë dhe misionet e përbashkëta të çarmatimit, këshillimin dhe asistencën ushtarake, misionet për parandalimin e konflikteve, misionet për stabilizimin e gjendjes së krijuar pas konfliktit dhe luftën kundër terrorizmit, përfshirë këtu dhe ndihmën ndaj shteteve të treta në luftën kundër terrorizmit²²⁹. Në lidhje me mënyrën e realizimit të këtyre detyrave, dispozitat e Traktatit rregullonin vetëm kushtet që duhej të plotësoheshin, ndërsa objektivat, qëllimet dhe rregullat e përgjithshme për zbatimin e tyre do të përcaktoheshin nga Këshilli dhe koordinimi i aspekteve civile dhe ushtarake të detyrave do të ishte përgjegjësi e Përfaqësuesit të Lartë, i cili do të vepronte nën autoritetin e Këshillit dhe do të ishte në kontakt të vazhdueshëm me KPS-në (neni 43 i Traktatit).

b. Krijimi i një mbrojtje të përbashkët

Angazhimi i BE-së në ndërtimin e një politike të përbashkët mbrojtje, e cila më pas do të çonte drejt një mbrojtje të përbashkët, u rikonfirmua dhe në Traktatin e Lisbonës. Ndryshe nga Traktati i Amsterdimit, në të cilin përdorej shprehja “...që mund të çojë drejt një mbrojtje të përbashkët...”, në Traktatin e Lisbonës kjo shprehje u zëvendësua me “...që do të çojë drejt një mbrojtje të përbashkët...”, duke e bërë më të mundur realizimin e një objekti të tillë. Vendimi për krijimin e një mbrojtje të përbashkët do të merrej nga Këshilli, në mënyrë unanime, dhe vënia në zbatim i tij do të bëhej duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes së Shteteve Anëtare dhe duke respektuar angazhimet e tyre në kuadër të NATO-s. Një parashikim i tillë nxjerr edhe një herë në pah faktin se, megjithëse Shtetet Anëtare pranonin nevojën për një mbrojtje të përbashkët ato akoma nuk ishin të gatshme t’a realizonin atë në çdo mënyrë, duke i dhënë më tepër përparësi interesave kombëtare²³⁰.

Megjithatë, rëndësia e Traktatit të Lisbonës në këtë drejtim, qëndron në krijimin e disa mekanizmave që do të shërbenin si katalizatorë për arritjen e objektivit të krijimit të një mbrojtje të përbashkët, siç ishte parashikimi i klauzolës së mbrojtjes së ndërsjelltë (neni 42(7) i TBE-së), e cila përbënte bazën e “legjitimitetit politik”, dhe i bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar, ku qëllimi fillestar në propozimin e këtij bashkëpunimi ishte krijimi i një ushtrie europiane²³¹. Gjithashtu, njohja e personalitetit juridik të BE-së (neni 47 i TBE-së), ndikoi drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të rolit të saj si aktor ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe tërthorazi në rritjen e përpjekjeve për të realizimin e objektivës së krijimit të një mbrojtje të

²²⁹ Neni 43 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²³⁰ Neni 42(2) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²³¹ Gilles Combarieu, *Security and Defence Aspects of the Lisbon Reform Treaty* (Paris 2008), fq. 4-5, <http://europavarietas.visuarta.eu/> (hyrë për herë të fundit më 12 Mars 2014).

përbashkët. Në lidhje me PESMP-në, ky Traktat parashikonte të drejtën e BE-së për të nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare (neni 37 i TBE-së) dhe për t'u përfaqësuar në arenën ndërkombëtare.

Si përfundim mund të themi se, Neni 42(2) Traktatit të Lisbonës shënon fillimet e një politike të mbrojtjes së përbashkët, objektiv i cili duket se është më i realizueshëm në kuadër të këtij Traktati.

c. Instrumentat ligjore

Njohja e personalitetit juridik të BE-së, në lidhje me PJSP-në, solli dy pasoja të rëndësishme: *së pari*, mundësinë që BE-ja të nënshkruante marrëveshje me organizata ndërkombëtare dhe të anëtarësohej në to, dhe *së dyti*, krijimin e instrumentave të brendshme ligjore që BE-ja ka për zbatimin e PJSP-së dhe të PESMP-së në veçanti.

Instrumentat ligjore në dispozicion të BE-ja për zbatimin e PJSP-së, fillimisht u përcaktuan në Traktatin e Amstedit dhe ato ishin: a.) *parimet dhe udhëzimet*, të cilat përcaktonin orientimin e përgjithshëm politik; b.) *strategjitë e përbashkëta*, të cilat përcaktonin objektivat dhe mjetet për realizimin e tyre; c.) *veprimet e përbashkëta*, të cilat i adresoheshin situatave të veçanta dhe d.) *qëndrimet e përbashkëta*, të cilat i referoheshin një çështje konkrete.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës instrumentat ligjorë si “veprimet e përbashkëta”²³² dhe “qëndrimet e përbashkëta”²³³ u zëvendësuan përkatësisht me “vendime që përcaktojnë veprimet që duhet të ndërmerren nga BE-ja ” dhe “vendime që përcaktojnë qëndrimet që duhet të mbahen nga BE-ja”²³⁴. Ky Traktat nuk shprehet në lidhje me “strategjitë e përbashkëta”²³⁵, ndërsa “udhëzimet e përgjithshme” vazhdojnë të përcaktohen edhe nga ky Traktat²³⁶. Por, pavarësisht ndryshimeve në emërtim natyra e tyre vazhdon të mbetet e njëjtë, pasi ato nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe nuk karakterizohen nga supremacia mbi aktet e brendshme të Shteteve Anëtare.

Instrumentat ligjore nëpërmjet të cilave BE-ja do të drejtojë PJSP-në, përfshirë këtu dhe PESMP-në, janë të parashikuara në nenin 25 të TBE-së, i ndryshuar, dhe konkretisht ato janë: a.) udhëzimet e përgjithshme, b.) vendimet që përcaktojnë veprimet që duhet të ndërmerren dhe qëndrimet që duhet të mbahen nga BE-ja dhe marrëveshjet për vënien në zbatim të tyre, c.) forcimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare.

²³² Veprime të përbashkëta i referohen një situatë specifike ku ndërmarrja e veprimeve nga bashkimi konsiderohet e domosdoshme dhe në të përcaktohen objektivat, qëllimi dhe mjetet me të cilat do të realizohet. Ato angazhojnë Shtetet Anëtare.

²³³ Pozicione të përbashkëta nga njëra anë përcaktojnë qëndrimin që do të mbajë BE-ja për një çështje të caktuar dhe përcaktojnë në përgjithësi udhëzime të përgjithshme që politikat kombëtare të shteteve anëtare duhet të jenë në pajtim me to.

²³⁴ Neni 25 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²³⁵ Neni 12 i Traktatit të Nicës, <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²³⁶ Neni 12 i Traktatit të Nicës parashikon se: “...*parimet dhe udhëzimet e përgjithshme për PJSP-në do të përcaktohen...*”, ndërsa Neni 25 i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës përdor vetëm termin “parime të përgjithshme”.

Vendimet e marra nëpërmjet këtyre instrumentave ligjore edhe pse janë ligjorisht të detyrueshme për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare ato nuk mund të klasifikohen si akte ligjore, pasi Traktati i Lisbonës përjashton miratimin e akteve ligjore për çështje që kanë të bëjnë me PESMP-në²³⁷.

Një parashikim i tillë sjell dy pasoja ligjore në praktikë: *së pari*, bazuar në Protokollin 1²³⁸, parlamentet kombëtare nuk mund të ngrejnë pretendime për cënim të parimit të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit nga draftet e këtyre akteve joligjore, dhe *së dyti*, në rast të miratimit të akteve të tilla nga Këshilli, ky i fundit nuk është më nën detyrimin që buron nga Neni 16(8) i TBE-së, i ndryshuar²³⁹.

Gjithashtu hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës parashikonte katër lloje vendimesh^{240,241}, të cilat nuk mund të konsiderohen si akte të natyrës legjislative²⁴², pasi Traktati i BE-së përjashton mundësinë e miratimit të akteve të një natyre të tillë në fushën e PJSP-së, përfshirë këtu dhe PESMP-në si pjesë të saj (neni 41.1 i TBE-së)²⁴³. Këto vendime ishin:

- *Vendim në lidhje me objektivat strategjike dhe interesat e BE-së*: E drejta për të identifikuar objektivat strategjike dhe interesat e BE-së, të cilat përcaktojnë kufinj të PJSP-së dhe të veprime të ndërmarra nga Bashkimi në arenën ndërkombëtare, i përket Këshillit të BE-së²⁴⁴. Këto vendime mund të jenë pjesë e konkluzioneve ose raporteve të publikuara në përfundim të çdo mbledhje të Këshillit Europian ose të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme²⁴⁵. Gjithashtu, edhe qëndrimet e publikuara nga Përfaqësuesi i Lartë, në lidhje me një çështje që paraqet interes për BE-në, mund të përmbajnë objektiva strategjike dhe intetresa të BE-së për një çështje të caktuar²⁴⁶.

²³⁷ Neni 24(1) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës parashikon se: "...politika e jashtme dhe e sigurisë së përbashkët është subjekt i rregullave dhe procedurave të specifike. Ajo do të përcaktohet dhe do të zbatohet nga Këshilli Europian dhe Këshilli, në unanimitet, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga Traktati. Përjashtohet miratimi i akteve ligjore...", dhe Neni 31 (1) parashikon se: "...1. Vendimet në lidhje me këtë Kapitull do të merren nga Këshilli europian dhe Këshilli me unanimitet, përveç kur ky Kapitull parashikon ndryshe...".

²³⁸ Protokoll Nr. 1 "Mbi rolin e Parlamenteve Kombëtare në BE", Neni 2 dhe Neni 3.

²³⁹ Neni 16 (8) i TBE-së, i ndryshuar me Traktatin e Lisbonës parashikon se: "...8. Këshilli mbledhet në publik edhe në rast diskutimi dhe votimi të një projekt-ligji. Për këtë shkak, çdo mbledhje e Këshillit duhet të ndahet në dy pjesë, që kanë të bëjnë me diskutimin e akteve legjislative të Bashkimit dhe me aktivitetet jo legjislative", <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²⁴⁰ Neni 22.1 dhe 25 i TBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²⁴¹ Kjo kategori vendimesh, në fushën e PJSP-së, nuk duhet të ngatërrohet me "vendimet" që miratohen në fusha të tjera të politikës së BE-së, e cila është një nga llojet e akteve ligjore më të rëndësishme të Bashkimit (neni 288, paragrafi 4 i TFBE-së).

²⁴² Akte të natyrës legjislative janë ato akte të cilat miratohen sipas një procedure të përgjithshme ose të veçantë, shiko nenin 289 të TFBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²⁴³ <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁴⁴ Neni 22.1 i TBE-së, <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).

²⁴⁵ Këshilli i BE-së, *Deklarata për shtyp - Mbledhja e 3230 e Këshillit të Punëve të Jashtme*, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁴⁶ <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 03.10.2015).

Ndër dokumentat më të rëndësishëm strategjikë të miratuar nga BE-ja do të veçoja SES-në, Strategjinë e BE-së kundër Armëve të Shkatërrimit në Masë (2003)²⁴⁷, Strategjinë e BE-së kundër Terrorizmit (2005)²⁴⁸ dhe Strategjinë e BE-së për Sigurinë e Brendshme (2010)²⁴⁹.

- *Vendim mbi qëndrimet e përbashkëta*: Strategjitë dhe objektivat e përgjithshme të BE-së vihen në zbatim dhe konkretizohen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve të përbashkëta, të cilat adoptohen nga Këshilli i Ministrave. Qëndrimet e përbashkëta, në të shumtën e rasteve, qartësojnë objektivat e BE-së dhe specifikojnë qëndrimin diplomatik që ajo mban ndaj një çështje të caktuar. Këto përdoren kur Bashkimi kërkon të qartësojë pozitën e tij ndaj qeverive të shteteve të cilat dështojnë në respektimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë, të shtetit të së drejtës dhe të normave të së drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu, këto qëndrime përveç se mund t'i adresohen një shteti në veçanti, ato mund t'i adresohen edhe disa shteteve ose një rajoni në rastet kur synojnë parandalimin ose zgjidhjen e konflikteve, luftën kundër terrorizmit dhe procesin e varfërimit të armëve bërthamore²⁵⁰. Ndër qëndrimet e përbashkëta të adoptuar nga Bashkimi do të veçoja atë në rastin e Kubës (1996)²⁵¹, Zimbabve (2002)²⁵², Bjellrusisë²⁵³, Koresë së Veriut²⁵⁴, Iranit (2007)²⁵⁵ dhe Sirisë²⁵⁶.

Në kuptim të qëndrimeve të përbashkëta përfshihen dhe sanksionet, masat shtrënguese ndaj shteteve të treta, individuale apo ndaj entiteteve, të cilat janë një nga mjetet më të rëndësishme të politikës së jashtme të BE-së dhe i shërbejnë realizimit të objektivave të saj në pajtim me parimet e PJSP-së. Legjitimiteti i këtyre sanksioneve në të shumtën e rasteve buron nga mandati i KS të OKB-së dhe janë në zbatim të masave të vendosura nga rezolutat e KS-së. Edhe vetë BE-ja, në mënyrë autonome, mund të vendosë masa shtrënguese²⁵⁷.

²⁴⁷ <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁴⁸ Po aty.

²⁴⁹ <https://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵⁰ Derek Mix, *The European Union: Foreign and security policy*, (Congressional Research Service 08 Prill 2013), <https://www.fas.org/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵¹ Council of European Union, *Common Position of 2 December 1996 defined by the Council on the basis of Article J.2 of the Treaty on European Union, on Cuba* (02 Dhjetor 1996), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵² Council of European Union, *Decision of 13 September 2002 implementing Common Position 2002/145/CFSP concerning restrictive measures against Zimbabwe* (13 Shtator 2002), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵³ Council of European Union, *Common Position of 9 July 1998 defined by the Council on the basis of Article J.2 of the Treaty on European Union, concerning Belarus*, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵⁴ <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 03 Tetor 2015).

²⁵⁵ <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵⁶ European Commission, *Restrictive measures (sanctions) in force* (07 Qershor 2017), <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

²⁵⁷ European Union External Actions, *Common Foreign and Security Policy*, <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).

- *Vendim mbi veprimet e përbashkëta*: Veprimet e përbashkëta, në të shumtën e rasteve, i referohen operacioneve ose misioneve të natyrës ushtarake ose civile të ndërmarra nga BE-ja në kuadër të PESMP-së (shiko kapitullin mbi misionet). Në kuptim të veprimeve të përbashkëta përfshihet edhe mbështetja financiare ose çdo lloj tjetër mbështetje që Bashkimi jep ndaj organizatave ndërkombëtare të angazhuara në fusha si: varfërimi i armëve të shkatërrimit në masë (psh. Agjensia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike)²⁵⁸ ose rindërtimi i paqes (psh. OSBE-ja).
- *Vendim mbi zbatimin e marrëveshjeve në lidhje me qëndrimet dhe veprimet e përbashkëta*: Në zbatim të qëndrimeve dhe të veprimeve të përbashkëta të miratuara nga BE-ja, ajo mund të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare me organizata ndërkombëtare (NATO, Unioni Afrikan) ose me shtetet e treta, ku këto të fundit mund të jenë pjesëmarrëse në operacion ose shtetet në të cilat do të zhvillohet operacionet dhe misionet e ndërmarra nga BE-ja. Në rastin e fundit marrëveshjet përmbajnë dispozita që do të rregullojnë statusin që do të ketë misioni i BE-së ose forcat e saj të angazhuara në të.

Në lidhje me këto instrumenta ligjore mund të themi se ato për shkak të natyrës së tyre të përzier, legislative dhe politike, përbëjnë një zonë “gri” të legjislacionit të BE-së, pasi atyre u mungon karakteri detyrues dhe GjND-ja nuk ka juridiksion për të kontrolluar pajtueshmërinë e tyre me Traktatet ose t’i interpretojë ato në raste paqartësish²⁵⁹. Për këtë arsye, ato mund të karakterizohen si “*soft law*” i Bashkimit.

Megjithatë, bazuar në parimet më të rëndësishme mbi të cilën funksionin politika e jashtme e BE-së, si ai i koherencës dhe i qëndrueshmërisë, Shtetet Anëtare kanë detyrimin të mbështesin politikën e jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit në mënyrë aktive dhe pa rezerva, sipas frymës së besnikërisë dhe solidaritetit reciprok, dhe gjithashtu të pajtohen me veprimet e tij në këtë fushë²⁶⁰.

4.2 Aftësitë dhe kapacitetet mbrojtëse të Bashkimit European

Që nga koha e themelimit të saj BE-ja është konsideruar si një fuqi civile, e cila i ka kushtuar rëndësi forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe politik dhe zgjidhjes diplomatike të konflikteve, ndërsa NATO është konsideruar si organizata përgjegjëse për realizimin e mbrojtjes kolektive dhe vendi ku Shtetet Anëtare mund të diskutonin për çështje që kishin të bënin me sigurinë dhe mbrojtjen. Situata e krijuar gjatë Luftës së Ftohtë, paaftësia e BE-së për të marrë vendime për të ndërhyrë politikisht ose ushtarakisht gjatë konflikteve në Ballkan dhe më së fundmi situata në Ukrainë, ndryshimet gjeopolitike, shtimi i konflikteve në afërsi të kufinjve të Europës, shtimi i fluksit të emigrantëve nga zonat e konfliktit dhe terrorizmi xhihadist, nxorri në pah urgjencën për të ndërmarë hapa në drejtim të ndërtimit dhe të forcimit të kapaciteteve dhe

²⁵⁸ International Atomic Energy Agency, *IAEA – EU Joint Action: Partnership in Improving Nuclear Security*, <https://www.iaea.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁵⁹ Neni 24.1 i TBE-së.

²⁶⁰ Neni 24.3 i Traktatit të BE-së, Versioni i Konsoliduar.

aftësive të BE-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Madje, edhe në ato raste kur operacionet ushtarake të BE-së kanë rezultuar të sukseshme, merita nuk mund t'i atribuohet drejtëpërdrejtë komandës dhe kapaciteteve të kufizuara të saj, por se Shteteve Anëtare me “xhepa të mëdha”. Për këtë arsye, politika europiane e mbrojtjes do të jetë e sukseshme vetëm nëse disponon aftësitë e duhura ushtarake, në të kundërt ajo do të ishte një guaskë boshe²⁶¹.

Krijimi i një force të qëndrueshme ushtarake jo vetëm që do të ndikonte në rritjen e aftësisë së BE-së për të reaguar menjëherë dhe me efektivitet ndaj emergjencave kudo në botë, por në të njëjtën kohë do të ishte një mjet për diplomacinë e BE-së. Në funksion të pajisjes së BE-së me aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme ushtarake për të vepruar në rajone të largëta konfliktesh, të forcimit të aspektit ushtarak të PESMP-së dhe të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare, u krijuan a.) Trupat Europiane (Eurocorps), b.) Grupet e Betejave (Battlegroups), c.) Forcat e Xhandarmërisë dhe d.) kapacitetet detare dhe ajrore

a. Trupat Europiane

Miratimi i “Detyrave të Petërsbergut”, ndër të cilat parashikohej edhe se BE-ja duhet të krijonte kapacitetet e nevojshme për të përdorur forcën kur kjo do të ishte e domosdoshme²⁶², i hapi rrugë krijimit të Trupat Europiane, ndërsa vendimi për t'i vendosur ato në dispozicion të saj u mor në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në Romë më 1993²⁶³. Trupat Europiane do të ishte një forcë ushtarake e përbërë nga 35 000 – 40 000 trupa, të cilat do të ishin të gatshme për mision dhe do të angazhoheshin në situatat kur NATO nuk do të dëshironte ose nuk do të ishte në gjendje të ndërhynte²⁶⁴. Këto forca mund të vepronin në kuadër të BE-së, OKB-së, NATO-s²⁶⁵ ose të një vendimi të përbashkët të marrë nga shtetet kontribuese të tij.

Si një strukturë ushtarake shumëkombëshe²⁶⁶, Trupat Europiane karakterizohet nga fleksibiliteti në vendimmarrje, një strukturë të plotë funksionale, nga planifikimi deri në zbatimin e operacioneve civile dhe ushtarake, dhe pasja e kapaciteteve të nevojshme për ndërmarrjen e misioneve në mjedise komplekse. Këto karakteristika do t'i mund t'i garantonin BE-së angazhim brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe në misionet të natyrës humanitare, paqeruajtëse, deri në ato me karakter ushtarak për menaxhimin e krizave, përfshirë dhe ato paqebërëse²⁶⁷. Në vitin

²⁶¹ Nga fjalimi i Catherine Ashton në Konferencën Vjetore të Agjensisë Europiane të Mbrojtjes, Mars 2014.

²⁶² Western European Union, *Petersberg Declaration* (19 Qershor 1992), <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁶³ *Komunikatë e Këshillit të Ministrave të BEP-së* (19 Maj 1993), <http://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁶⁴ Deklaratë për Shtyp e Zyrës së Shtypit të Gjermanisë Federale, *Eurocorps Will Strengthen European Pillar of NATO*, (22 Korrik 1992), fq. 1.

²⁶⁵ Agreement between the Supreme Allied Commander, Europe (SACEUR) and the Channel Committee, Concerning responsibility for the North Sea Sub-Area (17 Shkurt 1993).

²⁶⁶ Gjermania dhe Franca ishin shtetet themeluese. Më pas u shtua dhe Belgjika, Spanja (1 Korrik 1994), Luksemburgu (07 Maj 1996), Greqia, Italia, Austria dhe Turqia. Më 01 Janar 2016 Polonia u bë zyrtarisht anëtar i Eurocorps. Ndërsa SHBA-ja pritet të jetë pjesëmarrëse në të dhe pse statusi i saj nuk është akoma i qartë.

²⁶⁷ *Eurocorps: A force of European Union and NATO*, <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

2002 pas një vlerësimi të kapaciteteve të përgjithshme dhe atyre operacionale nga NATO, Trupat Europiane fiton statusin e një Force të Reagimit të Shpejtë²⁶⁸.

Pozicioni i Trupat Europiane, si kontribues i paqes dhe i sigurisë, u forcua më tej me miratimin e të ashtuquajturit Traktati i Strasburgut, i cili hyri në fuqi më 26 Shkurt 2009. Ky Traktat i njohu Trupat Europiane kapacitet ligjor, autonomi të plotë, zgjerim të përgjegjësisë në drejtim të nënshkrimit të kontratave, blerjes (përvetësimit) dhe shitjes (tjetërsimit) të pajisjeve dhe të punësimit të civilëve në rastet kur e çmon të nevojshme²⁶⁹.

Që nga momenti që është deklaruar operacional, Trupat Europiane janë angazhuar në: *i.*) Misionin në Bosnje dhe Hercegovinë në 1998 nën komandën e NATO-s (SFOR), *ii.*) Misioni në Kosovë, në 2002, ku ato përbënin pjesën kryesore të forcave të angazhuara atje (KFOR 3), *iii.*) Misioni në Afganistan, ku për periudhën gusht 2004 deri në shkurt 2005, Trupat Europiane morën komandën e 65 000 trupave të cilat ishin pjesë e Forcave Ndërkombëtare Ndhimëse të Sigurisë, *iv.*) Kabul (Afganistan) për periudhën Janar 2012 deri në Janar 2013, *v.*) operacionin Artemis në Kongo²⁷⁰, dhe *vi.*) Misioni trajnues i BE-së në Mali²⁷¹.

b. Grupet e Betejave

Në mbledhjen e Këshillit European në Këln, përfaqësuesit e Shteteve Anëtare theksuan domosdoshmërinë për të pajisur BE-në me mjetet dhe aftësitë e nevojshme për të marrë përsipër përgjegjësitë që rrjedhin nga një politikë e përbashkët Europiane për paqen dhe sigurinë. Për të luajtur plotësisht rolin e saj në arenën ndërkombëtare, pasjen e aftësive për të marrë vendime dhe për të reaguar në rastet e parandalimit të konflikteve dhe menaxhimit të krizave, BE-ja duhet të kishte në dispozicion të saj instrumenta të përshtatshëm, përfshirë dhe ato ushtarakë²⁷². Ky qëndrim u rikonfirmua dhe u zhvillua edhe më tej në mbledhjen e Këshillit European në Helsinki në 1999, në të cilën u vendosën objektiva konkrete për mobilizimin e trupave nën komandën e BE-së dhe “reagimi i shpejtë” u cilësua si një nga aspektet më të rëndësishme të menaxhimit të krizave. Këto iniciativa shënojnë gjithashtu dhe hapat e parë në drejtim të krijimit të “EU Battlegroup”²⁷³.

²⁶⁸ *History of HQ Eurocorps*, <http://www.eurocorps.org/> (hyrë për herë të fundit më 14 Tetor 2015).

²⁶⁹ <http://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷⁰ Në 2003 BE-ja dërgoi operacionin e saj të parë ushtarak, jashtë Europe, në mënyrë të pavaruar nga NATO, në RDK, i cili konsistonte në një numër forcash prej 1500 ushtarësh. Objektivat e këtij misioni ishin stabilizimi i situatës, rivendosja e sigurisë dhe përmirësimi i situatës humanitare, duke garantuar mbrojtjen e personave të vendosur në kampet e refugjatëve në Bunia. Mandati i tij ishte të shërbente si forcë ndërlidhëse për tre muaj deri me vendosjen e trupave të misionit të OKB-së.

²⁷¹ *Eurocorps: A force of European Union and NATO*, <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷² Cologne European Council, *European Council declaration “On strengthening the common european policy on security and defence”*, Anex III, (3 – 4 Qershor 1999) <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷³ Helsinki European Council, *On strengthening the common european policy on security and defence*, pika II dhe Aneksi I i Aneksit IV (10 – 11 Dhjetor 1999) <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

Në zbatim të SES-së dhe të Planit European për Zhillimin e Aftësive, BE-ja nisi zhvillimin e konceptit të “Forcave Europiane të Reagimit të Shpejtë”²⁷⁴, i cili u finalizua në konferencën e mbajtur më 22 Nëntor 2004 në lidhje me kapacitetet ushtarake të BE-së²⁷⁵ dhe u bë pjesë e dokumentit të quajtur “Objektivat e 2010”. Në këtë dokument, ku përcaktoheshin objektivat e BE-së në drejtim të mbrojtjes dhe të sigurisë, ndër të tjera parashikohej se në funksion të përgjigjes në mënyrë efektive dhe të menjëhershme ndaj krizave, BE-ja duhet të kishte forca të gatshme, Grupet e Betejave²⁷⁶. Këto forca do të vepronin nën mandatin e OKB-së për rivendosjen e paqes dhe të sigurisë, edhe pse jo domosdoshmërisht, dhe do të mund të ishin të gatshme të angazhoheshin brenda pak ditëve.

Grupet e Betejave do të formoheshin nga kontributi i një ose disa Shteteve Anëtare dhe do të konsistonin në batalione prej rreth 1500 ushtarësh të trajnuar, të ndihmuar nga shërbimet mbështetëse dhe të pajisur me logjistikën përkatëse²⁷⁷. Këto forca të reagimit të shpejtë, të cilat duhet të ishin të gatshme për mobilizim nga 5 deri në 10 ditë, do të mund të angazhoheshin: *së pari*, si forcë mbështetëse për forcat që tashmë ishin mobilizuar në një operacion; *së dyti*, si forcë e parë, për krijimin e terrenit për mobilizim të një numri më të madh forcash; dhe *së treti*, si forcë e vetme në operacionet ku vetëm ato do të angazhoheshin, të cilat do të ishin për një periudhë të shkurtër dhe do të konsistonin në një numër të kufizuar veprimesh²⁷⁸. Grupet e Betejave mundën të ishin operacionale vetëm në vitin 2007, ku dy prej tyre çdo vit ishin në gjendje gadishmërie me rotacion çdo gjashtë muaj²⁷⁹.

Këto trupa mund të angazhohen për të gjithë spektrin e misioneve dhe operacioneve të parashikuara në nenet 42.1 dhe 43.1 të TBE-së, të cilat mund t’i klasifikojmë në pesë kategori si: *i.)* misionet paqebërëse, të cilat përfshijnë dhe përdorimin e forcës, *ii.)* misione që kanë për qëllim stabilizimin e situatës, rindërtimin e vendit dhe asistencën ushtarake për vendet e treta, *iii.)* misionet për parandalimin e konflikteve, *iv.)* operacionet për evakuimin e popullsisë, dhe *v.)*

²⁷⁴ Në mbledhjen e Këshillit European në Helsinki, më 1999, u miratuan “Objektivat e së Ardhmes” (Headline Goal), ku ndër të tjera Shtetet Anëtare ranë dakort për krijimin e një Force të Reagimit të Shpejtë, e natyrës ushtarake, e përbërë nga 50 000 deri më 60 000 trupa, e cila do të ndërmerrete operacione në lidhje me të gjitha “Detyrat e Petërsbergut”.

²⁷⁵ Military Capability Commitment Conference, *Declaration on European Military Capabilities* (22 Nëntor 2004), <https://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷⁶ Në dokumentin “Objektivat e 2010” ulja e numrit të forcave të gatshme justifikohet se Shtetet Anëtare vendosën të përcaktonin objektiva të reja duke pasur parasysh SES-në, evolucionin në teknologji dhe ndryshimet në përpilimin e strategjive. Për këtë arsye parashikimi në Objektivat e Helsinkit të një force më të madhe justifikohet nga “Detyrat e Petërsbergut” të përfshira në Titullin V të Traktatit të Amsterdimit. Ndërsa parashikimi i krijimit të grupeve më të vogla, në “Objektivat e 2010”, justifikohet nga zgjerimi i natyrës së “Detyrave të Petërsbergut”.

²⁷⁷ European Parliament, *EU Battlegroups* (12 Shtator 2006), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷⁸ “Headline Goal 2010” të miratuara nga Këshilli i Punëve të Përgjithshme dhe i Marrëdhënieve me Jashtë më 17 Maj 2004 në mbledhjen e Këshillit European më 17 – 18 Qershor 2004, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁷⁹ EU Council Secretariat, “EU Battlegroups”, *Factsheet*, Shkurt 2007, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

operacionet e natyrës humanitare. Përveç këtyre të parashikuara nga Traktati, misione të tjera janë dhe ato të përfshira në “Detyrat e Petërsbergut” dhe ato të parashikuara në SES-në²⁸⁰.

Megjithë suksesin e arritur në disa operacione ku BE-ja ka marrë pjesë, si misioni Artemis në RDK, misioni EUFOR RD në RDK në 2008, misioni EUFOR TCHAD/RCA dhe ndërhyrja në Republikën e Afrikës Qëndrore, gjatë funksionimit të Grupeve të Betejave janë evidentuar disa mangësi si²⁸¹:

- *Natyra e kufizuar e operacioneve.* Për shkak të numrit të vogël të forcave nga 1500 deri 20 000 mijë, Grupet e Betejave nuk janë në gjendje të mbulojnë të gjithë spektrin e “Detyrave të Petërsbergut” dhe nuk janë të përshtatshme për angazhim në operacione të një intensiteti të lartë²⁸².
- *Ndryshimi i vendodhjes dhe i drejtimit.* Për shkak se vetëm dy grupe janë në gadishmëri përgjatë një viti, duke shërbyer me rotacion, përveç kostos së madhe të shpenzimeve dhe kohës së harxhuar për qënien gati të tyre, kjo ka ndikuar edhe në krijimin e pakënaqësive brenda njësive të krijuara.
- *Mosfunksionimi i Grupet e Betejave si “forcë ushtarake”.* Për shkak se PESMP-ja i njeh të drejtën Shteteve Anëtare të krijojnë Grupet e tyre, duke i karakterizuar ato “si lehtësues”, të cilët funksionojnë mbi baza *ad hoc*, ato karakterizohen nga mungesa e qëndrueshmërisë dhe nuk përbëjnë një strukturë permanente²⁸³.
- *Statusi i paqartë i këtyre forcave.* Mospërpilimi që në fazën planifikuese të operacionit të marrëveshjeve që rregullojnë statusin e forcave në të, krijon vështirësi në veprimin e tyre në terren dhe në përcaktimin e privilegjeve që ato posedojnë në vendin pritës.
- *Mangësi në kapacitete.* Për shkak se vetëm disa nga Battlegrops kanë të gjithë njësitë e nevojshme për të vepruar në mënyrë “të pavarur”, ndërsa të tjerët ose nuk i posedojnë ato ose i krijojnë në moment të fundit, kjo ndikon në efektivitetin e angazhimit të tyre brenda një kohe sa më të shkurtër.
- *Mangësitë në logjistikë dhe mungesa e pajisjeve mbështetëse* si aeroplanmbajtëset dhe transportieret, të cilat vihen në dispozicion të Grupet e Betejave vetëm për operacionet ku ato janë të domosdoshme, ndikon në zgjatjen e kohës së përgatitjes dhe të mobilizimit²⁸⁴. Psh. për mobilizimin e një Battlegroup janë të domosdoshme 200 fluturime të C-130 aeroplanmbajtëseve ose 30 fluturime të C-17 Globemaster Transporter, të cilat i disponon

²⁸⁰ EU Council Secretariat, “EU Battlegroups”, fq. 2.

²⁸¹ Matthew McCay, “Rapid Reaction Capability of the European Union: Taking the Last Big Step”, *Occasional Paper Series*, Nr. 27, 2014.

²⁸² Claudia Major dhe Christian Molling, “EU Battlegroups: What Contribution to the European Defence?”, Research Paper, *Stiftung Wissenschaft und Politik*, Berlin (Qershor 2011), fq. 19, <http://www.swp-berlin.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸³ Ana Isabel Xavier, “The EU’s Battlegroups in perspective: addressing present challenges for future deployments”, *Austria Institut für Europa und Sicherheitspolitik*, (Korrik 2013), <http://www.aies.at/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸⁴ The Swedish National Audit Office, *The Nordic Battlegroup 2008 – a part of the EU’s rapid reaction capability*, 2010 <http://www.riksrevisionen.se/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

vetëm Mbretëria e Bashkuar. Po në këtë drejtim, rëndësi ka dhe mungesa e eksperiencës në mobilizimin e pajisjeve ushtarake në distanca të largëta²⁸⁵.

- *Mungesa e një politike të përbashkët në fushën e armatimeve dhe të një tregu të përbashkët për pajisjet ushtarake dhe ato të mbrojtjes.* Bashkëpunimi në fushën e armatimeve ka ruajtur natyrën e tij ndërqeveritare, pasi procesi i prodhimit, tregtimit dhe procedurat e prokurimit për pajisjet ushtarake nuk janë pjesë e shtyllës komunitare. Çështjet që kanë të bëjnë me PJSP-në, veçanërisht mbrojtjen, udhëhiqen nga interesat kombëtare të Shteteve Anëtare²⁸⁶.
- *Papajtueshmëritë në teknologji dhe në pajisjet që përdoren gjatë operacioneve ushtarake.* Duke qenë se Grupet e Betejave krijohen nga kontributi vullnetar i Shteteve Anëtare dhe mbi baza *ad hoc*, ato jo të gjitha disponojnë aftësi dhe kapacitete të njëjta, duke krijuar në këtë mënyrë papajtueshmëri në teknologjinë e përdorur dhe në pajisjet e vëna në dispozicion të misionit²⁸⁷. Rëndësi në këtë drejtim ka dhe shumëllojshmëria e kulturave dhe prejardhjeve etnike, programet e ndryshme të trajnimit të trupave ushtarake dhe institucionet *ad hoc*.
- *Mungesa e një ndarje të qartë të funksioneve drejtuese të operacionit krijon probleme edhe në koordinimin e veprimeve në terren.* Psh. në rastin e misionit EUFOR/CHAD hartimi i strategjisë realizohej nga Sekretariati dhe Shtabi Ushtarak i BE-së, ndërsa planifikimi i operacionit në terren realizohej nga Shtabi Francez i Mbrojtjes, si shteti me kontributin më të madh në forca. Gjithashtu, krijimi i njësisive të reagimit të shpejtë me baza kombëtare dhe jo shumëkombëshe dhe mbikombëtare, krijon terren për përfshirjen në vendimmarrje të interesave politike të Shteteve Anëtare (si psh. rasti i përfshirjes së Francës, ish vend kolonialist, në misionin EUFOR Tchad/RCA)²⁸⁸.
- *Koha e gjatë e mobilizimit dhe periudha e shkurtër e angazhimit.* Periudha e gjatë e kohës që kalon nga momenti i marrjes së vendimit për mobilizim të Battlegroup deri në mobilizimin efektiv të tyre në terren, e zbeh natyrën e saj si forcë e reagimit të shpejtë në situatat e krizave. Referuar dokumentave të BE-së periudha që i duhet një Battlegrop për të qenë “gati për mobilizim” në zonat e konfliktit është gati dhjetë ditë. Kjo periudhë mund të jetë e mjaftueshme në rastin e krizave të cilat nuk kanë një “bum” shpërthimi (psh. ish Jugosllavi, Mali), por jo në rastet kur situata ka tendencë të degradojë shpejt (psh. Bosnje dhe Hercegovinë (Srebrenica), Ruanda)²⁸⁹.

²⁸⁵ Karl Heinz Kamp, “European “Battlegroups”: A New Stimulus for the European Security and Defense Policy”, Paper Nr. 15 (2004), fq. 4 <http://www.kas.de/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸⁶ Burkard Sghmitt, “Armaments cooperation in Europe”, Institute for Security Studies, <https://peacepalacelibrary.nl/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸⁷ Alexander Mattelaer, “The strategic planning of EU military operations – The case of EUFOR TCHAD/RCA”, *Institution for European Studies Working Paper*, Nr. 5 (2008), <http://www.ies.be/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸⁸ Bjoern Siebert, “EUFOR Tchad/RCA – A Cautionary Note”, *European Security Review*, Nr. 37 (2008), <http://www.tamlyn-serpa.com/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁸⁹ Office of UN Secretary General, Report of the Secretary General pursuant to General Assembly Resolution 53/35, 1999, fq. 57 – 63.

- “*E para forcë ushtarake që hyn në një operacion dhe e para që del nga ai*”. Ato veprojnë si “forcë ndërlidhëse” dhe janë pararendëse të një force me mandat më të gjerë dhe kohëzgjatje më të madhe. Duke qenë se, koha që i duhet për mobilizim një force më të madhe si psh. ato të OKB-së është gati gjashtë muaj dhe periudha gjatë së cilës Grupet e Betejave janë të angazhuara është nga 30 – 120 ditë, kjo mospërputhje krijon boshllëk²⁹⁰. Ndërsa, hapësira përgjatë së cilës këto forca do të angazhoheshin mendohet të ishte rreth 6000 km nga Brukseli ose sipas parashikimeve në dokumentat që rregullojnë funksionimin e Grupet e Betejave²⁹¹.
- *Mangësitë në financimin e operacioneve dhe mosmbulimi plotësisht i kostove nga buxheti i BE-së*. Vetëm një përqindje shumë e vogël e kostove të operacioneve ushtarake të ndërmarra nga Grupet e Betejave financohen nga instrumentat e Bashkimit, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga kontributet e Shteteve Anëtare në proporcion me GNI e tyre sipas mekanizmit Athena²⁹². Pra, kostot mbulohen nga ai shtet të cilit i bie “barra”.
- *Mungesa e vullnetit politik dhe vështirësitë në vendimmarrje*. Procedura e marrjes së vendimit për nisjen e një misioni kalon nëpër tre faza: *e para*, votimi në Këshill, i cili ka natyrë ndërqeveritare dhe secili Shtetet Anëtar gëzon të drejtën e vetos, duke e bërë të vështirë arritjen e unanimitetit; *e dyta*, përcaktimi i bazës ligjore për planifikimin e misionit i quajtur Koncepti për Menaxhimin e Krizave, për të cilën nuk ka një kufizim në kohë dhe i nënshtrohet miratimit nga Shtetet Anëtare, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionet e tyre të brendshme; dhe *e treta*, marrja e vendimit për nisjen e misionit²⁹³.
- *Pritshmëritë e ndryshme të Shteteve Anëtare*. Këto jo vetëm që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes, por edhe shkaktojnë papajtueshmëri në lidhje me qëllimin për të cilin duhet të mobilizohen Grupet e Betejave. Shtete si Gjermania dhe Holanda janë të mendimit se Grupet e Betejave duhet të mobilizohen vetëm në situatat më kritike, për të cilat ndërhyrja ushtarake është e pashmangshme²⁹⁴. Ndërsa të tjera si Irlanda mendojnë se mandati i OKB-së është kusht i domosdoshëm për të ndërhyrë²⁹⁵.

²⁹⁰European Parliament: Directorate General for External Policies of the Union, *The European Security and Defence Policy: from the Helsinki Headline Goal to the EU Battlegroups*, (12 Shtator 2006), fq. 22, <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹¹Laura Chappell, “Differing Member State Approaches to the Development of the EU Battlegroups Concept: Implication for CSDP”, *European Security*, Volume 18, Issue 4 (2009), <http://epubs.surrey.ac.uk/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹²Anna Barcikowska, “EU Battlegroups – ready to go?”, European Union Institute for Security Studies Brief Issue, Nr. 40 (2013), fq. 4 <http://www.iss.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹³Magnus Lorenz, *Enhancing the Common Security and Defense Policy through concrete changes in the decision – making infrastructure in regard to EU Battle groups* (2012), <http://www.academia.edu/> (hyrë për herë të fundit më 03.11.2015).

²⁹⁴Marin Terlikowski, “Polish – led EU Battle Group”, *The Polish Institute of International Affairs*, Buletini Nr. 3 (79) (2010).

²⁹⁵Statement by the Minister for Justice, Equality and Defense – on the motion before Dail Eireann seeking approval of the Memorandum of Understanding regarding Ireland Participation in the Austro/German Battlegroup (2010), <http://www.defence.ie/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

Nga sa më lart, mund të themi se, nga njëra anë krijimi i Grupet e Betejave i garanton BE-së kapacitetet e nevojshme për të reaguar në mënyrë të menjëhershme në rastet e krizave, duke e bërë në këtë mënyrë më koherente, më aktive dhe më të aftë. Por, nga ana tjetër mangësitë në pajisjet mbështetëse, mungesa e eksperiencës, veshtirësitë në procesin vendimmarrës dhe mjetet e pamjaftueshme financiare minojnë suksesin e këtyre trupave ushtarake.

A janë Battlegroup-s të BE-së dhe Forcat e Reagimit të NATO-s rivale apo plotësuese të njëra tjetrës?

Në Samitin e NATO-s të mbajtur më 21 Nëntor 2002 u hodh ideja e krijimit të një force të reagimit të shpejtë, e cila do të ishte e pajisur me të gjitha asetet e nevojshme tokësore, detare dhe ajrore me qëllim garantimin e fleksibilitetit dhe mobilizim të shpejtë kudo që do të ishte e nevojshme²⁹⁶. Në Samitin e Stambollit, më 2004, liderat e Shteteve Anëtare ranë dakort që Forcat e Reagimit të NATO-s (në vijim Forcat e Reagimit) të përbëheshin prej rreth 25 000 trupa, të cilët do të mobilizoheshin brenda pesë ditësh dhe do të ishin operacionale për 30 ditë²⁹⁷. Në 2006, në Samitin e Rigës, kjo forcë deklarohet operacionale²⁹⁸.

Përsa i përket natyrës së operacioneve ku mund të angazhohen këto forca ato janë të ngjashme me ato të Grupeve të Betejave, dhe konkretisht janë: *i.)* si forcë e vetme në zbatim të nenit V të Traktatit (mbrojtja e përbashkët) ose në rastet e krizave (operacione për evakuimin e popullsisë, mbështetje për menaxhimin e pasojave të fatkeqësive, në misione humanitare dhe në operacionet kundër terrorizmit); *ii.)* si forcë e parë në një situatë konflikti, e cila do të përgatisë terrenin për ardhjen e një force më të madhe; dhe *iii.)* si forcë demonstrative e vendosshmërisë dhe e solidaritetit të NATO-s për parandalimin e krizave, duke përdorur diplomacinë²⁹⁹.

Ndonëse si Grupet e Betejave ashtu edhe Forcat e Reagimit janë ideuar si forca të reagimit të shpejtë, të cilat janë të gatshme për të ndërhyrë në çdo kohë gjatë fazave fillestare të konflikteve, midis tyre ka dhe dallime.

- **Së pari**, Grupet e Betejave konsistojnë në një numër prej 1500 trupash, ndërkohë që një batalion i Forcave të Reagimit numëron rreth 9 500 trupa.
- **Së dyti**, teorikisht forcat e këmbësorisë së Grupeve të Betejave asistohen edhe nga ato detare dhe ajrore, por mënyra e realizimit të këtij bashkëpunim nuk gjen një pasqyrim të qartë në idenë e krijimit të Grupet e Betejave. Në këtë mënyrë, megjithë përpjekjet e Bashkimit për të zhvilluar kapacitetet e reagimit në rrugë detare dhe ajrore, Grupet e

²⁹⁶ NATO, “Prague Summit Declaration”, NATO Press Release (21 Nëntor 2002), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹⁷ NATO, “Instambul Summit Communique”, NATO Press Release (28 Qershor 2004), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹⁸ NATO, “Riga Summit Declaration” (29 Nëntor 2006), pika 23, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

²⁹⁹ Juha Kaitera dhe Guy Ben – Ari, “EU Battlegroups and the NATO Response Force: A marriage of Convenience”, *Center for Strategic and International Studies* (Prill 2008), fq. 3, <http://csis.org/> (hyrë për herë të fundit më 04.11.2015).

Betejave janë larg së qënurit një force gjithëpërfshirëse, duke qenë e përqëndruar kryesisht në misionet e zhvilluara në tokë.

- **Së treti**, natyra e operacioneve që këto forca ndërmarrin është e ndryshme. Forcat e Reagimit mund të mobilizohen që nga operacionet për menaxhimin e krizave deri tek ato në kuadër të mbrojtjes së përbashkët, ku këto të fundit nuk janë në natyrën e operacioneve të tyre. Pra, Forcat e Reagimit angazhohen në misione të një shkalle intensiteti më të lartë³⁰⁰.
- **Së katërti**, Grupet e Betejave nuk përbëjnë një forcë permanente të drejtuar nga një komandë permanente, ndërsa Forcat e Reagimit kanë komandën dhe selinë e tyre të përhershme³⁰¹.

Në përfundim mund të themi se, me gjithë ndryshimet dhe ngjashmëritë që ato kanë, sfidat që këto forca përballen janë të njëjta, që nga forcimi i bashkëpunimit, si në fazën përgatitore të operacioneve dhe në atë operacionale në terren, deri në shmangien e mbivendosjeve, për shkak se shumë Shtete Anëtare të BE-së janë dhe anëtare të NATO-s. Përbushja e angazhimeve e Shteteve Anëtare në të dy këto struktura nuk ka të bëjë vetëm me plotësimin e numrit të trupave në dispozicion të tyre, pasi Sekretariati i NATO-s ka llogaritur se Shtetet Anëtare kanë potencial të mjaftueshëm rreth 2,4 milion trupa, por me faktin që këto trupa duhet të kenë përgatitjen e duhur ushtarake dhe të jenë të pajisura me logjistikën e nevojshme³⁰².

Me qëllim shmangien e mbivendosjes, mendoj se BE-ja duhet të synojë zbatimin e Marrëveshjeve të “Berlin Plus”, duke përdoruar asetet dhe kapacitetet e NATO-s në ato operacione kur kjo e fundit nuk dëshiron të angazhohet. Gjithashtu, BE-ja duhet të nxisë forcimin e bashkëpunimit me NATO-n, si përsa i përket planifikimit të operacioneve ashtu edhe trajnimit të përbashkët të trupave ushtarake, duke shmangur në këtë mënyrë dhe shpenzimet e dyfishta.

c. Forca Europiane e Xhandarmërisë

Idea për krijimin e një Force Europiane të Xhandarmërisë (në vijim Forcat e Xhandarmërisë) u hodh në mbledhjen e Ministrave të Mbrojtjes së BE-së, në Shtator të 2003, dhe ishte iniciativë e gjashtë Shteteve Anëtare të BE-së: Francës, Italisë, Hollandës, Portugalisë, Rumanisë dhe Spanjës. Kjo ide, e cila u finalizua më 20 Korrik 2006, kishte si qëllim të forconte aftësitë e reagimit të BE-së në rastet e situatave për menaxhimin e krizave dhe të kontribuonte në zhvillimin e PJSP-së. Ndonëse në Traktatin Themelues, Forcat e Xhandarmërisë janë përcaktuar si forcë policore dhe ushtarake, në funksionet e tyre nuk përfshihet ndërhyrja në rastet e krizave ndërkombëtare³⁰³.

³⁰⁰ Gustav Lindstrom, “Enter the EU Battlegroups”, *Challiot Paper*, Nr. 97 (Shkurt 2007), fq. 47 – 52, <http://www.iss.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰¹ Christian Molling, “NATO and EU Rapid Response: Contradictory or Complementary?”, *CSS Analyses in Security Policy*, Vol. 2, Nr. 22 (2007), <http://www.css.ethz.ch/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰² Juha Kaïtera dhe Guy Ben – Ari, fq. 7 <http://csis.org/> (hyrë më 04.11.2015).

³⁰³ *Treaty Establishing the European Gendarmerie Force (EUROGENDFOR)*, <http://www.statewatch.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

Kjo forcë e cila mund të veprojë në të gjitha fazat e një operacioni, e vetme ose në bashkëpunim me forca të tjera, në kuadër të BE-së, OKB-së, OSBE-së, NATO-s apo organizatave të tjera ndërkombëtare ose koalicionëve *ad hoc*, do të mund të ushtrojë të gjithë spektrin e misionëve policore, duke zëvendësuar policinë lokale ose t'a mbështesë atë³⁰⁴. Ajo mund të ndërhyjë si në fazën fillestare të një konflikti, me qëllim stabilizimin ose rivendosjen e rregullit, gjatë konfliktit duke vepruar si një forcë ushtarake dhe në fazën përfundimtare të konfliktit duke ndihmuar kalimin e përgjegjësive nga komanda ushtarake tek ajo civile.

Forcat e Xhandarmërisë karakterizohen nga fleksibiliteti, pasi numri i forcave të saj mund të arrijë deri në 2500 dhe mund të mobilizohen brenda një periudhe të shkurtër kohe, brenda 30 ditëve. Vlera e kësaj force qëndron në këto drejtime:

- *Eksperienca në operacionet paqeruajtëse*: Që nga viti 1990, edhe pse jo të gjitha në të njëjtën kohë dhe me disa ndryshime të vogla në natyrën e detyrave, statusin dhe kohëzgjatjen e misionit, Forcat e Xhandarmërisë janë përfshirë në disa operacione si në Kongo, Kosovë, Shqipëri, Afganistan, Bosnje dhe Hercegovinë, Irak, Maqedoni, Palestinë, Timorin Lindor, Haiti etj.
- *Përshtatshmëria e këtyre forcave*: Në mungesë të një studimi të detajuar në lidhje me performacën e Forcave të Xhandarmërisë, autorë të ndryshëm kanë dhënë mendimin e tyre në lidhje me arsyet se pse këto forca mund të garantojnë rezultate më të kënaqshme. Amitage dhe Moisan (2005) shpjegojnë se për shkak të numrit të madh të misionëve në të cilat këto forca kanë marrë pjesë, ato paraqesin aftësi të larta në luftime, në mobilizim dhe janë të pajisura me të gjitha mjetet logjistike të nevojshme³⁰⁵. Bigo (2000) shprehet se shumëllojshmëria e misionëve i mundëson këtyre forca të jenë prezente aty ku policia vendase nuk ka guxim të shkojë, si në rivendosjen e rendit në një situatë konflikti, dhe aty ku ushtria nuk dëshiron të veprojë ose nuk di si të ndërhyjë, si në mbajtjen nën kontroll të armikut³⁰⁶. Për shkak të ndërthurjes së karakteristikave të një force policore dhe ushtarake, këto forca kanë njohuritë e nevojshme për të reaguar në operacionet për menaxhimin e krizave.
- *Struktura e qartë e organizimit dhe ngjashmëritë midis forcave të Shteteve Anëtare*: Operacionet e së kaluarës kanë treguar se këto forca kanë një strukturë të qartë drejtimi dhe një status të mirëpërcaktuar. Megjithë dallimet e pakta në ideologjinë e funksionimit të tyre, të cilat krijohen nga kontributi i shteteve themeluese, Forcat e Xhandarmërisë kanë zhvilluar standarte, doktrinë dhe procedura të përbashkëta. Ndërsa në lidhje me statusin e këtyre forcave mund të themi se në nenin 29 të Traktatit Themelues të Forcave të Xhandarmërisë parashikohet se, këto forca dhe stafi mbështetës i tyre gjatë ushtrimit të

³⁰⁴ Neni 4 dhe 5 i Traktatit mbi Themelimin e FEXH-së, <http://www.statewatch.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰⁵ David Armitage dhe Anne Moisan, "Constabulary forces and postconflict transition: the Euro-Atlantic dimension", *Strategic Forum*, No. 218, (2005), <https://www.files.ethz.ch/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰⁶ Didier Bigo, "When two become one, internal and external securitisations in Europe", <http://citeseerx.ist.psu.edu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

mandatit nuk do të jenë subjekt i ligjeve të shtetit pritës dhe nuk do t'i nënshtrohen asnjë lloj procedimi³⁰⁷.

d. Kapacitetet detare dhe ajrore

Tregëtia dhe aktivitetet të tjera që mund të zhvillohen në det (peshkimi dhe shfrytëzimi i burimeve të energjisë) kanë rëndësi të madhe për ekonominë e BE-së dhe me qëllim shmangien e rreziqeve që mund të dëmtojnë këto interesa, ajo në kuadër të krijimit të kapaciteteve për “reagim të shpejtë” zhvilloi dhe konceptin e reagimit të shpejtë në rrugë detare. Hapi i parë në këtë drejtim ishte listimi në raportin për zbatimin e SES-së, të 2008, si rreziqe dhe sfida që mund të kërcënonin sigurinë dhe interesat e BE-së edhe ato që lidheshin me fushën detare, si ndryshimet klimaterike, pirateria dhe siguria energjitike.

Më konkretisht, roli dhe rëndësia që kanë forcat detare për operacionet e drejtuara nga BE-ja në kuadër të PJSP-së u identifikuan dhe në 2012 në Konceptin e BE-së për Sigurinë në Operacionet Detare (EU Maritime Security Operation Concept), i cili u pasua nga miratimi i Strategjisë Europiane për Sigurinë Detare (EU Maritime Security Strategy), në Mbledhjen e Këshillit të Punëve të Përgjithshme më 24 Korrik 2014.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve ajrore, më 2011 Komiteti Ushtarak i BE-së ra dakort për t'i shtuar misionet të BE-së në kuadër të PJSP edhe përkrahjen e forcave ajrore. Këto forca, ashtu si Battlegropus, mund të marrin pjesë në operacione të mevetësishme ose si komponent përbërës i operacioneve të cilat kanë një ndërthurje të forcave tokësore, ajrore dhe ato detare³⁰⁸.

4.3 Drejt krijimit të një ushtrie Europiane

Deklarata e Presidentit të Komisionit Europian Jean Claude Juncker, i cili mirëpriti idenë e krijimit të një ushtrie Europiane, ngjalli reagim midis Shteteve Anëtare dhe ekspertëve të fushës³⁰⁹. Për disa nga këto ideja e krijimit të një ushtrie Europiane nuk është asgjë më tepër se një iluzion, ndërsa për të tjerët shërben si stimul për t'i kushtuar më tepër rëndësi forcimit të kapaciteteve ushtarake të BE-së, në kushtet kur çështjet e sigurisë në Europë dhe në zonat fqinje me të po bëheshin gjithnjë e më shqetësuese.

Ideja për krijimin e një ushtrie Europiane daton që me projektin për krijimin e Komunitetit Europian të Mbrojtjes, i cili kishte si qëllim përfshirjen e mbrojtjes së Shteteve Anëtare nën një strukturë të përbashkët mbikombëtare (institucione të përbashkëta, forca të përbashkëta ushtarake, buxhet të përbashkët dhe programe të përbashkëta). Që nga mbledhja e Këshillit Europian në Helsinki kryetarët e shteteve dhe të qeverive europiane kanë theksuar në vazhdimësi rëndësinë që ka për pozitën e BE-së zhvillimi në mënyrë të pavarur të kapaciteteve të saj vendimarrëse për të ndërhyjë ushtarakisht në rastet e konflikteve ndërkombëtare, pavarësisht

³⁰⁷ <http://www.statewatch.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰⁸ European External Action Service, *EU Military Rapid Response Concept* (Bruksel, 17 Dhjetor 2014), fq. 65,

<http://www.statewatch.org/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³⁰⁹ <http://www.bbc.com/> (hyrë për herë të fundit më 03 Tetor 2015).

nga qëndrimi i NATO-s për t'u angazhuar ose jo. Megjithatë, me këtë nuk duhet të kuptojmë që shtetet Europiane janë në rrugën e krijimit të një ushtrie Europiane, porse kjo i shërben shmangjes së mbivendosjeve të angazhimit të forcave ushtarake, si në kuadër të NATO-s edhe në kuadër të BE-së.

Hapa konkretë në këtë drejtim u bënë me ndryshimet e prezantuara nga Traktati i Lisbonës si parashikimi i klauzolës së bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar (neni 44 i TBE-së) dhe i klauzolës për ndihmë të ndërsjelltë, të cilat i hapën rrugë zhvillimit të kapaciteteve të Bashkimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, në kuadër të PJSP-së. Por realizimi në praktikë i objektivave të parashikuara në këtë Traktat kufizohej në miratimin e planeve të veprimit, strategjive apo politikave të përbashkëta.

Në vijim të përpjekjeve në mbledhjen e Këshillit Europian në Bruksel, më 20 Dhjetor 2013, u prezantuan një sërë veprimesh, të cilat do të kishin si qëllim rritjen e efektivitetit dhe të impaktit të PJSP-së, zhvillimin e aftësive të BE-së dhe forcimin e industrisë Europiane të mbrojtjes. Ndërsa në mbledhjen e Këshillit më 18 Nëntor 2014, përveçse u përcaktuan objektivat për të ardhmen, u ra dakort dhe për miratimin e Strategjisë Europiane për Sigurinë Detare dhe Planin e Veprimit dhe të Kornizës për Politikën e BE-së në fushën e sigurisë informatike, për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe afatgjatë.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve BE-ja është larg krijimit të një ushtrie të përbashkët dhe kjo për disa arsye të cilat janë:

- *Mbrojtja një çështje kombëtare*: Shtimi i detyrave të Petersbergut synonte t'i garantonte BE-së ndërmarrjen e operacioneve të natyrës humanitare, të shpëtimit, të menaxhimit të krizave dhe ato paqebërëse, duke e angazhuar atë përtej kufinjve të saj territoriale. Ndërkohë nga ana tjetër Shtetet Anëtare vazhdonin t'a konsideronin mbrojtjen një çështje kombëtare. Duke deklaruar se çdo ide për krijimin e një ushtrie europiane do të haste me veto-n e tyre³¹⁰.

Mungesa e dëshirës së Shteteve Anëtare për t'u angazhuar ushtarakisht në një situatë konflikti, u bë e qartë në rastin e Grupeve të Betejave. Sipas aktit për krijimin e Grupeve të Betejave ato duhet të angazhohen brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, por që në të vërtetë nuk u përdorën asnjëherë. Shkak për këtë ishte dallimi ndërmjet strategjive ushtarake kombëtare dhe mungesa e një mekanizmi financimi, pasi kostoja mbulohej nga Shteti Anëtar i cili kishte rradhën për t'u angazhuar.

- *Natyra ndërqeveritare e PJSP-së*: Ekzistenca e një ushtrie është karakteristikë e shteteve dhe për të pasur një ushtri europiane fillimisht duhet të ekzistojë një BE e cila të qëndrojë mbi Shtetet Anëtare të saj. Në kushtet kur vendimet më të rëndësishme, sidomos ato që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës, merren nga Shtetet Anëtare jemi larg një force ushtarake e cila të jetë nën komandën e BE-së.

BE-ja që në fillimet e saj është projektuar për të qenë më tepër një bashkim ekonomik dhe politik, sesa një bashkim në fushën sigurisë dhe të mbrojtjes. Gjithashtu, institucionet e BE-së nuk janë projektuar për të lehtësuar vendimmarrjen në fushën e

³¹⁰ <https://www.gov.uk/> (hyrë për herë të fundit më 18 Prill 2018).

politikës së jashtme apo në çështjet ushtarake, e cila duhet të karakterizohet nga një vendimmarrje e shpejtë, ndonjëherë dhe e fshehtë, dhe një reagim po i tillë. Kultura politike Europiane karakterizohet nga një vendimmarrje në themel të së cilës qëndron kompromisi.

- *Reduktimi i buxheteve të Shteteve Anëtare në drejtim të mbrojtjes apo mosinvestimi në drejtimin e duhur.* Sipas AEM-së shpenzimet e Shteteve Anëtare kanë rënë rreth 40% në periudhën 2006-2015 dhe më shumë se gjysma e tyre shkon në drejtim të trajnimit të personelit. Gjithashtu, një rënie të ndjeshme kanë pësuar dhe investimet në kërkim dhe zhvillim (me 14% për periudhën 2005-2010), ndërkohë që SHBA-ja shpenzon pothuajse shtatë herë më shumë. Mungesa e fondeve dhe moskrijimi i fondit të fillimit (start up fund), i cili synon të rrisë investimet e Shteteve Anëtare, ka krijuar vështirësi që AEM-ja të mund të ushtrojë të gjitha funksionet e saj³¹¹. Por, problemi në këtë drejtim nuk qëndron vetëm tek ulja e investimeve e Shteteve Anëtare, por në faktin që këto janë kryer pa një marrëveshje paraprake midis tyre, duke rritur pabarazitë (shiko Tabelat 2 dhe 3).
- *Mungesa e një tregu të përbashkët për pajisjet në fushën e mbrojtjes dhe të një sistemi të unifikuar rregullash për prokurimin e pajisjeve ushtarake.* Prodhimi i pajisjeve në fushën e mbrojtjes është përqëndruar kryesisht në gjashtë shtete të BE-së duke shkaktuar në këtë mënyrë copëzim të tregut europian për pajisjet mbrojtëse. Ky copëzim ka sjellë kufizimin e konkurrencës dhe të mundësisë për të hyrë në treg të subjekteve të reja dhe inovative. Në këto kushte, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare, në vitin 2009 hyri në fuqi Direktiva për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes (2009/81/EC) dhe Direktiva për Transferimin e Produktëve të Lidhura me Mbrojtjen (2009/43/EC).

Direktiva 2009/81/EC, e cila gjen zbatim për kontrata specifike në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, për blejren e armëve, municioneve dhe materialeve të tjera ushtarake, ka si qëllim vendosjen e rregullave të njëjta në fushën e prokurimit të pajisjeve ushtarake dhe rritjen e transparencës së procedurave në këtë drejtim³¹². Ndërsa Direktiva 2009/43/EC ka si qëllim lehtësimin e termave dhe kushteve për transferimin brenda Komunitetit të produkteve që lidhen me mbrojtjen³¹³. Por, për shkak të rëndësisë strategjike që ka për ekonominë e Shteteve Anëtare sektori i mbrojtjes, të cilin ato e shohin si një çështje që ka të bëjë me sovranitetin e tyre, masat e marra nga Bashkimi nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një treg të vetëm Europian për pajisjet në fushën e mbrojtjes. Shtetet Anëtare i janë shmangur prokurimit publik për pajisjet në fushën e

³¹¹ Carmen Christina Cirling, "European Defence Cooperation: State of Play and Thoughts on EU Army", Briefing (Mars 2015), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³¹² Directive 2009/81/EC of the European Parliament and of the Council, *On the coordination of procedures for the award of certain works contracts, supply contracts and service by contracting authorities or entities in the field of defence and security, and amending Directive 2004/18/EC and 2004/17/EC* (13 Korrik 2009), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

³¹³ Directive 2009/43/EC of the European Parliament and of the Council, *Simplifying terms and conditions of transfers of defence-related products within the Community* (06 Maj 2009), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

mbrojtjes, duke e cilësuar atë si çështje që lidhet me interesat thelbësore të sigurisë së tyre (neni 346 i TFBE-së).

- *Mangësitë në kapacitete dhe aftësi.* Misioni në Libi dhe në Mali edhe një herë nxorri në pah pamjaftueshmërinë e kapaciteteve dhe mangësitë në aftësitë e BE-së për të vepruar në situatat e konfliktit. Mangësitë më të mëdha u vunë re në shërbimet e inteligjencës, mbikqyrjes, zbulimit dhe goditjes së objektivave, në pajisjet mbështetëse si aeroplanmbjatese dhe transportiere, në mungesën e armëve të precisionit të lartë etj³¹⁴.
- *NATO si forcë kryesore ndërhyrëse.* Disa Shtetet Anëtare i frikësoheshin idesë se krijimi i një ushtrie europiane do të ishte në konkurrencë të vazhdueshme me strukturat e NATO-s, duke krijuar mbivendosje. Gjithashtu këto shtete i frikësoheshin idesë se me krijimin e një ushtrie SHBA-ja nuk do të kishte më arsye për të qenë e angazhuar në Europë.

Situata faktike tregon që forca kryesore ndërhyrëse në situatat e konfliktit është NATO, e cila gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen Europiane, pasi pjesa më e madhe e Shteteve Anëtare të BE-së janë njëkohësisht dhe anëtare të NATO-s. Një problem tjetër i rëndësishëm për ushtrinë Europiane është edhe marrëdhënia e bashkëpunimit me NATO-n, ku kjo e fundit njihet si forcë e parë ndërhyrëse. Funkzionimi i ushtrisë Europiane do të krijonte mbivendosje me objektivat e NATO-s dhe do të ulte besueshmërinë e Aleancës në Europë.

Në përfundim mund të themi se, një forcë ushtarake “mbikombëtare” do të ishte një mjet i fuqishëm për politikën e jashtme të BE-së dhe do t’i shërbente përbushjes së objektivës për të qenë aktor ndërkombëtar nëpërmjet reagimit shpejt dhe me efektivitet ndaj sfidave të së ardhmes. Me qëllim pasjen e një ushtrie të përbashkët Europiane, fillimisht Bashkimi duhet të ketë një politikë të jashtme efektive. Në kushtet kur Shtetet Anëtare kanë vështirësi për të arritur në një marrëveshje sesi do të reagojnë ndaj një situatë të caktuar konflikti, së fundmi rasti i Ukrainës, aneksimi i Krimesë apo luftimet në Donbas, funksionimi i një ushtrie Europiane do të ishte i pamundur dhe jo efektiv.

a. Integrimi ushtarak i Bashkimit European pas BREXIT

Para BE-së shtrohej detyra për të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të ndërtuar një Bashkim më efektiv, më të bashkuar dhe më të aftë për të reaguar me qëllim realizimin e interesave dhe prioriteteve të tij në drejtim të promovimit të paqes dhe të garantimit të sigurisë së qytetarëve të tij dhe të tërësisë së tij territoriale. Hapi i rradhës në drejtim të forcimit të kapaciteteve ushtarake për të vepruar në rajone të largëta konfliktesh dhe të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare, ishte krijimi i Grupeve të Betejave, të cilat konsistonin në batalione prej rreth 1500 ushtarësh të trajnuar, të ndihmuar nga shërbimet mbështetëse dhe të pajisur me logjistikën përkatëse. Të konceptuara si forca të reagimit të shpejtë ato duhet të ishin të gatshme për mobilizim nga 5 deri në 10 ditë dhe do të mund të angazhoheshin si forcë mbështetëse për forcat që tashmë ishin mobilizuar në një operacion, si

³¹⁴ Carmen Cristina Cirling, “European Defence Cooperation - New impetus needed”, *European Parliamentary Research Service* (18 Dhjetor 2013), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

forcë e parë, për krijimin e terrenit për mobilizim të një numri më të madh forcash dhe si forcë e vetme në operacionet ku vetëm ato do të angazhoheshin, për një periudhë të shkurtër dhe do të konsistonin në një numër të kufizuar veprimesh. Që nga momenti që u deklaruan operacionale, në vitin 2007, BE-ja ka mobilizuar tëtëmbëdhjetë Grupe Betejash, të cilat kanë vepruar nën kontrollin e Këshillit. Të menduara si një instrument ushtarak që do t'i garantonte Bashkimit të reagonte shpejt në rast të një krize, ato njëkohësisht i krijonte Shteteve Anëtare mundësinë që nëpërmjet ndërmarrjes së operacioneve ushtarake të përbashkëta të krijojnë eksperiencën e nevojshme për të bashkëpunuar në çështje të mbrojtjes.

Në drejtim të forcimit të bashkëpunimit në fushën ushtarake përpjekjet kanë qenë të vazhdueshme, duke nisur që nga krijimi i PSMP-së deri në krijimin e mekanizmave të veçantë të bashkëpunimit, si ai i bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar, dhe përfshirja e klauzolës së ndihmës së ndërsjelltë, e cila parashikonte mundësinë që Shtetet Anëtare të ndihmojnë çdo shtet tjetër anëtar i cili është viktimë e një sulmi të armatosur në territorin e tij, duke përdorur të gjitha mënyrat në dispozicion të tyre, përfshirë dhe përdorimin e forcave ushtarake nëse do të ishte e nevojshme.

Pas sulmeve terroriste në Paris, në nëntor të 2015 Franca ishte i pari shtet që zbatoi klauzolën e ndihmës së ndërsjelltë, e cila u miratua në unanimitet. Kjo i garantoi asaj dhe përkrahjen ushtarake të Bashkimit në rastin e ndërhyrjeve në Mali, Siri dhe në Republikën e Afrikës Qendrore. Përdorimi i kësaj klauzole dhe jo i asaj të mbrojtjes kolektive përbën avantazh për Francën në dy drejtime: *së pari*, kualicioni i shteteve kundër Shtetit Islamik kishte natyrë *ad hoc*, jashtë strukturës së NATO-s. Në këtë drejtim neni 42.7 kërkon ndërhyrjen e secilit Shtet Anëtar ndërsa neni 5 kërkon ndërhyrjen e NATO-s. *Së dyti*, NATO është një aleancë ushtarake, ndërsa BE-ja zotëron si komponentin ushtarak dhe atë civil, i cili mund të jetë i domosdoshëm në një situatë konfliktive³¹⁵.

Pavarësisht se Shtetet Anëtare kishin rritur shpenzimet e tyre në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes me rreth 12%, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet tyre i shkaktonte Bashkimit një humbje që llogaritej nga 25 deri në 100 bilion euro. Për këtë arsye, në Samitin e Bratislavës Shtetet Anëtare ranë dakort që Bashkimi duhej të garantojë ruajtjen e paqes, respektimin e demokracisë dhe sigurinë e qytetarëve të tij nëpërmjet zbatimit të plani konkret, që do t'i mundësonte një përdorim më efektiv të kapaciteteve të tij.

Në vitin 2016 Presidenti i Komisionit European Junker deklaroi se ambicia e Europës për mbrojtjen e qytetarëve të saj brenda dhe jashtë kufinjve territorialë mund të realizohej vetëm nëse ajo do të investonte në forcimin e burimeve ekzistuese, të investonte në kapacitete të tjera dhe të krijonte një industri të mirëfilltë të mbrojtjes. Siguria e Bashkimit kërkonte investim në teknologji të përbashkëta, në pajisje të rëndësishme strategjike si në tokë, det, dhe ajër dhe në forcimin e sigurisë kibernetike. Një industri mbrojtje e fortë, konkurruese dhe inovative do t'i garantonte Europës autonominë e domosdoshme strategjike³¹⁶.

³¹⁵ <http://www.ecfr.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

³¹⁶ <https://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

Natyra e sfidave me të cilat po përballëj siguria e Bashkimit shtronte para Shteteve Anëtare një përgjigje më gjithëpërfshirëse, e cila nuk duhej të limitohej vetëm në përpjekjet për të krijuar një ushtri të përbashkët por të një mbrojtje e përbashkët europiane e bazuar në një sistem industrial europian, në një teknologji europiane dhe në një treg europian të mbrojtjes. Konflikti në Ukrainë, aneksimi i Krimesë nga Rusia dhe rritja e ndikimit gjeopolitik rus në lindje dhe në vendet e Ballkanit do të nxirrte edhe një herë në pak nevojën e krijimit të një force të kombinuar europiane, cila do të mund të realizohej vetëm pas largimi të Britanisë nga blloku dhe nxitjes së SHBA-ve që Bashkimi të investonte më shumë në drejtim të mbrojtjes.

Për vite me rradhë euroskeptikët britanikë dhe kundërshtarët e BE-së kanë kundërshtuar me forcë idenë e krijimit të një ushtrie europiane, duke konsideruar rolin parësor të NATO-s si forcë ndërhyrëse, e pajisur me elementin ushtarak, që përbën forcën e saj, dhe atë politik, i cili garanton legjitimitetin e ndërhyrjes. Arsyet e këtij kundërshtimi janë disa: *së pari*, sipas tyre mbrojtja duhet të mbetet një çështje kombëtare; *së dyti*, në vazhdimësi NATO ka treguar se ka qenë efiçente në garantimin e tërësisë territoriale të Bashkimit, duke mos pasur nevojë për krijimin e mbivendosjeve; *së treti*, në disa raste anagazhimi në një operacion të përbashkët të NATO-s dhe BE-së ka rezultuar i suksesshëm, duke ndërthurur elementin ushtarak dhe atë civil; *së katërti*, ekzistenca e NATO-s mban të angazhuar në rajon SHBA-në, e cila është dhe financuesi kryesor; *së pesti*, për sa kohë Shtetet Anëtare nuk paguajnë kuotën e tyre të detyrimit në NATO të njëjtën gjë do të bëjnë dhe me detyrimet ndaj ushtrisë europiane; dhe *së gjashti*, një ushtri europiane do të shërbente si “Kali i Trojës” në realizimin e objektivit të krijimit të një super shteti³¹⁷.

Shqetësimi u rrit edhe më shumë me zgjedhjen e Donald Trump si president i SHBA-së, i cili gjatë fushatës së tij elektorale e konsideroi NATO-n si diçka të “vjetëruar” dhe refuzonte të zbatonte nenin e mbrojtjes reciproke. Ndodhur para situatës ku SHBA-ja nga njëra anë mund të kufizonte kontributet e saj ndaj NATO-s dhe nga ana tjetër mund të mos respektonte angazhimet ushtarake dhe atomike ndaj Europës dhe të ofronte mbështetjen e saj ndaj operacioneve të ndërmarrë nga Bashkimi, ky i fundit duhej të rriste përpjekjet e tij për të garantuar integritetin europian në fushën e mbrojtjes.

Situata ishte e tillë që vetë ekzistenca e Bashkimit po vihej në diskutim, rajoni gjithnjë e më shumë po bëhej i paqëndrueshëm dhe i pasigurtë dhe krizat brenda dhe jashtë kufinjve po përbënin kërcënim për sigurinë e qytetarëve. Shtetet Anëtare nuk kishin as forcën dhe as kapacitetet e nevojshme për t'i adresuar të vetme rreziqet që i kanoseshin paqes dhe sigurisë dhe BE-ja kishte nevojë për një strategji globale të qartë. Globale si përsa i përket shtrirjes territoriale por edhe fushave të cilat strategjia duhet të mbulojë dhe instrumentave që në të duhet të parashikohen, si ato ushtarakë, civile (garantimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rindërtimi i vendit pas konfliktit) dhe socialë (krijimi i vendeve të punës). Këto ambicie gjetën pasqyrim në Strategjinë Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, e cila i adresojë pesë prioritetet³¹⁸:

³¹⁷ <http://www.conservativehome.com/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

³¹⁸ <http://eeas.europa.eu/> / (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

- **Siguria e BE-së** - Zbatimi i strategjisë duhet të nisë brenda kufinjve të Bashkimit, siguria e të cilit kërcënohet nga aktet terroriste, krizat financiare, ndryshimet klimaterike, pamjaftueshmëria e burimeve energjitike dhe krimi kibernetik. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë sëbashku dhe me partnerët e tyre, duke nisur me NATO-n.
- **Rindërtimi i shteteve dhe i shoqërive nga lindja në jug** – Në kuadër të politikës së zgjerimit dhe asaj të fqinjësisë Bashkimi duhet të ndihmojë në forcimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Gjithashtu ai do të ofrojë asistencën e tij ndaj shteteve stabiliteti i të cilave kërcënohet nga shkaqe ekonomike, ndryshimet klimatike, lëvizjet migratore, të cilat më pas kërcënojnë dhe sigurinë në kufinj të BE-së.
- **Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj konflikteve** – BE-ja nëpërmjet zbatimit të qasje gjithëpërfshirëse ndaj konflikteve dhe krizave do të reagojë në të gjitha fazat e një konflikti duke nisur që nga parandalimi, ndërhyrja në *peace making*, stabilizimi dhe rindërtimi i vendit pas konfliktit dhe marrja e masave për mospërsëritjen e tij. Përsa i përket shtrirjes gjeografike ajo do të ndërhyjë si në konfliktet me natyrë lokale, kombëtare, rajonale dhe globale. Të gjitha këto do të realizohen në bashkëpunim me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë.
- **Udhëheqje bashkëpunuese** – BE-ja përkrah ardhjen në pushtet të qeverive demokratike të cilat i ofrojnë qytetarëve siguri dhe respektim të të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë drejtim ajo ofron mbështetje në rajone të ndryshme, të cilat ndikojnë dhe në sigurinë e saj, si në Mesdhe, Lindjen e Mesme dhe Afrikë, në veri dhe në jug të Azisë dhe në Artik.
- **Qeverisja globale për shekullin e 21-të** – BE-ja do të angazhohet në ndryshimin e sistemit aktual të qeverisjes bazuar në respektimin e normave të së drejtës ndërkombëtare.

Ndonëse Strategjia Globale, përbënte një nivel tjetër të ambicieve të Bashkimit dhe përcaktonte prioritetet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, mënyra sesi këto do të zbatoheshin ishin pjesë e një një pakete gjithëpërfshirëse të quajtur Plani i Zbatimit. Veprimet e parashikuara në këtë plan mund të kategorizohen në: a.) reagimin ndaj konflikteve dhe krizave, b.) ndërtimi i kapaciteteve të partnerëve, dhe c.) mbrojtja e BE-së dhe e qytetarëve të tij nëpërmjet marrjes së veprimeve konkrete. Realizimi i këtyre prioritetëve do të bëhet në përputhje me PJSP-në, dispozitat e Traktateve dhe duke respektuar bashkëpunimin me NATO-n dhe OKB-në³¹⁹.

Në pajtim me aktet e referuara më lart dhe me deklaratën e përbashkët NATO-BE, Bashkimi miratoi Plan Veprimin European të Mbrojtjes, nëpërmjet të cilit Komisioni propozonte³²⁰:

Së pari, krijimin e një Fondi European të Mbrojtjes, u cili do të financonte investimet në kërkim dhe në zhvillimin e teknologjisë dhe pajisjeve të mbrojtjes. Ky fond do të përbëhet nga dy “dritare”, ajo e kërkimit dhe ajo e kapaciteteve. “Dritarja e kërkimit” do të financonte kërkimin në teknologjitë e reja të mbrojtjes si në elektronikë, software për analizimin e të dhënave dhe deshifrimin e tyre. Ndërsa “Dritarja e kapaciteteve” do të vepronte si një mjet financiar që do t’i mundësonte Shteteve Anëtare blerjen e përbashkët të aseteve. Krijimi i këtij

³¹⁹ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

³²⁰ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

fondi do të mundësonte përdorimin më me efektivitet të parave të taksapagueseve europianë, duke eliminuar mbivendosjet në shpenzime.

Së dyti, të mbështesë investimet në blerjen e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla dhe të furnizuesve për mbrojtjen.

Së treti, të krijojë dhe të forcojë kushtet për krijimin e një tregu të përbashkët të mbrojtjes dhe të ndihmojë kompanitë që punojnë në fushën e mbrojtjes për të operuar përtej kufinjve të një shteti. Në këtë drejtim Komisioni mbështeti zbatimin efektiv të dy direktivave, atë 2009/43/EC për transferimin ndërkufitar të produkteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe atë 2009/81/EC për prokurimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes me qëllim koordinimin e procedurave për nënshkrimin e kontratave, të cilat kishin si qëllim vendosjen e standarteve për industrinë e mbrojtjes, zhvillimi i politikave sektoriale dhe lehtësimi i procedurave për të marrë pjesë në procesin e prokurimeve ndërkufitare.

Pas ndryshimeve të prezantuara me Traktatin e Lisbonës hapi më i rëndësishëm në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes ishte nënshkrimi i marrëveshjes për Bashkëpunimin e Përhershëm të Strukturuar nga ministrat e 23 Shteteve Anëtare më 13 Nëntor 2017. Kjo marrëveshje kuadër do t'i mundësonte Shteteve Anëtare, të cilat dëshironin dhe posedonin kapacitetet e nevojshme, të zhvillonin sëbashku kapacitetet dhe aftësitë mbrojtëse nëpërmjet ndërmarrjes së iniciativave të përbashkëta dhe hartimit të projekteve konkrete, të investonin në projektet e përbashkëta, të rrisnin gadishmërinë e forcave të tyre të armatosura dhe të shtonin kontributin e tyre në trupa ushtarake. Ndërsa BE-së do t'i mundësonte ndërmarrjen e misioneve dhe operacioneve të cilat kërkonin një nivel më të lartë angazhimi. Të gjitha këto do të realizoheshin në bazë të udhëzimeve politike të gjithëpranuara³²¹.

Respektimi i angazhimeve të marra në kuadër të Bashkëpunimit të Përhershëm dhe të Strukturuar do të garantohej nga vlerësimi i përvitshëm i bërë nga Përfaqësuesi i Lartë. Përsa i përket aspekteve që lidheshin me kapacitetet ai do të ndihmohej nga Agjencia Europiane e Mbrojtjes. Shpenzimet do të mbuloreshin nga buxheti i Bashkimit.

Angazhimet e përbashkëta të parashikuara në këtë marrëveshje kuadër shtriheshin në pesë fusha kryesore³²²:

Së pari, bashkëpunim në drejtim të përmbushjes së objektivave që kishin të bënin me nivelin e shpenzimeve për pajisje ushtarake dhe mbrojtëse dhe rishikimi i këtyre objektivave nën dritën e ndryshimeve që ndodhin në fushën e mbrojtjes dhe të përgjegjësive që BE-ja ka në ruajtjen e rendit botëror – Kjo nënkuptonte rritjen në vazhdimësi të buxhetit të mbrojtjes, rritjen deri në 20% të shpenzimeve për arritjen e kapaciteteve dhe rritjen e investimeve në përmirësimin e teknologjisë dhe në kërkim.

Së dyti, përafrimi sa më shumë të jetë e mundur të strukturave që veprojnë në fushën e mbrojtjes, dhe nxitjen e bashkëpunimit në fushën e trajnimeve dhe të logjistikës. Kjo

³²¹ <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

³²² <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

nënkuptonte dhe përdorimin e kapaciteteve të përbashkëta me qëllim rritjen e efektivitetit dhe forcimin e bashkëpunimit nëpërmjet shpërndarjes së informacionit.

Së treti, marrjen e masave konkrete në drejtim të rritjes dhe përforsimit të gadishmërisë, të ndërveprimit, të fleksibilitetit dhe të mobilizimit të forcave të Shteteve Anëtare, përfshirë këtu dhe mundësinë e rishikimit të procedurave vendimmarrëse.

Së katërti, bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare me qëllim për të garantuar marrjen e të gjithave masave të nevojshme për realizimin e objektivave, duke iu drejtuar dhe Aleancës në ato raste kur ky mekanizëm ishte i pamjaftueshëm për t'i relaizuar ato.

Së pesti, pjesëmarrja në përpilimin e programeve të përbashkëta për armatimet në kuadër të Agjensisë Europiane të Mbrojtjes.

Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar ishte një mesazh i rëndësishëm politik si për qytetarët europianë edhe jashtë Bashkimit. Për qytetarët europianë nënkupton më shumë siguri dhe është një shenjë e qartë e gadishmërisë së Shteteve Anëtare për të përkrahur realizimin e një politike të sigurisë dhe të mbrojtjes së përbashkët dhe realizimin e objektivave të vendosura në Strategjinë Europiane, ndërsa për shtetet e treta nënkupton gadishmërinë e Shteteve Anëtare për të zhvilluar më tej politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes së përbashkët. Megjithatë, pavarësisht ndikimit pozitiv në drejtim të forcimit të integritetit të mbrojtjes së Bashkimit, anëtarësia në këtë lloj bashkëpunimi mbetet vullnetare. Ky lloj bashkëpunimi duhet të respektonte dispozitat e Traktateve dhe të Protokolleve shtesë, të kushtetutave të Shteteve Anëtare, të angazhimeve të tyre në kuadër të Aleancës dhe të mos cënonte sovranitetin e tyre kombëtar.

Në kushtet kur lëvizja e forcave ushtarake nëpër Europë realizohet sipas rregullave të mirëpërcaktuara, të cilat jo rradhë herë kanë krijuar kufizime, përkrahësit e idesë së integritetit ushtarak të BE-së hodhën idenë e krijimit të “Zonës Ushtarake Shengen”. Krijimi i një zone të tillë do t'i mundësonte personelit ushtarak dhe pajisjeve ushtarake të lëvizin më me lehtësi nëpër kufinj të Europës pa iu nënshtruar kufizimeve diplomatike dhe procedurave që rregullojnë lëvizjen e pajisjeve ushtarake. Në analogji me lëvizjen e qytetarëve, kjo nënkuptonte pa qenë subjekt i kontrolleve nëpër kufinj.

Idea e krijimit të një “Zone Ushtarake Shengen” për lëvizjen e lirë të trupave dhe pajisjeve ushtarake nëpër Europë, është hedhur fillimisht në 2015 nga gjenerali Ben Hodges, komandant i forcave të SHBA-s në Europë, dhe më pas në 2016 nga ministri i jashtëm i Italisë Paolo Gentiloni, në Samitin e Bratislavës. Kjo ide është përkrahur dhe nga NATO, e cila synonte që BE-ja të vendoste rregulla të reja që të krijonin lehtësira për mobilizimin sa më të shpejtë të forcave në ushtarake në kufi me Rusinë. Në mbledhjen e ministrave të mbrojtjes më 08 Nëntor 2018 ajo i kërkoi zyrtarisht BE-së që normat e ligjeve kombëtare të lehtësojnë kalimin e nëpër kufinj të forcave ushtarake dhe të përmirësojnë infrastrukturën civile në pajtim me nevojat ushtarake. Ndërsa në 15 Shkurt 2018 NATO njoftoi për krijimin e Komandës Logjistike, e cila do të ndihmonte në përmirësimin e lëvizjes nëpër Europë të trupave ushtarake dhe të pajisjeve të domosdoshme të mbrojtjes³²³.

³²³ <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

Në përfundim, në lidhje me idenë e një “Zone Ushtarake Shengen” mund të themi se krahas anëve pozitive, realizimi i saj është më i lehtë të thuhet sesa të bëhet. *Së pari*, jo të gjithë shtetet anëtare të NATO-s janë dhe anëtare të marrëveshjes së Shengenit dhe krijimi i një zone Shengen mund të hasë në kundërshti politike. *Së dyti*, është e nevojshme nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet të cilat janë anëtare të NATO-s por jo të BE-së dhe me Britaninë e Madhe, kur ajo të mos jetë më pjesë e Bashkimit.

Në shërbim të krijimit të zonës shengen dhe me qëllim ruajtjen e paqes dhe garantimin e sigurisë së qytetarëve europianë, Presidenti i Komisionit Junker dhe Përfaqësuesja e Lartë Mogerini, më 28 Mars prezantuan Plan Veprimin për Lëvizshmërinë Ushtarake, në pajtim me kërkesat e prezantuara nga Pentagoni dhe NATO. Ky plan veprimi kishte si qëllim thjeshtëzimin e formaliteteve doganore për lëvizjen e trupave dhe të pajisjeve në rast të operacioneve ushtarake, për transportin e materialeve të rrezikshme në pronësi të forcave ushtarake dhe bashkëpunimin në nivel europian për të garantuar që rrjeti i rrugëve dhe i hekurudhave të jenë i përshtatshëm për transportin e pajisjeve dhe të trupave ushtarake. Lehtësimi i lëvizjes së trupave dhe të pajisjeve do t’i ndihmonte BE-në të ishte më efektive ndaj parandalimit të krizave, me eficientë në mobilizimin e forcave ushtarake dhe më e shpejtë në reagim ndaj kërcënimeve që i kanosen sigurisë dhe paqes³²⁴.

Për krijimin e një rrjeti të përshtatshëm transporti ky Plan Veprimi propozonte ndërmarrjen, në kuadër të Agjencisë Europiane të Mbrojtjes, deri në 2025 të veprimeve në këto fusha kryesore³²⁵:

- **Specifikimet ushtarake** – të cilat përbëjnë fillesën për një lëvizje efektive dhe të koordinuar të pajisjeve dhe të trupave ushtarake nëpër Europë. Specifikimet ushtarake do të hartohen nga Shërbimi për Veprimet me Jashtë dhe Shtabi Ushtarak dhe do të reflektojnë kërkesat e BE-së dhe të Shteteve Anëtare, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me nevojat infrastrukturore.
- **Infrastruktura e transportit** – kjo fushë ka të bëjë me politikën e miratuar nga Shtetet Anëtare që rregullojnë fushën e transportit dhe investimet në këtë drejtim. Deri në 2019, Komisioni duhet të ketë identifikuar se cilat pjesë të transportit janë të përshtatshme për të realizuar transportin e pajisjeve dhe të trupave ushtarake dhe në cilat pjesë kërkohen investime të mëtejshme. Gjithashtu, Komisioni do të llogarisë dhe koston e këtyre investimeve.
- **Çështjet normative dhe procedurale** – Komisioni do të analizojë mundësinë për modernizimin dhe thjeshtëzimin e normave doganore dhe harmonizimin e rregullave për transportin e mallrave të rrezikshëm ushtarakë. Në të njëjtën kohë, Agjencia Europiane e Mbrojtjes do të mbështesë Shtetet Anëtare për përpilimin e lejeve të lëvizjes ndërkufitare. Përveç anës normative, eficienta e zbatimit të këtij planveprimi varet edhe nga bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe nga bashkëpunimi me aktorë të tjerë të angazhuar në fushën e mbrojtjes si NATO dhe SHBA. Ky planveprimi do t’i mundësojë

³²⁴ <https://ec.europa.eu/>(hyrë për herë të fundit më 16 Prill 2018).

³²⁵ Po aty.

BE-së dhe Shteteve Anëtare reagojnë shpejt në rast misionesh apo operacionesh të ndërmarra në kuadër të PJSP-së dhe në pajtim me nevojat dhe përgjegjësitë e tyre në drejtim të mbrojtjes, edhe në kuadër të NATO-s. Gjithashtu duhet theksuar se eliminimi i barrierave doganore nuk nënkupton cënimin e sovranitetit kombëtar të Shteteve Anëtare, por zbatimi i këtij plan veprimi do të respektojë tërësinë territoriale të Shteteve Anëtare dhe procesin e tyre vendimmarrës. Lëvizshmëria e forcave dhe pajisjeve ushtarake është gjithashtu një nga angazhimet në kuadër të Bashkëpunimit të Përheshëm të Strukturuar të analizua më lart.

Të gjitha masat e ndërmarra nga BE-ja janë të domosdoshme për të ndërtuar një Bashkim më efektiv, më reagues dhe më të vendosur për realizimin e interesave dhe prioritetëve të tij në promovimin e paqes dhe në garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe të territorit të tij. Përveç bashkëpunimit ushtarak, pjesë e integritit të mbrojtjes së BE-së është forcimi i fuqisë së nukleare, pavarësisht se idea e krijimit të një programi të përbashkët nuklear është akoma në fillimet e saj.

Që nga nënshkrimi i Traktatit të Euroatom, kur mendohej se fuqia nukleare do të ishte burimi kryesor i energjisë në të ardhmen, shumë ka ndryshuar në politikat e Bashkimit. Por megjithatë, rritja e çmimit të naftës dhe të gazit natyror, të cilat jo në pak raste kanë qenë shkak konfliktesh dhe krizash, por edhe ndryshimet klimatike e kanë nxitur Bashkimin të marrë masa për hartimin e politikave që do të mund t'i sigurojnë atij sigurinë e burimeve të energjisë. Pyetja që ngrihet në këtë rast është se çfarë roli do të luajë BE-ja në drejtim të krijimit të një politike të përbashkët për energjinë nukleare?

Deri më sot, sikurse rezulton nga përmbajtja e Strategjisë Europiane të Sigurisë dhe e Strategjisë Europiane kundër Terrorizmit, siguria nukleare është konsideruar si çështje kombëtare dhe Shtetet Anëtare kanë detyrimin të miratojnë kuadrin e nevojshëm ligjor për të garantuar sigurinë e qytetarëve dhe të mjedisit. Ndërsa në arenën ndërkombëtare është KS i OKB-së i cili ka miratuar disa Rezoluta në drejtim të sigurisë nukleare. Në kushtet kur pasojat e një incidenti nuk prekin vetëm një shtet, ato kanë pranuar mundësinë që një reagim i mirëkoordinuar nëpërmjet politikave dhe udhëzimeve të përbashkëta është më efikas për minimizimin e efekteve negative. Në këtë drejtim ato kanë shfrytëzuar mekanizmat e krijuar nga Bashkimi për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit. Ekzistenca e akteve ligjore të përbashkëta dhe të pranura nga të gjitha Shtetet Anëtare shmang interpretimin dhe kuptimin ndryshe të akteve të së drejtës kombëtare.

Në lidhje me rolin e Bashkimit në garantimin e sigurisë nukleare mund të themi, se ndonëse përdorimi i energjisë nukleare për qëllime paqesore rregullohet nga Traktati i Euroatom, i cili përbën një entitet të pavarur nga Bashkimi, Komisioni kontrollon aktivitetin nuklear në këto drejtime³²⁶:

Së pari, sigurinë nukleare që lidhet me përdorimin e instalimeve nukleare dhe menaxhimin e mbetjeve nukleare. Bashkimi garanton respektimin e standarteve të sigurisë për të gjithë aktivitetet në fushën e energjisë nukleare ku janë të përfshirë civilët si prodhimi i

³²⁶ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 18 Prill 2018).

energjisë, në kërkim shkencor dhe për qëllime mjekësore. Shtetet Anëtare kanë detyrimin të respektojnë rregullat e sigurisë brenda veprimeve të ushtruara në territoret e tyre. Pas incidentit të ndodhur në Fukushima, Komisioni theksoi domosdoshmërinë e përditësimit të rregullave ekzistuese dhe harmonizimin e praktikave të Shteteve Anëtare. Në 2014 BE-ja përditësoi rregullat për instalimin e pajisjeve nukleare, Direktiva 2014/87/Euroatom. Siguria nukleare lidhet edhe me mbrojtjen nga rrezatimi të shtetasve dhe mjedisin, masat mbrojtëse për transportin e lëndëve radioaktive dhe të mbetjeve dhe menaxhimin e mbetjeve nukleare.

Së dyti, mbrojtja nukleare, nënkupton masat të cilat garantojnë që materialet nukleare të përdoren vetëm për atë çfarë kanë deklaruar përdoruesit e tyre dhe në përputhje me normat ndërkombëtare. Këto masa përfshijnë të gjitha fazat, që nga furnizimi me materiale të para nga vendet e treta deri në tregtimin e tyre jashtë BE-së.

Së treti, mbrojtja e materialit nuklear dhe të instalimeve ndaj akteve keqbërëse.

Në kuadër të Traktatit të Euroatom-it kontrolli i kontratave për importin dhe eksportin e materialeve nukleare realizohej nga Agjensia e Furnizimeve të Euroatom, e cila kontrollonte nëse këto kontrata kishin shënimin “materiali do të përdoret për qëllime paqësore” dhe nëse ato kishin të përfshira në dispozita klauzolën e mbrojtjes. Gjithashtu ajo ishte përgjegjëse për të autorizuar eksportin e lëndëve nukleare jashtë Bashkimit dhe kishte detyrë të vendndodhjen e materialeve nukleare brenda kufinjve të BE-së. Për të parandaluar përdorimin e lëndëve nukleare në akte terroriste, BE-ja kishte miratuar rregullore dhe direktiva të cilat ishin të detyrueshme dhe për Shtetet Anëtare dhe kishte krijuar një rrjet me njësi të specializuara në luftën kundër terrorizmit, të cilat ndihmonin njësitë kombëtare të inteligjencës në koordinimin e veprimeve të tyre³²⁷.

³²⁷ <https://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 18 Prill 2018).

KAPITULLI V

OPERACIONET DHE MISIONET E BASHKIMIT EUROPIAN. BASHKËPUNIMI NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE NATO-s

Një ide më të qartë të gjendjes së PESMP-së, të pikëpyetjeve ligjore që kanë lindur gjatë operacioneve dhe misioneve në të cilat BE-ja është angazhuar dhe mënyra sesi ato janë zgjidhur mund t'a krijojmë vetëm duke analizuar misionet dhe operacionet në të cilat ajo është angazhuar. Operacionet ose misionet në të cilat BE-ja është angazhuar përta i përket kohëzgjatjes së tyre i ndajmë në dy grupe të mëdha: në operacione tashmë të përfunduara dhe në ato të cilat janë akoma në vazhdim. Ndërsa përta i përket natyrës së këtyre operacioneve apo misioneve ato i ndajmë në ato të natyrës ushtarake dhe në ato të natyrës policore. Disa prej tyre janë dhe të natyrës së përzier si për shembull Misioni AMIS II në Darfur dhe në Rajonin e Sudanit.

Në lidhje me kornizën ligjore të këtyre misioneve dhe operacioneve mund të themi se: ***Së pari***, forcat e BE-së kanë vepruar, kryesisht, bazuar në mandatin e KS të OKB-së, në kuadër të ndonjë marrëveshje paqeje ose pas kërkesës së shtetit pritës; ***Së dyti***, statusi i forcave dhe veprimet që do të ndërmerren në kuadër të operacionit në të shumtën e rasteve rregullohen nga Marrëveshjet për Statusin e Misionit (Status of Mission Agreement) dhe Marrëveshjet për Statusin e Forcave (Status of Forces Agreement), të cilat lidhen ndërmjet BE-së dhe shtetit pritës; ***Së treti***, është Këshilli Europian ai i cili me anë të një vendimi të përbashkët vendos ngritjen dhe nisjen e planifikimit të operacionit, i cili në të shumtën e rasteve pasohet nga një vendim i dytë për nisjen e operacionit; ***Së katërti***, kontrolli politik dhe drejtimi strategjik i operacionit i përket Komitetit të Politikave dhe të Sigurisë; ***Së pesti***, në të shumtën e rasteve BE-ja ka vepruar në bashkëpunim me organizata të tjera ose shtete të treta, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve; ***Së gjashti***, për çdo mision, të paktën për ato të natyrës ushtarake, hartohet një plan veprimi dhe përcaktohen rregulla që sanksionojnë mënyrën e angazhimit në mision; dhe ***Së shtati***, për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe financimin e këtyre operacioneve gjejnë zbatim dhe normat e së drejtës europiane.

Rëndësi të veçantë për këtë punim merr trajtimi i operacioneve ose misioneve në të cilat BE-ja dhe NATO kanë bashkëpunuar së bashku në terren, sidomos në ato raste të cilat kërkojnë ndërthurjen e elementëve ushtarakë me ato civilë. Bazat e këtij bashkëpunimi i gjejmë: ***së pari***, në deklaratën e përbashkët NATO – BE mbi PESM-në, në të cilën NATO riafirmon gadishmërinë e saj për t'i lejuar BE-së akses në kapacitet e saj për planifikimin e misioneve të saj; dhe ***së dyti***, në Marrëveshjet e Berlin Plus, të cilat i lejojnë BE-së që për operacionet e saj të menaxhimit të krizave, të drejtuara nga vetë ajo dhe në rastet kur NATO nuk angazhohet, të përdorë asetet dhe kapacitetet e kësaj të fundit.

Këto dy organizata kanë bashkëpunuar sëbashku³²⁸:

³²⁸ NATO, http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49217.htm (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

- *Në Ballkanin Perëndimor:* Në Korrik të 2003 NATO dhe BE publikuan “Një përqasje e përbashkët për Ballkanin Perëndimor”, në të cilën evidentoheshin fushat kryesore të bashkëpunimit dhe objektivi i përbashkët i tyre, i cili ishte rivendosja e stabilitetit në rajon. Ato bashkëpunuan në rastin e Bosnje dhe Hercegovinës, Maqedonisë dhe Kosovës.
- *Në Afganistan:* Njëpërmjet misionit të saj NATO synoi të krijonte një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurtë, në të cilin qeveria Afgane dhe aktorët ndërkombëtarë, BE-ja njëpërmjet misionit të saj, të mund të ndihmonin në ndërtimin e institucioneve demokratike, vendosjen e shtetit të së drejtës dhe rindërtimin e vendit.
- *Në Afrikë:* NATO dhe BE së bashku mbështetën misionin e UA-së në Darfur dhe që nga Shtatori 2008, në kuadër të luftës kundër piraterisë, forcat detare të tyre janë vendosur në brigjet e Somalisë.

5.1 Angazhimi i Bashkimit European dhe i NATO-s në ish Jugosllavi

Në raport me fqinjët e saj lindorë ish Jugosllavia ka patur përballë BE-së një pozitë më të privilegjuar, sidomos përse i përket dimensionit ekonomik, ku rëndësi kanë marrëveshjet e tregtisë më 1970 dhe paketa e ndihmës ekonomike, PHARE³²⁹, që ju akordua asaj nga Komuniteti European (sot BE-ja) më 1990. Krisja e këtyre marrëdhënieve nisi më 1991 kur krerët e Republikave që përbënin ish Jugosllavinë nuk arritën në një marrëveshje për realizimin e zgjedhjeve federale, pasi nga njëra anë Slobodan Millosheviç dhe serbët nacionalistë ishin kundër marrjes së presidencës nga Kroacia dhe nga ana tjetër kroatët kishin shfaqur ambicien e tyre për t’u shkëputur nga federata, e cila u bë publike njëpërmjet referendumit të 19 Maj-it 1991. Më parë ishte Sllovenia ajo e cila më 20 Shkurt 1991 kishte deklaruar shkëputjen nga ish Jugosllavia. Si kundërpërgjigje e deklaratave për shkëputje të Sllovenisë dhe Kroacisë, më 27 Qershor Ushtria Popullore e Jugosllavisë (në vijim UPJ) hyri fillimisht në Lubjanë, duke vijuar më pas në Kroaci dhe në Bosnje dhe Hercegovinë.

Qëndrimi fillestar i Komunitetit European ishte në favor të ruajtjes së kufinjve të ish Republikës Federale të Jugosllavisë (në vijim ish RFJ) dhe të arritjes së një konsensusi politik, për arsye se njohja e pavarësisë dhe e kufinjve të rinj të Kroacisë dhe të Sllovenisë do të krijonte një precedent të rrezikshëm për Europën Qëndrore dhe Lindore. Me qëllim mënjanimin e përshkallëzimit më tej të konfliktit, Komuniteti European ndoqi fillimisht rrugën diplomatike, duke kërcënuar me ndërprerjen e ndihmave ekonomike nëse UPJ-ja nuk do të tërhiqej. Ai gjithashtu propozoi pezullimin e përkohshëm deri në tre muaj të çdo lëvizje për pavarësi dhe zgjedhjen e Stipe Mesiç si mbajtës të presidencës së rradhës. Si rezultat i këtyre përpjekjeve diplomatike u arrit disa herë armëpushimi, por jo ndërprerja përfundimtare e luftimeve. Në kushtet kur këto përpjekje diplomatike rezultuan të kota, më 5 Korrik 1991 Ministrat e Jashtëm të 12 Shteteve Anëtare arritën në një vendim të përbashkët për të vendosur në të gjithë ish Jugosllavinë embargon e armëve dhe të çdo pajisje tjetër ushtarake.

³²⁹ PHARE është një nga tre instrumentat para anëtarësimit në BE, i cili finanohet nga kjo e fundit dhe ka si qëllim të ndihmojë shtetet e Europës Qëndrore dhe Lindore të cilat synojnë të anëtarësohen në BE.

Arritja e Marrëveshjes së Brionit nga Trojka e Komunitetit European, e cila kryesisht kishte të bënte me Slloveninë, shtoi shpresat për arritjen e një marrëveshje më gjithëpërfshirëse me autoritetet federale. Për shkak të mungesës së kapaciteteve ushtarake, të cilat u arritën të krijoheshin me Traktatin e Mاستrihtit, dhe në kushtet kur ndërhyrja ushtarake ose të çdo forme tjetër ndërhyrje, konsiderohej si cënim i sovranitetit të ish Jugosllavisë, pasi spastrimi etnik po ndodhte brenda shtetit, vendosja në vend e një misioni monitorues ishte e vetja mundësi për Komunitetin³³⁰.

Ideja për të ndërhyrë ushtarakisht në ish Jugosllavi me qëllim ndalimin e luftimeve u hodh nga Franca dhe gjeti mbështetjen e Italisë dhe të Belgjikës dhe hezitimin e Britanisë së Madhe, e cila kishte rezerva përse i përket numrit të forcave të nevojshme. Për shkak të kufizimeve të parashikuara në Ligjin Themelor Gjermania e kishte të pamundur të ndërhynte ushtarakisht jashtë mandatit të NATO-s. Në kushtet e një pamundësie për arritjen e një marrëveshje për krijimin e një force europiane dhe pas dështimit të negociatave në Konferencën e Paqes në Hagë, Komuniteti European i kërkoi KS-së së OKB-së për t'u angazhuar në terren, i cili përveç miratimit të Rezolutës 713 për vendosjen e embargos së armëve nuk ndërmori asnjë veprim tjetër.

Deri në momentin e arritjes së Planit Carrington – Cutileiro në Shkurt 1992, Komuniteti European në vazhdimësi i ka qëndruar idesë së ruajtjes së kufinjve të Federatës së ish Jugosllavisë dhe se çdo ndryshim i tyre duhej të realizohej në mënyrë paqësore. Por ndodhur në kushtet e një spastrimi etnik, Komuniteti European pranoi të merrte parasysh dëshirën e Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë (15 Shtator 1991) dhe Bosnje dhe Hercegovinës (15 Tetor 1991) për shkëputje, por me kusht që këto të garantonin respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Shteti i parë anëtar i cili ishte pro njohjes së pavarësisë së këtyre shteteve ishte Gjermania, e cila më 23 Dhjetor 1991 njohu në mënyrë të njëanshme Slloveninë dhe Kroacinë, ndërsa Britania e Madhe dhe Spanja, për shkak të problemeve të tyre të brendshme (Irlanda e Veriut për Britaninë e Madhe dhe Rajoni Bask dhe i Katalonjës për Spanjën), ishin skeptike. Por, me nënshkrimin e Traktatit të Mاستrihtit të gjitha Shtetet Anëtare ranë dakort për të njohur çdo Republikë.

Në kushtet e mungesës së arritjes së një konsensusi për mobilizimin e një force ushtarake europiane dhe kur spastrimi etnik vazhdonte, OKB-ja në përputhje me Kreun VIII të Kartës vendosi mobilizimin, fillimisht në Kroaci, të Forcës Mbrojtëse të OKB-së (UNPROFOR), e cila përbëhej nga rreth 15 mijë trupa³³¹. Mandati i këtij misioni ishte çmilitarizimi i “Zonave të Mbrojtura nga OKB-ja”, me qëllim mbrojtjen e popullsisë nga çdo sulm i mundshëm. Ky mandat u zgjerua më tej duke përfshirë në të dhe funksione të natyrës monitoruese në “zonat rozë” të Kroacisë, me qëllim për t'i mundësuar forcave ushtarake kontrollin e hyrjes së civilëve në zonat e mbrojtura dhe të kufinjve.

³³⁰ *Brioni Declaration* (08 Korrik 1991), <http://www.ucdp.uu.se/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

³³¹ UN, *Resolution 743* (21 Shkurt 1992), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

Me shtrirjen e konfliktit në Qershor të 1992 dhe në Bosnje dhe Hercegovinë, mandati i UNPROFOR u zgjerua dhe në këtë shtet, duke garantuar sigurinë dhe funksionimin e aeroportit të Sarajevës me qëllim shpërndarjen e ndihmave humanitare në qytet dhe në rrethinat e tij. Në Shtator 1992 në mandat u përfshi dhe shoqërimi i të burgosurve civilë të liruar në rast kur kërkohet nga Komiteti i Kryqit të Kuq, monitorimi i zonave ku ndalohej fluturimi dhe shmangia e të gjithave udhëtimeve të natyrës ushtarake mbi Bosnje dhe “zonat e sigurta”. Detyrë e këtyre forcave ishte dhe monitorimi i marrëveshjeve të armëpushimit në Kroaci dhe Bosnje. UNPROFOR ishte e autorizuar të përdorte forcën vetëm në rast vetëmbrojtje dhe në koordinim me forcat e NATO-s, në mbështetje të veprimeve ushtarake të kësaj të fundit³³². Në Shtator 1992 pjesë e mandatit të UNPROFOR u bë dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, me qëllim monitorimin dhe raportimin e çfarëdolloj zhvillimi që do të ndodhte në kufinj të saj dhe që mund të cënonte stabilitetin e saj³³³.

Nga ana tjetër, me qëllim arritjen e një zgjidhje për situatën e krizës në ish Jugosllavi, BE-ja vazhdonte përpjekjet e saj diplomatike, përpjekje këto që rezultuan të pasuksesshme. Seria e vazhdueshme e dështimeve diplomatike dhe dështimi i negociatave të paqes, të drejtuara nga Vance dhe Owen, nxorrën në pah vështirësinë e arritjes së një politike të përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes. Në këto kushte, me qëllim për t'i hapur rrugë ndërhyrjes ushtarake të shteteve europiane që ishin pro, më 13 Gusht 1992 KS i OKB-së miratoi Rezolutën 770, nëpërmjet së cilës ftonte të gjitha Shtetet Anëtare për të përdorur të gjitha masat e “domosdoshme” në mbështetje të përpjekjeve humanitare në Bosnje³³⁴. Thirrje së cilës iu përgjigjën Franca dhe Britania e Madhe.

a. Bosnje dhe Hercegovina dhe ndërhyrja ndërkombëtare e Bashkimit Europian

Për më tepër se tre vjet NATO dhe BE-ja, në bashkëpunim me njëra tjetrën, zbatuan efektivisht si sanksionet ekonomike dhe embargon e armëve të vendosur ndaj ish Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe kohe ato koordinuan veprimet e tyre në dy operacione të pavarura, përkatësisht Sharp Vigilance dhe Maritime Monitor, të cilat më 15 Qershor 1993 u zëvendësuan nga operacioni i përbashkët Sharp Guard, i cili zgjati deri më 19 Qershor 1996³³⁵. Misioni Sharp Guard kishte si qëllim monitorimin e zbatimit të saksioneve të vendosura nga OKB-ja (Rezolutat e KS 713, 757, 787, 820 dhe 943), duke kontrolluar lëvizjen e anijeve në Adriatik. Ndërsa në zbatim të Rezolutave 1021 dhe 1022 të KS-së, ky mision u shtri vetëm për të garantuar respektimin e embargos së armëve të rënda dhe municioneve, ku përfshiheshin minat, helikopterët, aeroplan mbajtëset etj³³⁶. Ndonëse, ky bashkëpunim ndihmoi në frenimin e përshkallëzimit më tej të konfliktit dhe në krijimin e kushteve për arritjen e një Marrëveshje Paqe për Bosnje dhe Hercegovinën, ai gjithashtu nxorri në pah pamjaftueshmërinë e sanksioneve të

³³² UN, *Resolution 816* (31 Mars 1993), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

³³³ UN, *Former Yugoslavia-UNPROFOR*, <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017); UN, *Former Yugoslavia-UNPROFOR*, <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

³³⁴ UN, *Resolution 770* (13 Gusht 1992), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017); UN, *Resolution 781* (09 Tetor 1992), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

³³⁵ UN, *Resolution 1074* (01 Tetor 1996), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

³³⁶ <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

natyrës ekonomike dhe domosdoshmërinë e formave të tjera të ndërhyrjes me qëllim ndërprerjen e luftimeve në ish Jugosllavi dhe rivendosjen e paqes.

Nga ana tjetër, angazhimi i forcave të OKB-së, misioni UNPROFOR, në konfliktin në ish Jugosllavi dhe sidomos në Bosnje rezultoi i pasuksesshëm dhe nxorri në pah paaftësinë e forcave paqeruajtëse për t'u angazhuar në një mision të një natyre aq komplekse, i cili kërkonte domosdoshmërisht dhe ndërhyrjen ushtarake për ndërprerjen e tij. Nevoja e ndërhyrjes në konflikt të një force shumëkombëshe dhe të pajisur me të gjitha aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme, u bë dhe më e qartë me rënien e “zonave të sigurta”, si Srebrenica dhe Zepa, dhe më pas me masakrën e Srebrenicës. Për shkak të rregullit të vendosur nga OKB-ja më 1993 sipas së cilit ndërhyrjet ushtarake të NATO-s duhet të bëheshin me miratimin e përbashkët të saj dhe të OKB-së, NATO ndonëse e ngarkuar me përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e gjashtë “zonave të sigurta” në Bosnje dhe Hercegovinë, si forcë mbështetëse për misionin paqeruajtës UNPROFOR nuk ishte në gjendje të ndërhynte ushtarakisht për t'i dhënë fund konfliktit.

Në 1995, pas masakrës së Srebrenicës, OKB-ja e cila ishte e paaftë t'i jepte fund konfliktit i dorëzoi “çelësin” komandës së NATO-s, e cila po në këtë vit si kundërpërgjigje të shkeljes nga Jugosllavia të disa nga Rezolutat e KS-së nisi operacionin Deliberate Force duke i dhënë dritën jeshile fushatës ajrore³³⁷. Operacioni Deliberate Force nga njëra anë ndihmoi në rritjen e besueshmërisë së NATO-s tek komuniteti ndërkombëtar dhe nga ana tjetër ishte dëshmi e aftësisë së saj për të udhëhequr një fushatë ushtarake mjaft komplekse, madje duke përdorur dhe forcën, jo vetëm në kuadër të mbrojtjes kolektive por edhe në misione të natyrës paqeruajtëse, për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizës.

Me arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit në Dhjetor të 1995, e cila i dha fund konfliktit në Bosnje, NATO angazhohet në Bosnje në një mision paqeruajtës IFOR, i cili bazuar në Rezolutën 1031 të KS-së mandati i tij ishte garantimi i zbatimit të aspekteve ushtarake të marrëveshjes së paqes dhe të siguronte moskthimin e konfliktit në vend³³⁸. Pas realizimit me sukses të zgjedhjeve në Shtator të 1996, misioni IFOR përfundon mandatin e tij dhe në 20 Dhjetor të 1996 NATO vendos mobilizimin në Bosnje të një force shumëkombëshe SFOR, me qëllim për të garantuar qëndrueshmërinë e paqes së vendosur dhe zbatimin e aspekteve civile të marrëveshjes së paqes, përfshirë këtu dhe promovimin e ndërtimit të institucioneve demokratike, rindërtimin e ekonomisë dhe të lehtësimit të procesit të kthimit të refugjatëve në shtëpitë e tyre³³⁹. Të dy këto misione vepronin nën drejtimin dhe kontrollin politik të NATO-s.

Në funksion të një paqe afatgjatë dhe të zbatimit të të gjitha aspekteve civile të Marrëveshjes së Dejtonit rëndësi paraqet dhe bashkëpunimi i SFOR me organizata të tjera ndërkombëtare, sidomos me BE-në, e cila më 01 Janar të 2003 mobilizoi forcën e saj policore, EUPM. Ky mision, i cili ishte i pari që BE-ja ndërmori në kuadër të PESM-së, ishte vazhdim i misionit policor të OKB-së dhe fillimisht u parashikua që të zgjaste për periudhën 2003 – 2005,

³³⁷ Robert C. Owen, *Deliberate Force: A Case Study in Effective Air Campaigning* (Air University Press, 2000), <http://www.au.af.mil/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³³⁸ UN, *Resolution 1031* (14 Dhjetor 1995), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³³⁹ <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Maj 2017).

por që në fakt vazhdoi deri më 30 Qershor 2012³⁴⁰. Në përputhje me angazhimet në kuadër të Paktit të Stabilitetit objektiv i këtij misioni ishte arritja e marrëveshjeve të qëndrueshme në fushën policore, në përputhje me praktikën më të mira europiane dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e standardeve të forcës policore të Bosnje dhe Hercegovinës. Ky objektiv do të arrihej nëpërmjet monitorimit, këshillimit dhe kontrollimit të këtyre forcave policore, duke përjashtuar ushtrimin e kompetencave ekzekutive apo vendosjen e komponentëve të armatosur³⁴¹. Problematika që krijoi në praktikë realizimi i këtij objektiv ishte se për shkak të mosekzistencës së asnjë katalogu me praktikën më të mira, për të cilat Shtetet Anëtare të kishin rënë dakort, ndonjë detyrat e “monitorimit” dhe “këshillimit” ishin të qarta problem ishte “kontrollimi” në kushtet kur misioni nuk gëzonte kompetenca ekzekutive si arrestimi apo ushtrimi i ndjekjes penale. Me zgjatjen e mandatit të misionit EUPM, si pjesë e objektivave u përfshi dhe trajnimi i policisë vendase për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, përmirësimin e legjislacionit dhe forcimin e bashëpunimit ndërmjet strukturave ligj zbatuese.

Në lidhje me legjitimitetin e misionit EUPM të BE-së, mund të themi se ai veprroi nën mandatin e KS-së së OKB-së, pas thirrjes që Sekretari i Përgjithshëm i bëri partnerëve ndërkombëtarë për të marrë përsipër përgjegjësitë e tyre, dhe statusi i forcave të misionit dhe normat e së drejtës që do të gjenin zbatim rregullohej nga Marrëveshja për Statusin e Misionit (në vijim MSM), e cila u nënshkrua para nisjes së misionit³⁴². Në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje parashikohej se EUPM-ja do të gëzonte statusin e një misioni diplomatik, zyrat dhe mjetet e transportit që do të përdoreheshin nga misioni do të ishin të paprekshme, ndërsa personelit të misionit i njiheshin të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato të personelit të ambasadave. Në lidhje me juridiksionin kjo marrëveshjeje i jepte prioritet Shteteve Anëtare, ku ato dhe institucionet e Komunitetit do të ishin përgjegjëse për t’iu përgjigjur çdo ankese apo pretendimi ndaj një anëtari të stafit dhe për të nisur çdo veprim kundër tij (Veprimi i Përbashkët 2002/210/CFSP)³⁴³.

Siç u tha më lart ky mision nuk ishte i natyrës ushtarake dhe në nenin 5(1) dhe 6(2) të MSM-së parashikohej se anëtarët e EUPM-së nuk do të mund të mbanin armë dhe nuk do të mund të ndërmerrnin asnjë veprim apo aktivitet në kundërshtim me natyrën e funksioneve të tyre. Ndërsa në nenin 6(1) të saj parashikohej se ishte përgjegjësi e shtetit pritës marrja e të gjitha masave të nevojshme për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e EUPM-së dhe të anëtarëve të tij³⁴⁴.

Përveç arritjeve në drejtim të forcimit të besueshmërisë dhe përgjegjshmërisë së forcave policore boshnjake, të rritjes së aftësive operacionale dhe investiguese në luftën ndaj krimit të

³⁴⁰ Council of the European Union, *Joint Action 2007/749/CFSP On the European Union Police Mission (EUPM) in Bosnia and Herzegovina (BiH)* (19 Nëntor 2007), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴¹ Council of the European Union, *Joint Action on the European Union Police Mission (2002/210/CFSP)* (11 Mars 2002), <http://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴² UN, *Resolution 1396* (2002), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴³ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴⁴ UN, *Resolution 1396* (2002), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

organizuar, të forcimit të integritetit dhe të rritjes së shkallës së llogaridhënies ndaj qytetarëve, gjatë zbatimit në terren të planit të misionit u vërejtën dhe disa probleme si: *Së pari*, mangësitë në prokurimin e pajisjeve të nevojshme për misionin dhe mungesa e një programi të përbashkët; *Së dyti*, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe ulja me kalimin e kohës së aftësive trajnuese dhe kualifikuese të oficerëve; *Së treti*, mospasja parasysh të mësimave të nxjerra nga misioni i mëparshëm i OKB-së, duke mos i kushtuar rëndësi të njëjtë trajnimit të strukturave ligjzbatuese, të drejtësisë dhe të sistemit penitenciar; *Së katërti*, ekzistenca e strukturave paralele dhe e dy drejtuesve të misionit, ai i misionit policor të OKB-së, i cili ushtronte detyrat ekzekutive dhe ishte i autorizuar për përdorimin e forcës dhe ai i misionit policor të BE-së, i cili kishte një mandat më të kufizuar; *Së pesti*, mungesa e komunikimit dhe e bashkëpunimit midis shteteve të ndryshme³⁴⁵ dhe *Së gjashti*, mandati i kufizuar i misionit, pasi monitorimi, këshillimi dhe kontrollimi ishin detyra të pamjaftueshme për të realizuar objektivat e këtij misioni, dhe mungesa e detyrave me karakter ekzekutiv, e cila bëri që mjaft përgjegjësi të mbeteshin të pambuluara nga ky mision. Statistikat tregojnë se, që nga koha e nisjes së këtij misioni në 2004 krimi u rrit me 22% në Republikën Srpska dhe me 32% në Federatën Serbo – Kroate. Suksesi i këtij misioni u minua edhe nga vazhdimi i konflikteve etnike në vend, të cilat ky mision nuk ishte në gjendje t'i ndalte³⁴⁶.

Me miratimin në unanimitet të Rezolutës 1575, KS-ja i OKB-së mirëpriti qëllimet e BE-së për të nisur një operacion të natyrës ushtarake, i cili në zbatim të Aneksit 1 – A dhe Aneksit 2 të Marrëveshjes së Dejtonit do të kishte si objektiv stabilizimin e paqes së vendosur duke garantuar zbatimin e aspekteve ushtarake të kësaj marrëveshje. Në këto kushte me Vendimin 2004/803/CFSP të datës 25 Nëntor 2004 Këshilli vendosi nisjen e operacionit EUPOR ALTHEA, i cili filloi efektivisht më 02 Dhjetor 2004 dhe në vendim nuk përcaktohej një afat për kohëzgjatjen e tij³⁴⁷. Ky operacionin i cili zëvendësoi misionin e drejtuar nga NATO, SFOR, u zhvillua në kuadër të zbatimit të Marrëveshjeve të Berlin Plus dhe BE-ja përdori zyrtar qëndrore, kapacitetet dhe aftësitë planifikuese të NATO-s. Kontrolli politik dhe drejtimi strategjik i misionit i përkiste BE-së, por duke përdorur të gjithë zinxhirin e drejtimit të misionit të NATO-s. Edhe pse ndryshoi emri i komandës së operacionit rreth 80% e trupave të misionit SFOR vazhduan të qëndronin në terren³⁴⁸.

³⁴⁵ Michael Merlingen, “The EU Police Mission in Bosnia and Herzegovina (EUPM)” in *European Security and Defence Policy: The First 10 Years (1999 – 2009)*, ed. G. Grevi, D.Helly dhe D. Keohane (Institute for Security Studies, 2009), fq. 161 – 171, <http://www.iss.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴⁶ James Lyon, “EU’s Bosnia Police Mission is ‘Laughing Stock’”, *Politico* (2005) <http://www.politico.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴⁷ UN, *Resolution 1639* (21 Nëntor 2005), <http://www.ohr.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁴⁸ UN, *Resolution 1575* (22 Nëntor 2004), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

Operacioni ALTHEA kishte këto objektiva: *së pari*, të siguronte ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin e Forcave të Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës; *së dyti*, të mbështeste përpjekjet e Bosnje dhe Hercegovinës për të ruajtur një ambient të sigurtë, dhe *së treti*, të ofronte mbështetje për strategjinë gjithëpërfshirëse që BE-ja kishte përgatitur për Bosnjen³⁴⁹.

Përsa i përket Marrëveshjes për Statusin e Forcave (në vijim MSF) mund të themi se ato të drejta dhe privilegje që u aplikuan për forcat e misionit SFOR të NATO-s, *mutatis mutandis* gjetën zbatim dhe për forcat e operacionit ALTHEA të drejtuar nga BE-ja. Nëse i referohemi Marrëveshjes së Dejtonit, në të parashikoheshin rregulla vetëm për forcat e misionit SFOR të drejtuara nga NATO dhe nuk ka asnjë referim për forcat e misioneve të tjera. Por, KS-ja me miratimin e Rezolutës 1551 dhe 1575 e plotësoi këtë boshllëk duke parashikuar zbatimin e këtyre rregullave dhe për misionin e drejtuar nga BE-ja dhe forcat e saj.

Sipas këtyre dokumentave për misionin e BE-së dhe forcat e saj do të gjenin zbatim Konventa e OKB-së për Privilegjet dhe Imunitetet, me përjashtim të rasteve kur në MSF parashikohet ndryshe. Personeli i BE-së do të gëzonte imunitet nga arrestimet ose ndalimet, ndërsa personeli ushtarak në lidhje me shkeljet e kryera në Bosnje do t'i nënshtrohej juridiksionit të tij kombëtar. Për të gjithë personelin ekzistonte detyrimi për të respektuar të drejtën vendase, për aq sa ajo do të ishte në pajtim me detyrat dhe mandatin e ngarkuar, duke shmangur çdo veprim i cili binte në kundërshtim me natyrën e operacionit. Privilegje dhe imunitete i ishin garantuar dhe personelit vendas të punësuar nga misioni. Në lidhje me të drejtën për të mbajtur armë, këto akte parashikonin se personeli i BE-së mund të mbante armë vetëm në rast se ishin të autorizuar nga komanda e operacionit³⁵⁰.

b. Bashkëpunimi BE-NATO në rastin e Kosovës

Përveç Bosnjes, situata paraqitej mjaft kritike edhe në Kosovë, ku për shkak të luftës dhe spastrimit etnik që po ndodhte atje më tepër se 300 mijë kosovarë që nga fillimi i luftimeve kishin braktisur shtëpitë e tyre. Gjithashtu, paafëësia e diplomacisë europiane për t'i dhënë fund luftimeve, pasi dy raundet e takimeve në Rambuje për arritjen e një marrëveshje paqeje kishin dështuar, nxorri në pah domosdoshmërinë e ndërhyrjes së një force shumëkombëshe. Për këtë arsye, me qëllim dhënies fund të katastrofës humanitare dhe spastrimit etnik që po ndodhte në Kosovë, NATO merr vendimin për të ndërhyrë ushtarakisht nëpërmjet operacionit Allied Force. Ky operacion përveç qëllimit për t'i dhënë fund dhunës dhe represionit që po ndodhte në Kosovë, synonte të detyronte personelin ushtarak dhe forcat paramilitare serbe të tërhiqeshin nga Kosova dhe të vendoste atje një prezencë ushtarake ndërkombëtare, e cila do të garantonte kthimin e sigurtë të refugjatëve dhe arritjen e një marrëveshje politike për Kosovën në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së³⁵¹. Me miratimin e Rezolutës 1244, ky operacion

³⁴⁹ http://eeas.europa.eu/csdp/missions-and-operations/althea-bih/index_en.htm (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵⁰ <http://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017); <http://www.euforbih.org/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵¹ NATO, *The Kosovo Air Campaign* (2016), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

përfundoi më 10 Qershor 1999 për t'i lënë vendin mobilizimit të një force ndërkombëtare civile, ku përsëri NATO kishte rolin kryesor.

Misioni civil i NATO-s, KFOR, i cili u vendos në Kosovë më 12 Qershor 1999, do të vepronte në mbështetje të misionit të OKB-së, UMNİK, dhe mandati i tij buronte nga Rezoluta 1244 e KS-së dhe Marrëveshja Tekniko – Ushtarake e lidhur midis NATO-s dhe Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Serbisë. Ky mision i cili operoi sipas Kreut VII të Kartës së OKB-së si një operacion për vendosjen e paqes, synonte realizimin e këtyre objektivave: (i). Frenimin e çdo lloj forme kërcënimi ose armiqësie ndaj Kosovës nga forcat serbe; (ii). Krijimin e një ambjenti të sigurtë dhe vendosjen e rregullit në vend; (iii). Çmilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në vijim UÇK); (iv). Mbështetjen e veprimeve humanitare dhe koordinimin e veprimeve me ato të organizatave të tjera që vepronin në terren si OKB dhe BE. Gjithashtu, NATO luajti një rol mjaft të rëndësishëm në zbatimin e Marrëveshjes së Parimeve që do të udhëhiqin normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, e negociuar nga BE-ja. Nisur nga përmbajtja e këtyre detyrave mund të themi se, misioni KFOR i NATO-s ishte një mision i natyrës civile³⁵².

Në funksion të ndërtimit të një Kosove të qëndrueshme, demokratike dhe multietnike misioni KFOR i NATO-s bashkëpunoi dhe koordinoi veprimet e tij dhe me misionin e OKB-së (UMNIK) dhe atë të BE-së (EULEX), ku rëndësi për këtë punim paraqet analiza e misionit EULEX (European Union Rule of Law Mission) të BE-së, i cili nuk ishte pasardhës i misionit të NATO-s në Kosovë, por vazhdim i atij të OKB-së, UMNİK. Vendimi i Shteteve Anëtare të BE-së për nisjen e misionit EULEX, që u mor në Shkurt të 2008, ishte pjesë e përpjekjeve të BE-së për të promovuar paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe për të mbështetur autoritetet kosovare në rrugën e reformave. Mandati i këtij misioni, që zgjati deri në Qershor 2016, ishte të asistonte dhe të mbështeste autoritetet kosovare në forcimin e shtetit të së drejtës, sidomos në drejtim të policisë, gjyqësorit dhe të doganave³⁵³. Ky mandat ushtrohej nën Rezolutën 1244 të KS-së së OKB-së dhe komanda politike dhe strategjike e këtij misioni i përkiste BE-së.

c. Kriza në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe bashkëpunimi BE-NATO

Në fillim të vitit 2001 për shkak të rritjes së tensioneve në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (në vijim RJM) dhe me qëllim shmangien e përshkallëzimit më tej të konfliktit NATO dhe BE, në përputhje me angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Ohrit, nisën koordinimin e përpjekjeve të tyre. Si bazë për nisjen e operacioneve nga këto dy organizata shërbeu kërkesa e Presidentit të ish RJM dhe Rezoluta 1371 të KS-së së OKB-së, e cila mirëpriste angazhimin në vend të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe mobilizimin e një force ndërkombëtare të sigurisë, e cila do të kontribuonte në ruajtjen dhe forcimin e sigurisë.

³⁵² Lord Robertson of Port Ellen, *Kosovo one year on: Achievement and Challenge* (2000), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵³ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 27 Prill 2017).

Në funksion të ruajtjes së paqes dhe të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor NATO ndërmori në ish RJM tre misione: Essential Harvest, Amber Fox dhe Allied Harmony, ku në të tre këto raste ajo ka ndërhyrë pas kërkesës së autoriteteve vendase për praninë e një force ndërkombëtare, e cila do të mund t'i rikthente stabilitetin vendit, i cili ndodhej shumë pranë shpërthimit të një lufte civile. Në 7 Qershor 2001 pas arritjes së marrëveshjes së paqes, Marrëveshjes së Ohrit, ndërmjet qeverisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Shqiptarëve (në vijim UÇSH), Presidenti Trajkovski kërkoi asistencën e NATO-s për të garantuar tërheqjen dhe çarmatimin e UÇSH-së. Kjo kërkesë u pranua nga NATO, e cila nisi operacionin Essential Harvest për një periudhë nga 22 Gusht deri më 27 Shtator 2001, me kushtin që dialogu politik ndërmjet palëve në proces të kishte një përfundim pozitiv dhe angazhimi i trupave të NATO-s të rregullohej nga miratimi paraprakisht i Marrëveshjes për Statusin e Forcave. Ky operacion ishte i natyrës ushtarake dhe personeli ushtarak ishte ngarkuar me mbledhjen, ruajtjen dhe asgjësimin e armëve³⁵⁴.

Me mbarimin e Operacionit Essential Harvest, NATO pas kërkesës së qeverisë maqedonase nis një operacion tjetër, Amber Fox. Ky operacion zgjati nga 4 Tetori 2001 deri më 16 Dhjetor 2002, pas zgjatjes së mandatit të tij. Mandati i këtij operacioni përfshinte garantimin e sigurisë së vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE-së dhe të BE-së, të cilët ishin të angazhuar në monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit³⁵⁵.

Me qëllim minimizimin e rreziqeve që i kanoseshin stabilitetit të vendit NATO pranon rëndësinë që do të kishte për vendin ekzistenca e një pranie ushtarake dhe për këtë arsye nis misionin e saj të tretë Allied Harmony. Misioni paqeruajtës i NATO-s, Allied Harmony, ishte vazhdim i misionit të mëparshëm dhe mandati i tij përfshinte, përveç garantimin e sigurisë së vëzhguesve ndërkombëtarë, dhe asistimin e qeverisë për të rivendosur pushtetin e saj në të gjithë vendin. Më 31 Mars të 2002 NATO merr vendim t'i japë fund Operacionit Allied Harmony, i cili pas arritjes së marrëveshjes midis saj dhe BE-së, sipas së cilës kjo e fundit mund të përdorë asetet dhe kapacitetet e NATO-s, ky operacion pasohet nga CONCORDIA³⁵⁶.

Operacioni CONCORDIA në ish RJM-në, i cili ishte i pari mision për menaxhimin e krizave i një natyre ushtarake, nisi mbi bazën e kërkesës së autoriteteve të shtetit pritës dhe fillimisht u programua të zgjaste për gjashtë muaj, por që u zgjat deri më 15 Dhjetor 2003. Ky operacion u pasua nga EUPOL PROXIMA dhe EUPAT, të cilat do të trajtohen në vazhdim³⁵⁷. Mandati i këtij misioni konsistonte në aktivitete që kishin të bënin me forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimin e programeve për rindërtimin e institucioneve shtetërore dhe forcimin e forcave

³⁵⁴ NATO, *Skopje Request NATO assistance*, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵⁵ NATO, *NATO's role in the former Yugoslav Republic of Macedonia* (2004), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵⁶ NATO, *NATO's role in Former Yugoslav Republic of Macedonia*, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵⁷ Catriona Mace, "Operation Concordia: Developing a "European" approach to crisis management", *International Peacekeeping Journal* (Vol. 11, Issue 3, 2004).

policore, në funksion të promovimit të stabilitetit dhe të frenimit të shpërthimit të konflikteve etnike³⁵⁸.

Në Planin Operacional dhe në Rregullat e Angazhimit të Misionit, të cilat u miratuan më 18 Mars 2013, parashikohet se përmbushja e këtyre objektivave do të bëhet duke përdorur asetet dhe kapacitetet e NATO-s, në kuadër të Marrëveshjeve të Berlin Plus. Me qëllim për të ndihmuar BE-në në planifikimin strategjik, operacional dhe taktik të misionit, Zyrat Operacionale të saj u përfshinë në Zyrat Qëndrore të Aleancës në Mons të Belgjikës³⁵⁹. Kontrolli politik dhe drejtimi strategjik i operacionit i përkiste KPS-së, pra BE-së, i cili ishte i autorizuar të merrte çdo vendim të rëndësishëm në lidhje me operacionin, përfshirë dhe të drejtën për të ndryshuar planin operacional, drejtuesin e operacionit dhe rregullat e angazhimit, të gjitha këto në pajtim me objektivat e misionit³⁶⁰.

Në nenin 12 të Veprimit të Përbashkët 2003/92/CFSP parashikohet se rregullimet për statusin e forcave të operacionit të drejtuar nga BE-ja do të ishin pjesë e marrëveshjeve që BE-ja do të përfundonte me qeverinë e ish RJM. Bazuar në këtë nen, më 21 Mars 2001 u arrit Marrëveshja për Statusin e Forcave, e cila hyri në fuqi ditën e nisjes së misionit më 31 Mars 2003 dhe e shtrinte veprimin e saj edhe mbi personelin dhe asetet e shteteve të treta që merrnin pjesë në operacion³⁶¹. Në nenin 2 dhe 9 të saj parashikohet se forcat e drejtuara nga BE-ja kishin detyrimin të respektonin ligjet, rregulloret e ish RJM, ligjet që kishin të bënin me mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore dhe të drejtën ndërkombëtare. Çdo veprim i ndërmarrë nga stafi i misionit duhet të ishte në pajtim me natyrën e operacionit. Sipas nenit 5 të gjitha hapësirat ku ishte vendosur stafi i misionit, vendet ku ato qëndronin, arkivat dhe dokumentat e tyre ishin të paprekshme dhe nuk mund të ishin objekt kontrolli. Korespondenca e misionit gëzonte status të njëjtë me atë të një misioni diplomatik. Privilegjet dhe imunitetet që u njiheshin stafit të përfaqësive diplomatike i njiheshin dhe personelit të misionit (neni 6). Madje neni 7(2) i njihete personelit të misionit të drejtën për të mbajtur armë dhe municione, por me kusht që ato të ishin të autorizuar për një veprim të tillë³⁶².

Përsa i përket pretendimeve për shpërblime të dëmeve që mund të shkaktonin forcat e misionit ato ndaheshin në dy kategori. Pretendimet për dëme që rridhnin nga veprimet e

³⁵⁸ Council of the European Union, *Decision 2003/202/CFSP "Relating to the launch of the EU military operation in the Former Yugoslav Republic of Macedonia"* (18 Mars 2003), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁵⁹ *Council Conclusion on ESDP-operation in the Former Yugoslav Republic of Macedonia (FYROM)* (18 March 2003), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁶⁰ Neni 4(1) dhe 10(2) i Council Joint Action 2003/92/CFSP.

³⁶¹ Council of the European Union, *Decision 2003/222/CFSP "Concerning the conclusion of the Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status of the European Union-led Forces (EUF) in the Former Yugoslav Republic of Macedonia"* (21 Mars 2003), EU, *Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status of the European Union-led forces in the Former Yugoslav Republic of Macedonia*, <http://eur-lex.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁶² EU, *Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status of the European Union-led forces in the Former Yugoslav Republic of Macedonia*, <http://eur-lex.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

ndërmarrja gjatë trazirave publike, për mbrojtjen e forcave të misionit ose që ishin të domosdoshme për realizimin e objektivave të operacionit, të cilat nuk do të ishin subjekt i asnjë lloj dëmshpërblimi nga shtetet që merrnin pjesë në operacion dhe nuk do të mbuloheshin nga mekanizmi financiar i BE-së. Ndërsa të gjitha të tjerat, do të shqyrtoheshin nga një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të misionit të BE-së dhe të ish RJM dhe arritja e një marrëveshje do të ishte e mundur vetëm pasi shteti i interesuar do të kishte dhënë pëlqimin e tij. Në ndryshim nga misioni në Bosnje (EUPM), në Marrëveshjen për Statusin e Forcave nuk parashikohej asnjë dispozitë që të rregullonte përgjegjësinë e përbashkët të BE-së për pretendime që rridhnin nga veprimet e përbashkëta³⁶³.

Në përfundim mund të themi se, nga njëra anë operacioni CONCORDIA luajti një rol të rëndësishëm në drejtim të konsolidimit të rolit të BE-së si një aktor i rëndësishëm për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botë dhe nga ana tjetër, prania e vazhdueshme e NATO-s në terren e vështirësoi pozicionimin e BE-së si ofruesin kryesor të sigurisë dhe si aktorin kryesor politik *vis-à-vis* me autoritetet maqedonase. Gjithashtu, mosrënia dakort paraprakisht midis NATO-s dhe BE-së për procedurat sipas së cilave do të realizohej shkëmbimi i informacionit e vështirësoi së tepërmi komunikimin dhe koordinimin ndërmjet tyre³⁶⁴.

Pas përfundimit të operacionit CONCORDIA, BE-ja ndër morri në ish RJM dhe dy misione të tjera të natyrës civile, misioni PROXIMA dhe EUPAT. Më 15 Dhjetor 2003 BE në përputhje me objektivat e përcaktuara në Marrëveshjen e Ohrit nisi misionin policor EUPOL PROXIMA, i cili zgjati deri më 14 Dhjetor të 2005³⁶⁵. Kontrolli politik dhe drejtimi strategjik i misionit i përkiste BE-së, të cilin e realizonte nëpërmjet KPS-së. Në mandatin e këtij misioni përfshihej monitorimi, udhëheqja dhe këshillimi i policisë lokale me qëllim konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe të rendit në vend, koordinimi i veprimeve me autoritetet vendase në luftën kundër krimit të organizuar, rritjen e efektivitetit të policisë lokale dhe forcimin e besueshmërisë së qytetarëve tek ajo. Ndonëse ky mandat nuk përfshinte detyra të natyrës ekzekutive, forcat e misionit ishin të autorizuar të kishin një njësi mbrojtëse të armatosur³⁶⁶.

Në lidhje me privilegjet dhe imunitetet që i njiheshin misionit dhe personelit të tij në nenin 5 dhe 6 të Marrëveshjes për Statusin e Misionit parashikohej se misioni gëzonte status të barazvlefshëm me atë të një misioni diplomatik, përfshirë këtu edhe përjashtimin nga juridiksioni civil, penal dhe administrativ i ish RJM-së, sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet

³⁶³ EU, *Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status of the European Union-led forces in the Former Yugoslav Republic of Macedonia*, <http://eur-lex.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁶⁴ International Crisis Group, “Macedonia: No Room for Complacency”, *Europe Report* (No. 149, 2003), <http://www.cespi.it/> (hyrë për herë të fundit më 22 Nëntor 2015).

³⁶⁵ Council of the European Union, *Joint Action 2004/789/CFSP “On the extension of the European Union Police Mission in the Former Yugoslav Republic of Macedonia (EUPOL ‘Proxima’)”* (2004), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁶⁶ EU, *Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status and activities of the European Union Police Mission in the Former Yugoslav Republic of Macedonia (EUPOL Proxima)*, *Official Journal L 016*, 23/01/2004 P. 0066 – 0073, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

Diplomatike, ndërsa personeli i misionit gëzonte të gjitha imunitetet dhe privilegjet që gëzonin agjentët diplomatikë. Në marrëveshje parashikohej dhe mundësia për të hequr dorë nga imuniteti i garantuar, nëse kjo nuk do të çënonte interesat e BE-së³⁶⁷.

Me përfundimin e misionit PROXIMA, BE-ja nisi misionin EUPAT (EU Police Advisory Team), i cili kishte si qëllim të mbështeste krijimin e një force policore efektive dhe profesionale në ish RJM. Mund të themi se për nga natyra, ky mision mund të konsiderohet vazhdim i misionit PROXIMA, por më i vogël në personel³⁶⁸.

Në përfundim mund të themi se, mësimet e nxjerra për BE-në nga kriza në ish Jugosllavi ishin të shumta:

- **Së pari**, kjo krizë e gjeti BE-në të papërgatitur nga pikëpamja e kapaciteteve për të përballuar një konflikt të përmasave të tilla, jo vetëm për sa i përket shtrirjes gjeografike por edhe kompleksitetit të çështjeve. Ajo nuk dispononte kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të përballuar krizën në terren.
- **Së dyti**, për shkak se në kohën e nisjes së konfliktit BE-ja akoma nuk kishte krijuar një politikë të përbashkët të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe nuk ishin ngritur strukturat mbështetëse, qëndrimet e saj ishin shpesh jokoherente.
- **Së treti**, BE-ja dështoi të fliste nën një zë të vetëm dhe rruga që ajo dinte më mirë të adresonte konfliktet ishte ajo diplomatike, duke ia lënë barrën më të madhe në vendimmarrje OKB-së dhe NATO-s.
- **Së katërti**, mekanizmat që BE-ja kishte në dispozicion për menaxhimin e situatës pas konfliktit ishin të papërshtatshme, joefektive dhe karakterizoheshin nga shkalla e lartë e burokracisë.
- **Së pesti**, BE-ja nuk ishte e pranishme në terren, në vendin e konfliktit, dhe pse shpenzonte më tepër se SHBA-ja në programet për rindërtimin e vendit. Ndërsa NATO ishte e fokusuar në misionet për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, BE-ja, e cila fillimisht duhet t'i kushtonte më tepër rëndësi forcimit të kapaciteteve të saj civile, ishte e angazhuar në misione të një intensiteti më të ulët, siç ishin ato për rindërtimin e vendit pas konfliktit.

5.2 Afganistani dhe bashkëpunimi në terren ndërmjet Bashkim Europian dhe NATO-s

Pas sulmeve të 11 Shtatorit në SHBA, shtetet aleate të NATO-s vendosën të vënë në zbatim Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, klauzolën e mbrojtjes kolektive, nëse sulmet do të

³⁶⁷ *Agreement between the European Union and the Former Yugoslav Republic of Macedonia on the status and activities of the European Union Police Mission in the Former Yugoslav Republic of Macedonia (EUPOL Proxima).*

³⁶⁸ Në lidhje me këtë përfundim shiko Council of the European Union, *Joint Action 2005/826/CFSP "On the establishment of an EU Police Advisory Team (EUPAT) in the Former Yugoslav Republic of Macedonia (FYROM)"* (2005), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

rezultonin të ishin të programuara nga jashtë. Në përfundim të hetimit nga i cili rezultoi se sulmet terroriste ishin objekt i Nenit 5 dhe pas refuzimit të forcave talebane për dorëzimin e Osama Bin Laden, SHBA-ja dhe Aleatët nisën bombardimet ajrore ndaj objektivave të Al – Qaeda-s. Në vijim, më 14 Nëntor 2011 KS-ja i OKB-së nëpërmjet Rezolutës 1378 i hapi rrugë krijimit të një force shumëkombëshe paqeruajtëse, ndërsa nëpërmjet Rezolutës 1386 ai autorizoi mobilizimin e Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Afganistan (International Security Assistance Force, ISAF). Më 11 Gusht 2003, drejtimin e kësaj force, që deriatëherë vepronte nën komandën e OKB-së, e merr NATO³⁶⁹.

Ky mision bazohej në kërkesën e Qeverisë Islamike të Republikës së Afganistanit dhe në mandatin e KS-së së OKB-së, i cili autorizonte krijimin e një force shumëkombëshe për të asistuar qeverinë vendase në vendosjen dhe ruajtjen e sigurisë në Kabul dhe në zonat përreth, duke garantuar në të njëjtën kohë dhe sigurinë e personelit të OKB-së. Në Tetor të 2003 misioni u shtri në të gjithë Afganistanin. Duke analizuar rezultatet e miratuara, në lidhje me mandatin e KS-së së OKB-së mund të themi se, edhe pse forcat e misionit ISAF nuk ishin forca të OKB-së ato ishin një forcë ndërkombëtare e mandatuar nga kjo e fundit, sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB së, ndërsa drejtimi, koordinimi i veprimeve në terren dhe planifikimi i misionit ishte përgjegjësi e NATO-s³⁷⁰.

Objektivi i këtij misioni ishte të mbështeste qeverinë afgane në ruajtjen e sigurisë në vend dhe të asistonte atë në krijimin e një force të sigurisë, e cila do të garantonte që vendi të mos kthehej në një “parajsë” për grupet terroriste. Gjithashtu, ISAF kontribuoi në rindërtimin dhe zhvillimin e vendit dhe ofroi mbështetjen e tij për misionet humanitare që vepronin në vend, duke grantuar dhe sigurinë e tyre. Bazuar në aktet rregullatore ky mision zgjati deri më 2014, vit në të cilin përgjegjësia për sigurinë e vendit i kaloi forcave afgane, të cilave u kaloi dhe komanda e operacionit³⁷¹.

Në përfundim të tij misioni ISAF u pasua nga misioni mbështetës RSM (Resolute Support Mission), sipas vendimit të marrë në Samitin e NATO-s në Çikago. Ky mision që nisi më 1 Janar 2015 dhe drejtohej nga NATO nuk ishte i natyrës ushtarake, por ai synonte të ofronte mbështetjen e tij në trajnimin, këshillimin dhe asistimin në aktivitetet që kishin të bënin me sigurinë e funksionarëve të lartë në ministrinë e mbrojtjes, në ushtri dhe në polici. Vendosja e këtij misioni u realizua pas kërkesës së qeverisë afgane dhe përfundimit të Marrëveshjes për Statusin e Forcave ndërmjet NATO-s dhe autoriteteve afgane, në të cilën gjen rregullim statusi i

³⁶⁹ Ky mision u krijua në përputhje me angazhimet e marra në Konferencën e Bonit, në Dhjetor 2001. *Agreement on provisional arrangements in Afghanistan pending the re – establishment of permanent government institution*,

<http://www.un.org> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷⁰ <http://pom.peacebuild.ca/AfghanistanPeaceOperation.shtml> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷¹ NATO, *ISAF's mission in Afghanistan* (2015), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

misionit. Ky mision u mbështet gjithashtu edhe nga OKB-ja, nëpërmjet miratimit më 12 Dhjetor 2014 të Rezolutës 2189³⁷².

Me qëllim realizimin e objektivit primar të misionit ISAF, atë të krijimit të një Force Afgane të Sigurisë Kombëtare të aftë dhe profesionale, dhe adresimin në mënyrën e duhur të problemeve ishte e domosdoshme angazhimi i një force civile e cila do të mbështeste aktivitetet ushtarake të NATO-s në terren dhe që do të realizonte ndërthurjen e elementëve ushtarakë me ato civilë të misionit. Për këtë arsye, BE-ja nisi misionin e saj policor në Afganistan, EUPOL Afghanistan. Angazhimi i këtyre organizatave në Afganistan ishte pjesë e një plani ndërkombëtar i cili kishte si qëllim ndërtimin e shtetit të së drejtës, përmirësimin e sistemit të qeverisjes, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe transparente, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga autoritetet vendase³⁷³.

Misioni policor EUPOL Afghanistan, i cili nisi në 2007 në kuadër të PESM-së, si mision i natyrës civile kishte si qëllim të mbështeste reformat që qeveria afgane po ndërmerre për krijimin e një force policore të aftë dhe efektive, e cila do të mund të garantonte respektimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, pjesë e objektivave të tij ishte dhe ofrimi i mbështetjes për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave ligjzbatuese dhe atyre të drejtësisë penale. Realizimi i këtyre objektivave synonte të arrinte reformimin e Ministrisë së Brendshme, rritjen e profesionalizmit, të përgjegjshmërisë dhe të transparencës në polici dhe reformimin e sistemit të drejtësisë. Referuar dokumentave që rrëgullonin mandatin e këtij misioni rezultoi se ai do të ishte aktiv deri më 31 Dhjetor 2016³⁷⁴.

Në nenin 5a dhe 9 të Veprimit të Përbashkët 2007/369/CFSP parashikohej se drejtimi politik dhe operacional i misionit i përkiste BE-së, e cila e realizonte nëpërmjet KPS-së. Ndërsa në nenin 8 parashikohej se rregullat në lidhje me privilegjet dhe imunitetet që do të gëzonte stafi i misionit do të gjenin pasqyrim në një marrëveshje që palët do të nënshkruanin në përputhje me nenin 24 të Traktatit, e cila u arrit më 13 Shtator 2010, dhe do e shtrinte veprimin e saj edhe mbi personelin dhe asetet e shteteve të treta që merrnin pjesë në operacion³⁷⁵.

Konkretisht, në nenin 2 të saj parashikohej se forcat e drejtuara nga BE-ja kishin detyrimin të respektonin ligjet dhe rregulloret e shtetit pritës dhe duhet të tërhiqeshin nga çdo veprim i cili do të ishte në kundërshtim me objektivat dhe natyrën e misionit. Sipas nenit 5 të gjitha hapësirat ku ishte vendosur stafi i misionit, vendet ku ato qëndronin, arkivat dhe

³⁷² <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷³ Tokyo Conference on Afghanistan, *The Tokyo Declaration: Partnership for Self-Reliance in Afghanistan from Transition to Transformation* (2012), <http://www.mofa.go.jp/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷⁴ Council of the European Union, *Council Joint Action 2007/369/CFSP "On establishment of the European Union Police Mission in Afghanistan (EUPOL AFGHANISTAN)"* (30 Maj 2007), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷⁵ Council of the European Union, *Council Decision 2010/686/CFSP concerning the signing and conclusion of the Agreement between the European Union and the Islamic Republic of Afghanistan on the Status of the European Union Police Mission in Afghanistan (EUPOL AFGHANISTAN)* (13 Shtator 2010), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

dokumentat e tyre ishin të paprekshme dhe nuk mund të ishin objekt kontrolli. Asetet dhe pronat që i përkisnin misionit ishin të përjashtuara nga çdo proces gjyqësor dhe korespondenca e misionin gëzonte status të njëjtë me atë të një misioni diplomatik³⁷⁶.

Ndërsa në lidhje me statusin e personelit të misionit marrëveshja parashikonte se ato do të gëzonin të njëjtat privilegje dhe imunitete që u njiheshin dhe stafit të përfaqësive diplomatike (neni 6). Personeli vendas, i cili ishte i punësuar nga misioni, do të gëzonte vetëm ato privilegje të cilat i njiheshin nga shteti pritës (neni 7). Në lidhje me sigurinë, sipas dispozitave të marrëveshjes, personelit të misionit nuk i njihej e drejta për të mbajtur armë dhe municione, pasi siguria e tij do të garantohej nga autoritetet vendase (neni 9)³⁷⁷.

Përsa i përkiste përgjegjësisë për shpërblimin e dëmeve që mund të shkaktonin forcat e misionit ato ndaheshin në dy kategori. Ndaj pretendimeve për dëme të ardhura nga veprimeve të ndërmarra gjatë trazirave publike, nga veprime të ndërmarra për mbrojtjen e forcave të misionit ose nga kryerja e veprimeve të domosdoshme operationale, misioni EUPOL Afghanistan dhe personeli i tij nuk do të kishin asnjë lloj përgjegjësie. Pretendimet për dëme të ndryshme nga ato më lart, për dëmtime të shëndetit ose të shkakimit të vdekjes, në mungesë të një marrëveshje, do të shqyrtoheshin nga një komision i përbashkët me përfaqësues të misionin dhe të shtetit pritës (neni 16).

Në përfundim në lidhje me angazhimin e BE-së në Afganistan mund të themi se, më shumë sesa kontribuese në misionin ushtarak ISAF të NATO-s, ajo më tepër ka qenë e angazhuar me misionin policor EUPOL Afghanistan, i cili ishte i natyrës civile. Kontributi në trupa dhe pjesëmarrja në ndarjen e përgjegjësisë për Shtetet Anëtare ka qenë shumë më i ulët se ai i partnerëve të tjerë transatlantik³⁷⁸. Pra, ndërkohë që BE-ja ishte angazhuar në misionet paqeruajtëse dhe ato për rindërtimin e vendit, NATO ishte e angazhuar në misionet paqebërëse.

Angazhimi i BE-së në Afganistan, EUPOL Afghanistan, mund të konsiderohet larg së qënuri i suksesshëm dhe gjatë misionit u evidentuan një sëri mangësish si: pamjaftueshmëria në staf dhe në asete, mungesa e financimeve, mungesa e një strukture të qartë organizative dhe drejtuese e operacionit si dhe vështirësitë në koordinimin e veprimeve në terren me organizatat e tjera ndërkombëtare. Të gjitha këto elementë vënë në pikëpyetje besueshmërinë e BE-së si një aktor ndërkombëtar për menaxhimin e krizave³⁷⁹.

³⁷⁶ Po aty.

³⁷⁷ Council of the European Union, Council Decision 2010/686/CFSP concerning the signing and conclusion of the Agreement between the European Union and the Islamic Republic of Afghanistan on the Status of the European Union Police Mission in Afghanistan (EUPOL AFGHANISTAN) (13 Shtator 2010), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷⁸ NATO, *Resolute Support Mission in Afghanistan*, <http://www.rs.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁷⁹ M. Larive, "From speeches to actions: EU involvement in the war in Afghanistan through the EUPOL Afghanistan mission", *European Security*, Vol. 21, no. 2 (2012).

5.3 Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit European dhe NATO-s në Afrikë

a. Në mbështetje të Unionit Afrikan në Darfur

Kriza në rajonin e Darfurit është konsideruar si një nga krizat më të rënda humanitare në historinë e njerëzimit, e cila rezultoi në mijëra njerëz të vrarë dhe të dëbuar nga shtëpitë e tyre. Në kushtet kur natyra e problemeve të hasura në Sudan varionte që nga dëbimet në masë të popullsisë, katastrofat natyrore deri mungesën e ushqimeve dhe kequshqyerja, ishte e domosdoshme një ndërhyrje humanitare gjithëpërfshirëse. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes, e cila i dha fund luftës civile ndërmjet Sudanit të Veriut dhe atij Jugor, BE-ja ka qenë vazhdimisht e angazhuar në rajon duke asistuar palët në zbatimin e saj. Ndërsa, bashkëpunimi NATO dhe BE në këtë rajon shihet në mbështetjen që të dy këto organizata i kanë dhënë misionit të UA-së në Darfur.

Që nga momenti i fillimit të krizës, BE-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të paqes dhe të stabilitetit të vendit, ndihmë e cila kulmoi me nisjen më 18 Korrik 2005 të misionit në mbështetje të misionit të UA-së në Sudan, AMIS (African Union Mission in Sudan), i cili u transformua në AMIS II me rritjen e kapaciteteve dhe duke përfshirë dhe komponentin civil, atë policor. Qëllimi i këtij misioni ishte të garantonte një përgjigje efektive ndaj krizës në Darfur, duke mbështetur përpjekjet politike, ushtarake dhe policore të UA-së, të cilat i përkiste dhe përgjegjësia kryesore e misionit AMIS³⁸⁰. Në Prill të 2007 mandati i misionit mbështetës të BE-së u zgjerua duke përfshirë dhe mbështetjen ndaj misionit të UA-së në Somali dhe ai përfundoi më 31 Dhjetor 2007, kur u zëvendësua nga misioni i përbashkët OKB/UA, UNAMID³⁸¹³⁸².

Në lidhje me misionin mbështetës të ndërmarrë nga BE-ja në kuadër të PJSP-së, mund të themi se ai ishte i një natyre të përzier civile dhe ushtarake. Natyra ushtarake e tij konsistonte në faktin që BE-ja vendosi në dispozicion të UA-së pajisjet dhe asetet e saj ushtarake, ndihmoi në planifikimin operacional të misionit dhe angazhoi në terren vëzhguesit e saj ushtarakë. Ndërsa natyra civile e këtij operacioni shikohet në veprime si trajnimi i forcave afrikane, ndihma që BE-ja dha për transportin strategjik të trupave dhe të pajisjeve dhe në ndihmën e dhënë për trajnimin e policinë vendase. Në fund të mandatit në kompetencat e misionit mbështetës u përfshi dhe ajo e ndërmjetësimit të negociatave për dhënien fund të konfliktit. Ndërthurja e elementëve ushtarakë dhe civilë vihet re edhe në faktin që ndonëse drejtimi strategjik dhe kontrolli politik i operacionit mbështetës i përkiste KPS-së, ky i fundit në

³⁸⁰ Council of the European Union, *Joint Action 2005/557/CFSP "On the European Union civilian-military supporting action to the African Union mission in the Darfur region of Sudan"* (2005), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁸¹ <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁸² The Council of European Union, *Joint Action 2007/245/CFSP amending Joint Action 2005/557/CFSP on the European Union civilian-military supporting action to the African Union mission in the Darfur region of Sudan with regard to the inclusion of a military support element providing assistance to the setting up of the African Union Mission in Somalia (AMISOM)* (Prill 2007), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

punën e tij dhe në fushat përkatëse këshillohej nga Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave dhe nga Komiteti Ushtarak i BE-së, ku ky i fundit asistojë nga Shtabi Ushtarak³⁸³.

Sikurse u tha më lart, misioni mbështetës i BE-së bazohej në kërkesën për mbështetje të bërë nga misioni i UA-së në Darfur, kërkesë e cila ishte në përputhje me Rezolutat e KS-së të miratuara nga OKB-ja me anët të cilave kjo e fundit kërcënonte me vendosjen e sanksioneve ndaj Sudanit nëse ai nuk do të respektonte angazhimet e tij ndaj Darfur – it. Gjithashtu, misioni mbështetës i BE-së në Darfur u mbështet dhe nga OKB-ja, e cila më 30 Korrik 2004 miratoi Rezolutën 1556³⁸⁴.

Në lidhje me statusin e forcave të misionit mund të themi se ai gjen rregullim në dispozitat e Marrëveshjes për Statusin e Misionit dhe në ato të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Organizatës së Unitetit Afrikan. Sipas këtyre akteve Përfaqësuesi i Lartë i BE-së kishte përgjegjësinë të garantonte zbatimin e detyrime ligjore nga Shtetet Afrikane në territorin e të cilave ishin vendosur apo do të vendosej personeli i misionit të BE-së³⁸⁵. Ashtu sikurse Marrëveshjet për Statusin e Misionit të përfunduara për misionin ARTEMIS dhe ALTHEA, edhe kjo marrëveshje përmbante disa elementë të veçantë, ku rëndësi paraqet detyrimi i forcave të misionit për të respektuar të drejtën humanitare ndërkombëtare.

Në lidhje me pjesëmarrjen e shteteve të treta në operacion, ndonëse Veprimi i Përbashkët 2005/557/CFSP nuk parashikonte ndonjë rregullim të posaçëm, ai theksonte rëndësisë që ka për ecurinë e misionit bashkëpunimi me organizata të tjera si OKB dhe NATO, ku angazhimi i kësaj të fundit në Darfur daton që nga viti 2005, pas kërkesës për mbështetje të UA-së për misionin paqeruajtës AMIS, i cili kishte për qëllim t'i jepte fund akteve të dhunës në rajon dhe të përmirësonte situatën humanitare. Ndërsa, misioni i NATO-s, i cili zgjati për periudhën Qershor 2005 deri më Dhjetor 2007, kishte si qëllim të mbështeste UA-në në zgjerimin e misionit të tij AMIS në Darfur, nëpërmjet ofrimit të ndihmës në transportin ajror të trupave paqeruajtëse nëpër rajon. Misioni mbështetës i NATO-s nuk përfshinte ndihmën në forca luftuese.

Gjatë periudhës që zgjati misioni, NATO dhe BE, në koordinim me njëra tjetrën siguruan transportin e rreth 37 500 forcave paqeruajtëse, policë dhe vëzhgues ushtarakë nëpër të gjithë rajonin e Sudanit. Edhe pse menaxhimi i operacionit realizohej nga NATO, një strukturë e posaçme për menaxhimin e transportit ajror ndodhej në bazat e UA-së në Adis Ababa, e cila kishte përgjegjësinë për koordinimin e trupave dhe të personelit që transportohej në terren³⁸⁶. Pra, përgjegjësia për ecurinë e misionit AMIS i përkiste UA-së, ndërsa NATO dhe BE-ja kontribuonin në transportin ajror të trupave paqeruajtëse.

Gjatë kohës që zgjati operacioni i UA-së AMIS mbështetja e NATO-s ishte dhe në logjistikë dhe në trajnimin e strukturave të misionit, ku ajo u përqëndrua në përmirësimin e teknologjisë dhe të teknikave për analizimin, kuptimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për krizën në

³⁸³ Neni 4 i Council Joint Action 2005/557/CFSP.

³⁸⁴ <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁸⁵ Council Joint Action 2005/557/CFSP, pragrafin e 15-të të.

³⁸⁶ NATO, *Assistance to the African Union*, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

Darfur dhe në identifikimin e zonave në të cilat përdorimi i aseteve të UA-së do të rezultonte më efektiv dhe do të frenonte përhapjen më tej të konfliktit. Procesi i trajnimit të personelit operativ u realizua në bashkëpunim me BE-në³⁸⁷.

Nisur nga problematikat e hasura në terren, mund të themi se BE-ja i referohej OKB-së në rast të marrjes së një vendimi për të ndërhyrë ushtarakisht në rajon, pavarësisht se të dyja këto organizata nuk e konsideronin situatën të krijuar në Darfur si genocid, në dallim nga SHBA-ja. Gjithashtu, sukcesi i misionit të BE-së u minua nga qëndrimi armiqësor që mbajti administrata sudaneze ndaj saj dhe nga mungesa e një politike të jashtme të strukturuar dhe të qartë, pasi përparësi kishte bashkëpunimi dypalësh me Shtetet Anëtare, të cilat jo rradhë herë refuzonin mbështetjen financiare ndaj misionit dhe nuk dëshironin një angazhim afatgjatë në rajon, por një mision ndërlidhës që të paraprinte ndërhyrjen e OKB-së. Financimi i misionit mbështetës në Darfur nga Instrumenti për Stabilitet dhe Instrumenti European për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut, si mekanizma të reagimit të menjëhershëm, dhe jo nga buxheti i BE-së nuk ishte i mjaftueshëm për të mbuluar të gamën e gjerë të problematikës së shfaqur në terren. Në përfundim mund të themi se sukcesi i misionit varet nga hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse ku të ndërthuren masa në drejtim të sigurisë, ekonomisë dhe tregtisë dhe jo të zëvendësohen vetëm nga ndërhyrje të natyrës politike.

b. Lufta kundër piraterisë

Sukcesi i përpjekjeve për rivendosjen e paqes dhe të sigurisë në Afrikë dhe siguria e një prej rrugëve më të rëndësishme tregtare, përgjatë Kanalit të Suezit, kërcënohej nga sulmet e vazhdueshme të anijeve pirate përgjatë bregdetit Somalez dhe pjesës perëndimore të Oqeanit Indian. Për këtë arsye, me qëllim ndërprerjen e sulmeve pirate dhe rritjen e sigurisë në rajon, që nga viti 2008 NATO dhe BE bashkëpunojnë sëbashku me organizata të tjera ndërkombëtare në misione kundër piraterisë në brigjet e Somalisë.

Në mbështetje të operacioneve humanitare të OKB-së dhe pas kërkesës së kësaj të fundit nëpërmjet rezolutës 1816, e cila e konsideroi piraterinë si një kërcënim për paqen dhe sigurinë botërore, NATO ka ndërmarrë një serë operacione të natyrës ushtarake përgjatë bregdetit Somalez dhe pjesën perëndimore të Oqeanit Indian. Me qëllim garantimin e sigurisë së rrugëve detare të tregtisë në periudhën Mars – Gusht 2009 NATO ndërmori operacionin Allied Protector, i cili kishte si objekt mbrojtjen ndaj sulmeve pirate dhe ndërprerjen e tyre ndaj anijeve tregtare përgjatë Gjirit të Aden-it dhe gadishullit të Somalisë. Forcat e NATO-s kishin funksione vëzhguese dhe mbrojtëse në rastet kur do të ishte e domosdoshme³⁸⁸. Përgjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2008, në mbështetje të Rezolutave 1814, 1816 dhe 1838 të KS të OKB-së, NATO ndërmori misionin Allied Provider, i cili nëpërmjet patrullimeve në zonë ishte përgjegjës për të garantuar sigurinë e mjeteve lundruese të OKB-së që transportonin ndihma dhe të mjeteve të tjera përgjatë bregdetit Somalez³⁸⁹.

³⁸⁷ NATO, *Assisting African Union in Darfur, Sudan*, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁸⁸ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 27 Prill 2018).

³⁸⁹ Po aty.

Prania e NATO-s përgjatë bregdetit ndihmoi në parandalimin e sulmeve pirate dhe ato plaçkitëse që përbënin rrezik për rajonin dhe për anijet tregtare që kalonin në zonë. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe Rregullat e Angazhimit, në rast sulmi anijet që patrullonin përgjatë bregdetit ishin të autorizuara të përdornin dhe forcën.

Në kuadër të angazhimit të saj në luftën kundër piraterisë dhe në pajtim me Rezolutën 2020 të KS, NATO nis operacionin Ocean Shield. Ky operacion fillimisht u përqëndrua në aktivitet që zhvilloheshin në det ku nëpërmjet vëzhgimeve forcat e NATO-s kishin si synim primar identifikimin e anijeve pirate dhe parandalimin e rrëmbimit dhe të plaçkitjes të anijeve tregtare që lundronin në zonat e kontrolluara. Pjesë e këtij misioni ishte dhe garantimi i një lundrimi të sigurtë për anijet me ndihma humanitare të OKB-së deri në portin e Mogadishut, në Somali. Pas identifikimit të anijeve pirate synimi i misionit ishte shkatërrimi i tyre dhe i logjistikës mbështetëse nëpërmjet marrjes së çfarëdolloj mase të nevojshme, përfshirë edhe përdorimin e forcës. Ndërsa për shtetet e rajonit të përfshira në luftën kundër piraterisë, misioni Ocean Shield ofroi programe trajnuese dhe pajisjen me mjetet dhe kapacitetet e nevojshme me qëllim krijimin e aftësive të pavarura për të luftuar piraterinë. Nisur nga rëndësia që ka për rajonin dhe për ekonominë botërore në përgjithësi, siguria e lundrimit përgjatë bregdetit të Somalisë dhe në Oqeanin Indian, NATO do të mbetet e angazhuar në rajon deri në fund të 2016³⁹⁰. Megjithëse NATO nuk do të ndërmarrë më drejtpërdrejtë misione kundër piraterisë ajo do të vazhdojë të jetë e angazhuar në rajon dhe në mesdhe në kuadër të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Për shkak se pirateria paraqet një shkallë të lartë rrezikshmërie dhe kompleksiteti, duke u krahasuar me krimin e organizuar, është e nevojshme që masat ushtarake të ndërthuren me ato ligjore, politike dhe diplomatike, të cilat ishin në dispozicion të BE-së, e cila së bashku me ndihmën e dhënë nga aktorët e tjerë ndërkombëtarë synon jo vetëm të luftojnë pasojat e fenomenit por t'a godasin atë që në themel, duke luftuar shkaqet e tij. Angazhimi i BE-së në rajonin e Afrikës Lindore (Somali, Kenia, Eritre dhe Xhibut) është kushtëzuar nga rëndësia gjeo strategjike që paraqet rajoni, nga angazhimi i vazhdueshëm i saj në situatat e konfliktit dhe të krizës që kanë shpërthyer në rajon, nga dëshira e Bashkimit për të ndihmuar rritjen ekonomike të rajonit dhe nga domosdoshmëria për të mbrojtur qytetarët dhe për të garantuar sigurinë e kufinjve të tij.

Për këtë qëllim më 14 Nëntor të 2011 Këshilli i Ministrave adoptoi një plan veprimi për rajonin, i cili do të shërbente si guidë e angazhimit multisektorial të Bashkimit në rajon. Në këtë dokument përcaktohet se në bashkëpunim me Unionin Afrikan, Bashkimi nëpërmjet angazhimit të tij në rajon synon të realizojë këto prioritetet: *së pari*, të kontribuojë në ndërtimin e strukturave politike të qëndrueshme dhe të përgjegjshme; *së dyti*, të kontribuojë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve të lindura; *së treti*, miminimizimin e rreziqeve që mund t'i kanosen sigurisë së Bashkimit nga rajoni; *së katërti*, të promovojë rritjen ekonomike të rajonit dhe *së pesti*, të mbështesë bashkëpunimin ekonomik ndërmjet shteteve të rajonit³⁹¹.

³⁹⁰ NATO, *Counter Piracy Operations*, <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹¹ <http://europa.eu/rapid/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

Për shkak të rëndësisë gjeo strategjike që paraqet për interesat e BE-së stabiliteti dhe siguria në Gadishullin e Somalisë dhe në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian, në 2008 ajo nisi operacionin ATALANTA (EU NAVFOR Somalia), i cili ishte i natyrës ushtarake dhe zhvillohej në pajtim me Rezolutat e miratuara nga KS-së në lidhje me piraterinë³⁹².

Në zbatim të Veprimit të Përbashkët dhe të Rezolutave të KS-së, mandati i operacionit ATALANTA ishte: *së pari*, të garantonte mbrojtje për mjetet e lundrimit të programit humanitar të OKB-së (World Food Programme), të misionit të UA-së dhe të çdo mjeti tjetër që mund të ishte objekt i sulmeve pirate; *së dyti*, të shkatërronte, të frenonte dhe të ndërpriste çdo akt piraterie dhe plaçkitje të armatosur në det; *së treti*, të monitoronte veprimtarinë e peshkimit përgjatë brigjeve të bregdetit somalez; *së katërti*, të mbështeste misionet e tjera të BE-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare që vepronin për të forcuar sigurinë detare në veçanti dhe atë të rajonit në tërësi; dhe *së pesti*, të garantonte rast pas rasti mbrojtjen e anijeve të cilat lundronin në brigjet somaleze dhe që mund të ishin objekt i ndonjë sulmi³⁹³. Fillimisht ky mandat u programua të ushtrohej deri më 2014, por u shty deri në Dhjetor të 2016³⁹⁴.

Në kuadër të luftës kundër piraterisë rëndësi merr dhe procedimi penal i personave të përfshirë në këto aktivitete. Për këtë arsye misioni i BE-së asiston dhe Programin për Zhvillim të OKB-së (United Nations Development Programme - UNDP) dhe Zyrën për Krimet dhe Narkotikët e OKB-së (United Nations Office for Drugs and Crime – UNODOC) me qëllim sigurimin e kushteve të përshtashme për të garantuar një proces gjyqësor të drejtë dhe eficient personave të akuzuar për pirateri në Somali, ndërkohë që anijet e misionit shërbejnë për transportin e personave të dyshuar në vendet ndaj të cilave janë kostatuar aktet e piraterisë me qëllim gjykimin e tyre, në zbatim të marrëveshjeve të nëshkruara nga Bashkimi.

Për shkak se një rol të rëndësishëm në luftën kundër piraterisë merr edhe kordinimi dhe shkëmbimi i rezultatit të hetimeve, misioni ATALANTA dërgon në zyrat e Interpolit informacionin e nevojshëm për të gjitha aktet e piraterisë që evidentohen në brigjet e Gadishullit të Somalisë, i cili në bashkëpunim me Europol analizojnë këto të dhëna me qëllim hartimin e strategjive për të luftuar piraterinë. Në këtë drejtim BE-ja mbështet bashkëpunimin ndërmjet organeve të hetimit të shteteve që çënohen nga kjo veprimtari, duke grumbulluar çdo provë për procedimin e financuesve, të organizatorëve dhe të negociatorëve³⁹⁵.

Misioni ATALANTA është pjesë e një tërësie veprimesh që BE-ja ka ndërmarrë në Gadishullin e Somalisë, me qëllim evidentimin e shkaqeve të cilat çënojnë paqen dhe sigurinë në rajon dhe reduktimin e pasojave që vijnë nga këto veprime kriminale. Në kuadër të një strategjie gjithëpërfshirëse me qëllim krijimin e kapaciteteve të nevojshme të vendeve të rajonit për të

³⁹² UN, *United Nations Documents on Piracy* (2012), <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹³ <http://www.eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹⁴ Council of the European Union, *Decision 2014/827/CFSP Amending Joint Action 2008/851/CFSP on a European Union military operation to contribute to the deterrence, prevention and repression of acts of piracy and armed robbery off the Somali coast* (2014), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹⁵ <http://www.eeas.europa.eu/> (hyrë më 14.12.2015).

luftuar piraterinë dhe për të garantuar sigurinë në det BE-ja është angazhuar dhe në misionin EUCAP Nestor dhe në misionin trajnues EUTM Somalia. Misioni EUCAP Nestor, i nisur më 16 Korrik 2012, është një mision civil në kuadër të PJSP, i cili ka si qëllim forcimin e kapaciteteve në fushën detare, përfshirë dhe luftën kundër piraterisë dhe krimeve të tjera të ndodhura në fushën detare, të shteteve të Gadishullit të Somalisë dhe ato të ndodhura në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian³⁹⁶.

Dy objektivat kryesore të këtij misioni janë: *së pari*, të ndihmojë në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve ekzistuese detare të Xhibutit, Kenia-s dhe Tanzanisës, dhe *së dyti*, nëpërmjet këshillimit ligjor dhe operacional, trajnimit të rojeve detare dhe pajisjes me pajisjet e nevojshme të ndihmojë në forcimin e shtetit të së drejtës, fillimisht në rajonin e Somalisë, duke mbështetur Policinë Detare. Ndërsa misioni EUTM Somalia, i nisur më 10 Prill 2010, është një mision i natyrës ushtarake me karakter trajnues, i cili ka si qëllim forcimin e Qeverisë së Përkohshme dhe institucioneve të tjera në Somali, të cilat do të kontribuonin në stabilizimin e vendit³⁹⁷.

Përveç këtyre misioneve Bashkimi European është i angazhuar në rajon dhe nëpërmjet:

a.) Programit për Interneraret Detare Kryesore, i cili është themeluar në kuadër të Instrumentit për Stabilitet dhe është i fokusuar në garantimin e sigurisë së internerareve kryesore detare që mund të rrezikohen nga sulmet pirate, me qëllim sigurimin e anijeve të lundrimit dhe të tregtisë. Në mbështetje të këtij programi Bashkimi ka miratuar dhe një projekt prej 6 milion euro, MARSIC, në drejtim të forcimit të shkëmbimit të informacionit, të trajnimit të strukturave përgjegjëse dhe të zbatimit Kodit të Sjelljes së Xhibutit në drejtim të luftës kundër piraterisë dhe të plaçkitjes së anijeve të lundrimit. Gjithashtu ky projekt është fokusuar dhe në krijimin e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit administrativ dhe të rojeve detare me qëllim kontrollin dhe garantimin e sigurisë përgjatë brigjeve detare³⁹⁸.

b.) Programit Rajonal për Sigurinë Detare, i cili vepron në kuadër të Fondit European për Zhvillim dhe ka si qëllim të mbështesë zbatimin e Strategjisë Rajonale për Afrikën Lindore dhe Jugore, miratuar në tetor 2010 për të luftuar piraterinë dhe për nxitur forcimin e sigurisë së rajonit nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve. Në këtë drejtim BE-ja mbështet zhvillimin e një planveprimi për të luftuar piraterinë, forcimin e instrumentave ligjore për arrestimin, transferimin, procedimin dhe vuajtjen e dënimit të personave të akuzuar për pirateri, mbulimin e dëmeve ekonomike dhe humbjet që shkakton pirateria dhe forcimin e kapaciteteve të autoriteteve vendase, sidomos në drejtim të mbikëqyrjes dhe të veprimeve të tjera të ndërmarra nga rojet bregdetare³⁹⁹.

³⁹⁶ Council of the European Union, *Decision 2012/389/CFSP*, "On the European Union Mission on Regional Maritime Capacity Building in the Horn of Africa (EUCAP NESTOR) (2012), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹⁷ Council of the European Union, *Decision 2010/96/CFSP on a European Union military mission to contribute to the training of Somali security forces* (2010), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

³⁹⁸ <https://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 14 Prill 2016).

³⁹⁹ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

c.) Zhvillimi i projekteve pilot në lidhje me piraterinë dhe ndërgjegjësimin e autoriteteve vendase, i cili është i një natyre studimore dhe shkencore. Këto projekte analizojnë mundësinë e përdorimit të burimeve njërezore dhe të teknologjisë, si për shembull satelitët, të cilët të vlerësojnë në kohë reale trafikun detar dhe rreziqet që mund t'i kanoseve anijeve civile dhe tregtare⁴⁰⁰.

d.) Lufta kundër peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në Oqeanin Indian, të cilat edhe pse jo të lidhura drejtpërdrejt kanë efekt pozitiv në përmirësimin e sigurisë në det. Në këtë drejtim BE-ja mbështet politikat rajonale të peshkimit, duke kontrolluar dhe zbatimin e tyre. Për këtë arsye nga viti 2007 deri në 2011 Komisioni Europian ka financuar dhe Programin Rajonal për Peshkimin në Jugperëndim të Oqeanit Indian, i cili synon të reduktojë numrin e mjeteve që peshkojnë në mënyrë ilegale dhe të kontrollojë administrimin e burimeve të peshkut ton⁴⁰¹.

Në përfundim mund të themi se, angazhimi i NATO-s dhe BE-së në Gadishullin e Somalisë dhe në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian paraqet rëndësi të veçantë për marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy organizatave. Edhe pse operacioni ATALANTA i BE-së dhe Ocean Shield i NATO-s janë aktivë në të njëjtin territor dhe kanë mandat të ngjashëm ndërmjet tyre ato nuk ka asnjë plan të përbashkët për veprim apo ndarje të zonave të veprimit. Operacioni ATALANTA është nën drejtimin politik dhe strategjik të BE-së dhe nuk zhvillohet në kuadër të Marrëveshjes së Berlin Plus, ndërsa NATO ka qenë e angazhuar në rajon atëhere kur asnjë organizatë tjetër nuk ishte e gatshme. Por megjithatë këto organizata kanë arritur të zhvillojnë një *modus operandi*, i cili i mundëson një koordinim mjaft të mirë të veprimeve në terren, pavarësisht mungesës së vullnetit politik. Këto operacione janë plotësues të njëri tjetrit dhe mekanizmat që NATO disponon i mundësojnë asaj të reagojë me efektivitet ndaj çfarëdolloj situatë krize të hasur në brigjet detare të Somalisë, në Gjirin e Adenit dhe në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian.

Gjithashtu, angazhimi i NATO-s në rajon nxorri në pah dhe rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin privat, pasi gjatë zhvillimit të operacioneve ajo bashkëpunoi me aktorët që ishin aktivë në industrinë detare duke i informuar për format e reja të piraterisë dhe për pasojat shkatërruese që ajo kishte në ekonomi dhe industri. Mësimet e nxjerra nga operacionet e NATO-s, sidomos operacioni Ocean Shields, shkojnë përtej atyre operacione thjesht të natyrës detare porse janë tregues i mënyrës sesi duhet të ndërtohet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë jo vetëm elementin ushtarak por edhe atë civil.

⁴⁰⁰ Po aty.

⁴⁰¹ <https://stopillegalfishing.com/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).

KAPITULLI VI

BASHKËPUNIMI I BASHKIMIT EUROPIAN ME ORGANIZATA TË TJERA NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

6.1 Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara

“...Bashkimi European, është ndërtuar mbi të njëjtat vlera, mbi të njëjtin vizion për një rend botëror bashkëpunues, të cilat shërbyen si baza të themelimit të OKB-së, shtatëdhjetë vite më parë. Në këto shtatëdhjetë vite, rreziqet që i kanosen paqes kanë evoluar vazhdimisht. Po ashtu duhet të evoluojmë dhe ne...”⁴⁰²

Një nga objektivat e BE-së, e parashikuar në Strategjinë Europiane të Sigurisë ishte dhe ndërtimi i një bashkëpunimi efektiv shumëpalësh, i cili do të ndihmonte në ndërtimin e një shoqërie demokratike, do të garantonte mirëfunksionimin e institucioneve ndërkombëtare dhe ndërtimin e një rendi ndërkombëtar të bazuar mbi rregulla. Realizimi i një objektiv të tillë, që është një tregues i qartë i dëshirës dhe ambicies së BE-së për të qenë një aktor kyç në arenën ndërkombëtare, shtron nevojën e bashkëpunimit të saj me organizata të tjera ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim merr bashkëpunimi me OKB-në.

Fillimisht, bashkëpunimi ndërmjet këtyre organizatave rajonale dhe globale realizohej ndërmjet Shteteve Anëtare pjesëmarrëse në to duke i lënë pak ose aspak hapësirë bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet tyre. Për këtë arsye, edhe në Kartën e OKB-së këto marrëdhënie nuk kanë gjetur një rregullim të shprehur, përveç disa përjashtimeve në fushën e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, ku këto agjenci apo bashkime rajonale ngarkohen me zbatimin e vendimeve të marra nga KS-ja në këtë fushë dhe në atë të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke vepruar në përputhje me qëllimet dhe parimet e sanksionuara në Kartë. Sipas Kartës veprimet e këtyre organizatave shtriheshin deri në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve dhe ato mund të vepronin vetëm pasi të ishin të pajisura me autorizimin e KS, ku ky i fundit mund t'i drejtohej atyre për të ndërhyrë ushtarakisht në zgjidhjen e konflikteve.

Marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe OKB-së në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes datojnë që në vitet 1950, vit në të cilin BE-ja deklaroi angazhimin e saj për të garantuar zbatimin e Kartës së OKB-së, duke ofruar mbështetje ndaj misioneve paqeruajtëse të ndërmarra nga OKB-ja dhe duke e njohur këtë të fundit me të drejtën për të ndërhyrë ushtarakisht në rast konflikti të armatosur⁴⁰³. Në vijim, zhvillimet në fushën e politikës europiane të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe angazhimet e përbashkëta të këtyre organizatave në zonat e

⁴⁰² Fjalimi i Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, Frederica Mogherini, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në 09 Mars 2015.

⁴⁰³ European Parliament, *Presidency Conclusions* (Kanë, 26 – 27 Qershor 1995), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

konfliktit në Bosnje, Kosovë dhe në Timorin Lindor ndikuan në forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Në këtë drejtim vlen për t'u përmendur dhe fjalimi i mbajtur nga përfaqësuesi i BE-së në mbledhjen e 55-të të Asamblesë së Përgjithshme, i cili i dha një shtysë të mëtejshme bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të përbashkët të krizave, ndërsa hapa konkretë u ndërmorën në mbledhjen Këshillit Europian në Nicë⁴⁰⁴, i cili u pasua me mbledhjen e Këshillit të Punëve të Përgjithshme më 11 Qershor 2001 dhe të Këshillit Europian në Gutenberg. Në këto takime u theksua rëndësia që ka partneriteti BE-OKB në fushën e parandalimit të konflikteve dhe vlera e shtuar e përfshirjes së kapaciteteve ushtarake dhe civile të BE-së në operacionet për menaxhimin e krizave të ndërmarrë nga OKB-ja, ku kjo e fundit do të kishte përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë. Nga analiza në tërësi e konkluzioneve të arritura në këto mbledhje rezulton se bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe OKB-së do të përfshinte këto fusha:

- **Parandalimin e konflikteve:** Në këtë drejtim rëndësi të veçantë merr forcimi i bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve dhe analizave në lidhje me krizat aktuale dhe ato të mundshme, zbulimi i të dhënave, koordinimi i aktivitetit diplomatik dhe i mesazheve të dhëna, koordinimi i veprimeve taktike, trajnimi i përbashkët dhe rritja e bashkëpunimit në fushën e monitorimit të zgjedhjeve dhe në asistencën parazgjedhore.
- **Aspektet ushtarake dhe civile të menaxhimit të krizave:** Garantimi i pjesëmarrjes së kapaciteteve ushtarake dhe civile të BE-së në operacionet e OKB-së do të përbënte një vlerë të shtuar për operacionet e OKB-së pasi, do të ndikonte në përmirësimin e standarteve në operacionet për menaxhimin e krizave civile, në lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, në programimin dhe zbatimin e programeve për menaxhimin e krizave dhe në koordinimin e veprimeve në terren.
- **Konfliktet rajonale** si në Ballkanin Perëndimor, Lindjen e Mesme dhe në Afrikë, të cilat do të vazhdojnë të jenë rajonet që do të kenë prioritet në këtë bashkëpunim. Në terren ky bashkëpunim u pasqyrua me ndërhyrjen e BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, ku Misioni Policor i BE-së (EU Police Mission) zëvendësoi misionin e OKB-së aty (UN Mission i Bosnia Herzegovina UNMIBH) dhe Task Forcën e Policisë Ndërkombëtare. Po këtë vit BE-ja veprroi në mbështetje të operacionit të OKB-së në RDK, ku operacioni Artemis shënoi angazhimin e parë ushtarak të shpejtë të BE-së në mbështetje të OKB-së.

Në funksion të ndërtimit të një bashkëpunimi sa më të qëndrueshëm midis BE-së dhe OKB së në fushën e menaxhimit të krizave, ishte e nevojshme arritja e një marrëveshje formale ku të përcaktoheshin modalitetet e bashkëpunimit në praktikë. Fillimisht, kjo ide gjeti vend në komunikatën e Komisionit dhe Parlamentit Europian më 10 Shtator 2003, në të cilën parashtruheshin dhe tre objektiva kryesore: (i). Rritja e aftësisë së Bashkimit për të ndërmarrë iniciativa dhe për të zbatuar vendimet e përbashkëta, e cila mund të realizohej vetëm nëse ai do të kishte kapacitetet e nevojshme ushtarake dhe civile; (ii). Bashkëpunimi sistematik midis dy

⁴⁰⁴ European Parliament, *Conclusions of the Presidency* (Nicë, 07 – 10 Dhjetor 2000), pg. 12 <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

organizatave sidomos në fushën e parandalimit të konflikteve dhe të menaxhimit të krizave; dhe (iii). Përmirësimi i pozicionit të BE-së në OKB, e cila nënkuptonte të drejtën për të paraqitur rekomandime, të drejtën për të replikuar etj⁴⁰⁵.

Kjo komunikatë u pasua me miratimin e Deklaratës së Përbashkët BE – OKB “Mbi Menaxhimin e Krizës”, më datë 24 Shtator 2003, ku palët me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe ndërtimin e mekanizmave të besueshëm dhe të qëdrueshëm civilë dhe ushtarakë për menaxhimin e krizave, ranë dakort⁴⁰⁶:

- **Së pari**, në parim, përgjegjësia kryesore për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë i përkiste KS-së së OKB-së, i cili vepron në përputhje me Kartën e OKB-së, ndërsa BE-ja do të vijonte angazhimin e saj për të kontribuar në realizimin e objektivave të OKB-së në menaxhimin e krizave.
- **Së dyti**, për ndikimin pozitiv që ka pasur bashkëpunimi ndërmjet tyre në operacionet për menaxhimin e krizave dhe konkretisht: Misioni Policor i BE-së në Bosnje Hercegovinë, i cili mori përgjegjësitë që më parë i përkisnin Task Forcës Policore të OKB-së; Operacioni Ushtarak i BE-së në RDK, ku forcat e BE-së u mobilizuan menjëherë pas kërkesës së KS-së, duke zëvendësuar misionin Artemis dhe studimi nga e BE-ja i mundësive dhe mënyrave për të ndihmuar në krijimin e një Njësie Policore të Integruar në Kinshasa, e cila do të mund të vepronte si forcë siguruese për qeverinë dhe institucionet e përkohshme.
- **Së treti**, për krijimin e një mekanizmi të përbashkët këshillimor, i cili do të merrte në analizë mënyrat dhe mjetet për të garantuar koordinim dhe pajtueshmërinë e veprimeve të këtyre organizatave. Fushat e veprimit të këtij mekanizmi ishin:
 - a.) *Planifikimi*, i cili nënkuptonte bashkëpunim ndërmjet njësive të planifikimit të misioneve dhe asistencën e ndërsjelltë të tyre në alokimin e burimeve logjistike si dhe në përdorimin e përbashkët të pajisjeve.
 - b.) *Trajnimi*, nëpërmjet krijimit të standardeve dhe procedurave të përbashkëta për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil; sinkronizimin e programeve të trajnimit për policinë civile, për oficerët dhe vëzhguesit ushtarakë dhe zhvillimin e konferencave, seminareve dhe ushtrimeve të përbashkëta.
 - c.) *Komunikimi* për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qendrave të studimit të situatës dhe krijimit të grupeve të dialogut.
 - d.) *Praktikat më të mira*, nëpërmjet krijimit të një sistemi të organizuar për shkëmbimin e eksperiencave të fituara dhe mësimave të nxjerra nga operacionet e mëparshme, duke përfshirë edhe misionet e transferuara.

Hapi tjetër në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe OKB-së u ndërmor në mbledhjen e Këshillit të Punëve të Përgjithshme dhe të Marrëdhënieve me Jashtë, ku

⁴⁰⁵ *The European Union and the United Nations: The choice of multilateralism* (10 Shtator 2003), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁰⁶ Deklarata e Përbashkët mbi Bashkëpunimin BE - OKB për Menaxhimin e Krizës, <http://eu-un.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 13 Shtator 2015).

ndër të tjera BE-ja shprehu qëndrimin e saj pozitiv në lidhje me forcimin e marrëdhënieve me OKB-në dhe organizatat e tjera rajonale ose ndërkombëtare, kjo në pajtim me Kapitullin e VIII të Kartës së OKB-së. Gjithashtu, ajo konfirmoi angazhimin e saj për vënien në zbatim të reformave për të cilat palët do të binin dakort dhe gadishmërinë për të zgjeruar më tej diskutimet dhe bashkëpunimin me OKB-në nëpërmjet arritjes së një marrëveshje formale⁴⁰⁷. Nga ana tjetër, OKB-ja, nevojën për forcimin e bashkëpunimit me organizata të tjera rajonale ose ndërkombëtare e pasqyroj në Rezolutën 1631 të KS-së, të 17 Tetor 2005. Këto përpjekje u finalizuan më 07 Qershor 2007, ku BE-ja dhe OKB-ja dolën me një Qëndrim të Përbashkët mbi Bashkëpunimin BE – OKB në Menaxhimin e Krizave⁴⁰⁸.

Nga pikëpamja operationale, në këtë periudhë, rëndësi merr misioni ushtarak në Çad dhe në Afrikën Verilindore dhe Qëndrore i quajtur EUFOR Tchad/RCA, që BE-ja ndërmori në kuadër të politikës së saj të mbrojtjes dhe të sigurisë, në përputhje me rezolutën 1778 të KS-së së OKB-së. Qëllimi i këtij misioni ishte: *i*). Mbrojtja e popullsisë civile dhe garantimi i zhvendosjes së saj; *ii*). Lehtësimi i shpërndarjes së ndihmave humanitare dhe garantimi i lëvizjes së lirë të personelit humanitar nëpërmjet rritjes së sigurisë në zonat e operacioneve; dhe *iii*). Mbrojtjen e personelit të OKB-së. Ky mision u zëvendësua me misionin MINURCAT të OKB-së, ku forcat e kësaj të fundit morën vendin e atyre të BE-së⁴⁰⁹.

Pozitat e BE-së në OKB-së, dhe konkretisht në Asamblenë e Përgjithshme, do të forcoheshin më tej me miratimin e rezolutës 65/276, e cila nga njëra anë solli ndryshime të rëndësishme në statusin e vëzhguesit të BE-së dhe nga ana tjetër ndikoi në rritjen e potencialit të BE-së për të mbështetur nismat e OKB-së në një mënyrë më efektive. Disa nga “të drejtat dhe privilegjet” që kjo rezolutë i njohu BE-së ishin: *së pari*, të drejtën e përfaqësuesve të BE-së për të ndërhyrë në debat në çdo moment dhe jo vetëm në fund të tij; *së dyti*, të drejtën për të shpërndarë komunikata në lidhje me qëndrimin e saj, të cilat do të konsideroheshin si dokumente zyrtare të OKB-së; *së treti*, të drejtën për të paraqitur propozime dhe amendamente verbale, të cilat do të hidheshin në votim pas kërkesës së një shteti anëtar; dhe *së katërti*, të drejtën e replikës, vetëm pasi të kishin folur të gjithë ata që kishin kërkuar fjalën⁴¹⁰.

Ndërsa, ndryshimet e prezantuara me Traktatin e Lisbonës, nga njëra anë shërbyen për krijimin e kuadrit të domosdoshëm institucional dhe ligjor për forcimin e pozitës së BE-së në fushën e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes dhe të kapaciteteve ushtarake dhe civile të saj, nga ana tjetër prezantimi i personalitetit juridik të BE-së i hapi rrugën forcimit të bashkëpunimit me partnerët e saj strategjikë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Konkretisht neni 42 i këtij Traktati, në të cilin përcaktohen fushat e veprimtarisë së BE-së si misionet paqeruajtëse, parandalimi i konflikteve dhe forcimi i sigurisë ndërkombëtare, parashikon se të gjitha veprimet e ndërmarra nga BE-ja duhet të jenë në përputhje me parimet e OKB-së.

⁴⁰⁷ General Affairs and External Relations Council, *Council conclusions on UN world summit* (Bruksel, 07 Nëntor 2005) <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁰⁸ Council of the European Union, *Joint Statement on UN-EU cooperation in Crisis Management* (Bruksel, 07 Qershor 2007), <https://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁰⁹ UN, *Resolution 1861* (2009) <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹⁰ <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

Më tej, në pajtim me këto parime, në vitin 2011, BE-ja publikoi planin e masave të veprimit që do të ndikonte në rritjen e mbështetjes së PESMP-së ndaj operacioneve paqeruajtëse të OKB-së. Ky plan masash përfshinte gjashtë fusha veprimi, të cilat ishin: (i). Përcaktimi i kontributit ushtarak dhe civil që Shtetet Anëtare mund të vënë në dispozicion të OKB-së; (ii). Krijimi i konceptit të të qënurit të BE-së komponent përbërës i operacioneve të OKB-së; (iii). Angazhimi i pavarur i kapaciteteve civile të BE-së në mbështetje të operacioneve të OKB-së; (iv). Angazhimi i pavarur i kapaciteteve ushtarake të BE-së në mbështetje të operacioneve të OKB-së; (v). Asistencë ndaj Unionit Afrikan dhe organizatave të tjera rajonale ose ndër rajonale; dhe (vi). Shkëmbimi ndërsektorial⁴¹¹.

Përsa i përket bashkëpunimit në terren ndërmjet BE-së dhe OKB-së, mund të themi se ai do të realizohej në dy mënyra: *së pari*, nëpërmjet vënies së kapaciteteve ushtarake të Shteteve Anëtare të BE-së në dispozicion të operacioneve të ndërmarrja nga OKB-ja, dhe *së dyti*, nëpërmjet ndërmarrjes së operacioneve nga vetë BE-ja mbi bazën e kërkesës së OKB-së. Në mbledhjen e Këshillit Europian të mbajtur më 17 – 18 Qershor 2004, u përcaktuan modalitetet sipas së cilave BE-ja do të mund të siguronte kapacitetet e nevojshme ushtarake në mbështetje të operacioneve të OKB –së, ndërsa aspektet civile të bashkëpunimit BE – OKB në drejtim të menaxhimit të krizave do të gjenin një rregullim të mëvonshëm⁴¹².

Në lidhje me mënyrën e parë mund të themi se, ky proces bashkëpunimi mund të niste mbi bazën e një kërkesë nga Shtetet Anëtare ose si një operacion i BE-së pas kërkesës së OKB-së, por gjithmonë nën kontrollin politik dhe nën drejtimin strategjik të BE-së. E drejta për të vendosur kapacitetet ushtarake në dispozicion të operacioneve të OKB-së i përkiste vetëm Shteteve Anëtare të BE-së dhe këto kapacitete nuk do të konsideroheshin si të “ngrira” për qëllime të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë së BE-së. Në këtë rast, BE-ja do të kishte vetëm rol drejtues dhe orientues me qëllim krijimin e një strukture sipas së cilës Shtetet Anëtare, në mënyrë vullnetare, do të mund të shkëmbenin informacione në lidhje me një operacion të OKB-së, dhe nëse do të binin dakort edhe të koordinonin kapacitetet e tyre me ato të OKB-së. Një model i tillë bashkëpunimi nuk do të ndikonte në mënyrën e vendimarrjes së Shteteve Anëtare në kuadër të OKB-së apo në marrëveshjet dypalëshe që këto shtete do të lidhnin me Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse të OKB-së⁴¹³.

Mënyra e dytë e bashkëpunimit, nënkuptonte ndërmarrjen e operacioneve në mbështetje të OKB-së nga BE-ja, së cilës i përkiste kontrolli politik dhe drejtimi strategjik. Në një rast të tillë Bashkimi, i cili do të vepronte nën mandatin e OKB-së, mund të ndërmerre vetë një operacion ose të merrte përgjegjësi për një nga komponentët përbërës brenda strukturave të

⁴¹¹ European External Action Service, *Action to enhance EU CSDP support to UN peacekeeping* (Bruksel, 24 Nëntor 2011) <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹² Council of the European Union, *ESDP Presidency Report* (Bruksel, 13 Dhjetor 2004), pg. 19, <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST%2016062%202004%20INIT> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹³ *EU – UN cooperation in military Crisis Management Operations: Elements of Implementation of the EU – UN Joint Declaration*, pg. 4-6.

misionit të OKB-së, siç ishte rasti i Bosnje dhe Hercegovinës. Në rastin e fundit ky komponent i BE-së do të vepronte nën kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të saj⁴¹⁴.

Në kuadër të kësaj forme bashkëpunimi, rëndësi të veçantë kanë operacionet që kërkojnë një reagim të menjëhershëm, ku aftësia e trupave të BE-së për të ndërhyrë në mënyrë të menjëhershme përbën një vlerë të shtuar për operacionet e OKB-së. Operacione të tilla mund të klasifikohen në dy kategori: a.) “bridging model”, i cili i jep kohë OKB-së për të nisur ose riorganizuar misionin e saj, ku mund të përfshihet dhe instalimi i personelit të operacionit, dhe b.) “stand by model”, i cili konsiderohet si operacion për tërheqjen e kapaciteteve civile ose ushtarake nga rajonet e konfliktit⁴¹⁵.

Në përfundim mund të themi se, bashkëpunimi midis BE-së dhe OKB-së në fushën e menaxhimit të krizave paraqet rëndësi të veçantë për të dy këto organizata, pasi BE-ja përfiton nga legjitimiteti që i garanton mandati i KS të OKB-së dhe OKB-ja përfiton nga besueshmëria dhe aftësia operacionale e BE-së, sidomos në rastin e misioneve komplekse.

Megjithatë, BE-ja dhe OKB-ja janë akoma larg të qënurit partnerë strategjikë. Nga njëra anë, OKB-ja e shikon BE-në si një organizatë plotësuese dhe si një mjet për të përbushur detyrimet e saj në fushën e menaxhimit të krizave. Nga ana tjetër, BE-ja gëzon të drejtën e “përzgjedhjes” së operacioneve duke ruajtur në këtë mënyrë autonominë në vendimmarrje dhe duke diktuar, në të shumtën e rasteve, kushtet dhe ritmin e bashkëpunimit dhe duke mos treguar një vullnet të fortë për të rritur përkrahjen e saj ushtarake në operacionet e drejtuara nga OKB-ja. Për më tepër, Shtetet Anëtare të BE-së janë skeptike për të pranuar komandën dhe kontrollin e OKB-së mbi forcat e tyre. Pra, mund të themi se këto marrëdhënie janë karakterizuar nga ajo se çfarë OKB-ja kërkon dhe se çfarë BE-ja është e gatshme të ofrojë (shiko tabelën 4).

Sfida e së ardhmes për këto organizata është optimizimi i potencialit të secilës prej tyre dhe kalimi i pengesave të brendshme. BE-ja duhet të luajë një rol më aktiv me qëllim realizimin e objektivave të saj, duke zgjeruar kapacitetet e saj ushtarake dhe civile dhe përmirësimin e diplomacisë e saj. Gjithashtu ajo duhet të jetë më koherente në përdorimin e strukturave të saj dhe më e gatshme për të bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë me qëllim për të garantuar një zonë sigurie dhe paqe. Përkrahja e një bashkëpunimi shumëpalësh do të ndihmonte në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe në forcimin e pozitës së saj në arenën ndërkombëtare (shiko tabelën 5).

6.2 Bashkëpunimi me Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë

Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (në vijim OSBE) dhe BE-ja mund të cilësohen si “partnerë natyralë” përse i përket bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe të

⁴¹⁴ EU – UN cooperation in military Crisis Management Operations, pg. 7.

⁴¹⁵ Po aty, pg. 13 – 14.

mbrojtjes⁴¹⁶. Për këto organizata mund të themi që jo vetëm kanë qëllime të ngjashme, por edhe që fushat e veprimtarisë së tyre janë plotësuere të njëra tjetrës.

Duke iu referuar akteve themeluese të BE-së, bazat e këtij bashkëpunimi i gjejmë në nenin 21 të Traktatit të BE-së, në të cilin parashikohet se një nga objektivat e PJSP-së, ajo për ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve dhe ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare, do të përmbushet në pajtim me parimet e OSBE-së të parashikuara në Aktin Final të Helsinkit dhe objektivat e Kartës së Parisit, në lidhje me kufinj të jashtëm. Ndërsa, nëse i referohemi akteve të OSBE-së, bazat për bashkëpunimin me organizatat e tjera do t'i gjejmë në dy dokumentat themelorë të saj, Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit, në të cilat parashikohet se kjo organizatë ka si qëllim rritjen e rolit të saj në forcimin e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve dhe në nxitjen e ndërtimit të marrëdhënieve miqësore midis shteteve, duke vepruar në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së OKB-së. Rëndësi në këtë drejtim, paraqet dhe Karta për Sigurinë Europiane, e cila si objektivi kryesor parashikon forcimin e bashkëpunimit me ato organizata dhe institucione, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre zgjerimin e zonës së sigurisë brenda fushës së veprimit të OSBE-së⁴¹⁷.

Bashkëpunimi BE - OSBE ka dy dimensione, atë strukturor dhe atë operacional. Në lidhje me atë strukturor mund të themi se hapat e para në këtë drejtim janë bërë në mbledhjen e Këshillit Europian në Helsinki, ku ndër të tjera në raportin përfundimtar thuhet se ky bashkëpunim merr një rëndësi të veçantë për forcimin e PESMP-së dhe për rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe civile të BE-së në menaxhimin e krizave, me qëllim për t'i mundësuar kësaj të fundit ushtrimin plotësisht të të gjitha përgjegjësisive në lidhje me detyrat për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizave⁴¹⁸. Gjithashtu, në këtë mbledhje rëndësi të veçantë iu kushtua dhe forcimit të kapaciteteve civile të BE-së, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së saj në misione të ndërmarra nga organizata të tjera, si OKB dhe OSBE, ose nga ajo vetë. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, Shtetet Anëtare dhe BE-ja, duhet të krijojnë dhe të përcaktojnë modalitetet e funksionimit të një force të ndërhyrjes së shpejtë, e cila do të mund të përdoret si në misionet e ndërmarra nga BE-ja edhe në ato të ndërmarra nga OKB-ja ose OSBE-ja, në përgjigje të kërkesës së këtyre të fundit⁴¹⁹.

Propozimet e rradhës u paraqitën në mbledhjen e Këshillit Europian në Santa Maria da Feira, në Nicë dhe në Gutenberg. Ndër të tjera në mbledhjen e Këshillit Europian në Santa Maria da Feira liderat europianë theksuan rëndësinë që ka për forcimin e PESMP-së forcimi i bashkëpunimit jo vetëm midis strukturave ushtarake dhe civile brenda BE-së, por edhe me

⁴¹⁶ Javier Solana, *The European Union and the Organisation for Security and Cooperation in Europe: The shape of future cooperation* (Vjenë, 25 Shtator 2002), <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹⁷ OSCE, *Charter for European Security* (Stamboll, Nëntor 1999), <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹⁸ Helsinki European Council, *Presidency Conclusions*, Annex IV (Helsinki, 10 – 11 Dhjetor 1999), fq. 1, <https://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴¹⁹ Helsinki European Council, Aneksi II i Aneksit IV.

partnerët ndërkombëtarë si OSBE, OKB dhe Këshillin e Europës (në vijim KE)⁴²⁰. Ndërsa bashkëpunimi në fushën civile duhej të përqëdrohej në përcaktimin e udhëzimeve të përgjithshme për përzgjedhjen dhe trajnimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve kriminalistë dhe në rritjen e standarteve në operacionet policore, të ndërmarrë nga vetë BE-ja ose në kuadër të organizatave të tjera si OSBE. Gjithashtu, bashkëpunimi në këtë drejtim duhet të synonte bashkimin e përpjekjeve, mënjanimin e mbivendosjeve të operacioneve dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit në lidhje me misionet policore⁴²¹.

Në Mbledhjen e Këshillit European në Nicë, përta i përket bashkëpunimit në fushën ushtarake Shtetet Anëtare ranë dakort për krijimin e një strukture të përherhme ushtarako – politike, e cila do të quhej Shtabi Ushtarak i Bashkimit European (European Union Military Staff (EUMC)), i cili ndër të tjera kishte si funksion ndërtimin e marrëdhënieve të vazhdueshme me NATO-n dhe të marrëdhënieve të përshtatshme me strukturat paralele në OKB dhe OSBE⁴²². Ndërsa në fushën civile, rëndësi e veçantë iu kushtua rritjes së efektivitetit të misioneve policore dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Për këtë qëllim më 25 Tetor 2000 u mbajt dhe një seminar në lidhje me forcimin e shtetit të së drejtës në kuadër të misioneve për menaxhimin e krizave, ku përfaqësues të BE-së, OKB-së, OSBE-së dhe KE-së shkëmbyen eksperiencat e tyre⁴²³.

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në Gutenberg u theksua se një nga objektivat kryesore të BE-së në fushën e marrëdhënieve me jashtë ishte parandalimi i konflikteve, realizimi i së cilës shtronte para BE-së nevojën për të bashkëpunuar me organizata të tjera rajonale, të cilat kishin të njëjtin objekt të veprimtarisë së tyre, përfshirë këtu dhe OSBE. Rëndësi të veçantë në këtë kuadër merr dhe Draft Programi për Parandalimin e Konflikteve të Dhunshme, në të cilin parashikohej se BE-ja duhet të ndërtojë dhe të mbështesë krijimin e një partneriteti efektiv me OKB-në, OSBE-në, me organizata të tjera rajonale dhe me elementë të shoqërisë civile. Ky bashkëpunim duhet të shtrihej në të gjitha fazat e një operacioni, që nga njoftimet e para për një rrezik të mundshëm, analizën e veprimeve konkrete që mund të ndërmerren, koordinimin e veprimeve taktike në terren dhe realizimin e programeve të përbashkëta trajnuese, me qëllim mënjanimin e mbivendosjeve⁴²⁴.

Sikurse shihet dhe nga përmbajtja e dokumentave të trajtuar më lart bashkëpunimi BE-OSBE ishte në hapat e parë dhe kishte natyrë *ad hoc*, duke mos u bazuar në struktura të qëndrueshme dhe të përherhme, të cilat do t'i shërbenin intensifikimit të bashkëpunimit, vazhdimësisë së tij dhe pajtueshmërisë së veprimeve në terren të misionit të BE-së dhe atij të OSBE-së. Kjo situatë nisi të ndryshojë në vitin 2003 kur Këshilli i Punëve të Përgjithshme

⁴²⁰ European Parliament, *Conclusions of the Presidency* (Santa Maria da Feira, 19 – 20 Qershor 2000), Aneksi I, pg. 8, <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²¹ Po aty, Aneksi I, Shtojca 4, pika B.

⁴²² European Council, *Presidency Conclusions* (Nicë, 7-9 Dhjetor 2000), Aneksi V i Aneksit VI, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²³ European Council, *Presidency Conclusions* (Nicë, 7-9 Dhjetor 2000), Aneksi II i Aneksit VI, pika III <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²⁴ Council of the European Union, *Draft European Union Programme for the Prevention of Violent Conflicts* (Bruksel, 07 Qershor 2001), Pika IV, <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

ndërmori hapa të rëndësishëm në përcaktimin e parimeve udhëzuese dhe të fushave të bashkëpunimit. Në lidhje me parimet udhëzuese palët ranë dakort se⁴²⁵:

- Pavarësisht shtrukturës dhe qëllimit të ndryshëm, BE-ja dhe OSBE-ja ndajnë të njëjtat vlera, parime dhe përgjegjësi në parandalimin e konflikteve, në menaxhimin e krizave, në rehabilitimin e situatës së pas konfliktit, në promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe në rindërtimin e institucioneve. Të dy këto organizata njohin dhe pranojnë rolin parësor të OKB-së në çështje që i përkasin paqes dhe sigurisë.
- OSBE-së do të luante rolin e një instrumenti për promovimin e paqes dhe të sigurisë nëpërmejt përdorimit të diplomacisë.
- Masat që këto organizata do të ndërmerren për forcimin e bashkëpunimit, përveç se duhej të ishin në pajtim me programin e BE-së për parandalimin e konflikteve dhe frymën e “Platformës për Bashkëpunimin në Fushën e Sigurisë” të OSBE-së, ato duhej të garantonin dhe natyrën specifike të këtyre organizatave.
- Bashkëpunimi BE - OSBE duhet të synonte shmangien e mbivendosjeve dhe evidentimin e vlerave të shtuara për secilën organizatë. Ky bashkëpunim do të ishte në një proces të vazhdueshëm evoluimi në përputhje me nevojat e PJSP-së së BE-së dhe me ato të OSBE-së.

Në lidhje me fushat e bashkëpunimit mund të themi se në përgjithësi ai do të shtrihej në çështje të natyrës politiko - ushtarake, ekonomike, në çështje që kanë të bëjnë me mjedisin dhe me të drejtat e njeriut. Ky bashkëpunim do të orientohej veçanërisht në drejtim të⁴²⁶: *së pari*, Forcimit të bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe analizave, gjetjes dhe grumbullimit të të dhënave, koordinimit të veprimeve dhe qëndrimeve diplomatike, zhvillimit të konsultimeve të herëpashershme ndërmjet përfaqësuesve përkatës, trajnimeve të përbashkëta dhe koordinimit të veprimeve në terren; dhe *së dyti*, Rritjes së iniciativave të përbashkëta të cilat mund të përfshinin kontributin e BE-së në operacionet e OSBE-së për menaxhimin e krizave, zbatimin e programeve të përbashkëta ose të koordinuara në situatat postkonfliktuale dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizës mbi bazën e kërkesës së OSBE-së.

Pavarësisht se në çdo mbledhje të Këshillit Europian theksohej se në kuadër të politikës për ndërtimin e një bashkëpunimi efektiv shumëpalësh Bashkimi duhet të rriste angazhimin e tij në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit me partnerët më të rëndësishëm rajonalë, ndër vite pak është bërë për forcimin e bashkëpunimit me OSBE-në në fushën e PESMP-së, edhe pse ajo vazhdon të konsiderohet si një nga partnerët strategjikë të BE-së në PESMP. Në mungesë të strukturave të përhershme të bashkëpunimit, marrëdhëniet midis dy organizatave janë zhvilluar mbi bazën e dialogut dypalësh, siç është dhe Konferenca Vjetore mbi Sigurinë.

⁴²⁵ European Commission, <http://europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²⁶ Po aty.

Pas viteve 2004 rëndësi për marrëdhëniet BE - OSBE paraqet Draft Raporti i Vlerësimit të Rolit të BE-së *vis – a – vis* me OSBE-në”, në të cilin Bashkimi parashtronte këto objektiva për të ardhmen⁴²⁷:

- *Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis BE-së dhe OSBE-së.* Si rreziqe për sigurinë dhe paqen BE-ja në strategjinë e saj “Një Europë e Sigurtë në një Botë më të Mirë”, konsideron terrorizmin, pasurimin e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, dështimin e shtetit dhe të demokracisë dhe krimin e organizuar. Nga ana tjetër, OSBE-ja në aktin e saj “Strategjia për të Përcaktuar Rreziqet për Sigurinë dhe Stabilitetin në Shekullin e 21” identifikon këto rreziqe: konfliktet e brendshme dhe ato të jashtme, terrorizmin, krimin e organizuar, diskriminimin dhe mungesën e tolerancës, rreziqet të natyrës ekonomike dhe mjedisore dhe ato të natyrës politiko – ushtarake. Edhe pse në pamje të parë këto rreziqe mund të duken të ndryshme, thelbi i tyre është i njëjtë, pasi të gjitha ato përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë në Europë dhe jashtë saj. Në këto kushte këto dy organizata duhet jo vetëm të forcojnë bashkëpunimin midis tyre, por edhe të grantojnë pajtueshmërinë e politikave të tyre.
- *Forcimi i performacës së BE-së në kuadër të veprimtarisë së OSBE-së.* Kjo mund të realizohet vetëm nëse BE-ja dhe OSBE-ja “flasin në një zë të vetëm”, përsa i përket fushave për të cilat kanë rënë dakort të bashkëpunojnë. Një gjë e tillë do të rriste besueshmërinë dhe influencën e BE-së në OSBE. Gjithashtu, BE-ja duhet të jetë fleksibël në ndryshimin e prioriteteve të saj dhe të bashkëpunojë me OSBE-në në këtë drejtim.
- *Ruajtja dhe zbatimi i vlerave dhe standarteve të OSBE-së në zonën Euro – Atlantike.* Gjatë viteve të funksionimit të saj OSBE-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në arkitekturën e sigurisë europiane si forum për një dialog gjithëpërfshirës dhe si platformë për përpilimin e veprimeve të përbashkëta. Elementët si efektshmëria e diplomacisë së saj, prezenca e saj afatgjatë në vendet e konfliktit dhe besueshmëria e saj si një vëzhgues dhe lehtësues i paanshëm kanë treguar që janë një avantazh në rast reagimi ndaj një situatë krize. Gjithashtu Operacioni Special i Vëzhgimit në Ukrainë nga ana e OSBE-së, tregoi edhe njëherë rëndësinë që kanë instrumentat e saj për operacionet e BE-së⁴²⁸. Nga ana tjetër edhe OSBE-ja vlerëson kontributin e kapaciteteve të BE-së në forcimin e sigurisë europiane, duke nisur që nga misionet parandaluese, në ato të menaxhimit të krizave dhe deri në ato për rivendosjen e paqes⁴²⁹.

Në lidhje me bashkëpunimin operacional BE – OSBE, mund të themi se ai është orientuar në drejtim të: (i). Parandalimit të konflikteve dhe rehabilitimit të situatës pas konfliktit; (ii). Zgjerimit të rasteve të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve; (iii). Zbatimit të vlerave dhe standardeve të OSBE-së në zonën Euro – Atlantike; dhe (iv). Përshtatjes së strukturave të OSBE-

⁴²⁷ Council of the European Union, *Draft Assessment Report on the EU's role vis a vis the OSCE* (Bruksel, 10 Dhjetor 2004), <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²⁸ European Union, *EU Statement on European Security* (Vjenë, 18 Shkurt 20015), <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴²⁹ OSCE, *Astana Commemorative Declaration towards a Security Community* (03 Dhjetor 2010), pg. 11 dhe Shtojca 11, <https://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

së me ato të BE-së⁴³⁰. Si shembuj të këtij bashkëpunimi, të cilat paraqesin rëndësi në praktikë, mund të përmendim⁴³¹:

- *Bashkëpunimi në konfliktet në ish Jugosllavi*. Misioni i OSBE-së dhe Misioni Vëzhgues i Komunitetit European (The European Community Monitor Mission), i përbërë nga vëzhgues ushtarakë dhe civilë, kishin si qëllim vëzhgimin e situatës dhe garantimin e zbatimit të sanksioneve të vendosura nga aktorët ndërkombëtarë. Misioni Vëzhgues i KE-së përveç mandatit të tij monitorues, pa të drejtë të ndërhynte ushtarakisht, gjithashtu kishte si objektiv dhe uljen e rreziqeve që mund të shkaktonin konflikte të dhunshme dhe nxitjen e zhvillimit të marrëdhënieve të qëndrueshme⁴³².
- *Bashkëpunimi në rastin e Bosnje dhe Hercegovinës dhe të Kosovës*, nëpërmjet mobilizimit të kapaciteteve civile në periudhën e pas luftës, në pajtim me angazhimet e ndërmarra në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore⁴³³.
- *Bashkëpunimi në Maqedoni*, në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, ku misionet e BE-së në kuadër të PESMP-së ndihmuan në zbatimin e kësaj marrëveshje.
- *Bashkëpunimi në rastin e Gjeorgjisë*, ku BE-ja ndihmoi autoritetet gjeorgjiane për të forcuar kapacitetet në mbështetje dhe në mbrojtje të Misionit të Vëzhguesve të OSBE-së, i cili ishte vendosur në zonën kufitare midis Republikës së Gjeorgjisë dhe asaj të Çeçenisë, dhe Ingush, pjesë e Federatës Ruse.

Në përfundim mund të themi se, ndonëse nga njëra anë operacioni Special i Vëzhgimit në Ukrainë nga ana e OSBE-së, tregoi edhe njëherë rëndësinë që kanë instrumentat e saj për operacionet e BE-së dhe nga ana tjetër edhe OSBE-ja vlerëson kontributin e kapaciteteve të BE-së në forcimin e sigurisë europiane, duke nisur që nga misionet parandaluese, në ato të menaxhimit të krizave dhe deri në ato për rivendosjes e paqes, BE-ja dhe OSBE-ja ndajnë objektiva të ndryshme në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe janë larg të qënurit aleatë. Ambicia e BE-së është të jetë një aktor global në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke marrë kështu operacione dhe përtej kufinjve të saj, ndërsa OSBE-ja është më aktive me operacione të ndërmarra kryesisht brenda zonës së saj të influencës si në Europën Juglindore, Europën Lindore, në Kaukaz dhe në Azinë Qendrore.

Gjithashtu, miratimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë dhe drejtimi i fokusit të BE-së në operacionet humanitare, solli një mbivendosje me dimensionin humanitar të operacioneve të OSBE-së, duke rrezikuar që këto dy organizata të duplikojnë njëra tjetrën. Për këtë arsye, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe rritjen e efektivitetit të operacioneve, ndonëse mekanizmat *ad hoc* të bashkëpunimit mund t'i përshtaten më së miri çdo situatë konflikti, do ishte e domosdoshme krijimi i strukturave të përhershme të bashkëpunimit dhe i një mekanizmi për koordinimin e operacioneve, përfshirë këtu dhe programet e trajnimit.

⁴³⁰ Po aty.

⁴³¹ <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 20 Shtator 2015).

⁴³² Western European Union, *Declaration on implementation of UN sanctions on the former Yugoslavia* (Luksemburg, 05 Prill 1993) <http://www.weu.int/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴³³ Jan Wouters dhe Frederik Naert, fq. 566-568.

6.3 Bashkëpunimi me organizata rajonale në Afrikë

Pas konflikteve në Etiopi, Eritre, Mozambik, Angola dhe Somali, Komuniteti European (sot BE) adoptoi në vitin 1993 konceptin për rehabilitimin e shteteve të prekura nga luftrat ose katastrofat natyrore, përfshirë këtu edhe shtetet afrikane⁴³⁴. Ndonëse këto programe nuk kishin të njëjtën natyrë me operacionet për parandalimin e konflikteve ose me ato për rindërtimin e vendit pas konfliktit, që ndërmerr sot BE-ja, për këto shtete ato mund të cilësohen si të tilla⁴³⁵. Këto shënojnë fillimet e angazhimit të Komunitetit në Afrikë. Ndërsa fillesat e një bashkëpunimi formal midis BE-së dhe organizatave rajonale në Afrikë, në drejtim të parandalimit të konflikteve, i gjejmë në mbledhjen e Këshillit European në Esen⁴³⁶, në të cilën përfaqësuesit europeanë theksuan rëndësinë që do të kishte në këtë drejtim zhvillimi i një dialogu intensiv me Organizatën e Unitetit Afrikan (në vijim OUA).

Në vijim të forcimit të këtij bashkëpunimi, në mbledhjen e Këshillit European në Madrid u përcaktuan parimet e përgjithshme dhe udhëzimet bazë në lidhje me mënyrën e ndërhyrjes së BE-së në situatat e konfliktit në Afrikë. Sipas këtyre parimeve dhe udhëzimeve, BE-ja do të mbështeste veprimet e ndërmarra nga strukturat përkatëse të vendeve Afrikane, sidomos nga OUA-ja, në fushën e parandalimit të konflikteve, si një nga prioritetet e PJSP-së, duke vepruar në pajtim me Mekanizmin për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikteve. Mbështetja që BE-ja do të ofronte në fushën e diplomacisë parandaluese, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe në ruajtjen e paqes, do të synonte realizimin e këtyre objektivave⁴³⁷:

- *Rritjen e shkallës së përfshirjes së vendeve afrikane në operacionet për parandalimin dhe zgjidhjen e krizave;*
- *Përmirësimin e bashkëpunimit në drejtim të koordinimit të veprimeve midis BE-së, shteteve Afrikane dhe Shteteve Anëtare të organizatave ndërkombëtare;*
- *Harmonizimin e veprimeve të përbashkëta dhe koordinimin e përpjekjeve në këtë drejtim, në funksion të procesit të demokratizimit;*
- *Rritjen e fleksibilitetit të mobilizimit të forcave dhe të mjeteve ushtarake;*
- *Nxitjen e bashkëpunimit me OKB-në;*
- *Forcimin e kapaciteteve ekzistuese të OUA-së.*

Në zbatim të konkluzioneve të miratuara në mbledhjen e Këshillit European në Madrid, Komisioni adoptoi komunikatën drejtuar Këshillit të titulluar “*BE-ja dhe çështja e konflikteve në*

⁴³⁴ Court of Auditors, *Special Report No. 4/2000 on rehabilitation actions for ACP Countries as an instrument to prepare for normal development aid, accompanied by Commission's replies* (Prill 2000), <http://aei.pitt.edu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴³⁵ Jan Wouters dhe Frederik Naert, “The EU and conflict prevention: a brief historic overview”, *Working Paper No. 52*, (Prill 2003), fq. 12 <https://www.law.kuleuven.be/> (hyrë për herëtë fundit më 22 Shtator 2015).

⁴³⁶ European Council, *Presidency Conclusions* (Esen, 09 – 10 Dhjetor 1994), pika 8, <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴³⁷ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

*Afrikë: Rindërtimi i paqes, parandalimi i konflikteve dhe më tej*⁴³⁸. Sipas kësaj komunikate BE-ja duhet të maksimizonte ndikimin e saj në rajon nëpërmjet përdorimit në mënyrë efektive të kapaciteteve të saj, sidomos në rastet e parandalimit të konflikteve, duke evidentuar dhe luftuar ato shkaqe që përbëjnë burim kryesor të këtyre konflikteve. Realizimi i një objektiv të tillë mund të arrihej nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve, analizave të përbashkëta, koordinimit të veprimeve dhe bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet Shteteve Anëtare, por edhe atij me organizatat ndërkombëtare. Në lidhje me pozicionin e BE-së në situatat e konfliktit, në komunikatë thuhet se ajo nuk duhet të impononte zgjidhje por, duhet të ofronte mundësi dhe alternativa dhe të ndikonte në forcimin e kapaciteteve të shteteve afrikane, përfshirë dhe fusha si trajnimet, logjistikën dhe komunikacionin. Përgjegjësia kryesore për operacionin dhe e drejta e vendimarrjes do t'i përkiste vetë shteteve afrikane, si aktori kryesor në operacion⁴³⁹.

Duke qenë se për BE-në rëndësi paraqet edhe ana operationale, më 02 Qershor 1997 Këshilli i BE-së, në mbështetje të operacioneve të ndërmarra në terren nga shtetet afrikane, miratoi qëndrimin e përbashkët në lidhje me parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve në Afrikë. Nëpërmjet këtij qëndrimi Bashkimi shpreh gadishmërinë e tij për të reaguar ndaj krizave duke u fokusuar kryesisht në ndihmën që ai do të ofronte në drejtim të parandalimit të shpërthimit të një konfliktit të mundshëm, që në fazat më të hershme të tij, dhe në rindërtimin e paqes. Gjithashtu, ai shprehu dhe gadishmërinë e tij për të mbështetur shtetet afrikane në krijimin e kapaciteteve në drejtim të parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve, nëpërmjet propozimeve konkrete me OUA-në⁴⁴⁰.

Më tej, më 25 Maj 1998, Këshilli adoptoi qëndrimin e përbashkët në fushën e të drejtave të njeriut, të shtetit të së drejtës dhe të mirëqeverisjes në Afrikë. Vendimi për zbatimin në praktikë të këtyre qëndrimeve u mor më 20 Tetor 1997, kur Këshilli i BE-së njëkohësisht shprehu mbështetjen e tij ndaj Mekanizmit për Parandalimin, Menaxhimin dhe Zgjidhjen e Konflikteve të krijuar nga OUA-ja, i cili kishte si qëllim zbulimin e shkaqeve të konfliktit dhe reagimin e menjëhershëm ndaj tyre⁴⁴¹.

Në përgjigje të zhvillimeve të reja, ky qëndrim i përbashkët u zëvendësua me atë të datës 14 Maj 2001, i cili kishte si objektiv të kontribuonte në forcimin e kapaciteteve të shteteve afrikane, dhe sidomos të OUA-së, në fushën e parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së

⁴³⁸ European Commission, *The EU and the issue of conflicts in Africa :peace-building, conflict prevention and beyond* (Bruksel 1996), <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴³⁹ European Commission, *The EU and the issue of conflicts in Africa :peace-building, conflict prevention and beyond* (Bruksel 1996), <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴⁰ Council of the European Union, *Common Position (97/356/CFSP) defined by the Council on the basis of Article J.2 of the Treaty on European Union, concerning conflict prevention and Resolution in Africa* (02 Qershor 1997), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴¹ Council of the European Union, *Common Position (98/350/CFSP) defined by the Council on the basis of Article J.2 of the Treaty on European Union, concerning human rights, democratic principles, the rule of law and good governance in Africa* (25 Maj 1998), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

konflikteve të dhunshme⁴⁴². Realizimi i kësaj objektive shtronte para BE-së domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet Shteteve Anëtare të saj, por edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare, veçanërisht me OKB-në. Zbatimi i këtij qëndrimi të përbashkët në praktikë u shoqërua me koordinimin e veprimeve në terren, shkëmbimin e informacioneve dhe fakteve, zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta dhe krijimin e strukturave të përshtatshme për drejtimin e operacioneve⁴⁴³.

Si shtysë në forcimin e bashkëpunimit midis BE-së/KE-së dhe shteteve afrikane do të shërbente dhe miratimi për një periudhë 20 vjeçare të Marrëveshjes së Kotonos, e lidhur midis BE-së dhe shteteve Afrikane, të Paqësorit dhe të Karaibeve. Kjo marrëveshje, e cila ka qenë objekt rishikimesh të vazhdueshme, parashikonte bashkëpunim ndërmjet palëve në fushën politike, të ekonomisë, të tregtisë dhe në atë të zhvillimit të vendit. Nën ombrellën e bashkëpunimit politik përfshiheshin edhe çështje si rivendosja e paqes në vendet e paskonfliktit, parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhja e tyre. Pas ndryshimeve të miratuara në vitin 2010, fushat e bashkëpunimit u rishikuan duke përfshirë në to edhe çështje që kishin të bënin me sigurinë⁴⁴⁴.

Në përgjigje të nismave të ndërmarra nga BE-ja, në Samitin e 37-të OUA-së, liderat e Shteteve Anëtare miratuan dokumentin e Partneritetit për Zhvillimin e Afrikës. Ndër të tjera në këtë dokument thuhej se rivendosja e paqes dhe forcimi i sigurisë paraqet rëndësi të veçantë për zhvillimin e vendit dhe realizimi i këtyre objektivave mund të arrihej vetëm nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe strukturave të nevojshme për të parandaluar, menaxhuar dhe zgjidhur konfliktet, jo vetëm në nivel rajonal por edhe duke bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë, nëpërmjet hartimit të politikave të qarta⁴⁴⁵.

Miratimi i këtij dokumenti dhe krijimi i Unionit Afrikan (në vijim UA), i cili zëvendësoi OUA-në, paraqet një rëndësi të veçantë për bashkëpunimin me BE-në, pasi i mundësoi kësaj të fundit për të qenë më aktive në vendet afrikane. Ndërsa adoptimi në 2002 nga Shtetet Anëtare të UA-së të konceptit të Arkitekturës Afrikane të Paqes dhe të Sigurisë dhe miratimi i Protokollit të Këshillit për Paqen dhe Sigurinë, i cili përcaktoi elementët përbërës të këtij mekanizmi dhe

⁴⁴² Council Common Position 2004/85/CFSP concerning conflict prevention, management and resolution in Africa and repealing Common Position 2001/374/CFSP (datë 26 Janar 2004), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴³ Council of the European Union, *Common Position (2001/374/CFSP) concerning conflict prevention, management and resolution in Africa* (14 Maj 2001), <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴⁴ European Commission, *Partnership agreement between the members of the African, Caribbean and Pacific group of states of the one part, and the European Community and its Member States of the other part (The Cotonou Agreement)* (Korrik 2000), <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴⁵ OSAA, *The New Partnership for Africa's Development (NEPAD)* (Tetor 2001), pg. 71-78, <http://www.un.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017)

funksionet e tij, krijoi hapësira të reja për diskutime midis UA-së dhe BE-së, për çështje të sigurisë dhe të paqes⁴⁴⁶.

Vendimtare për bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe UA-së ishte dhe miratimi në 2005 i Strategjisë për Afrikën, në të cilën parashikohej se një ndër shtyllat më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi ishte ajo në fushën e paqes dhe të sigurisë. Miratimi i kësaj strategjie shënoi një kapitull të ri në marrëdhëniet midis Europës dhe Afrikës, si një kontinent i vetëm, dhe i hapi rrugë bashkëpunimit në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Ky dokument, i cili përbënte një hap tjetër në drejtim të forcimit të sigurisë dhe të stabilitetit të rajonit, i hapi rrugë forcimit të kapaciteteve të vendeve afrikane për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve⁴⁴⁷.

Zbatimi i kësaj strategjie do të realizohej nëpërmjet hartimit të planeve të përbashkëta, të krijimit të mekanizmave të monitorimit, të vlerësimit, të rishikimit dhe të krijimit të instrumentave të nevojshëm që do të garantonin financimin e veprimeve që palët do të ndërmerrnin⁴⁴⁸. Gjithashtu, në funksion të rritjes së efektivitetit të operacioneve për parandalimin e konflikteve në 2009, BE-ja hodhi idenë për krijimin e një Mekanizmi për Paralajmërimin e Hershëm, i cili konsistonte në ngritjen e disa qendrave në Britaninë e Madhe, Francë, UA dhe BE që do të bashkëpunonin duke shkëmbyer informacion në lidhje me rreziqet e mundshme⁴⁴⁹.

Objektivat kryesore që synonte të realizonte ky bashkëpunim afatgjatë në fushën e sigurisë ishin: (i). Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit Afrikë – BE në fushat e interesit të përbashkët, e cila do të përfshinte si bashkëpunimin institucional edhe atë operacional, sidomos për çështje që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë; (ii). Forcimi dhe promovimi i paqes, sigurisë, qeverisjes demokratike, respektimit të të drejtat dhe lirive themelore të njeriut dhe zhvillimit të një ekonomie të qëndrueshme; (iii). Promovimi i idesë për ndërtimin e një sistemi efektiv shumëpalësh bashkëpunimi, përfshirë këtu dhe OKB-në; dhe (iv). Nxitja e faktorit ndërkombëtar për të qenë pjesëmarrës aktiv në operacionet për parandalimin e konflikteve dhe në ato për rindërtimin e vendit pas konfliktit⁴⁵⁰.

Këto objektiva u rikonfirmuan edhe në Samitin e mbajtur në Bruksel me liderët e vendeve afrikane dhe ato të BE-së më 2–3 Prill 2014. Në këtë samit pjesëmarrësit miratuan dhe një plan i cili përcaktonte orientimet bazë dhe prioritetet për vitet 2014-2017, të cilat ishin: a.) Paqja dhe Siguria; b.) Demokracia, mirëqeverisja dhe të drejtat e njeriut; c.) Zhvillimi i

⁴⁴⁶ *Protocol relating to the establishment of the Peace and Security Council of the AU*, <http://www.peaceau.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴⁷ Council of the European Union, *Council Conclusions on Strengthening African Capabilities for the Prevention, Management and Resolution of Conflicts* (Bruksel, 13 Nëntor 2016), <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁴⁸ Po aty, fq. 21 – 25.

⁴⁴⁹ Council of the European Union, *Council conclusions on ESDP* (Bruksel, 17 Nëntor 2009), pg. 120, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/esdp/111274.pdf (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁵⁰ Council of the European Union, *The Africa – EU strategic partnership: A joint Afrika – EU Strategy* (Lisbonë, 09 Dhjetor 2007), pg.8, <http://www.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

qëndrueshëm dhe i gjithëanshëm i vendit dhe integrimi i kontinentit; dhe d.) Bashkëpunimi në çështjet e që kërcënojnë stabilitetin e kontinentit⁴⁵¹.

Përveç anës strukturore dhe operacionale rëndësi për këtë marrëdhënie bashkëpunimi ka dhe aspekti ekonomik, sidomos përse i përket krijimit të kapaciteteve dhe strukturave të nevojshme në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Për këtë arsye, duke patur parasysh rëndësinë që marrin masat ekonomike dhe diplomatike në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, BE-ja duhet të synojë të mbështesë integrimin e Afrikës në ekonominë botërore dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dhe krijimit të mekanizmave të bashkëpunimit.

Për këtë arsye, në kuadër të ndihmës financiare BE-ja, pas kërkesës së liderave Afrikanë, krijoi “Mekanizmin për Paqen në Afrikë” (African Peace Facility), i cili financohej nga Fondi Europian për Zhvillim⁴⁵² dhe kishte si qëllim mbështetjen e axhendës së UA-së në fushën e paqes dhe të sigurisë. Krijimi i një mekanizmi të tillë jo vetëm që do të garantonte një mbështetje financiare për operacionet e ndërmarra nga Shtetet Anëtare të UA-së dhe do të ndikonte në forcimin e kapaciteteve dhe në rritjen e numrit të programeve trajnuese në Afrikë, por gjithashtu do të ndikonte edhe në rritjen e rolit dhe të angazhimit të BE-së në këto rajone konflikti dhe në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimi me UA-në, duke i dhënë në këtë mënyrë më tepër fleksibilitet PESMP-së në këtë drejtim.

Si prioritete të financimit të tij ky mekanizëm kishte: *së pari*, Krijimin e kapaciteteve; *së dyti*, Financimin e Mekanizmit të Reagimit të Hershëm, i cili do të vepronte për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e krizave; dhe *së treti*, Operacionet për ruajtjen e paqes të udhëhequra nga vendet afrikane. Ndërsa financimi i operacioneve për rindërtimin e vendit pas situatave të konfliktit do të mbulohej nga Fondi Europian për Zhvillim, i cili funksiononte jashtë kornizës së buxhetit të BE-së⁴⁵³.

Në lidhje me këto mekanizma financimi mund të themi se ato janë një tregues i rritjes së mbështetjes financiare të BE-së ndaj operacioneve të ndërmarra nga vendet Afrikane në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Nga njëra anë Mekanizmi për Paqen në Afrikë i dha BE-së mundësinë për të adresuar shpërndarjen e fondeve të saj për çështje që kishin të bënin me paqen dhe sigurinë në mënyrë më efektive, dhe nga ana tjetër rriti fleksibilitetin e BE-së dhe të UA-së për të reaguar ndaj krizave. Ndërsa krijimi i Fondit Europian për Zhvillim, i cili financohej direkt nga Shtetet Anëtare dhe funksionimi i tij rregullohej nga dispozita të mëvetësishme, ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së BE-së në operacionet e drejtuara nga vendet Afrikane.

Përse i përket fushës operacionale mund të themi se forcimi i PJSP-së dhe i PESMP-së solli dhe rritjen e numrit të ndërhyrjeve të BE-së në Afrikë në kuadër të ruajtjes së sigurisë dhe të

⁴⁵¹ <http://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-summit/2014/04/02-03/> (hyrë për herë të fundit ,[27 Prill 2018)

⁴⁵² Fondi Europian për Zhvillim mbështet programet e ndërmarra në vendet dhe territoret në zhvillim, me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik, social dhe humanitar dhe bashkëpunimin rajonal. Për më tepër shiko European Union, *European Development Found*, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁵³ European Commission, <https://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

paqes, edhe pse nën mandatin e OKB-së. Disa nga këto operacione janë në vazhdim e sipër dhe të tjera kanë përfunduar tashmë. Ndër veprimet operacionale të përfunduara tashmë, të natyrës civile, do të përmendim: EUSSR në Guine, EUPOL Kinshasa në RDK, EUPOL në RDK, EUVASEC në Sudanin e Jugut dhe AMIS II në Sudan dhe Darfur. Ndërsa ato të natyrës ushtarake janë: EUFOR në Republikën e Afrikës Qendrore, EUFOT Çad dhe dhe në Afrikën Qendrore, ARTEMIS dhe EUPOL në RDK⁴⁵⁴.

Operacionet e natyrës civile që janë akoma në proces janë: EUBAM në Libi, EUCAP SAHEL në Mali dhe në Nigeri, EUSEC në RDK, EUCAP në Somali dhe Tanzani, ndërsa operacione me karakter ushtarak janë: EUMAM në Afrikën Qendrore, EUTM në Somali, EU NAVFOR në Atalanta dhe EUTM në Mali⁴⁵⁵.

Në përfundim nga sa më lart, mund të themi se bashkëpunimi rajonal me organizatën e UA-së paraqet rëndësi pasi ruajtja e një paqe dhe sigurie të qëndrueshme në Afrikë është thelbësore për sigurinë Europiane, sidomos në fusha si terrorizmi, trafikimi i lëndëve narkotikëve dhe i qënieve njerëzore dhe emigracioni. Tregues i kësaj është edhe rritja e numrit të misioneve që BE-ja ka ndërmarrë në Afrikë, në kuadër të PESMP-së, të cilat janë më të shumta në numër krahasuar me misionet në Ballkan, Gjeorgji, Lindjen e Mesme etj.

Nëpërmjet PESMP-së, BE-ja ka qenë aktive në Afrikë në dy mënyra: *së pari*, në mënyrë *ad hoc*, nëpërmjet mekanizmit të reagimit të menjëhershëm në rastet e menaxhimit të krizave (si në RDK, Çad, Afrikën qendrore, Somali, Sudan), dhe *së dyti*, nëpërmjet Strategjisë së Përbashkët UA-BE, duke ndërmarrë angazhime afatgjate për të ndihmuar vendet afrikane në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve dhe strukturave të reagimit ndaj krizave. Pavarësisht rezultateve pozitive, për shkak të mungesës së një strukture të qartë të politikës së jashtme të Bashkimit, bashkëpunimi me UA është karakterizuar nga natyra e tij dypalëshe me Shtetet Anëtare sesa nëpërmjet mekanizmave të BE-së.

6.4 Bashkëpunimi me Shoqatën e Kombeve të Azisë Juglindore

Bashkimi European ka interesa strategjike në forcimin e marrëdhënive të bashkëpunimit me Shoqatën e Kombeve të Azisë Juglindore (në vijim ShKAJL). Forcimi i pozitës, i ndikimit dhe integrimi i saj është mirë për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit dhe krijon mundësi për të bashkëpunuar me organizata të tjera rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim përballjen e rreziqeve që kërcënojnë paqen.

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore daton që në vitin 1972, ku palët ranë dakort që integrimi rajonal do të ishte mjeti për të adresuar çështje si ruajtja e stabilitetit rajonal, ndërtimi i shoqërive të zhvilluara dhe përballja me rreziqet që kërcënojnë paqen dhe sigurinë. Fillimisht, bashkëpunimi është karakterizuar nga takime politike, në të cilat diskutohej në lidhje me rreziqet e mundshme që mund t'i kanoseshin rendit botëror, sesa nga një bashkëpunim konkret për krijimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes apo për

⁴⁵⁴ <http://www.eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 26 Shtator 2015).

⁴⁵⁵ Ibid.

menaxhimin real të situatave të konfliktit. Pra, ky bashkëpunim më tepër ka rezultuar në përpilimin e deklaratave politike me karakter jodetyrues, sesa në krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit nga të cilat të burojnë detyrime ligjore për palët e përfshira në to.

Ndërkohë që kriza e viteve 1997 – 1998 dhe aktet terroriste të 11 Shtatorit, i bënë të qartë Europës se pavarësisht distancës gjeografike, konfliktet rajonale dhe lokale të ndodhura në Azi përbënin një rrezik të mundshëm për stabilitetin ekonomik dhe politik të saj. Nevoja për ndryshimin e politikës së deriatëhershme të BE-së në Azi, shprehet qartë edhe në Komunikatën e Komisionit drejtuar Këshillit më 13 Korrik 2001, ku ndër të tjera thuhet se BE-ja duhet t'i kushtojë më tepër rëndësi bashkëpunimit me Azinë, nëpërmjet riformulimit të politikave të vjetra dhe krijimit të fushave të reja të bashkëpunimit. Ndërsa në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë, BE-ja duhet të kontribuonte në stabilitetin e rajonit dhe të ndihmonte në ruajtjen e paqes në Azi, me qëllim ruajtjen e interesave të saj ekonomike dhe ato në fushën e sigurisë.

Këto priorite u bënë më të qarta me adoptimin e Strategjisë për Azinë, e cila kishte si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Europës dhe Azisë në fushën e sigurisë dhe më konkretisht në drejtim të⁴⁵⁶:

- *Forcimit të angazhimit të BE-së në Azi në fushën e politikës dhe në atë të sigurisë.*
- *Krijimit të aleancave me partnerët aziatikë me qëllim reagimin ndaj sfidave të përbashkëta, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë forcimit të dialogut dhe shkëmbimit të eksperiencave në rastet e parandalimit të konflikteve.*
- *Ndërgjegjësimi të përbashkët për rreziqet e reja që i kanosen paqes dhe sigurisë.*

Në 2003 Komisioni hodhi idenë për ndërtimin e një partneriteti të “ri” me Azinë, pasi fuqizimi i pozitës së SHKAJL-së do të ishte garancia më e mirë për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në rajon. Përveç bashkëpunimit për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, mirëqeverisjen, drejtësinë, punët e brendshme dhe tregtinë, BE-ja në fushën e prioritetëve të saj shtoi edhe bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, ku ajo do të ofronte eksperiencën e saj në rastet e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve, shoqëruar me mbështetjen e saj në terren në rastin e misionëve të ndërmarra nga këto shtete⁴⁵⁷. Të njëjtin qëndrim, në lidhje me rëndësinë e bashkëpunimit me vendet e Azisë, BE-ja mbajti edhe me miratimin e Strategjisë Europiane të Sigurisë.

Nevoja për forcimin e bashkëpunimit midis këtyre organizatave dhe zgjerimi i mëtejshëm i tij është theksuar edhe në një sërë dokumentash dhe mbledhje të karakterit politik të mbajtura në vazhdim. Në 19 Maj 2015 Përfaqësuesi i Lartë i BE-së dhe Komisioni miratuan Komunikatën e Përbashkët “BE-ja dhe Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore Një bashkëpunim me qëllim strategjik”, e cila parashikonte ide konkrete për të forcuar bashkëpunimin sektorial dhe sipas një strukture të mirëpërcaktuar dhe të përditësuar⁴⁵⁸. Nga analiza e këtij dokumenti rezulton se që ky bashkëpunim do të shtrihej në këto fusha:

⁴⁵⁶ The Commission, *Enhancing the Asia Strategy*, <http://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁵⁷ *Commission launches a 'new partnership' with South East Asia* (09 Korrik 2003), <https://www.google.al/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

⁴⁵⁸ <https://eur-lex.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 27 Prill 2018).

- **Tregëtia dhe investimet** – Sipas statistikave të publikuara nga BE-së, kjo e fundit rezulton të jetë një nga partnerët kryesorë në tregëti dhe investitori kryesor në investimet direkte të huaja. Aktualisht BE-ja ka përfunduar negociimin e Marrëveshjeve të Tregëtisë së Lirë me Singaporin dhe Vietnamin dhe është duke vazhduar negociimin me shtetet e tjera anëtare të ShKAJL. Përveç marrëveshjeve të tregëtisë dhe asistencës financiare, BE-ja do të mbështesë organizatën për të promovuar një rritje ekonomike të qëndrueshme, për të krijuar një klimë të përshtatshme për kryerjen biznes, harmonizimin e standarteve, forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e standarteve ndërkombëtare të së drejtës së punës, të mbështesë rritjen socialo ekonomike të shoqërisë dhe krijimin e mundësive që Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme të BE-së të jenë aktive dhe në shtetet anëtare të ShKAJL-së. Lufta për zotërim territorial në jug dhe në lindje të detit të Kinës përbën problem jo vetëm për interesat ekonomike të BE-së por edhe për stabilitetin e rajonit.
- **Edukim, kërkim shkencor dhe kulturë** – BE-ja mbështet bashkëpunimin në drejtim të kërkimit shkencor, shkëmbimit të studentëve nëpërmjet programeve të studimit, modernizimin e sistemit të edukimit dhe zhvillimit të panairëve të edukimit arsimor.
- **Bashkëpunimi politik** – Në funksion të ndërtimit të një partneriteti politik, BE-ja bashkëpunon për promovimin dhe garantimin e standartave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, siç është shfuqizimi i dënimit me vdekje.
- **Bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes** – Ndonëse bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe ShKAJL është fokusuar në çështje ekonomike dhe sociale, në vijim këto organizata angazhohen të vijojnë bashkëpunimin dhe për çështje të sigurisë detare dhe piraterisë, menaxhimit të katastrofave natyrore, krimit ndërkufitar, luftës kundër terrorizmit, trafikimit, krimit kibernetik, varfërimit të armëve të shkatërrimit në masë, konflikteve për kufinj të mbikëqyrjen e zhvillimit të zgjedhjeve elektorale. Shtimi i fushave jotradicionale të bashkëpunimit tregon se BE-ja është e interesuar që nëpërmjet ShKAJL të ruajë stabilitetin dhe paqen në rajon, pasi çdo konflikt mund të precipitohet duke u bërë kërcënim dhe për sigurinë e Bashkimit.
- **Integrimi dhe ndërlidhja** – Në komunikatën për “Politikën e Jashtme të Aviacionit të BE-së” Komisioni theksoi rëndësinë që do të kishte për të që ShKAJL të krijonte një treg të përbashkët të aviacionit civil. Në këtë drejtim BE-ja do të ofronte asistencën e saj teknike për krijimin e strukturës institucionale, me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët të sigurtë dhe të qëndrueshëm. Gjithashtu, Banka Europiane e Investimeve dhe Shtetet Anëtare do të mbështesnin me financime ndërtimin e një sistemi të përmirësuar të transportit urban.
- **Bashkëpunimi sektorial** – Të dy këto organizata kanë interes të bashkëpunojnë dhe për çështje, të cilat ndonëse jo në mënyrë të drjetpëdrejtë ndikojnë në stabilitetin e rajonit dhe më gjerë të Europës, siç janë ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale, shfrytëzimit të burimeve ujore dhe energjitike nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave, të praktikave më të mira dhe gjetjes së zgjidhjeve më efektive.

Nga pikëpamja institucionale mund të themi se, anëtarësimi i BE-së në Forumin Rajonal të ShKAJG dhe në Këshillin për Siguri dhe Bashkëpunim në Azi dhe Paqësor, si një anëtar me të drejta të plota, ndikoi në forcimin e bashkëpunimit ndër rajonal ndërmjet këtyre organizatave. Ky bashkëpunim u forcua më tej nëpërmjet zhvillimit të mbledhjeve dypalëshe. Nën politikën e një bashkëpunimi efektiv shumëpalësh në 2005 BE-ja bashkëpunoi së bashku me disa Shtete Anëtare të ShKAJG (Tajlandën, Malajzinë, Brunein, Filipinet dhe Singaporin), Norvegjinë dhe Zvicrën në misionin monitorues në Aceh, Indonezi, mandati i së cilit ishte monitorimi i zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit të arritur ndërmjet Lëvizjes për Lirinë e Aceh dhe Qeverisë së Indonezisë, duke kontribuar në një zgjidhje paqësore, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të situatës së konfliktit⁴⁵⁹.

Në përfundim mund të themi se, që pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe ShKAJL kanë përparuar së tepërmi duke u bërë më sistematike, më koherente dhe më gjithëpërfshirëse. Siç duket nga aktet e miratuara nga Bashkimi, tashmë Azia është pjesë e axhendës ndërkombëtare të tij dhe bashkëpunimi nuk shtrihet ngushtësisht vetëm në fushën e sigurisë, por edhe në fusha si tregëtia, ndryshimet klimaterike, transporti dhe ndërlidhja të cilat ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në stabilitetin e rajonit dhe më gjerë të Europës.

Programet e BE-së në kuadër të bashkëpunimit me SHKAJL-në kanë qenë një vlerë e shtuar për nxitjen dhe forcimin e bashkëpunimit, edhe pse disa nga këto kanë qenë mjaft ambicioze dhe jo në pajtim me axhendën e SHKAJL-së. Zbatimi në praktikë i këtyre programeve ka hasur në mungesën e eksperiencës, të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve dhe mungesën e gadishmërisë së strukturave paralele në SHKAJL-në, sidomos të Sekretariatit. Pavarësisht angazhimit të këtyre organizatave për të forcuar bashkëpunimin ekonomik dhe politik, përparimi i ngadaltë i BE-së për të përfunduar marrëveshjet e bashkëpunimit i ka lënë vend iniciativave të Shteteve Anëtare, të cilat kanë ndjekur mbrojtjen e interesave të tyre në rajon.

Investimi në këtë bashkëpunim do të sjellë përfitime të rëndësishme për interesat e ekonomike dhe politike të BE-së. Nga ana tjetër BE-ja nëpërmjet iniciativave të saj luan një rol të rëndësishëm në integrimin e organizatës dhe në nxitjen e konkurrencës në ekonomi. Edhe pse BE-ja dhe ShKAJL-ja janë partnerë strategjikë në integrimin e tyre, ndërmjet tyre ka dallime të mëdha si përsa i përket zhvillimit ekonomik, sistemit të tyre politik dhe institucional. Për shkak të natyrës ndërqeveritare të kësaj organizate, sistemit të vendimmarjes mbi bazë konsensusin, buxhetit të ulët (vetëm 16 milion dollarë në vit dhe kontribut i barabartë nga të gjitha shtetet) dhe pozitës së dobët politike të Sekretariatit, realizimi i objektivave të vendosura nga aktet e themelimit dhe krijimi i një rajoni të sigurtë për qytetarët e saj paraqitet mjaft sfidues.

Ndikim në këtë drejtim ka pasur dhe fakti që tradicionalisht BE-ja e ka konsideruar veten si “soft power”, duke mos u përpjekur për të vendosur dominancën e saj në rajon, siç po veprojnë aleatët e saj SHBA dhe Kina. Kjo e fundit ka mbajtur marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me BE-në, jo për të inkurajuar angazhimin e Bashkimit në rajon por për të ndikuar qëndrimin e tij në

⁴⁵⁹ EU Council Secretariat, *EU monitoring mission in ACEH (Indonesia)* (07 Shtator 2006), <http://www.eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

çështje të sigurisë në Siri, Iran dhe në Afrikën e Veriut. Ndonëse BE-ja i kushton rëndësi dialogut politik dhe zgjidhjes së çështjeve duke respektuar parimet e së drejtës ndërkombëtare, ajo duhet të marrë masa për të përballuar “pushtimin” e Kinës duke ndjekur një politikë më të fortë ndaj saj. Si shembull mund të përmend, konfliktin midis Kinës dhe Japonisë për Ishujt Senkaku në lindje të Detit të Kinës, ku BE-ja nuk ndërhyri duke ruajtur paanshmërinë e saj, e cila dukej që ishte ndikuar nga presioni i ushtruar nga Kina. Kjo qasje e BE-së ndaj çështjeve që i përkasin sigurisë së Azisë është edhe më pak efektive kur gjithnjë e më shumë po rritet shitja e armëve që vijnë nga Europa, përfshirë dhe Kinën. Pavarësisht politikave të embargos së armëve Shtetet Anëtare e shikojnë tregun kinez si një nga më fitimprurësit.

Problem tjetër për bashkëpunimin BE-ShKAJL është edhe rritja e problemeve politike në Mianmar, Tajlandë dhe në Indonezi, të cila e përballnin BE-në me sfida të reja. Pas zgjedhjeve politike të 2015, BE-ja ndërhyri në Mianmar duke ofruar ndihmat financiare në mbështetje të komisionit për të drejtat e njeriut, ndërmarrjes së reformave në drejtësi, në administratë dhe në polici, trajnimeve për respektimin e të drejtave të njeriut, nxitjes së dialogut midis grupeve etnike dhe ngritjes së Qendrës së Paqes. Pas puçit ushtarak në 2014 në Tajlandë, BE-ja ndërpreu tregëtinë me vendin dhe u angazhua në ndërmarrjen e reformave për rikthimin e demokracisë.

Angazhimi i BE-së në Azi ka rëndësi për tre arsye: *Së pari*, pozicioni gjeografik, ndryshimet demografike, rritja ekonomike janë elementë të cilat duhet të merren parasysh nga Bashkimi, pasi po ndryshojnë në mënyrë të menjëhershme. *Së dyti*, natyra globale e rreziqeve me të cilat po përballlet rendi botëror si krizat ekonomike, pasurimi i armëve të shkatërrimit në masë, pandemitë, ndryshimet klimaterike, lëvizjet migratore dhe aktet terroriste kërkojnë një bashkëpunim dhe koordinim të veprimeve jo vetëm në nivel rajonal por edhe global. *Së treti*, marrëdhëniet e BE-së me Azinë i jep përgjigje pyetjeve që lidhen me rëndësinë e BE-së si aktor ndërkombëtar. Ndonëse shtete si Kina, Japonia dhe India janë të afta për të ndërmarrë reforma dhe për të mbrojtur interesat e tyre, shtetet e vogla anëtare të ShKAJL kanë nevojë për angazhimin e aleatëve ndërkombëtarë.

KAPITULLI VII

SFIDAT E SË ARDHMES. NJË BASHKIM EUROPIAN I RI DHE NJË NATO E RE

7.1 Bashkimi European si një aktor global

Përfundimi i Luftës së Ftohtë solli midis akademikëve dhe analistëve debatin se çfarë rendi botëror është duke lindur. Teza unipolare, sipas së cilës aktori dominues në arenën ndërkombëtare vazhdon të jetë SHBA-ja, ka qenë ajo më e përhapura, e cila përkrahej nga Stephen Brooks dhe William Wohlforth⁴⁶⁰. Ndërkohë në kundërshtim të kësaj teze ishte ajo e mbrojtur nga presidenti i Këshillit për Marrëdhëniet me Jashtë, Richard Haass, i cili parashikonte një kaos në arenën ndërkombëtare ndërkohë që dominanca dhe ndikimi i SHBA-së do të zëvendësohej nga një shumëllojshmëri aktorësh, duke nisur që nga shtetet, regjimet rajonale, organizatat jofitimprurëse, individët dhe deri tek media. Ky lloj rendi botëror do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë tek SHBA-ja dhe të tërthortë në organizatat që ajo aderonte, përfshirë NATO-n⁴⁶¹. Një sistem i tillë multipolar dhe i pabalancuar për neo realistët është shkak për konflikte dhe luftë për zonat e influencës⁴⁶².

Para rreziqeve “moderne” që i kanosen rendit botëror si pasurimi i armëve të shkatërrimit në masë, ngrohja globale, ekspansioni i Kinës dhe terrorizmi fetar, politika nuk duhet të mbetet më një çështje e brendshme, por shtetet dhe organizatat duhet të përshtasin politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe të zgjerojnë fushat e bashkëpunimit. Domsdoshmëria për ndryshim dhe përshtatje vlen edhe për BE-në, i cili sikurse ka thënë dhe presidenti Barak Obama, vetëm duke dhënë kontributin e tij ai do të jetë një partner strategjik serioz dhe do të ketë një rol të rëndësishëm në sigurinë botërore⁴⁶³.

Besueshmëria dhe legjitimiteti i BE-së si një aktor ndërkombëtar nuk buron nga aftësia vendimarrëse e institucioneve të tij, por së pari nga aftësia për të përdorur asetet dhe kapacitetet e tij civile dhe ushtarake për menaxhimin e krizave dhe së dyti nga gama e gjerë të instrumenteve në dispozicion të tij, të cilat i mundësojnë të ndërhyjë me efektivitet në ato situata konflikti ku të tjerët si SHBA-ja, NATO dhe OKB-ja, për çfarëdolloj arsye, si koha e gjatë e mobilizimit apo numri i madh i forcave dhe i paisjeve mbështetëse, e kanë të pamundur të ndërhyjnë.

Rëndësi në këtë drejtim merr dhe shumëllojshmëria e objektivave të vendosura nga BE-ja, si mbrojtja e të drejtave të njeriut, forcimi i demokracisë dhe ndërtimi i shtetit të së drejtës, rindërtimi i vendit pas konfliktit, ndërhyrjet humanitare, të cilat nuk kërkojnë domsdoshmërisht elementin ushtarak dhe i mundësojnë Bashkimit një përjasje ndryshe ndaj krizave. Kjo aftësi e

⁴⁶⁰ Stephen G. Brooks dhe William C. Wohlforth, *World Out of Balance: International Relations and the Challenge of American Primacy* (Princeton NJ: Princeton University Press, 2008).

⁴⁶¹ Richard N. Haass, “The Age of Non-Polarity: What Will Follow US Dominance?”, *Foreign Affairs*, May/June 2008.

⁴⁶² Kenneth N. Waltz, *Theory of International Politics*, (Reading, MA: Addison-Wesley, 1979), fq. 161-63.

⁴⁶³ <http://www.whitehouse.gov/> (hyrë për herë të fundit më 5 Nëntor 2017).

ndërthurjes së komponentit civil me atë ushtarak, pavarësisht se ky i fundit duhet të forcohet më tej edhe nëpërmjet autonomisë së financimit dhe forcimit të industrisë së rëndë, i mundëson Bashkimit adresimin në mënyrë të gjithëanëshme të krizave dhe përbën një vlerë të shtuar për sigurinë botërore.

Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, që nga çasti që është deklaruar operacionale nga BE-ja, ka shënuar rezultate pozitive dhe negative. Vlera e shtuar e PESM-së shihet së pari në legjitimitetin që i dha operacioneve të ndërmarra nga Bashkimi, pasi ai vepron mbi bazën e konsensusit të arritur nga Shtetet Anëtare, të cilat nuk mundën që më pas të kenë pretendime për ligjshmërinë e operacioneve. Në këtë drejtim ka ndihmuar dhe fakti që BE-ja vepron nën mburojën e OKB-së, ndërhyrjet e së cilës janë më të lehta për t'u pranuar nga popullsia dhe drejtuesit e vendeve në konflikt, sesa ato të kualicioneve *ad hoc* ose të NATO-s. Një avantazh tjetër është edhe gama e gjerë e objektivave të PESM-së, duke përfshirë në të si komponentin ushtarak edhe atë civil në drejtim të ndihmës së ofruar për stabilizimin dhe rindërtimin e vendit pas vendosjes së paqes, ndihmat humanitare, ndihma në drejtim të krijimit të institucioneve demokratike dhe të një shteti të së drejtës, reformimi i qeverisjes lokale etj.

Përsa i përket anëve negative të evidentuara gjatë zbatueshmërisë së PESM-së dhe që minuan rolin e BE-së si një aktor kyç i sigurisë botërore mund të përmend pamjaftueshmërinë në kapacitete dhe ngurimin e Shteteve Anëtare për të venë në dispozicion të Bashkimit burimet e nevojshme për ndërmarrjen e operacioneve dhe misioneve. Një element tjetër është edhe mungesa e institucioneve dhe e strukturave të përhershme, pasi bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes mbështetet kryesisht në komisione *ad hoc*. Mungesa e një komande europiane të unifikuar, të njësisive të përhershme dhe të manovrave të përbashkëta në terren. Në këtë drejtim ndikim ka pasur dhe mospërputhja midis objektivave të vendosura nga BE-ja në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe *status quo*-ja e PESM-së në politikën e jashtme. Gjithashtu, roli i NATO-s si një ofrues kryesor i mbrojtjes kolektive ka ndikuar në minimizimin e rolit të BE-së. Shtetet Anëtare të cilat janë dhe anëtare të aleancës me qëllim ruajtjen e sovranitetit të tyre për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes preferojnë të veprojnë në kuadër të NATO-s.

Sfidat me të cilat është përballuar politika europiane i kanë mësuar Bashkimit se për të qenë një aktor kyç i sigurisë botërore duhet që:

Së pari, PESM-ja të ristrukturohet dhe të rimarrë vendin e saj në kuadër të politikës së jashtme, duke mos u konceptuar si një shtyllë e tretë e politikës së BE-së. Ajo si një instrument në shërbim të rolit të Bashkimit në arenën ndërkombëtare duhet të konsiderohet si pjesë e asaj që ai bën si një aktor ndërkombëtar i sigurisë. Qëllim dhe prioritet i PESM-së duhet të mbetet forcimi i rolit politik të BE-së duke i kushtuar rëndësi dhe forcimit të kapaciteteve civile dhe shndërrimit të tij në një organizatë që posedon të gjitha mjetet për zgjidhjen e krizave si ato ligjore, ekonomike, humanitare, financiare, civile dhe ushtarake.

Së dyti, përcaktimi i qartë i rolit të BE-së në rendin ndërkombëtar. Nëse mbrojtja konsiderohet si një element i politikës së jashtme, objektivat dhe aspiratat që synon të arrijë në mbrojtjen kolektive duhet të jenë të qarta. Përveç stabilizimit dhe rindërtimit të vendit pas konfliktit, procesit të zgjerimit me anëtarë të rinj dhe të stabilizimit të zonave fqinje që mund të

përbëjnë rrezik për sigurinë e Bashkimit çfarë objektivash të tjera duhet të përcaktojë PESM-ja që të ndihmojë në ndërtimin e rendit botëror që Bashkimi dëshiron? Çfarë sistemi sigurie i shërben më së miri interesave dhe vlerave europiane? A duhet që interesat strategjikë të BE-së t'i përshtaten atyre të SHBA-së apo të NATO-s? A duhet që në kushtet e një qeverisje globale Bashkimi të përshtasë institucionet dhe politikat e tij? Pra, a duhet që BE-ja nëpërmjet politikës së saj të jashtme të forcojë më tej pozitën e saj në sistemin e sigurisë apo të mjaftohet vetëm me forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe politik?

Së treti, përcaktimi i kushteve të bashkëpunimit me SHBA-në, kur as PESM-ja dhe as NATO nuk janë aktorë politikë të pavarur. PESM-ja do të mbesë instrumenti civil dhe ushtarak i politikës së jashtme të Bashkimit, ndërsa NATO do të jetë instrumenti i solidaritetit ushtarak ndërmjet SHBA-së dhe Europës. Për këtë arsye është e nevojshme të bëhet një dallim, nga njëra anë bashkëpunimi taktik dhe teknik NATO-BE, i cili duhet të jetë i përkohshëm dhe *ad hoc*, dhe nga ana tjetër një bashkëpunimi strategjik me SHBA-në për çështje të interesit të përbashkët duke përfshirë edhe operacionet ushtarake që kërkojnë ndërhyrjen e NATO-s, i bazuar ky bashkëpunim mbi instrumente politike të përhershme. Ndër të tjera, në rast se ndërhyrja ushtarake është e domosdoshme në rast të një krize dhe SHBA vendos të marrë pjesë në operacion, NATO do të jetë mjete legjitim për të ndërhyrë dhe kapacitetet dhe burimet e BE-së mund të përdoren për të mbështetur misionin e NATO-s, në kuadër të bashkëpunimi *ad hoc* NATO-BE dhe mbi bazën e një strategjie të përbashkët BE-SHBA. Në raste të tjera, ku elementi ushtarak nuk është i zbatueshëm për çështje si psh. terrorizmi, Irani, procesi i paqes ndërmjet Izraelit dhe Palestinës, ose në rast të një konflikti të armatosur ku SHBA nuk dëshiron të ndërhyjë, si psh. rasti i Afrikës, NATO nuk do të luajë asnjë rol pasi në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë përgjegjësia do t'i përkasë BE-së.

Në vijim të këtij arsyetimi BE-ja duhet të ketë parasysh që: a.) Veprimet dhe qëndrimet e saj për çështje të politikës së jashtme duhet të karakterizohen nga qëndrueshmëria. b.) PESM-ja duhet të kalojë nga bashkëpunimi *ad hoc* në të përhershëm dhe nga bashkëpunimi në integrim. Kjo nënkupton krijimin e strukturave dhe të mekanizmave të përhershëm të bashkëpunimit, krijimin e një komande europiane, krijimin e njësisive të përhershme të reagimit të shpejtë dhe të një force për të reaguar në rast katastrofash natyrore dhe të krijimit të një fondi të pavarur për financimin e operacioneve, me qëllim që ajo mos të jetë e varur nga dashamirësia e Shteteve Anëtare. c.) Pajisja me kapacitetet e nevojshme për të patur një pavarësi strategjike. Në rast se BE-ja dëshiron të parandalojë shpërthimin e një konflikti, të bëjë diferencën në një operacion dhe të konkurojë me aktorët e tjerë të mbrojtjes kolektive duhet të jetë e pajisur me të gjitha kapacitetet e nevojshme që nga ato të planifikimit dhe të mbledhjes së informacionit, në ato të drejtimit dhe të financimit të tij. d.) Të legjitimojë Europën si garantuese dhe mbrojtëse së sigurisë. Në kushtet kur efektshmëria e masave të ndërmarra nga Bashkimi kushtëzohet nga ndarja në tre shtylla të politikës së tij dhe nga interesat e Shteteve Anëtare, ai duhet të vërë sa më shpejt në zbatim klauzolën e solidaritetit. e.) Të mos tërhiqet nga aktorët e tjerë në anën e gabuar

të një konflikti, duke i kushtuar rëndësi në rradhë të parë garantimit të sigurisë territoriale dhe të interesave të Bashkimit⁴⁶⁴.

Me ndryshimet që po përballet rendi botëror përreth BE-së, rendi dhe siguria po kërcënohet nga rreziqe të reja, duke nisur nga ato të natyrës ekonomike si kundërshtimi i modelit perëndimor të ekonomisë së tregut dhe daljes së shteteve si aktorë të rëndësishëm financiarë dhe ekonomikë. Në Azi problem mbetet forcimi i pozitës së Kinës, e cila po shtrin fuqinë e saj në Afrikë, dhe të Indisë, e cila e ka shtrirë influencën e saj në Azinë Jugore dhe më tej. Siguria e kufinjve të BE-së kërcënohet dhe nga pirateria në brigjet e Somalisë dhe në perëndim të Oqeanit Indian, e cila ka ndikim dhe në ekonominë e tij, konfliktet civile në rajonin e Afrikës së Veriut dhe në Lindjen e Mesme dhe nga fluksi i refugjatëve.

Pavarësisht se një nga objektivat e PESM-së është edhe varfërimi i armëve të shkatërrimit në masë, programet bërtahmore të Iranit dhe të Koresë së Veriut vazhdojnë të jenë shqetësim për rendin dhe sigurinë europiane. Forca e Bashkimit dhe politika e tij për zgjerim përballet me përpjekjet e Rosisë për të bërë pjesë të politikës së saj dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila duke kontrolluar dhe rrugët e transportit të naftës dhe të gazit natyror, përpjekje të cilat u finalizuan me ndërhyrjen e saj në Gjeorgji, synon të rifitojë pozitën e saj strategjike në rajon. Ndodhur para këtyre kërcënimeve BE-ja duhet të forcojë sigurinë në rrethinat e saj, duke ndjekur një politikë të qartë dhe efektive.

Duke u përballur me sfidat më të vështira që nga Lufta e Ftohtë, Europa duhet të jetë më e përkushtuar se kurrë për mbrojtjen e qytetarëve të saj. Ky angazhim, megjithatë, nuk mund të arrihet në mënyrë autonome. Për të ofruar paqe, prosperitet, siguri dhe mbrojtje, Europa duhet të besojë dhe të mbështetet në fuqinë e përpjekjeve dhe aftësive të përbashkëta, domethënë të ardhur nga NATO - së bashku me Shtetet e Bashkuara dhe Kanada - dhe Bashkimi Europian, të cilat kanë jo vetëm 22 anëtarë të përbashkët, por edhe të njëjtat vlera.

Nga sa më lart, BE dhe NATO publikuan një deklaratë të përbashkët në Varshavë, në interes të zhvillimit të opsioneve konkrete për zbatimin, në lidhje me interesat e tyre strategjike, të hartuara për të adresuar sfidat e ardhshme të Europës. Së bashku me Strategjinë e re Globale të BE-së e cila ende e konsideron NATO-n si "kornizën primare" të mbrojtjes kolektive për shumicën e Shteteve Anëtare, pavarësisht nga qëllimi i saj për të siguruar veprimin e jashtëm të BE me aftësitë dhe mjetet për të vepruar në nivel kombëtar ose struktura multilaterale, si NATO, ose vetëm si një aktor i pavarur i sigurisë (përmes dispozitave të PMSP-së të parashikuara në Traktatin e Lisbonës), këto dy dokumente bëhen shumë të ndërlidhura dhe përforcohen reciprokisht.

Për më tepër, ekziston një konsensus rreth lidhjes midis fqinjëve dhe partnerëve të Europës - si Ballkani Perëndimor, Gjeorgjia, Ukraina apo Afrika e Veriut - stabiliteti dhe siguria e kontinentit të vjetër. Prandaj, NATO dhe BE kanë vendosur të zgjerojnë kompromisin e tyre të

⁴⁶⁴ Nicole Gnesotto, "The need for a more Strategic EU" në "What Ambition for European Defence 2020", *European Union Institute for Security Studies*, Second Edition (Paris, 2009), fq. 36

vazhdueshëm me zhvillimin e paqes, elasticitetit dhe mirëqenies së qëndrueshme në këto vende, në dritën e Politikës së Hapur të NATO-s dhe Politikës Europiane të Fqinjësisë së BE-së⁴⁶⁵.

Megjithëse marrëdhënia ndërmjet NATO-s dhe BE-së mund të jetë komplekse, rritja e saj është padyshim urgjente, duke marrë parasysh sfidat aktuale që kërcënojnë kuadrin në të cilin ato veprojnë. *Së pari*, pasiguria politike në këto çështje pengon mundësinë e një sinergjie të plotë në nivelin e BE/NATO. *Së dyti*, përkundër lehtësimit të krizës financiare të Europës, problem mbetet ulja e buxhetit të mbrojtjes kombëtare. *Së treti*, rezultatet si zgjedhja e Brexit dhe Trump në SHBA krijojnë edhe më shumë paqartësi në nivelin e sigurisë, duke qenë se Britania e Madhe është një nga shpenzuesit kryesorë të mbrojtjes në Europë, dalja e saj nga BE e ka bërë rolin e saj në sigurinë europiane shumë të paqartë. Në Amerikë, ekziston një shqetësim i thellë që Presidenti Trump do të ulë shpenzimet amerikane me NATO-n; *Së katërti*, qëndrimi agresiv i Rusisë në territore si Krimea në Ukrainë dhe taktikat hibride përbëjnë një kërcënim që nuk do të zhduket lehtë. *Së pesti*, Turqia gjithashtu mund të shfaqet si një partner i paqëndrueshëm, duke marrë parasysh ngjarjet e fundit politike që ndodhën në këtë vend. *Së pesti*, aktet e terrorizmit në Europë, Afrikë dhe Lindjen e Mesme, të përjetësuar nga kërcënimet transnacionale si ISIS, kërkojnë jo vetëm veprime urgjente, por sidomos bashkëpunimin për të parandaluar sulme të mëtejshme⁴⁶⁶.

Për të përmbushur këto interesa strategjike, NATO dhe BE-ja u pajtuan të ndërmarrin veprime në fusha të tilla si: kërcënimet hibride (nëpërmjet informacionit dhe shkëmbimit të informacionit, por edhe komunikimit strategjik dhe reagimit), siguria kibernetike dhe mbrojtja (në misionet dhe trajnimin), lufta kundër piraterisë dhe kontrabandës njerëzore në Afrikë, të krijuara nga migracioni i lartë dhe rrjedhat e refugjatëve, forcimi i bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes dhe hulumtimet brenda komunitetit euroatlantik.

Ndryshimet në mjedisin e sigurisë së Europës ngrenë pyetje të rëndësishme në lidhje me kundërpërgjigjet e organizatave ndërkombëtare të interesuara, Bashkimit Europian dhe NATO-s. Ndërhyrja ruse në Ukrainë ka ndryshuar rrënjësisht situatën në kufijtë lindorë të Europës. Neni 5, (detyra kryesore e NATO-s), ka rifituar pozicionin e saj qendror siç është konfirmuar dhe në Samitin e Uellsit. Megjithatë, natyra hibride e kërcënimeve të reja ndaj Aleancës dhe BE-së vënë pikëpyetje ndërmarrjet thjesht ushtarake të marra nëpërmjet planeve të gadishmërisë dhe Task forcës së gatshme (Very High Readiness Joint Task Force (VJTF)). Përveç kësaj, konflikti është bërë normë në pjesë të mëdha të Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore (zona MENA). Shteti Islamik ka sjellë nivele ekstreme të dhunës brutale, ky entitet që herë silltet si aktor-shtet dhe herë si aktor jo shtet, përziën në përditshmërinë e terrorit të tij herë forma të luftës konvencionale e herë jokonvencionale. Në këtë optikë, politikat BE-së, në këtë zonë të paktën, janë të vjetëruara e të paaplikueshme. PMSP-ja, e projektuar fillimisht për t'u marrë me konfliktet në si në Bosnjë, ka nevojë për një rishikim thelbësor⁴⁶⁷.

⁴⁶⁵ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017).

⁴⁶⁶ <http://www.atlanticcouncil.org/> (hyrë për herë të fundit më 02 Korrik 2017).

⁴⁶⁷ <https://www.clingendael.org/> (hyrë për herë të fundit më 02 Korrik 2017).

Në përgjigje të ndryshimit të mjedisit të sigurisë BE dhe NATO kanë nevojë për strategji të reja. Por të dy organizatat do të duhet gjithashtu të nisin një rishikim se cilat do të jenë në të ardhmen nevojat e tyre (qoftë ushtarake qoftë teknike). Në të njëjtën kohë, NATO po lufton me çështjen se si duhet t'i përgjigjet kërcënimeve të tilla hibride, për të cilat organizata duket se nuk i ka akoma mjetet e nevojshme. BE-ja, nga ana tjetër, disponon instrumente jo-ushtarake për t'u ndeshur me këto kërcënime: masa diplomatiko-politike, politika ekonomike, tregtare dhe energjetike; sanksionet financiare dhe ekonomike, etj.

Sa i përket kapaciteteve, BE-ja ka përparuar mirë në zhvillimin e një qasje gjithëpërfshirëse. Por sa i vlefshëm është kjo qasje në konfliktet ku kolapsi i një shteti është elementi dominues dhe ku institucionet e dala nga shtete të rrënuara janë grupe ekstremiste?

Pra, reagimi i të dy aktorëve (NATO dhe BE) në një mënyrë të integruar, i cili është shumë e dëshirueshëm në përgjigje të kërcënimeve hibride, mbetet një sfidë e madhe dhe akoma e hapur.

7.2 Sfidat e së ardhmes, të ndryshme dhe të palidhura

• Rusia në kërkim të shkëlqimit të humbur

Pas thujse një dekade të vendosjes së rregullit brenda në shtëpi, Rusia i ka hedhur sytë dhe njëherë jashtë saj dhe ka vendosur që gjërave t'i shkojë deri në fund. Fillimisht u mendua se lufta në Gjeorgji ishte një hap i ngutur dhe i vogël i një dëshire ekspansioniste ruse, por konflikti i Ukrainës tregoi se Rusia ka planifikuar që të vendosë rregull edhe në oborrin e saj të afërt, para se të shtrihet në pjesë të tjera të globit. Me të vërtetë dhe në të drejtë të saj, Rusia mbetet një fuqi botërore dhe normalisht ka dhe duhet të ketë interesat e saj globale, por në mendjen e gjithkujt ngelet një pyetje, sa do të ishte e aftë të vepronte kaq guximshëm nëse nuk do të kishte një dëshirë izolacioniste të fuqive perëndimore? Këto veprime të Ruisë, mund të përkufizohen dhe të jipen si vijon:

➤ **Kërcënime hibride.** Do të ishte më e përshtatshme për të përdorur termin ndërhyrje duke aplikuar si “fuqi të butë” (*soft power*) dhe “fuqia të fortë” (*hard power*). Përdorimi i “fuqisë së butë”, megjithatë, është krejtësisht ndryshe nga kuptimi i saj në Perëndim, ku shihet si një mjet për të tërhequr vendet e tjera drejt komunitetit të përbashkët. Përballë kësaj motori kryesor është pikëpamja ruse e “fuqisë së butë”, domethënë për të ndikuar ose destabilizuar vendet përmes veprimeve jo-ushtarake. Politika e jashtme e Ruisë, sipas konceptit, të dhënë në shkurt 2013, i referohet përdorimit të *myagkaya sila*, i cili, përkthyer më mirë lexohet si “**forcë** e butë” dhe jo “fuqi e butë”⁴⁶⁸. Për Ruisë, ky koncept përfshin detyrimin e drejtpërdrejtë ose destabilizim me mjete që nuk janë të forta, pra çdo mjet përveç ndërhyrjes të drejtpërdrejtë ushtarake dhe shembulli i Ukrainës është shembulli tipik i zbatimit praktik të këtij koncepti⁴⁶⁹.

⁴⁶⁸ General Valery Gerasimov, “The Value of Science in Prediction”, *Military-Industrial Courier* (27 Shkurt 2013).

⁴⁶⁹ Keir Giles, Philip Hanson et.al, “The Russian Challenge”, *Chatham House Report* (June 2015), fq. 42-43, <https://www.chathamhouse.org/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017).

➤ **Modernizimi i forcave ushtarake ruse**⁴⁷⁰. Lufta hibride nuk përjashton përdorimin e forcave të armatosura të rregullta, përkundrazi. *Së pari*, ato mund të përdoren për të ndikuar dhe frikësuar kundërshtarin, për shembull duke kryer manovra dhe stërvitje në kufijtë e shteteve. *Së dyti*, ato mund të përdoren në një konflikt hibrid, në mënyrë të fshehtë, dhe në kombinim me forca të parregullta, siç është rasti në Ukrainën lindore. *Së treti*, dhe më kryesorja, doktrina luftarake Ruse nuk përjashton luftën e hapur dhe të plotë si mënyrën e fundit për të fituar një konflikt dhe për këtë arsye është e domosdoshme pasja e një force të armatosur moderne.

Lufta e Gjeorgjisë në vitin 2008 zbuloi dhe vuri në pah mangësitë e forcave të armatosura të Rusisë për sa i përket të teknologjisë së informacionit, dronëve pa pilot, municioneve të telekomanduara etj. Këto mangësi u përpoqën të rishihen me investime kolosale në buxhetin e ushtrisë për vitet në vijim. Por, presioni i ardhshëm i buxhetit është vetëm një faktor që ndikon në modernizimi. Nivelet e larta të korrupsionit, dobësia e industrisë së mbrojtjes, paaftësia organizative dhe vendosja e objektiavave jo realë e të mundshëm, janë faktorë të tjerë që bëjnë të pamundur rritjen në mënyrë thelbësore të operativitetit të forcave ushtarake ruse.

Sfida kryesore për BE dhe NATO do të jetë përballja me kërcënimet hibride, i cili është opsioni më i mundshëm që Rusia do të përdorë së pari në konfliktet e ardhshme. Por sfida kryesore për Perëndimin do të jetë për t'iu përgjigjur kërcënimit hibrid dhe aktivist të Kremlinit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, që nga *Fuqia e fortë* për *fuqi të butë* dhe nga demonstrimi i hapur i kapaciteteve të saj ushtarake dhe dëshirës për t'i përdorur ato në të njëjtën mënyrë që përdoren dhe nga Kremli zyrtar⁴⁷¹.

- **Kaosi në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme**

Për një kohë të gjatë, “Lindja e Mesme” ishte një sinonim për një zonë gjithnjë të trazuar në Jug-Lindje të Europës. Pas trazirave të Pranverës Arabe që filluan të përhapeshin në Maghreb, termi gjeografik për këtë zonë u bë LMAV (Lindje e Mesme dhe Afrika e Veriut). Sot, edhe LMAV nuk është më akronimi i duhur për të përshkruar këtë zonë me paqëndrueshmëri të madhe shoqërore dhe politike. Konfliktet janë përhapur nga brigjet e Afrikës Veriore në Mesdhe deri në Sahel (Mali, Nigeri) dhe madje edhe në Afrikën Sub-Sahariane (p.sh. Nigeria veriore). Kjo zonë, politikisht është zgjeruar dhe në Lindje, duke përfshirë Afganistanin dhe Pakistanin Veri-Perëndimor. Zgjerimi gjeografik është vetëm një tipar i kaosit në rritje në zonën më të gjerë të LMAV-s. Një karakteristikë tjetër është rritja e aktorëve jo-shtetërorë. Vetëm në Siri, janë të përfshirë në luftime rreth 1,200 grupe të armatosura⁴⁷². Në Libi janë më shumë se 1,700 klanet rivale, bandat kriminale, fraksionet fisnore dhe milicitë islamike po garojnë për pushtet. Por me ngritjen e Shtetit Islamik (ShI) dallimi midis aktorëve jo shtetëror dhe atyre shtetërorë është e bërë paqartë. Duke shpallur Kalifatin Islamik, duke pushtuar dhe mbrojtur e territor si dhe

⁴⁷⁰ <https://www.clingendael.org/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017).

⁴⁷¹ Margriet Drent, Rob Hendriks dhe Dick Zandee, “New Thretas, new EU NATO Responses”, *Netherlands Institute of International Relations*, (July 2015).

⁴⁷² <http://security.blogs.cnn.com/> (hyrë për herë të fundit më 05 Korrik 2017).

instalimin i institucioneve të ngjashme me ato shtetërore, ShI jep përshtypjen e të qenit një “shtet”⁴⁷³.

Efektet e përhapjes së kaosit në zonën më të gjerë të LMAV janë të jashtëzakonshme. *Së pari* dhe më kryesorja, pasojat humanitare janë tronditëse. Sirianët në botë sot mbajnë numrin më të madh të refugjatëve pas palestinezëve, me katër milion njerëz që kanë lënë vendin dhe rreth 8 milionë janë zhvendosur brenda vendit, e të marra së bashku përbëjnë pothuajse gjysmën e popullsisë së paraluftës në vend (22 milionë banorë). Një tjetër tipar i konflikteve në këtë zonë, tipar i cili ka marrë trajta të mëdha pas futjes në skenë të Shtetit Islamik është rritja e luftëtarëve të huaj. Rreth 20,000 xihadistë nga 90 vende i janë bashkuar ShI-it, apo grupeve të tjera ekstremiste në Siri dhe Irak. Shumica e tyre vijnë nga jo Perëndimore si Tunizi (3,000 luftëtarë), Arabia Saudite (2,500) dhe Jordania (2,089) dhe kanë potencialin që të destabilizojnë dhe të kryejnë sulme terroriste edhe në vendet e origjinës⁴⁷⁴.

Këto shtete të përfshira rëndë në konflikte, sot mund të quhen me plot gojën “shtete të dështuara”. Humbja e barrierave kontrolluese mundësojnë rrugë të reja e të rëndësishme tranziti për rrjetet kriminale. Libia është bërë qendër nevriligjike në rajon për trafikim jo vetëm të njerëzve, por edhe drogave, armëve, kontrabandës etj. Diçka mes 25 dhe 75% të drogërave, me prejardhje nga Amerika e Jugut, janë shpërndarë përmes Afrikës Perëndimore nëpër destinacione të Europës. Vendi gjithashtu është bërë një bazë shpërndarje për armët, duke ofruar mundësi të paligjshme për tregtarët e armëve që furnizojnë me këto armë më pas në grupe ekstremiste në Mali, Niger, Nigeri dhe gjetkë në rajon. Sipas një raporti të panelit të OKB-së, Libia është burimi kryesor i armëve të paligjshme. Armë krahu por dhe raketa trafikohen në të paktën katërmëdhjetë vende. Kështu, Libia po ushqen konflikte dhe pasiguri, duke përfshirë edhe terrorizmin, në disa kontinente⁴⁷⁵.

- **Rreziku i Shtetit Islamik (ShI)**

ShI është shfaqur si një kërcënim i madh për sigurinë në zonën e LMAV dhe përtej. "Suksesi" i hasur prej tyre në luftimet e armatosura, dhe propaganda inkurajuese për t'u bashkuar me misionin e Kalifatit, nuk ka tërhequr vetëm luftëtarët e huaj në fushat e betejës së Sirisë dhe Irakut, por gjithashtu ka rezultuar në krijimin e një numri në rritje të bashkëpunëtorëve ShI-së në të gjithë rajonin. Siç u tha më lart, ShI-ja nuk është as një shtet i plotë e i formuar, as një aktor jo shtetëror. E njëjta vlen edhe për karakteristikat e mënyrat e tij të luftimit. Është një kombinim i shumë elementeve: pushtimi tradicional territorial dhe luftimi i parregullt ose gueril, terrorist, por gjithashtu duke shfrytëzuar internetin për rekrutimin, dhe elementet të frikësimit mes terrorit dhe propagandën.

⁴⁷³ Margriet Drent, Rob Hendriks, Dick Zandee, fq. 16

⁴⁷⁴ <https://www.clingendael.org/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017)

⁴⁷⁵ Mark Shaw dhe Liona Mangan, “Illicit Trafficking and Libya’s Transition – Profits and Losses”, *The United States Institute for Peace*, (2014) <https://www.usip.org/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017).

Sipas një studimi të Institutit Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara në Londër⁴⁷⁶, tri mësimet u nxorrën me rëndësi të Ramadit në duart e ShI-së.

- Mësimi i parë është ai, ShI do të mbrojtë territorin që kontrollon dhe është i detyruar ta zgjerojë atë, në përputhje me kredon e tyre për shpalljen e Kalifatit. Për këtë qëllim të mbajtjes së territorit ShI do të shfrytëzojë çdo mundësi, në veçanti kur përballet me forca ushtarakisht të dobëta, si p.sh. ushtria irakiane. Kur sulmohen nga forcat ushtarake që janë të motivuara dhe të gatshëm për të luftuar – si p.sh. në rastin e çlirimit të Kobanit nga kurdët Peshmerga, mbrojtja e organizuar nga ShI ka qenë e fortë, madje edhe nën sulme ajrore. Kjo sjell se për të rimarrë territorin nga ShI, çdo fuqi ushtarake tokësore do të duhet të përballet me humbje të rënda.
- Mësimi i dytë është se SHI mund të kontrollojë relativisht lehtë territorin me popullsi sunite pasi popullsia lokale mund ta konsiderojë terrorin anti-shiit të ShI si një alternativë më të mirë sesa terrori i milicive Shiite të mbështetura nga Irani, të cilat tani janë të vetmet forca e gatshme për të luftuar ShI në provincat sunite si Anbar dhe Nineve.
- Mësimi i tretë ka të bëjë me gjeografinë e zonës. ShI i ka mundur vetes, nëpërmjet zhdukjes defakto të kufinjve, të manovrojë lehtësisht mes Irakut dhe Sirisë.

Gjithçka më lart, tregon se ShI nuk vepron më thjesht si pasojë e veprimeve të palëve të treta, por ka një strategji reaktive dhe efikase.

• Përfshirja e Kinës në Afrikën Qëndrore e të Veriut

Ashtu si dhe Rusia më lart, edhe Kina prej vitesh tashmë ka ndërmarrë një politikë agresive ndaj Afrikës (kryesisht qendrore dhe të Veriut), me qëllim mbrojtjen e interesave të saj, kryesisht ekonomike në këtë zonë. Përfshirja e Kinës në Afrikë bazohet në dy shtylla: diplomacia strategjike dhe biznesi⁴⁷⁷.

Vite më parë, Republika Popullore arriti që me vendet e paangazhuara në Afrikë të krijonte marrëdhënie të ngrohta (edhe pse jo në vazhdimësi) si p.sh. me regjimet socialiste në vende të tilla si Tanzania. Zhvendosja drejt zhvillimit të ekonomisë së Kinës filloi nën Deng Xiaoping në fillim të viteve 1980 dhe si pasojë ndryshoi tonin dhe natyrën e marrëdhënieve me Afrikën. Sigurimi i lëndëve të para për ndërmarrjet shtetërore të Kinës u bë fokusi kryesor i afrimit të Kinës në kontinentin afrikan. Siç ishte tipike e epokës së "rritjes paqësore" të Kinës, bizneset kineze nisën linja prodhimi dhe zhvilluan marrëdhënie tregtare në shumë vende afrikane pa tërhequr shumë vëmendje perëndimore⁴⁷⁸.

Ndërkohë, diplomacia strategjike e Kinës ndryshoi në qëllimin duke u fokusuar pothuajse tërësisht në Tajvan. Shtetet afrikane që kishin marrëdhënie me ishullin ishin "të ndëshkuar" duke iu vënë barriera diplomatike dhe tregtare nga Kina. Interesat e biznesit dhe kultivimi i shumë prej

⁴⁷⁶ Gareth Stansfield, "The Fall of Ramadi: Daesh Next Move", *RUSI Analysis* (19 Maj 2015), <https://rusi.org/> (hyrë për herë të fundit më 14 Qershor 2017).

⁴⁷⁷ <http://www.friendsofeurope.org/> (hyrë për herë të fundit më 04 Korrik 2017).

⁴⁷⁸ Yun Sun, "Xi and the 6th Forum on China-Africa Cooperation: Major commitments, but with questions", *Africa in Focus*, Brookings, 7 December 2015, <https://www.brookings.edu/> (hyrë për herë të fundit më 17 Qershor 2017).

54 votave afrikane të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u bënë objektiva të dyfishtë⁴⁷⁹.

Në vitin 2006, Pekini nxorri dokumentin e parë zyrtar të tijin për Afrikën, duke bërë thirrje për “bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë”. Duke ndjekur një thënie të vjetër kineze, “për t’i dhënë fund varfërisë, mjafton të ndërtoni një rrugë”, kompanitë kineze u përfshinë gjithnjë e më shumë në ndërtimin e infrastrukturës, energjitikë etj, si dhe eksplorimin e mineraleve dhe krijimin e tregjeve për produktet kineze⁴⁸⁰.

Ndryshimi kryesor në diplomacinë strategjike të Kinës në Afrikë është gatishmëria e saj për të shkuar përtej ndërtimit të infrastrukturës ekonomike dhe për të kaluar në "strukturën ndërkombëtare"⁴⁸¹. Argumenti i avancuar nga një grup udhëheqës i studiuesëve politikë kinezë është se marrëdhëniet e Kinës me Afrikën (si dhe zonat në zhvillim në Amerikën Latine dhe Azi) duhet të marrin më shumë "fuqi gjithëpërfshirëse politike", duke theksuar alternativën morale dhe politike të Kinës ndaj modelit demokratik perëndimor. Ideali i formuluar nga kjo shkollë mendimi është që Kina të njihet si një "pol ndikimi me fytyrë njeriu", që është në këto zona jo vetëm për të bërë biznes, por edhe për të përdorur fuqinë dhe ndikimin e saj për të siguruar "besueshmërinë strategjike". Qëllimi është ambicioz: përfshin krijimin e një perceptimi global të Kinës si fuqi botërore që ofron miqësi të qëndrueshme dhe të begatë⁴⁸².

Kjo politikë e re e Kinës shihet më tepër e zbatuar në Afrikë, ku ajo nënvizon gjithnjë e më shumë punën paqeruajtëse të OKB-së. Në vitin 2010, Kina ishte kontribuesi më i madh paqeruajtës i pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kina ofron inxhinierë, transport dhe logjistikë, policinë civile, stafin mjekësor dhe pajisjet. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2010 ka pasur një rritje prej njëzetfish në pjesëmarrjen e Kinës, duke u rritur me më shumë se 2100 paqeruajtës, ndoshta me më shumë mbështetje të personelit paqeruajtës do të jetë në dizpozicion për dhe pas vitit 2010⁴⁸³.

Gjatë mandatit të tij si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen shpesh argumentoi se Kina, BE dhe Aleanca kishin shqetësime të përbashkëta të sigurisë lidhur me terrorizmin ndërkufitar, përhapjen bërthamore, kërcënimet kibernetike, stabilitetin rajonal, piraterinë etj. Nga Afrika Veriore deri në Sahel, migrimi i pakontrolluar, rritja e grupeve terroriste islamike, përhapja e armëve dhe paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike në vende të tilla si Libia, Mali dhe Somalia vazhdojnë të paraqesin kërcënim për perëndimin dhe interesat e tyre ekonomike. Ndërkohë që migrantët afrikanë mund të jenë më pak shqetësues për Kinën, ka rreziqe për interesat e saj ekonomike, për shembull, vazhdimi dhe lulëzimi i tregtisë së ligjshme

⁴⁷⁹ <http://www.friendsofeurope.org/> (hyrë për herë të fundit më 17 Qershor 2017).

⁴⁸⁰ Li Ashan, “China and Africa: Policy and Challenges”, *China Security*, Vol. 3, No. 3 (2007), fq. 70, <http://www.cebri.com.br/> (hyrë për herë të fundit më 17 Qershor 2017).

⁴⁸¹ Deborah Brautigam, *Dragon’s Gift: The Real Story of China in Africa*, Oxford: Oxford University Press, 2010, fq. 308.

⁴⁸² Yan Xuetong, *Ancient Chinese Thought, Modern Chinese Power*, Princeton: Princeton University Press (2011).

⁴⁸³ Chin-Hao Huang, “Principles and Praxis of China’s Peacekeeping,” *International Peacekeeping*, Vol. 18, Issue 3, 2011, fq. 257-270.

në det pranë brigjeve afrikane dhe mbrojtja e diasporës kineze, e cila është në rritje në kontinent⁴⁸⁴.

Gjatë kryengritjes libiane të vitit 2011, Kinës iu desh të evakuonte më shumë se 35.000 punëtorë kinezë⁴⁸⁵. Pra, duke pasur parasysh këto shqetësime të përbashkëta, çfarë mund të bëjnë NATO, BE dhe Kina në tokë dhe në det për t'i adresuar ato? Precedenti historik sugjeron një preferencë për iniciativa plotësuese dhe jo të përbashkëta, edhe pse këto të fundit nuk mund të përjashtohen tërësisht. Në det, si NATO, BE dhe Kina kanë vendosur mjete detare për të adresuar rrezikun e piraterisë jashtë brigjeve të Somalisë. Kjo është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë ndërkombëtare, për NATO-n nën operacionin e saj Ocean Shield, ndërsa Kina (ashtu si dhe India dhe disa të tjerë) kanë ndërmarrë operacione të tjera të pavarura.

Konkurrenca globale strategjike midis vendeve perëndimore (duke përfshirë NATO dhe BE) dhe vlerat kineze është një realitet politik që tani shtrihet në fushën e sigurisë. Megjithatë, nuk është automatike ndërveprimi i koordinuar mes palëve, qëllimi i përbashkët mund të mundësojë përpjekje paralele me qëllim rritjen e stabiliteti në një zonë problematike të globit. Si rezultat i ndërveprimit konstruktiv në shumë (edhe pse jo të gjitha) pjesët e Afrikës, mes NATO-s BE dhe Kinës mund të marrin përfitime strategjike dhe taktike: strategjike, në kuptimin e gjetjes së objektivave të përbashkëta dhe përpjekjeve përforcuese të ndërsjellta që përfshijnë dialogun, taktike, në kuptimin e punës së bashku dhe mësimin nga njëri-tjetri.

Me këtë sfond të evolucionit të pranishëm të Kinës në Afrikë, një analizë e cila ofron disa nga shtyllat e politikës së jashtme kineze në Afrikë, mund të përmbledhet si vijon:

- Politikisht, Kina kërkon mbështetjen e Afrikës për politikën e saj zyrtare "një Kinë" ("One China Policy").
- Ekonomikisht, Afrika shihet kryesisht si një burim parësor i pasurive natyrore dhe mundësive të tregut për të nxitur rritjen e tregut vendas kinez.
- Nga pikëpamja e sigurisë, prania në rritje e interesave tregtare kineze në Afrikë ka çuar në sfida gjithnjë e më të mëdha të sigurisë për Kinën, pasi siguria e investimeve dhe e personelit kinez vijnë nën kërcënime për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe aktiviteteve kriminale.
- Kina gjithashtu sheh një interes themelor ideologjik në Afrikë, pasi suksesi i "modelit të Kinës" në vendet afrikane jo demokratike ofron mbështetje të tërthortë për ideologjinë politike të Kinës dhe ofron dëshmi se idealet perëndimore demokratike nuk janë universale.

- **Izolacionizmi dhe populizmi në sulm**

Izolacionizmi dhe populizmi "*anti-establishment*" është padyshim në rritje në të gjithë Perëndimin. Nga zgjedhja e Donald Trump-it, i cili u zotua të "zhdukë moçalin" në Uashington, përmes Brexit, në mbizotërimin e lëvizjeve të tilla si Pesë Yjet e Italisë në të majtë dhe lëvizja

⁴⁸⁴ Richard Weitz, "China and NATO: Grappling with Beijing's Hopes and Fears", China Brief, Volume 12 Issue 13, <https://jamestown.org/> (hyrë për herë të fundit më 16 Qershor 2017).

⁴⁸⁵ Noah Feldman, "What Is China's Navy Doing in the Mediterranean", (1 May 2015), <http://gulfnnews.com/> (hyrë për herë të fundit më 16 Qershor 2017).

“Für Deutschland” në të djathtë, një refuzim të politikave së ortodoksisë së vjetër dhe me ta elitat politike dhe institucioneve, po dëshmojnë një tërheqje të madhe në banorët e vendeve perëndimore e më gjerë.

Dikush mund të debatojë për shkaqet, dhe në mënyrë të qartë ekzistojnë specifika të ndryshme në Europë krahasuar me Shtetet e Bashkuara dhe madje edhe pjesë të ndryshme të Europës. Por ajo që është e qartë, është se Moska po inkurajon me padurim këtë valë, jo vetëm për shkak se po sfidon premiset e rendit ndërkombëtar liberal të bazuar në vlerat pas vitit 1945, por edhe sepse përbën kërcënim real për sigurinë e Europës.

Megjithëse është e lehtë të akuzosh Bashkimin European për procedurat e tejzgjatura dhe politikën bizantine, ai është gjithashtu një element themelor i arkitekturës së sigurisë të kontinentit. Një pjesë e sfidës së tij të veçantë është se nuk është vetëm viktimitë e valës populiste, por është edhe arsyeja.

Një shtysë e fuqishme, ka qenë një besim i perceptuar dhe jo krejtësisht i pajustificuar, që një elitë e Brukselit është e përkushtuar ndaj një projekti të unifikimit politik jashtë interesave dhe ambicieve të shteteve kombëtare. Gjithashtu, perspektiva e bërë realitet e një tërheqjeje të Mbretërisë së Bashkuar nga BE e ka përkeqësuar problemin. Për federalistët më të zjarrtë në Bruksel, vetë-përrjashtimi i kundërshtarit të tyre më të thekur, do të thotë që ky është momenti për të shtyrë më tej dhe më shpejt. Për ata, tashmë skeptikë, megjithatë, kjo i çliron ata të marrin në konsideratë më shumë "dalje", kjo nuk është thjesht një çështje politike dhe ekonomike. Nëse ka një mësim të rëndësishëm në diskutimet aktuale rreth mënyrës së luftës së Rusisë - nëse e quajmë hibride, jolineare ose asimetrike - është se konflikti në shekullin e njëzet e një, po luftohet sa në sferat e politikës, moralit, ekonomisë dhe qeverisje, po aq sa në fushën e betejës. Ndërkohë që NATO mbetet aleanca ushtarake e domosdoshme, BE-ja mund të luajë një rol të paçmueshëm në të gjitha ato fusha me të drejtë jashtë mandatit të NATO-s.

BE-ja po zhvillon tashmë rolin e saj të sigurisë, edhe pse në një masë të konsiderueshme kjo ende është në nivel deklarues dhe jo operacional. Strukturat paralele europiane të komandimit nuk duhet të dyfishojnë ose minojnë NATO-n, megjithëse kanë mundësinë të krijojnë një kakofoni mendimesh e veprimesh, dhe kjo nënkupton entuziazmin e Moskës për këto instrumenta të BE. Por ato gjithashtu përfaqësojnë një nismë afatgjatë më shumë për riafirmimin e impulseve federaliste sesa forcimin e forcave në terren.

Sidomos pas përballjes me idenë e humbjes së Mbretërisë së Bashkuar, me buxhetin më të madh ushtarak të Europës, BE-ja duhet të përqendrohet në dy prioritete paralele: *së pari*, rritjen e sigurisë, duke përmirësuar masat e përbashkëta të kundër-zbulimit dhe mbrojtjes së mjeteve të saj financiare dhe politike; *Së dyti*, duke i inkurajuar Shtetet Anëtare të kushtojnë burime të mjaftueshme për ushtritë e tyre kombëtare. Sidoqoftë, nëse BE-ja shpërbëhet ose thjesht shndërrohet në një faktor jo të rëndësishëm, atëherë shtetet individuale do të jenë kryesisht më pak të gatshme dhe të afta për t'i adresuar këto nevoja.

NATO nga ana tjetër po përballlet me sfida të ndryshme nga Bashkimi European. Edhe pse rregullisht një “tabelë qitjeje” midis populistëve, duke përfshirë Marine Le Pen të Francës, ka përgjithësisht më pak shanse për të parë shtetet të tërhiqen prej saj ose të shpërbëhet.

Përkundrazi, debatet përqendrohen nëse anëtarët e rinj të ardhshëm, sidomos Suedia dhe Finlanda, duhet të bashkohen, dhe gatishmëria e vendeve për të rritur buxhetet e tyre të mbrojtjes në 2% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), që NATO e konsideron minimumin themelor.

Sfida populiste europiane për NATO-n është më shpesh operative se sa ekzistenciale. Ka nga ato, sidomos në anën e Mesdheut, të cilët e konsiderojnë kërcënimin më të madh atë që vjen nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut dhe jo atë që vjen nga Rusia, dhe të cilët e vënë në pikëpyetje theksin aktual në kufinj të lindor të Alenacës dhe kryesisht në Balltik.

Natyrisht, një shtysë negative në fjalime, por akoma e papërcaktuar në vendime, vjen dhe nga SHBA-ja. Në gjurmët e fushatës, Donald Trump ishte skeptik për një NATO të "vjetëruar" dhe në veçanti për çdo angazhim të Shteteve të Bashkuara për të mbrojtur anëtarët që nuk kontribuojnë në atë që ai e konsideron të mjaftueshme për mbrojtjen e tyre. Nga ana tjetër, ai shprehu angazhimin e tij ndaj NATO-s në raste të tjera, dhe ai është i kufizuar nga një kongres dhe një aparat qeveritar që mbështesin një rol të vazhdueshëm dhe pozitiv të SHBA në Aleancë. Realisht, kërcënimi populist ndaj NATO-s nga e gjithë Atlantiku nuk është tërheqje, por apatia: një qeveri e SHBA.-së e cila e sheh avantazhin e saj të vërtetë në marrëdhëniet dypalëshe, ndoshta edhe me Rusinë, në vend të angazhimit shumëpalësh.

Ndërsa britanikët po zbulojnë se është më e lehtë të zotohen për Brexit sesa të arrihet ajo. Për më tepër, jo çdo fjalim i fushatës do të bëhet ndonjëherë politikë zyrtare, veçanërisht nëse rrezikon të përmbysë dekada të politikës ekzistuese. Nëse është diçka, është e rëndësishme të mos dorëzohemi në një ndjenjë të pafuqisë kumulative: asgjë nuk është më gërryese sesa të lejojë që diskutimi të lëvizë nga fakti nëse këto aleanca përballen me shpërbërjen sesa mënyrën më të mirë për menaxhimin e procesit.

Përveç kësaj, është gjithashtu e mundshme që sfidat e reja mund të jenë produktive në planin afatgjatë. Sfida ndaj NATO-s është të detyrojë Aleancën që të theksojë mesazhin e saj për vlerën e saj ndaj të gjithë anëtarëve të saj. Për më tepër, pa garanci nga Shtetet e Bashkuara, vendet europiane duhet të jenë më serioze për mbrojtjen e tyre (nga 28 shtetete aktualisht në Bashkimin Europian, 22 janë gjithashtu anëtarë të NATO-s).

Në çdo rast, ajo që është në fjalë nuk është aritmetikë e thjeshtë ushtar-për-ushtar. Siç është përmendur më lart, sfidat moderne të "jo-lineare" të sigurisë janë aq shumë sa i përket më tepër qeverisjes sesa "fuqia e zjarrit". Duke përdorur një sërë metodash jo ortodokse, nga spiunazhi dhe hackimi, nga disinformimi dhe financimi i fshehtë i lëvizjeve të dobishme politike, Moska po kërkon të zgjerojë dhe mbështesë këtë ndjenja ekzistuese të fajit dhe kundër sistemit brenda NATO-s dhe BE-së. Lëvizjet populiste janë shpesh midis aleatëve të tyre dhe mjeteve të zgjedhura, duke pasur parasysh refuzimin e tyre ndaj institucioneve ekzistuese, normave dhe madje edhe kuptimeve themelore të sistemit global.

Nëse BE-ja zgjedh të pretendojë se mbijetesa e tij është thjesht një çështje e marrëdhënieve publike më të mira, apo federalizmi të dyfishuar, atëherë ajo përballet me një të ardhme të diskutueshme. Megjithatë, një mënyrë për të ripohuar rëndësinë e saj është një forcë e fuqishme që ndihmon Shtetet Anëtare të mbrojnë veten kundër sfidave të pa adresuara më parë. Nëse trajtohet siç duhet, kjo mund të jetë një studim i rastit se si BE mund të krijojë sinergji dhe

të mbështesë anëtarët e saj në vend që të kërkojë të imponojë një perspektivë të Brukselit. Në këtë proces, kjo jo vetëm që do të rriste sigurinë evropiane dhe do të pengojë agresionin rus, por gjithashtu mund të privojë populistët e disa municioneve të tyre kundër BE-së.

- **Strategjia Europiane ndaj varfërimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë**

Sulmet e 11 Shtatorit, qëndrimet e ndryshme ndaj ndërhyrjes ushtarake të SHBA-s në Irak dhe rreziku në rritje që i kanosej paqes dhe sigurisë në botë dhe asaj të Bashkimit nga pasurimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë (në vijim AShK) dhe i pajisjeve për transportin dhe shpërndarjen e tyre si raketat balistike, nxorri në pah nevojën për adoptimin e një politike më gjithëpërfshirëse dhe më koherente. Në vijim të këtij angazhimi në 2003 BE-ja pas Deklaratës për varfërimin e Armëve të Shkatërrimit në Masë, e cila përcaktonte parimet bazë, miratoi Strategjinë Europiane ndaj Pasurimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë, e cila u zhvillua dhe zbatua më tej me miratimin e një Plan Veprimi. Ndërkohë që disa shtete nëpërmjet traktateve janë angazhuar në kontrollin e AShK dhe të sistemeve të shpërndarjes, nga ana tjetër disa të tjerë janë në kërkim të programeve për të zhvillimin e tyre, të cilat përbëjnë një rrezik të shtuar nëse këto lëndë kimike, biologjike, radiologjike dhe sistemet e shpërndarjes së tyre bien në dorë të grupeve terroriste apo përdoren gjatë konflikteve, siç ishte rasti i konfliktit Iran-Irak.

Sikurse përcaktohet dhe në SES-në, për sa kohë AShM përbëjnë rrezik për sigurinë e shteteve, qytetarëve dhe interesave të Bashkimit, ai nuk mund t'a injorojë rrezikun që vjen nga to por duhet të përdorë të gjithë instrumentat dhe politikat në dispozicion në funksion të parandalimit, të pengojë, të ndalojë dhe aty ku është e mundur të eliminojë programet për pasurimin e tyre. Gjithashtu, varfërimi i AShM, politikat e çarmatimit dhe të kontrollit të prodhimit të armëve ndikojnë dhe në suksesin e luftës kundër terrorizmit.

Për shkak të pasojave shkatërruese dhe numrit të madh të viktimave që ato shkaktojnë, Bashkimi, në zbatim të Qëndrimit të Përbashkët të 17 Nëntor 2003, ndaj pasurimit të armëve biologjike, kimike dhe pajisjeve për transportin dhe përhapjen e tyre duhet të ndërmarrë një paketë masash gjithëpërfshirëse, duke e adresuar në mënyrën e duhur rrezikun që vjen nga pasurimi i AShM, si⁴⁸⁶:

- Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, duke filluar që nga varfërimi i AShM, implementimi dhe forcimi i sanksioneve të përcaktuara në marrëveshjet dhe traktatet me qëllim përmbushjen e angazhimeve të ndërmarrë në kuadër të tyre⁴⁸⁷. Këto traktate duhet të pajisen me mekanizmat e nevojshëm për hetimin e shkeljeve dhe për të forcuar zbatueshmërinë e normave të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë dhe kriminalizimin e shkeljeve. Në këtë drejtim vlen dhe forcimi i rolit të KS të OKB-së në kontrollit të veprimeve në fushën e pasurimit, të cilat përbëjnë një rrezik të mundshëm për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

⁴⁸⁶ [http://register.consilium.europa.eu/\(hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017\).](http://register.consilium.europa.eu/(hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017).)

⁴⁸⁷ [https://eeas.europa.eu/\(hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017\).](https://eeas.europa.eu/(hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017).)

- Përfshirja e çështjes së varfërimit të AShM në të gjitha politikat e miratuara nga Bashkimi dhe përdorimi nga ky i fundit i të gjithave instrumentave dhe burimeve për të kontrolluar programet e shteteve për zhvillimin e tyre.
- Mbështetjen e institucioneve dhe të mekanizmave të krijuara për të garantuar respektimin e traktateve në fushën e varfërimit të AShM. Në këtë drejtim BE-ja duhet të rrisë mbështetjen e saj financiare, politike dhe teknike ndaj agjensive përgjegjëse për verifikimin e shkeljeve dhe për zbatueshmërinë e detyrimeve që rrjedhin nga traktatet ose marrëveshjet.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë të angazhuar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.
- Të luftojë që në “rrënjë” shkaqet e destabilitetit dhe të rrisë përpjekjet e tij në drejtim të parandalimit të konflikteve, ofrimit të ndihmës vendeve në rrezik, reduktimit të varfërisë dhe promovimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore. Në drejtim të ruajtjes së sigurisë rajonale rëndësi paraqesin dhe marrëveshjet që rregullojnë regjimin për kontrollin e armëve dhe procesin e çarmatimit të popullsisë. Bashkimi duhet të nxisë shtetet që të heqin dorë nga përdorimi i teknologjive dhe pajisjeve që mund të përdoren për pasurimin.
- Hartimi i politikave të qarta për kontrollin e eksporteve të lëndëve kimike, biologjike dhe të pajisjeve për shpërndarjen e tyre dhe përmirësimi i mekanizmave ekzistues të kontrollit. Në këtë drejtim në 2016 Komisioni miratoi rregulloren e cila prezantoi ndryshime të rëndësishme në rregullimin e regjimit doganor të Bashkimit, ku rëndësi paraqet përfshirja e sistemeve të reja të matjes dhe të dekuartimit të informacioneve për produktet dhe të përmirësimit të sistemit për shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve Anëtare⁴⁸⁸. Rëndësi paraqet dhe koordinimi i veprimeve me partnerët si me Agjensinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike, OKB-në, e cila vepron në kuadër të Rezolutës 1540.
- Bashkëpunimi me SHBA-në dhe partnerë të tjerë që ndajnë të njëjtat aspirata, duke i asistuar ato në drejtim të përmirësimit të procedurave dhe mekanizmave në luftën kundër pasurimit të armëve.
- Marrja e masave parandaluese si dialogu politik dhe presioni diplomatik, duke forcuar organizat përgjegjëse ndaj luftës për varfërimin e AShM.

Strategjia e Bashkimit për AShM në funksion të një koordinimi më të mirë të veprimeve të BE-së dhe të aktorëve të tjerë të angazhuar në luftën ndaj pasurimit të AShM, u përforcua me miratimin e “orientimeve të reja për veprim”, të cilat konsistojnë në: i.) Dënueshmërinë e veprimeve të ndërmarra në drejtim të pasurimit; ii.) Parandalimin e shpërndarjes së njohurive; iii.) Ndërgjegjësimin e kompanive, akademikëve dhe institucioneve financiare në lidhje me rreziqet që vijnë nga pasurimi i AShM; iv.) Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e interesuara, me qëllim përmirësimin e politikave të tyre për varfërimin e AShM dhe atyre për kontrollin e eksporteve; v.) Shtimin e përpjekjeve për të luftuar financimin e pasurimit të AShM⁴⁸⁹.

⁴⁸⁸ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017)

⁴⁸⁹ <http://register.consilium.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017).

Në ditët e sotme pasurimi i AShM dhe të sistemeve për shpërndarjen e tyre përbën një rrezik akoma edhe më të madh ndaj sigurisë së qytetarëve të Bashkimit, sesa në kohën kur Strategjia Europiane kundër AShM u miratua. Ky rrezik dhe efekti destabilizues që kërcënon sigurinë europiane dhe atë botërore përforcohet edhe më shumë nga fakti që pasurimi i këtyre armëve po merr përhapje në rajonet që janë në konflikt si Lindja e Mesme dhe Azia, të cilat nga njëra anë ndikojnë në intensifikimin e konfliktit dhe nga ana tjetër ekziston rreziku që këto armë të përdoren. Gjithashtu, globalizimi i të mirave dhe zhvillimi i tregtisë ka lehtësuar shpërndarjen e produkteve dhe të teknologjive që i shërbejnë programeve të pasurimit të AShM. Kjo nuk është vetëm rezultat i mungesës së vullnetit të disa shteteve, por edhe i veprimeve të ndërmarra nga disa grupe të paligjshme interesi. Rreziku bëhet edhe më i madh nëse këtij kuadri i shtohet edhe mundësia që grupet terroriste të përfshihen në aktivitetin e pasurimit të AShM, të cilat më pas mund t'i përdorin në ndonjë sulm.

Ndodhur para situatës ku AShM mund të jenë në duart e shteteve të interesuara ose të grupeve terroriste dhe të aktorëve të tjerë që synojnë destabilizimin e një shteti, ato përbëjnë sfidën më të madhe me të cilën përballlet siguria e Bashkimit dhe për këtë arsye ai duhet të shtojë përpjekjet e tij në këtë drejtim dhe të forcojë bashkëpunimin me organizata apo mekanizma të angazhuara në luftën kundër pasurimit të AShM. Angazhimi i Bashkimit në luftën kundër pasurimit të AShM duhet të përbëjë prioritet për politikën e tij dhe të Shteteve Anëtare duke pasur një adresim të gjithëanshëm të fenomenit nëpërmjet identifikimit dhe zbatimit të praktikave më të mira. Në rast se kjo nuk do të rezultonte e mjaftueshme, Bashkimi duhet të përcaktojë rastet kur ndërhyrja është e domosdoshme.

Bashkimi në një të vetëm të AShM dhe të terrorizmit përbën një nga kërcënimet më të mëdha, i cili mund të rezultojë në një numër të madh viktimash dhe të shkaktojë pasoja të rënda ekonomike dhe politike. Në këtë drejtim ky duhet të jetë një nga prioritetet e politikës së jashtme të Bashkimit, i cili në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe rajonale, shtetet e treta dhe qeveritë lokale të vendeve të rrezikuara nga shpërthimi i një konflikti duhet të marrë masa diplomatike dhe strategjike për të maksimizuar aftësinë dhe për të eliminuar rrezikun që vjen nga terrorizmi i AShM.

BE-ja dhe Shtetet Anëtare duhet të synojnë: *Së pari*, të kuptojnë qëllimet, kapacitetet dhe planet e grupeve terroriste për të blerë AShM apo zhvilluar pasurimin e tyre. Në këtë drejtim Bashkimi duhet të krijojë mekanizmat e specializuar për të vlerësuar besueshmërinë e kërcënimeve dhe të analizojë mundësitë reale të ndodhjes së një akti terrorist. *Së dyti*, t'i mohojë grupeve terroriste mundësinë për të patur akses në materiale, në njohuri dhe kapacitete që mund të mundësojnë pasurimin e AShM, veçanërisht për lëndët kimike helmuese dhe patogenët e rrezikshëm, në sistemet për transportin dhe shpërndarjen, në kapacitet që mundësojnë realizimin e një sulmi dhe fondeve për financimin e këtyre veprimeve. *Së treti*, të pengojnë grupet terroriste në realizimin e një sulmi duke përdorur AShM nëpërmjet strategjive parandaluese në varësi të natyrës së kërcënimit dhe se nga cilat grupe vjen ky kërcënim. *Së katërti*, të hartojnë plane të qarta dhe të krijojë mekanizma për të kontrolluar shpërndarjen e materialeve të paligjshme, të armëve dhe lëvizjen e personelit. Rëndësi paraqet dhe zbatimi i marrëveshjeve për të garantuar

sigurinë e kufinjve. *Së pesti*, të parandalojnë dhe të krijojë mekanizmat për të reaguar në rast të një sulmi terrorist. Pasi të ketë identifikuar mundësinë e ndërmarrjes së një sulmi duhet që të ketë mekanizmat e nevojshëm për të përmbajtur, ndaluar dhe eliminuar rrezikun. *Së gjashti*, krijimin e strukturave të inteligjencës për analizimin e të dhënave dhe informacionit të marrë nga grupet e mobilizuara në terren.

- **Ndryshimet klimatike dhe siguria Europiane**

Në 2008 përfaqësuesi i politikës së jashtme, Javier Solana, iu referua ndryshimeve klimatike si një rrezik që i kanoset sigurisë së BE-së, të cilat duhet të vendosen në themel të politikës europiane të sigurisë. Pasojat e këtyre ndryshimeve nuk janë vetëm në sferën humanitare, por edhe në atë politike dhe atë strategjike, duke ndikuar në interesat e Bashkimit. Pas rishikimit në 2008, SES-ja parashikon se ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale janë rreziqe që i kanosen sigurisë Europiane duke mos u konsideruar vetëm efekti i tyre në mjedis⁴⁹⁰.

Në 2012 Shërbimi Europian për Veprimet me Jashtë mori drejtimin e Rrjetit për Diplomacinë e Gjelbërt, e cila ishte një iniciativë që bashkonte zyrtarët e politikës së jashtme për të punuar në çështje që kishin të bënin me mjedisin dhe përshtatjen e politikës së jashtme me sfidat që ofronin ndryshimet klimatike. Gjithashtu ai ofron trajnime të zyrtarëve në lidhje me ndikimet që kanë në sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit ndryshimet klimatike dhe publikon studime të ndryshme në këtë fushë.

Çështja e sigurisë klimatike u përfshi dhe në axhendat e Shteteve Europiane, ku për shembull ministri i jashtëm gjerman iu referua “klimës dhe sigurisë” si prioritet të reja të veprimtarisë së jashtme, ndërsa ministri i shtetit e konsideroi sigurinë klimatike si një çështje kryesore, e cila kërkon një adresim ndërkombëtar. Në vijim të këyre qëndrimeve në 2010 Zyra Federale për Jashtë shtoi fondet për financimin e iniciativave rajonale ndaj ndryshimeve klimatike⁴⁹¹.

Strategjia Kombëtare e Sigurisë e Britanisë së Madhe, e miratuar në 2008, i referohej lidhjes që ekzistonte ndërmjet ndryshimeve klimatike dhe sigurisë, duke i konsideruar ndryshimet klimatike si një nga sfidat më të mëdha me të cilat do të përballet siguria dhe stabiliteti ndërkombëtar dhe si pasojë dhe siguria kombëtare⁴⁹². Gjithashtu dhe Danimarka, Suedia, Holanda, Franca dhe Spanja kanë miratuar strategjitë e tyre për sigurinë klimatike dhe kanë financuar një sërë seminaresh për këtë çështje⁴⁹³.

Pavarësisht studimeve, konferencave të mbajtura dhe akteve të miratuara nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare, ndikimi i tyre në politikat e Bashkimit është minimalist, pasi BE-ja ka qenë e angazhuar në rreziqet afatshkurtra, si kriza ekonomike, pranvera Arabe, tensioni ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës, dhe jo në ato afatgjata, duke bërë që siguria klimatike të mos jetë në listën e prioritetëve të tij. Përpjekjet e Bashkimit për të zhvilluar politika dhe strategji të cilat analizojnë

⁴⁹⁰ European Union, *Report on the Implementation of the European Security Strategy—Producing Security in a Changing World* (Brussels: European Union, 2008).

⁴⁹¹ www.auswaertiges-amt.de/ (hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017).

⁴⁹² Her Majesty's Government, *A Strong Britain in an Age of Uncertainty: The National Security Strategy*, 2008, 18 and 27.

⁴⁹³ Government of France, *L'Action Exterieur de la France Contre le Changement Climatique*, 2011.

rreziqet që i kanosen sigurisë nga faktorët klimatikë minohen dhe nga fakti që politikëbërësit janë akoma të paqartë sesi t'i adresojnë një zgjidhje sa më të shpejtë. Shkak tjetër janë dhe institucionet, për shkak se kompetencat për politikën e jashtme dhe të sigurisë, të sigurisë të burimeve energjitike dhe të ndryshimeve klimatike janë të ndara ndërmjet disa institucioneve ku asnjëri prej tyre nuk është pajisur me funksionet për të iniciuar dhe udhëhequr veprime që të kenë ndikim efektiv në politikat ndaj ndryshimeve klimatike.

Para BE-së shtrohet detyra e hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, e cila të jetë pararendëse dhe të përgatisë terrenin për rreziqet që mund t'i vijnë stabilitetit të Europës. Në 2013 Shërbimi European për Veprimet me Jashtë u angazhua në hartimin e një strategjie të re Europiane, e cila do të identifikonte sfidat afatgjata ndaj interesave të Bashkimit, duke e përfshirë faktorët klimatike pjesë e politikës së sigurisë. BE-ja duhet të adresojë politikat e saj të parandalimit të konflikteve dhe ndaj rreziqeve afatgjate që i kanosen sigurisë europiane siç është dhe ai që vjen nga ndryshimet klimatike duke përfshijë në to dhe faktorët mjedisorë.

Ndonëse prioriteti kryesor i këtyre politikave janë problemet e që i kanosen qeverive të vendeve në prag konflikti, si dështimi i shtetit, mungesa e demokracisë, shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, faktorët mjedisorë dhe klimatike mund të shërbejnë si nxitëse të konfliktit ose mund të shtojnë pasojat negative, dhe për këtë arsye strategjitë që parashikojnë vetëm masa për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit do të ishin të paplota nëse ato nuk i adresohen dhe faktorëve mjedisorë. Ndryshimet klimatike ndikojnë dhe sigurinë e ekonomisë së Bashkimit, duke u bërë kërcënim për sigurinë e burimeve dhe rezervave ushqimore. Pavarësisht kësaj, vetëm disa nga masat e marra nga BE-ja në drejtim të parandalimit të konflikteve kanë të integruar dhe rreziqet që mund të vijnë nga ndryshimet klimatike.

Në 2011 nga projektet e menaxhuara nga Instrumenti për Stabilitet në një situatë krize vetëm 1.5 milion euro nga fondi total prej 15 milion euro, iu adresua krizave të shkaktuara nga pakësimi i burimeve natyrore⁴⁹⁴. Ndërkohë në 2013 BE-ja ndërmori një program në vlerë 150 milion euro me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sigurisë ndaj ndryshimeve klimatike në Sahel, e cila lidhej drejtpërsëdrejti me ndërhyrjet në Mali. Gjithashtu ai financoi dhe dy programe, Klima në Jug dhe Klima në Lindje, të cilat synonin të ndërgjegjësonin shtetet fqinje me kufinj të Bashkimit në lidhje me ndryshimet klimatike. Për shembull Spanja nëpërmjet Forumit të Mesdheut Perëndimor koordinon veprimet e shteteve në jug të Mesdheut në lidhje me sigurinë e burimeve ujore.

Në hartimin e strategjive politikëbërësit europianë duhet të kenë parasysh:

- Kërcënim që i vjen sigurisë dhe stabilitetit nga ndryshimet klimatike nuk është problem vetëm i Bashkimit por ka karakter ndërkombëtar. Shtetet Anëtare në vend që të përqëndrohen në ruajtjen e resurseve të tyre duhet të bashkëpunojnë për ruajtjen e sigurisë së përbashkët.
- Rreziqet që vijnë nga faktorët mjedisorë duhet të jenë pjesë e politikave të Bashkimit në lidhje me parandalimin e konflikteve, duke përfshirë këtu dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve.

⁴⁹⁴ <http://carnegieeurope.eu/> (hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017)

➤ Të miratojë një strategji gjithëpërfshirëse, e cila të adresojë të gjitha rreziqet e mundshme që vijnë nga ndryshimet klimatike.

➤ Për shkak të efektit shkatërrues që mund të kenë katastrofat e shkaktuara nga ndryshimet klimatike, angazhimeve ushtarake të Bashkimit, si ato parandaluese dhe ato për zgjidhjen e krizave, duhet të shtrihen dhe në çështje që kanë të bëjnë me sigurinë klimatike. Kërkesat në fushën e mbrojtjes janë të lidhura me efektet që sjellin ndryshimet klimatike dhe ushtria mund të ofrojë kapacitetet e saj të shpëtimit dhe mbështetjen në logjistikë dhe në njerëz. Klauzola e solidaritetit dhe e ndihmës së ndërsjellë, e parashikuar në Traktatin e Lisbonës, i mundëson Bashkimit që të ndërhyjë në një shtet në rast se ai këcënohet nga katastrofat natyrore. Ndryshimet klimatike mund të ulin aftësitë luftuese të forcave ushtarake duke vendosur në rrezik logjistikën, infrastrukturën dhe sistemet e transportit, veçanërisht në zonat bregdetare, dhe mund të ndryshojnë kushtet atmosferike në të cilat trupat stërviten dhe operojnë.

➤ BE-ja duhet të ndryshojë qasjen e saj në gjeoekonominë e ndryshimeve klimatike, duke balancuar angazhimet e saj në kuadër të tregtisë së lirë dhe dëshirës së saj për përdorimin e energjisë së rinovueshme.

➤ Sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike dhe me të cilat përballet siguria europiane duhet të jenë pjesë e politikës së jashtme të BE-së. Konfliktet e viteve të fundit që nga Siria deri në Darfur janë tregues se nga çfarë rrezikohet siguria europiane, ku thatësitat dhe migrimi masiv rrisin gjasat për paqëndrueshmëri dhe shpërthimin e akteve të dhunës dhe ndryshimet klimatike mund të shtojnë shkallën e rrezikut.

Së pari, shtimi i rasteve të thatësitës ose të përmbytjeve mund të frenojë kulturat bujqësore, të pakësojë të ardhurat dhe të kërcënojë sigurinë e burimeve ushqimore, duke shërbyes si nxitës i konflikteve për burimet ujore dhe tokat e punueshme. *Së dyti*, shtimi i rasteve të fenomeneve ekstreme të motit mund të shkaktojë paqëndrueshmëri të shtetit. *Së treti*, disa ndryshime klimatike mund të nxisin migrimin masiv, i cili mund të destabilizojë një vend për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe të pamjaftueshmërisë së vendeve të punës për t'i përballuar ato. *Së katërti*, rreziqet që mund të vijnë nga ndryshimet klimatike mund të përdoren si justifikim për militarizimin e vendit, duke penguar përpjekjet e shteteve për të bashkëpunuar në drejtim të adoptimit të masave për të përballuar ndryshimet klimatike. Situata është më shqetësuese në ato zona ku kufinj të detarë janë të paqartë dhe vija bregdetare është në ndryshim për shkak të rritjes së nivelit të deteve dhe oqeanëve⁴⁹⁵.

7.3 Siguria dhe mbrojtja Europiane në Samitin e Varshavës

Ishte prej kohësh në ajër, që NATO dhe BE-ja, sikur po e humbnin shkëlqimin dhe tërheqjen e dikurshme. Nën gjurmët e Brexit dhe dëshirave “Separatiste” të ekstemit të majtë e të djathtë në Europë, seriozisht ishin vënë në pikëpyetje themelet e vetë Aleancës dhe vlerave perëndimore. Përdimi kishte para tij shumë sfida, e të gjitha njëherësh. Jo vetëm Rusia dhe terrorizmi, por edhe punët akoma të papërfunduara në Ballkan dhe Afganistan, sfida e valëve

⁴⁹⁵ <https://www.iss.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 10 Tetor 2017).

migratore nga vende në kaos etj. Të vetëdijshëm për madhësinë e sfidave para tyre, dhe sqarimin mbi misionin në të ardhme të perëndimit, liderët e NATO-s dhe BE-së u mblodhën në Varshavë.

Samiti i Krerëve të Shteteve dhe Qeverive, mbajtur në Varshavë më 8-9 korrik, e nisi NATO-n në të ashtëquajturën fazën e katërt të historisë së saj. *E para* ishte Lufta e Ftohtë; *E dyta*, ndërtimi dhe mbrojtja e paqes në Ballkan; *E treta* ishte përvoja e gjatë dhe e dhimbshme e Afganistanit; *E katërta* do t'a shohë mobilizimin e NATO-s, njëkohësisht “në Lindje” dhe “në Jug”. Në Varshavë, Shtetet Anëtare me mençuri i shmangen debatit se cila nga këto dy dimensione duhet të ketë prioritet. Në këtë drejtim, ka ndihmuar dhe ndërhyrja e Moskës në Siri.

Shumë gjëra kanë ndryshuar për dy vjet. Shteti Islamik është bërë një kërcënim i madh. Shkatërrimi sistematik i Sirisë, paqëndrueshmëria e Afganistanit dhe rënia e Libisë kanë prodhuar një valë masive migrimi. Ndërhyrja e Ruisë në Siri ka ndërlidhur problemet e 'Veriut' dhe Jugut e kjo do të thotë se NATO-ja nuk ka nevojë t'i japë përparësi njërit skaj të kontinentit mbi tjetrin.

Përkundër lajmeve të mëdha europiane të Brexit, Aleanca ka përcjellë me sukses imazhin e unitetit dhe vendosmërisë, që ishte i nevojshëm kundrejt Ruisë. Përsëritja, në qershor, e sanksioneve të lidhura me Ukrainën nga Bashkimi Evropian për gjashtë muaj të tjerë, ishte një provë e parë, të cilën anëtarët e BE-së e kaluan me sukses. Nga takimet me dyer të mbyllura në Varshavë nuk u paraqit asnjë mosmarrëveshje e madhe politike. Në përgjithësi, (jashtëzakonisht të gjatë, madje edhe nga standardet e NATO-s) Komunikata e Përmbylljes së takimit kishte frymën e duhur⁴⁹⁶.

Katër batalione (të udhëhequr nga SHBA, Britania e Madhe, Kanada dhe Gjermania), gjithsej rreth 4000, do të vendosen në Europën Lindore, një në secilën prej Shteteve Balltike dhe një në Poloni. Një prani e tillë i përmbahet angazhimit të njëanshëm të marrë në Aktin Themelues të NATO-Rusi 1997, për të shmangur praninë e përhershme të forcave luftarake të konsiderueshme në kufirin lindor të Aleancës. Kjo forcë, e cila është një pengesë më shumë se një prani luftarake, nuk do të jetë në gjendje të kundërshtojë një operacion të rëndësishëm rus, por qëllimi i saj do të ishte të ishte vetëm pengues e me shpresë parandalues. Vendimi i SHBA-së për të pasur trupa luftarake të përhershme në Poloni është në këtë drejtim veçanërisht e rëndësishme⁴⁹⁷.

Në “Jug”, NATO-ja si e tillë, nuk ka gjasa të mobilizohet për edhe ca kohë. Një rol kryesor për Aleancën, si një njësi kolektive ushtarake nuk është e nevojshme për momentin, as në Irak dhe Siri, as në Libi. Megjithatë, NATO do të fluturojë AWACS (fluturime mbledhje inteligjence) shtesë në rajon dhe do të shqyrtojë mundësinë e trajnimit dhe të ndihmës për forcat e armatosura të Irakut. Ajo ka vendosur të mbajë një prani të konsiderueshme ushtarake në Afganistan gjatë 2017 dhe të vazhdojë financimin për trajnimin e Forcave të Sigurisë Kombëtare Afgane. Ajo gjithashtu do të vazhdojë të kontribuojë në mbikëqyrjen e flukseve të migracionit (anëtarësimi turk i Aleancës është arsyeja kryesore për rolin e NATO-s)⁴⁹⁸.

⁴⁹⁶ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁴⁹⁷ <http://www.europarl.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁴⁹⁸ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

NATO ka deklaruar, përcaktuar dhe në prioritetet e administratës së re amerikane, se sistemi i mbrojtjes së raketave është funksional. Legjitimiteti i tij mund të duket i dobët që nga marrëveshja e Korrikut 2015 për programin bërthamor të Iranit, por Aleanca është e prirur të jetë në gjendje të pengojë dhe të mbrojë kundër raketave balistike të Teheranit, edhe nëse është e armatosur me raketa konvencionale.

Përfundimisht, për herë të parë në vite, NATO, që miripriti Malin e Zi si kandidatin e 29-të, nuk ka ndonjë kandidat të gatshëm dhe të aftë që troket në pragun e saj. Për shkak të qëndrimit të ri rus, Suedia dhe Finlanda po mendojnë për një ofertë anëtarësimi, por debati në këto dy vende është shumë larg dhe nuk ka konsensus popullor për një ofertë të tillë.

Në samitin e mëparshëm të zhvilluar në Cardiff në shtator 2014, çështja ukrainase kishte qenë në ballë. Pastaj Barack Obama i kishte thënë presidentit ukrainas Porochenko, i cili ishte ftuar të merrte pjesë në një seancë të posaçme, se “asnjë ushtar amerikan nuk do ta mbrojë Ukrainën”. Kiev nënshkroi një armëpushim me forcat separatiste njëzet e katër orë më vonë. Ishte gjithashtu në Cardiff ku aleatët morën masat e para “siguruese”, të cilat synonin të kujdesen për shqetësimet e shteteve baltike në dritën e qëndrimit agresiv të Moskës⁴⁹⁹.

Është interesante që takimi i Këshillit NATO-Rusi, i cili u zhvillua disa ditë pas Samitit të Varshavës (e dyta herë që nga viti 2014), ishte më pak i acaruar sesa atmosfera aktuale midis Moskës dhe Perëndimit do të sugjeronte. Kishte edhe një anë që lidhej me propozim rus për një mekanizëm formal të përshtatur për të zvogëluar rrezikun e përplasjeve ajrore në vendet kufitare. Disa do të thoshin, pa arsye, se një qëndrim më pak agresiv nga aeroplanët rusë, të cilët shpesh fluturojnë rrezikshëm pranë forcave të NATO-s, do të ishte një parakusht⁵⁰⁰.

Përkrahësit e një qëndrimi të ashpër ndaj Ruisë, mund ta shohin këtë si një shfaqësim për mosmarrjen e masave të forta kundërshtues, por edhe nga ana tjetër, Rusia duket sikur kërkon pak më shumë kohë e qetësi për të vlerësuar hapat e saj të ardhshëm strategjikë. Presim, në çdo rast, “kundërmassat” që ka të ngjarë të përfshijnë hapa që Rusia do të kishte marrë gjithsesi, si një riorganizim i pranisë së saj ushtarake në kufirin e saj perëndimor, ose një rritje në trupat e vendosur në mënyrë të përhershme në enklavën e vogël të Kaliningradit.

a. Masat për të ardhmen, sipas Samitit të Varshavës

Ndërsa e ardhmja e Europës bëhet më pak e sigurtë, NATO tani ka nevojë për një koncept të ri strategjik që fokusohet më pak në anëtarësimet e reja dhe më shumë vëmendje në respektimin e nenit 5. Kjo iniciativë duhet të ndodhë paralelisht me një njohje zyrtare që politika amerikane, e marrëdhënies nga zero me Rusinë (e pas luftës në Ballkan), pavarësisht nga arritjet e saj të mundshme në atë kohë, ka dështuar dhe nga nevoja për një arkitekturë të re të qëndrueshme pan-europiane të sigurisë.

NATO u përball me pengesën e parë të madhe ndaj politikës së saj të "Open Door" me pushtimin rus të Gjeorgjisë në vitin 2008, kjo menjëherë pas një samiti të NATO-s në Bukuresht, që nuk pranoi të zgjidhte një plan veprimi për anëtarësimin e Gjeorgjisë. Ndërsa katalizatori i menjëhershëm për pushtimin rus të Ukrainës dhe aneksimi i Krimesë në vitin 2014 ishte

⁴⁹⁹ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰⁰ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

perspektiva e një lidhjeje më të ngushtë midis Ukrainës dhe Bashkimit Europian, pushtimi kishte efektin e dhënies fund të çdo mundësie serioze për t'u bashkuar me NATO-n. Më vonë në vitin 2015, aktivitetet ruse të destabilizimit kundër shteteve baltike dhe një gamë të gjerë veprimesh provokative kundër anëtarëve të tjerë të NATO-s sinjalizuan një kundërshtim më të gjerë të ambicies së Aleancës për një "Europë, të tërë dhe të lirë"⁵⁰¹.

Ndërkohë, NATO vazhdon shtysën e zgjerimit të paepur në lindje, edhe pse nuk shfaq asnjë qëllim serioz për pranimin e aplikantëve të kualifikuar e strategjikisht të rëndësishëm, si Gjeorgjia. Ndërsa pranimi i fundit i Malit të Zi shënoi një hap të rëndësishëm dhe të dobishëm përpara drejt projektit të gjatë të konsolidimit të Ballkanit, shtimi i këtij vendi të bukur bregdetar, i rrethuar nga Italia rreth 500 kilometra në perëndim të kufirit lindor të NATO-s, nuk përfaqëson një vendim të vështirë nga Aleancës. NATO gjithashtu ka luftuar për të siguruar anëtarët e rinj se çdo luftë hibride ruse me të cilën ata përballen do të ndeshet me një kundërpërgjigje të fortë. Një aleancë me garanci sigurie të dyshimtë dhe me keqinterpretime është shumë më e rrezikshme se asnjë pa aleancë fare.

Në Konferencën e Sigurisë të Mynihut, kishte një ndjenjë të përhapur shqetësimi në komunitetin transatlantik, me një divergjencë të gjerë mbi mënyrën se si Aleanca duhet t'i përgjigjet këtyre ngjarjeve dhe për të ardhmen e Aleancës. Ndërhyrja ruse në Siri ishte pjesërisht një akt i shkathët për Putinin që t'a mbante vëmendjen larg nga Ukraina, por ky akt i shkathët nuk duhet të shkëpusë Shtetet e Bashkuara dhe Europën nga vendimet e mëdha me të cilat ata përballen.

Samiti i Varshavës duhet të përdoret për t'a kthyer Aleancën në zanafilla: siguria kolektive dhe mbrojtja territoriale në Europë dhe një sistem i ri i qendrueshëm i sigurisë për rajonin. Derisa kjo nuk është një luftë e re e ftohtë, Aleanca duhet të pranojë se të paktën tani për tani, kërcënimi më i rëndësishëm dhe i aftë për interesat e saj thelbësore është Rusia e ringjallur dhe revanshiste, e cila ka për synim destabilizimin e Europës dhe ndarjen e komunitetit transatlantik.

Presidenti Putin është padyshim qendror për këto politika ruse. Ai e udhëhoqi pushtimin e Gjeorgjisë si kryeministër, mbikëqyri aneksimin e Krimesë dhe urdhëroi pushtimin dhe destabilizimin e Ukrainës Lindore. Ai e ka tentuar mbivendosjen e interesave të Shteteve të Bashkuara dhe Ruisë në Siri, duke shfrytëzuar hatërmbetjet amerikane me Turqinë, një aleat i NATO-s. Ai ka qenë i qartë për përbuzjen e tij për Europën liberale dhe ka kërkuar në mënyrë aktive të mbështesë lëvizjet e krahut të djathtë europian dhe partitë politike. Nëse ndërhyrja e tij në Siri kishte për qëllim të gjeneronte më shumë refugjatë, është e pamundur të përcaktohet, por ai nuk ka demonstruar asnjë shqetësim për efektin e këtyre refugjatëve në një Turqi gjithnjë e më të brishtë dhe liderët kryesorë politikë në Europë.

Por dinamika është më e madhe se Putini. Ekziston një mbështetje e madhe dhe e qëndrueshme e Ruisë për nxitjen e një reagimi negativ ndaj NATO-s dhe infiltrimin e Aleancës në kufinj të afërt të Ruisë. Faktorët ekonomikë në Rusi e bëjnë shumicën e popullatës pre e lehtë për çdo formë nacionalizmi që fajëson problemet me armiqtë e jashtëm, realë apo të

⁵⁰¹ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

imagjinuar. Elitat ruse, gjithashtu, kanë tendencë për të ndarë dhe treguar pakënaqësinë e rënies së vendit të tyre në një dekadë thujse tejte të dobët, ekonomikisht dhe për të gjithë shoqërinë. Ndërsa Rusia është një version shumë më i dobët i ish-vetes së saj, ai është një aktor i aftë (dhe bërthamor), i cili është mjaft i fortë për t'u rezistuar dhe për të reaguar ndaj çdo zgjerimi të mëtejshëm të bashkësisë transatlantike.

Ky është një problem për ata që besojnë në komunitetin transatlantik, por disa prej tyre janë të vetëdijshëm për këtë. Për një kohë të gjatë, NATO-s i është lejuar të vazhdojë të veprojë sikur të ishte ende në fundin e viteve 1990. NATO është e ngarkuar me një sërë idesh të pazgjidhura në zemër të zgjerimit të NATO-s pas Luftës së Ftohtë. Kufijtë lindorë të Aleancës nuk u përcaktuan kurrë dhe identiteti strategjik dhe interesat e Ruisë kurrë nuk ishin parashikuar apo trajtuar seriozisht. Edhe emri i Aleancës ishte i pandryshuar - një emër që do të jetë gjithmonë i lidhur ngushtë nga rusët me Luftën e Ftohtë - dhe humbjen e tyre të saj. Luftërat në Afganistan dhe Irak përkohësisht e shtynë nevojën për t'u marrë me këto çështje, pasi Aleanca u ripozicionua dhe u mor me dërgimin e forcave jashtë “teatrit” të saj të parashikuar të operacioneve.

Asnjë nga këto arsye nuk do të thotë që Shtetet e Bashkuara dhe Europa nuk mund të bashkëpunojnë me Rusinë aty ku ky bashkëpunim është frytdhënës për palët. Por, një bashkëpunim i tillë duhet të fokusohet në situata ku aftësitë ruse kanë rëndësi për zgjidhjen e problemeve të ngutshme ndërkombëtare. Në qoftë se bashkësia transatlantike ishte më efektive në parandalimin, ose të paktën jo duke ndjellë, sjelljen subversive ruse, Rusia do të kishte më pak mundësi për të krijuar kriza që më vonë premtan të përpiqet t'i zgjidhë në këmbim të kompromisit dhe ftohjes së konflikteve.

Hapat që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nën diskutime të lodhshme u ndërmorën dhe u vendosën në Samitin e Varshavës janë⁵⁰²:

- *Hapa “Parandalues”*

Në vijim të deklaratave dhe të qëndrimit të mbajtur nga presidenti Donald Trump, ku secili shtet anëtar duhet të plotësojë pjesën e tij të kontributit për organizatën, pavarësisht rritjes së lehtë së investimeve në drejtim të veprimeve operative dhe në mirëmbajtje, madhësia relativisht e vogël dhe natyra e përkohshme e financimit rrezikojnë të ulin përshtypjen e angazhimit që synon të japë⁵⁰³. Përdorimi i këtyre fondeve për të ruajtur praninë e vazhdueshme dhe rotacionale të një ekipi luftarak do të krijojë një masë parandaluese të re, por nuk do të shikohet nga Moska si një formë dhe masë e besueshme. Por kjo masë, në varësi se ku do të vendoset në kufirin e Aleancës dhe Ruisë, mund të konsiderohet më tepër si masë provokuese. Sistemet ruse të mbrojtjes ajrore dhe sistemet tokësore në tokë tashmë po shpërndahen në kufijtë perëndimorë të Ruisë për të minimizuar ose mohuar prezencën e një brigade të NATO-s.

Në vend të kësaj, Shtetet e Bashkuara dhe NATO duhet të investojnë në forca të reja të përherëshme dhe kryesisht mbrojtëse, të rifreskojnë dhe modernizojnë aftësitë e tyre bërthamore dhe të ripërtërijnë vëmendjen ndaj mbrojtjes raketore të teatrit me një fokus të qartë mbi jo vetëm

⁵⁰² <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰³ <https://share.america.gov/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

raketat iraniane, por çdo raketë jo strategjike që mund kërcënojë rajonin. Veçanërisht, armët bërthamore taktike u përjashtuan nga traktati START⁵⁰⁴ dhe duhet të adresohen nga një pozicion i ri i mbrojtjes së NATO-s.

E gjithë kjo duhet të bëhet me buxhetet bazë të cilat shënojnë një angazhim afatgjatë për parandalimin e agresionit në rajon. Disa nga këto gjëra tashmë janë duke u bërë në nivele të ndryshme. Kjo është vetëm një çështje e reklamimit të tyre të saktë dhe duke u dhënë atyre qëllim më të madh strategjik.

- *Pranimi i Gjeorgjisë dhe rishikimi i parimeve për anëtarësimet e reja*

Kërkesa për anëtarësim e Gjeorgjisë duhet të hidhet poshtë në favor të një procesi drejt një marrëdhënie të negociuar, si një entitet jo anëtar. Duke kërkuar sigurinë nëpërmjet integritit politiko-ushtarak me Perëndimin gjatë 20 viteve të fundit, Gjeorgjia u refuzua përsëri nga Aleanca kur takimi ministror i NATO-s, Dhjetor 2015, nuk pranoi të iniciojë me Gjeorgjinë një Plan Veprimi për Anëtarësim (MAP) dhe nuk pranoi të lejojë bisedime të drejtpërdrejta për pranimin e saj. Aleanca duhet të përdorë rastin për të hedhur poshtë plotësisht procesin e MAP-it - për Gjeorgjinë dhe për të gjithë kandidatët e ardhshëm. Specialistët e mbrojtjes bien dakord gjerësisht se Gjeorgjia tashmë ka kryer më shumë reforma mbrojtëse sesa shumë aplikantë të tjerë të suksesshëm të NATO-s dhe se një hap tjetër i ndërmjetëm ka të ngjarë të jetë një ftesë për një agresion të ri rus⁵⁰⁵.

MAP mund të ketë qenë një mjet i dobishëm në nxjerrjen dhe përforcimin e reformave në një mjedis të sigurtë dhe të pakontestuar të sigurisë. Por ky mjedis është zhdukur. Të gjitha aplikimet për anëtarësim tani duhet të vazhdojnë përmes një procesi dypalësh të negociuar që është më pak burokratik dhe më reflektues transparent i interesave strategjikë të Aleancës. Si pjesë e këtij ndryshimi, Aleanca duhet të refuzojë "Politikën e Open Door" jo si zgjerim të pashmangshëm, por si një mjet shumë selektiv që Aleanca do të kërkojë të përdorë për të ngadalësuar sigurinë e saj.

Është jashtëzakonisht e vështirë që NATO të ndërmarrë ndonjë hap drejt integritit të Gjeorgjisë në Aleancë, duke pasur parasysh se forcat ruse në Abkhazi dhe Osetinë e Jugut do të sillnin nën fokus Neni 5 dhe garancitë që sjell ky nen për shtetet anëtare. Pretendimi i vazhdueshëm se NATO mund të zgjasë MAP dhe se ajo "mbetet e angazhuar ndaj protokollit të Bukureshtit" po mbjell konfuzion, duke harxhuar edhe ato burime të pakta dhe vëmendje dhe duke shkaktuar rreziqe të panevojshme. Për fat të mirë, ka mënyra të tjera që Aleanca mund të angazhohet me Gjeorgjinë⁵⁰⁶.

- *Mbështetje për Mbrojtjen Territoriale*

NATO ka shumë mënyra të tjera shumë efektive që mund të punojë me aleatët jo-NATO për të avancuar interesat e përbashkëta kundër aventurizmit ushtarak rus. Mbështetja e SHBA-ve dhe e NATO-s për Gjeorgjinë duhet të largohet nga trajnimi i guerrillasve dhe zhvillimi i forcave të policisë dhe menjëherë të fillojë të përqëndrohet ekskluzivisht në bërjen e vendit më të

⁵⁰⁴ <http://www.nti.org/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰⁵ <http://www.eurasianet.org/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰⁶ <https://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

vështirë për të pushtuar, okupuar apo kërcënuar. Asistenca ushtarake e NATO-s për vende si Gjeorgjia nuk ka gjasa të jetë në gjendje të pengojë agresionin rus. Por kjo mund ta bëjë shumë më të shtrenjtë dhe më të rrezikshëm, duke ndryshuar vendimin përfundimtar rus.

Sistemet anti-ajrore dhe anti-tank, të shoqëruara me investime të reja në komandën dhe kontrollin, si dhe inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin për Gjeorgjinë - dhe për Moldavinë dhe ndoshta një ditë, Ukrainën ose Bjellorusinë dhe çdo vend tjetër në midis NATO-s dhe Rosisë - do të ndihmonte në krijimin e një zone të vendeve që nuk ishin as pjesë e Europës apo e NATO-s e as subjekt i shtërngimit, subverzionit dhe intrigës së vazhdueshme ruse.

Merreni parasysh atë, një qasje moderne pragmatike ndaj problemit strategjik të qëndrueshëm të *Mittleeuropës*, një rajon i fragmentuar i varur midis fuqive më të mëdha në bazë të gjeografisë, gjuhës dhe kulturës. Siç doli nga epoka e fundit e perandorisë, Woodrow Uillon u përpoq të ribëjë rajonin nëpërmjet vetëvendosjes, një eksperiment i shkurtër pasi shtetet e dobëta ishin pre e lehtë nga fqinjët më të fortë. Një burim i përhershëm i paqëndrueshmërisë në rastin të mirë, Tim Snyder e përshkroi atë si "*Bloodlands*" (Tokë Gjaku)⁵⁰⁷. Në rastin më të keq Robert Kaplan, duke cituar Josef Pilsudski, themelues i Republikës së dytë Polake, i referohet nevojës për një grup "*Intermarium*" të shteteve demokratike të pandashme midis Detit Baltik dhe Detit të Zi⁵⁰⁸.

Edhe pse është e dëshirueshme nëse këto vende të jenë gjithashtu dhe demokratike, një hap i rëndësishëm drejt një sistemi të qëndrueshëm të sigurisë do të ishte dhe aftësia e këtyre shteteve për t'u vetëmbrojtur ushtarakisht ose të paktën të mos ishin vazhdimisht në lojë mes aleancave më të mëdha. Në minimum, kjo mund të blej kohë, duke i dhënë kulturës strategjike ruse një mundësi për të mbushur, për t'u rritur përtej ambicjeve post-imperiale dhe për të mësuar të jetojë brenda kufijve të një shteti kombëtar. Natyrisht, çdo strategji gjithëpërfshirëse e asistencës ushtarake do të duhej të shoqërohet me stabilitet kushtetues, një shkallë të lartë të transparencës dhe me reforma civile-ushtarake dhe komanduese dhe kontrolluese, për të siguruar që aftësitë menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme në mbështetje të qëllimit unik mbrojtës.

- *Rishikim të traktatit të sigurisë europiane*

Aleanca duhet të përdorë këto nisma për të nxjerrë në pah nevojën për një arkitekturë të re paneuropiane të sigurisë, e cila është e qëndrueshme dhe reale. Sa tërheqëse dhe frymëzuese është motoja "Europa, e tërë dhe e lirë", politika e deritanishme e NATO-s nuk dha rrugë të mjaftueshëm drejt arritjes dhe ruajtjes së këtij qëllimi. E vetmja marrëveshje tjetër e sigurisë paneuropiane, Traktati mbi Forcat Konvencionale në Evropë⁵⁰⁹, vdiq në vitin 2015 kur Rusia u tërhoq në mënyrë të njëanshme.

Samiti i Varshavës u përdor edhe për të shtruar pyetjen për atë që arrin Traktati mbi Forcat Konvencionale në Evropë, si dhe për të mbyllur çështjen e armëve bërthamore taktike së bashku me armët konvencionale në një pyetje më të gjerë rreth balancës së forcave në Europë. Aleanca gjithashtu mund të shfrytëzojë këtë mundësi për të hetuar se si garancitë kolektive të

⁵⁰⁷ <http://www.mikewallteacher.com/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰⁸ <http://sfppr.org/2017/07/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

⁵⁰⁹ <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 15 Qershor 2017).

sigurisë duhet të reformohen për të vepruar në një mjedis të kërcënimit asimetrik dhe luftës hibride.

Si pjesë e kësaj, Aleanca mund të sugjeronte edhe nevojën për të riemërtuar veten. Do të ishte budallallëk të zvogëlohej ose të hidhjej sistemi jashtëzakonisht i vlefshëm politik-ushtarak i Aleancës, me vendim-marrjen e bazuar në vlera dhe ndërveprimin teknik. Sidoqoftë, NATO nuk ka nevojë të konfliktohet me Rusinë dhe popullatën ruse, duke vazhduar të lëre përshtypje mbi ta me humbjen eventuale të tyre. Imagjinoni se çfarë do të ishte si të jetoni në Europë, të rrethuar nga një pakt i Varshavës!

- *Duke shikuar përpara*

Ndërsa Putini e ka provuar vazhdimisht veten të jetë lojtar i aksionit më shumë se i bllofit, ai merr rreziqe të llogaritura. Që të mos gabojmë në konflikte të reja që askush nuk i dëshiron, NATO shfrytëzoi këtë mundësi për të formuar në mënyrë proaktive axhendën e një samiti transformues në Varshavë dhe njoftoi një vullnet të ri të guximshëm për të menduar për të ardhmen, duke dyfishuar në masa parandaluese, duke rritur transparencën, dhe me armatosjen e aleatëve që janë të gatshëm dhe të gatshëm për të mbrojtur veten.

Duke ndihmuar Gjeorgjinë të përqëndrohet në mbrojtjen e saj territoriale dhe jo duke e përsëritur hapjen teorike ndaj anëtarësisë gjeorgjiane në Aleancë, NATO do të reduktojë nxitjen që Rusia të angazhohet në agresion të përtërirë në një të ardhme të afërt, si dhe të rivendosë në mendjet ruse ndjenjën e kohezionit dhe solidaritetit brenda Aleancës.

7.4 Siguria në kufinj të Bashkimit Europian

Mesdheu për shkak të pozicionit gjeografik të tij, nyje e rrugëve të tregtisë ndërkombëtare, ka zënë një vend të rëndësishëm në procesin e integritimit Europian. Ndodhur para situatës ku Mesdheu asnjëherë nuk ka qenë një rajon i qetë por është karakterizuar nga luftrat për dominim të territorit, si rasti i Qipros apo ai i Saharasë Perëndimore, garantimi i paqes dhe i stabilitetit në të ka qenë një komponent të rëndësishëm i politikës së jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit.

Interesi i BE-së në rajonin e Mesdheut, sidomos i disa prej Shteteve Anëtare të tij, buron që nga marrëdhëniet kolonialiste që ato kishin me disa prej këtyre shteteve. Pas procesit të dekolonializimit dhe Luftës së Ftohtë, prezenca Europiane në rajon shfaqet nëpërmjet Komuniteteve Europiane dhe politikave të jashtme të disa prej Shteteve Anëtare. Disa dispozita në Traktatin e Romës parashikonin mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve me disa shtete në jug të Mesdheut, të cilat dikur ishin nën ndikimin francez, duke mos e konsideruar rajonin si të tërë. Këto marrëveshje dypalëshe kryesisht përmbanin dispozita të karakterit ekonomik dhe të ndihmës financiare. Ndërsa në vitin 1972, në bashkëpunim me vendet e Mesdheut, u formulua Politika Globale për Mesdheun, e cila do të përbënte bazën për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Komunitetit Europian dhe vendeve në jug të Mesdheut.

Deri në përfundim të Luftës së Ftohtë asgjë nuk ndryshoi në politikën Europiane në drejtim të rajonit të Mesdheut, e cila kishte uljet dhe ngritjet e saj. Ndryshimet që ndodhën më

pas, si rreziku që i kanosej sigurisë Europiane nga terrorizmi islamik dhe nga dyndjet e emigrantëve që vinin nga zonat e konflikteve drejt brigjeve europiane, nxorrën edhe një herë në pah rëndësinë që ka për interesat e saj stabiliteti dhe siguria e Mesdheut. Burimet energjitike të rajonit përbënin një alternativë e cila do t'i garantonte Bashkimit pavarësinë nga Rusia. Tashmë siguria nuk kishte vetëm komponentin e saj ushtarak dhe diplomatik por edhe atë ekonomik, kulturor dhe politik. Dy ishin çështjet që shtroheshin për diskutim: *së pari*, cila ishte natyra e çështjeve që mund të përbënin rrezik për sigurinë; dhe *së dyti*, cili do të ishte modeli më i përshtatshëm i bashkëpunimit që do të nxiste stabilitetin në rajon.

Si një ndër institucionet Europiane, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit me vendet e rajonit të Mesdheut ka qenë Bashkimi European Perëndimor, i cili në 1992, në vijim të detyrave të Petërsbergut, vendosi të fillonte një dialog dypalësh me disa shtete, fillimisht me Algjerinë, Marokun dhe Tunizinë, për të vijuar me Egjiptin, Mauritaninë, Izraelin dhe Jordaninë.

Përveç Bashkimit, Mesdheu ka pasur interes strategjik dhe për Shtetet Anëtare, ku mund të përmendim Francën e cila në 1990 nxiti zhvillimin e Formumit për Mesdheun ose “Procesin 4+5”, ndërmjet Francës, Spanjës, Italisë dhe Portugalisë nga njëra anë dhe Maltës, Marokut, Tunizisë, Algjerisë dhe Libisë, Mauritanisë nga ana tjetër, sukcesi i të cilit u minua nga ngjarjet politike në Afrikën Veriore, në Algjeri dhe sanksionet e vendosura ndaj Libisë, pas bombës në Lokerbi. Të nxitur nga shembulli francez, Italia dhe Spanja mbajtën Konferencën mbi Sigurinë dhe Bashkëpunim në Mesdhe⁵¹⁰. Të tjera iniciativa për të nxitur bashkëpunimin me Mesdheun kanë qenë Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Mesdhe, Forumi për Mesdheun, Samitet për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut dhe Kontakt Grupi i OSBE-së për Mesdheun, të cilat ndonëse jo në pak raste kanë mbivendosur veprimet e njëra tjetrës, pak kanë bërë në përmirësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit.

Të gjitha këto çuan në mbajtjen në Nëntor 1995 të Konferencës Euro-Mesdhetare në Barcelonë, e njohur si “Procesi i Barcelonës”, ku morën pjesë 15 Shtete Anëtare dhe 12 shtete të Mesdheut. Kjo konferencë, e cila me nënshkrimin e Deklaratës së Barcelonës shënoi një kapitull të ri në politikën e Europës ndaj Mesdheut, kishte si qëllim t’u shndërronte rajonin në një zonë paqeje dhe sigurie dhe të nxiste zhvillimin ekonomik të tij, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet kulturave dhe civilizimeve të ndryshme të rajonit të Mesdheut duke krijuar një zonë paqeje, stabiliteti dhe sigurie. Ky partneritet përbëhej nga komponenti dypalësh ndërmjet BE-së dhe secilit.

E konceptuar si një platformë bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit dhe shteteve të Mesdheut jugor dhe lindor tre ishin fushat kryesore të bashkëpunimit (shporta)⁵¹¹:

a.) *Politik dhe për çështje të sigurisë* – Krijimi e një zone të përbashkët të paqes dhe të stabilitetit, nëpërmjet forcimit të dialogut politik të bazuar në parime të gjithëpranuara si mbrojtja, garantimi i të drejtave të njeriut dhe respektimi i demokracisë. Bashkëpunimi në këtë

⁵¹⁰ <https://www.cvce.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁵¹¹ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

fushë është ndikuar së tepërmi nga konflikti në Lindjen e Mesme, i cili ishte pengesë për bashkëpunimin në çështje të sigurisë.

b.) *Ekonomik* – Bashkëpunimi financiar dhe ekonomik në drejtim të krijimit të një zone të tregtisë së lirë, nëpërmjet arritjes së marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë midis BE-së dhe secilit prej shteteve të Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut dhe ndërmjet vetë këtyre shteteve. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ishte të rriste fluksin e tregtisë, dhe shoqëruar me reformat në fushën politike të ndikonte në rritjen ekonomike të vendit, e cila më pas në mënyrë indirekte do të ndikonte në vendosjen e paqes, ruajtjen e stabilitetit dhe në pakësimin e flukseve migratore. Në funksion të krijimit të këtyre zonave të tregtisë së lirë palët kishin vendosur si objektiv harmonizimin e rregullave dhe procedurave doganore, miratimin e akteve ligjore që do të përcaktonin rregulla të qarta për origjinën e mallrave, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe industriale, çertifikimin e mallrave dhe forcimin e konkurrencës. Realizimi i këtij bashkëpunimi do të përkrahej nga asistenca financiare e BE-së.

c.) *Social dhe kulturor* – Promovimi i afrimit të qytetarëve, duke inkurajuar shkëmbimet sociale, kulturore dhe njerëzore ndërmjet qytetërimeve. Qëllimi final i këtij bashkëpunimi do të ishte krijimi i shoqërive të lira dhe të civilizuar.

Për realizimin e objektivave të vendosura nga BE-ja, kjo e fundit duhej të stimulonte zhvillimin ekonomik të vendeve të Mesdheut jugor me qëllim uljen e problemeve të natyrës ekonomike dhe sociale, të promovonte qeverisjen demokratike dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe përmirësimin e ndërgjegjësimit social dhe kulturor në të dy anët e Mesdheut. Gjithashtu, rëndësi për sigurinë e Bashkimit merr edhe bashkëpunimi për çështje që kanë të bëjnë me qarkullimin e lirë të personave, rregullimin e migracionit të paligjshëm dhe trafikimin e qenieve njerëzore në jug të Mesdheut⁵¹².

Pavarësisht anëve pozitive, paqëndrueshmëria në Mesdhe e shkaktuar sidomos nga konflikti arabo-izrailit dhe botëkuptimet e ndryshme minuan realizimin e objektivave të vendosura. Përpjekjet për të rinovuar politikën Europiane për Mesdheun vijnë me propozimin e presidentit të Francës Sarkozy për krijimin e Bashkimit të Mesdheut. Ndërsa në 2004 Politika Europiane e Fqinjësisë u shtri dhe në vendet e Mesdheut dhe në Korrik 2008 Komisioni Europian miratoi planin për të ringritjen e “Procesit të Barcelonës” nën logon “Bashkimi për Mesdheun”, ku përveç elementëve inovativë të dyja këto nisma përfaqësonin një politikë më pak ambicioze të BE-së në rajon⁵¹³. Përveç ruajtjes së objektivave të parashikuara në pararendësin e tij, pasi *acquis* e Barcelonës u bë pjesë e tij, Bashkimi për Mesdheun karakterizohet nga një marrëdhënie më e balancuar bashkëpunimi, rritje e shkallës së transparencës dhe të llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Qëllimi i ndryshimeve të prezantuara ishte rritja e dialogut politik dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit dhe partnerëve mesdhetarë. Këto objektiva do të arriheshin nëpërmjet krijimit të strukturës së nevojshme institucionale. Parashikohej krijimi i një bashkëpresidence, sekretariati, zhvillimi rregullisht i takimeve

⁵¹² <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 5 Nëntor 2017).

⁵¹³ Po aty.

ndërministeriale dhe mbajtjes së samiteve. Bashkëpresidenca do të vendoste marrëdhëniet në balancë, ndërsa sekretariati do të luante një rol të rëndësishëm në sigurimin e fondeve për financimin e projekteve të reja të bashkëpunimit.

Projektet do të fokusoheshin në gjashtë fusha bashkëpunimi: energjia diellore, mbrojtja civile, arsimi i lartë, pastrimi i Mesdheut nga ndotja, nxitja e iniciativave të biznesit dhe nxitja e investimeve në ndërtimin e rrugëve. Pjesëmarrja në projekt për secilin shtet do të ishte vullnetare. Këto ndryshime reflektojnë interesat dhe prioritetet e reja të shteteve, të ndryshme nga Procesi i Barcelonës, ku energjitika merr më tepër rëndësi se promovimi i demokracisë, ruajtja e të drejtave të njeriut apo forcimi i rolit të shoqërisë civile, të cilat me Bashkimin për Mesdheun dalin në vend të dytë⁵¹⁴.

Arritjet e këtyre mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit dhe vendeve të Mesdhit mund t'i përmbledhim në këto drejtime⁵¹⁵:

- **Dialogu rajonal** – Përgjatë viteve të ekzistencës të Partneritetit Euro-Mesdhetar dhe të Bashkimit për Mesdheun, BE-ja dhe vendet e Mesdheut kanë arritur të ndërtojnë marrëdhënie të bazuara në dialog. Ky dialog shtrihet në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, në ato me karakter ekonomik, politik dhe social. Këto instrumenta janë të vetmet, përveç OKB-së, ku shtetet e përfshira në konfliktin e Lindjes së Mesme vendosen në të njëjtën tavolinë diskutimi.
- **Integrimi Rajonal** – Bashkimi nxit integrimin dhe bashkëpunimin ndërrajonal ekonomik, tregtinë e lirë në rajon, integrimin në çështje të drejtësisë, kulturore dhe sociale.
- **Promovimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe i demokracisë** – BE-ja bashkëpunon me partnerët e saj në rajon për të promovuar demokracinë, shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjithashtu, shtetet e rajonit në jug të Mesdheut pëfitojnë nga mekanizmi i Iniciativës Europiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut, i cili financon projekte që lidhen me asistencën elektorale dhe misionet e vëzhgimit, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut etj.
- **Tregëtia** - Partneri më i rëndësishëm tregëtar për vendet e Mesdheut është BE-ja, duke zënë rreth 50% të importeve dhe eksporteve.

Në kuadër të krijimit të një zone stabiliteti dhe sigurie në rajon, dhe për pasojë dhe për Bashkimin, rëndësi merr analiza e rolit të Unionit për Mesdheun në drejtim të parandalimit të konflikteve dhe zgjidhjes së krizave, luftës kundër terrorizmit dhe mbrojtjes civile. Pavarësisht angazhimit në drejtim të përmirësimit të ekonomisë të vendeve të Mesdheut jugor dhe të forcimit të sigurisë, masat e marra nga BE-ja kanë qenë të pamjaftueshme për të ndërtuar shoqëri demokratike, shtet të së drejtës dhe zgjidhjes së konflikteve të brendshme, ku këto të fundit vazhdojnë të jenë shqetësimi kryesor për partnerët europianë.

Ndonëse Partneriteti Euro-Mesdhetar është angazhuar për të garantuar paqen dhe stabilitetin në rajon, ai nuk është përfshirë direkt në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Aftësitë dhe kapacitetet e BE-së për menaxhimin e krizave dhe parandalimin e konflikteve, si

⁵¹⁴ <http://www.feps-europe.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018)

⁵¹⁵ <http://www.economy.gov.lb/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

promovimi i integritit rajonal, forcimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, ishin të pamjaftueshme dhe joeficiente për të reaguar në situata komplekse.

Që nga dita e miratimit të Deklaratës së Barcelonës, natyra e konflikteve kishte ndryshuar, nga ato ndërshtetërore në ato brenda grupeve rebele brenda shtetit, të cilat degjeronin deri në rënien e shtetit dhe futjen e tij në kolaps. Në deklaratë elementi i sigurisë ishte i nënvlerësuar dhe në të nuk parashikoheshin instrumentat për të ndërhyrë. Ndërsa në kuadër të PESM-së BE-ja i ka dhënë përparësi bashkëpunimit dypalësh, i cili realizohej me secilin prej Shteteve Anëtare dhe mbi baza vullnetare, nëpërmjet mbledhjeve dhe seminareve. Si raste në të cilat BE-ja është angazhuar dhe ka lejuar pjesëmarrjen e partnerëve mesdhetarë në PESM-së ka qenë Forca Detare Europiane EUROMARFOR dhe forca operationale e ndërhyrjes së shpejtë EUFOR.

Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit gjithmonë ka qenë një nga çështjet që ka qenë objekt kundërshtimesh gjatë procesit të miratimit të Deklaratës së Barcelonës, periudhë në të cilën Franca ka qenë nën sulmet e Grupit të Armatosur Islamik. Në vazhdim, sidomos pas sulmeve të 11 Shtatorit dhe ngjarjeve të ngjashme si sulmet në Londër, Aman, Madrid, Stamboll etj, terrorizmi ndërkombëtar ka qenë shqetësimi kryesor në Mesdhe. Një nga arritjet më të rëndësishme të Procesit të Barcelonës në luftën kundër terrorizmit ka qenë miratimi i Kodit të Sjelljes në Luftën kundër Terrorizmit, i cili edhe pse nuk jep një përkufizim se çfarë do të kuptohet “me akte terroriste”, paraqet rëndësi për faktin se dënon çfarëdolloj forme të akteve terroriste që kërcënon jetën dhe sigurinë e njerëzve dhe thekson se shtetet janë të vendosura të vazhdojnë luftën kundër terrorizmit për t’u zhdukur atë dhe të luftojnë burimet e financimit.

Në Kodin e Sjelljes në Luftën kundër Terrorizmit parashikohej se⁵¹⁶:

- Shtetet duhej të bashkëpunonin për përfundimin e Konventës së Përgjithshme mbi Terrorizmin, në të cilën do të jepet dhe një përkufizim për aktet terroriste, para sesionit të 60 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.
- Goditjen e terrorizmit në të gjitha format që ai do të manifestohet dhe marrjen e masave për parandalimin e tij.
- Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit do të realizohet në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare, parimeve të gjithë pranuar dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Shtetet të refuzojnë dhënien e azilit dhe të çfarëdolloj përkrahje personave të akuzuar për akte terroriste dhe të bashkëpunojnë për vënien e tyre para drejtësisë.
- Shkëmbimin e informacionit dhe të ekspertizës mbi baza vullnetare dhe ofrimin e asistencës teknike.
- Koordinimin e punës për të identifikuar faktorët që kontribuojnë në ndërmarrjen e një akti terrorist dhe të shkëmbejnë eksperiencat dhe ekspertizën sesi ato mund të luftohen.
- Forcimin e mekanizmave kombëtarë të reagimit pas goditjes nga një sulm terrorist.
- Të ndihmojmë viktimat e akteve terroriste dhe ofrimin e asistencës ndaj shteteve që janë objekt i një sulmi terrorist.

⁵¹⁶ <http://www.eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Për shkak se vendet e Mesdheut gjithnjë kanë qënë objekt i katastrofave natyrore dhe i atyre të shkaktuara nga njeriu, mbrojtja civile ka qënë një nga fushat ku bashkëpunimi ndërmjet shteteve ka qënë më efektiv dhe gjithmonë në rritje, në dallim nga dy fushat të përmendura më lart ajo është më pak sensitive. Ky bashkëpunim është bazuar jo vetëm në realizimin e projekteve të përbashkëta por edhe nëpërmjet krijimit të strukturave të përbashkëta.

Pavarësisht entuziasmit nën të cilin u zhvillua Procesi i Barcelonës, sot pas më shumë se 20 vitesh mund të themi se BE-ja dhe Shtetet Anëtare dështuan në krijimin e mekanizmave efektivë për të adresuar një konflikt rajonal, të cilat kanë çënuar dhe vetë bashkëpunimin euro-mesdhetar. Edhe pse pas sulmeve të 11 Shtatorit lufta kundër terrorizmit ishte një prioritet për Partneritetin për Mesdheun, nevoja për konsensus dhe dhënia më shumë rëndësi çështjeve që kishin të bënin me të drejtat e njeriut dhe demokracinë, minuan efektivitetin e këtij bashkëpunimi. Për shtetet anëtare ishte më i lehtë bashkëpunimi në çështje të cilat kishin më pak ndjeshmëri politike, në të cilat komponenti i sigurisë ishte më pak i pranishëm. Megjithë përpjekjet për të riaktivizuar Procesin e Barcelonës nëpërmjet Partneritetin për Mesdheun, organizata të tjera të angazhuara në fushën e sigurisë si NATO apo shtete si SHBA-ja nëpërmjet mekanizmave të tyre kanë qënë më të pranishme në rajon.

Procesi i Barcelonës dhe krijimi i Partneritetit Euro-Mesdhetar, pas lancimit të Politikës Globale për Mesdheun, shënoi nisjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe vendeve të Mesdheut. Ky partneritet, kishte si qëllim forcimin e marrëdhënieve me vendet në jug të Mesdheut nëpërmjet bashkëpunimit në një kategori të gjerë çështjes me natyrë politike, ekonomike, financiare, sociale dhe kulturore⁵¹⁷. Ndonëse për këto vite që ai ka vepruar janë shënuar arritje pozitive, eficaenca dhe sukcesi i këtij partneriteti është mjegulluar nga disa shkaqe:

Së pari, dështimi i procesit të paqes në Lindjen e Mesme pati një ndikim negativ, sidomos në drejtim të sigurisë dhe të politikës.

Së dyti, ndonëse Procesi i Barcelonës synonte të forconte bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe vendeve në jug të Mesdheut, ky bashkëpunim nuk ishte ndërtuar mbi pozita të barabarta, por është karakterizuar nga superioriteti i Bashkimit. Gjithashtu, dhe Shtetet Anëtare nuk ishin në pozita të barabarta. Propozimit të Francës për krijimin e një Bashkimi Mesdhetar, i cili do të vepronte jashtë kuadrit të Procesit të Barcelonës, Gjermania ju kundërpërgjigj se nëse Franca do të përqëndrohej ndaj vendeve në jug ajo do të kthehej ndaj vendeve të Europës Lindore. Në vijim ky propozim u ndryshua dhe u krijua Bashkimi për Mesdheun si pjesë e Procesit të Barcelonës.

Së treti, mungesa e demokracisë, mosekzistenca e shtetit të së drejtës dhe kontrolli i veprimtarisë së shoqërisë civile. Qeverisja në vendet në jug të Mesdheut është karakterizuar nga mungesa e rotacionit dhe e zgjedhjes, regjimet ushtarake kanë marrë drejtimin e vendit dhe elita lokale luan pak ose aspak rol në nxitjen e rritjes ekonomike dhe në ofrimin e një opsioni më demokratik. Ndërtimi i regjimeve demokratike dhe respektimi i të drejtave të njeriut janë çështje që nuk duhet të imponohen nga jashtë. Bashkëpunimi euro-mesdhetar duhet të synojë hartimin e politikave duke marrë parasysh veçantitë e secilit shtet.

⁵¹⁷ <https://www.barcelona.com/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Së katërti, bashkëjetesa me islamin. Rritja e radikalizmit ka çuar në shtimin e lëvizjeve anti perëndimore në jug dhe servirja e mesazheve anti islam nga media dhe nga botues europianë, të cilët kundërshtojnë dhe akuzojnë islamin, ka nxitur fobinë e qytetarëve ndaj tij. Gjithnjë e më shumë popullsia e këtyre vendeve është nën presion dhe ndihet e kërcënuar. Europeanët dhe qytetarët e vendeve të Mesdheut Jugor duhet të mësojnë të pranojnë dhe të kutojnë kulturat e njëri tjetrit.

Së pesti, financime të pamjaftueshme, interesa të ndryshme të Shteteve Anëtare dhe veprime jokoherente të tyre. Pavarësisht shpenzimeve të mëdha në Siri, BE-ja nuk mundi të shmangë krizën humanitare. Kjo mund të jetë dhe pasojë e ngurimit të Bashkimit për të ndërhyrë në fazat e hershme të konfliktit, duke u krahasuar me hezitimin e saj në rastin e Ballkanit.

a. Politika Europiane e Fqinjësisë

Kur bëhet fjalë për politikën e jashtme të BE-së, rëndësi paraqet dhe forcimi i lidhjeve ekonomike dhe politike me shtetet në kufinj të Bashkimit. Neni 8.1 i Traktatit parashikonte se Bashkimi duhet të ndërtojë marrëdhënie speciale me shtetet fqinje, duke synuar krijimin e një zone të prosperitetit dhe fqinjësie të mirë, të mbështetur në vlerat që drejtojnë dhe vetë Bashkimin dhe që bazohet në një bashkëpunim të afërt dhe paqësor, i cili bazohet në vlera si demokracia, shteti i së drejtës, mirëqeverisja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndërsa në kuadër të politikës së mirëqeverisjes, për BE-në ishte e domosdoshme të zhvillonte një politikë më koherente dhe efektive ndaj fqinjëve të saj.

E udhëhequr nga idea se ajo duhet të ofronte një politikë alternative asaj të zgjerimit, për shkak të numrit të kufizuar të shteteve që mund të anëtarësoheshin në BE, dhe të krijonte një zonë sigurie përreth kufinjve të jashtëm të saj, në 2003 Këshilli pranoi komunikatën e prezantuar nga Komisioni “Një Europë e Zgjeruar – Fqinjësia: Një Strukturë e re në lidhje me marrëdhëniet me fqinjët Lindor dhe Jugor”, e cila i hapi rrugë themelimit në 2004 të Politikës Europiane të Fqinjësisë. Qëllimi parësor i saj ishte minimizimi i dallimeve dhe ndarjeve që ekzistonin midis BE-së dhe fqinjëve të tij, ato të cilët ndajnë kufinj të Bashkimin në Europën Qëndrore dhe Lindore përfshirë dhe Ukrainën, Moldavinë dhe Biellrusinë, duke forcuar stabilitetin dhe sigurinë në të nëpërmjet bashkëpunimit politik, ekonomik, kulturor dhe në çështje të sigurisë⁵¹⁸.

Prioritetet e përcaktuara në dokumentat shoqëruese synonin t’i afronin vendet e Europës Qëndrore dhe Jugore më afër standarteve të Bashkimit. Fushat kryesore të bashkëpunimit të parashikuara në Plan Veprim ishin: dialogu politik dhe reformat, tregëtia dhe përgatitja e partnerëve për të qënë pjesë e tregut të përbashkët, drejtësia dhe çështje të brendshme, energjia, transporti, mjedisi, kërkimi dhe inovacioni dhe politikat sociale. Përsa i përket çështjeve të politikës së jashtme dhe të sigurisë ky bashkëpunim shtrihej në çështje si lufta kundër terrorizmit, lufta kundër pasurimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe ndërhyrja në parandalimin e konflikteve. Ky bashkëpunim do të mbështetej në parime të gjithëpranuara si ai i shtetit të së drejtës, mirëqeverisja, respektimi i të drejtave të njeriut, promovimi i marrëdhënieve

⁵¹⁸ Kjo politikë u propozua fqinjëve më të afërt të BE-së si Algjerisë, Armenisë, Bjellrusisë, Egjiptit, Gjeorgjisë, Izraelit, Jordanisë, Libisë, Moldavisë, Marokut, Palestinës, Sirisë, Tunizisë dhe Ukrainës. <https://eeas.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

të mira me fqinjët dhe respektimi i parimeve të ekonomisë së tregut, por duke marrë parasysh dhe interesat e secilit Shtet Anëtar⁵¹⁹.

Kjo politikë, e cila vepronte paralelisht me Procesin e Barcelonës, nuk synonte krijimin e një organizatë të re, pasi bashkëpunimi ndërmjet shteteve të përfshira në të dhe BE-së ishte i një natyre dypalëshe, por nëpërmjet saj Bashkimi synonte t'i ofronte këtyre vendeve bashkëpunim politik - duke forcuar dialogun politik, integrim ekonomik - duke pasur akses më të madh në programet dhe politikat e BE-së, përfshirë dhe atë të tregut të Përbashkët, rritjen e qarkullimit të mallrave, forcimin e bashkëpunimit për çështje të drejtësisë dhe të punëve të brendshme si shteti i së drejtës, mirëqeverisja, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoritetetve, promovimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët.

Me kalimin e viteve Politika Europiane e Fqinjësisë, e cila fillimisht ishte menduar për shtetet në kufi me Bashkimin, filloi të shtrihej dhe në vendet në jug të Mesdheut, duke u ndërthurur me Procesin e Barcelonës, dhe në Kaukaz me Armeninë, Azerbajxhanin dhe Gjeorgjinë. Në përshtatje të sfidave të reja me të cilat po përballlej siguria e Bashkimit, në vitin 2010-2011 ai rishikoi këtë politikë duke e vendosur theksin tek promovimi i demokracive të qëndrueshme, e cila përfshin zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, garantimin e lirisë së shprehjes, garantimin e së drejtës për t'u mbledhur dhe organizuar, pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe luftën kundër korrupsionit, zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës duke rritur aksesin në tregun e brendshëm të Bashkimit, krijimin e zonave të tregtisë së lirë dhe të lëvizjes së lirë të qytetarëve. Në drejtim, të forcimit të bashkëpunimit me fqinjët, rëndësi paraqet dhe forcimi i rolit të shoqërisë civile.

Bashkëpunimi në kuadër të Politikës Europiane të Fqinjësisë realizohet nëpërmjet planveprimeve dypalëshe të hartuara ndërmjet Bashkimit dhe secilit shtet. Këto plan veprimi përcaktojnë prioritetet afatshkurtër dhe afatgjatë të axhendës politike dhe ekonomike. Secili nga këto plane është pasqyrim i interesave, kapaciteteve dhe nevojave të BE-së dhe të shtetit përkatës. Pas rënies dakort, para BE-së qëndron sfida për të treguar se ka vullnetin e duhur politik për të vendosur në këto vende një rend demokratik, bazuar në parimet e gjithëpranuara.

Në lidhje me mënyrën e financimit të zbatimit të këtyre planeve parashikohej se ato do të financoheshin nga Bashkimi, ku nga 2007 të gjitha fondet do të ishin pjesë e një mekanizmi të vetëm financiar të quajtur Instrumenti i Fqinjësisë dhe i Partneritetit Europian. Gjithashtu, në zbatim të prioriteteve të vendosura Bashkimi do të ofronte asistencën e tij teknike⁵²⁰. Veprimtaritë e zhvilluara me qëllim promovimin e respektimit të parimeve të lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës do të financoheshin në instrumenti i Iniciativës Europiane për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut.

Politika Europiane e Fqinjësisë e dërgoi bashkëpunimin midis BE-së dhe vendeve fqinje në një nivel tjetër. Vlera e shtuar e këtij bashkëpunimi do të qëndronte në disa drejtime⁵²¹:

⁵¹⁹ <https://eeas.europa.eu> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁵²⁰ <http://carnegieendowment.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

⁵²¹ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

- ***Një dialog politik më efektiv*** - Politika Europiane e Fqinjësisë është një mjet që do të ndikonte në forcimin dhe rritjen e efektivitetit të politikës së BE-së ndaj fqinjëve, duke përdorur ky i fundit që gjithë instrumentët në dispozicion të tij dhe duke pasur parasysh nevojat e secilit shtet. Njëpërmjet saj BE-ja do të mbështeste realizimin e objektivave të politikës së saj së jashtme, përfshirë dhe për çështje që i përkisnin politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së si ato për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizës.

BE-ja dhe partnerët e saj do të bashkëpunonin dhe për forcimin e qeverisjes globale, ndërtimin e një multilateralizmi efektiv, koordinimin e veprimeve dhe angazhimin e partnerëve në çështje që kanë të bëjnë me PJSP-në dhe PESM-në, si parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, shkëmbimin e informacionit, zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta dhe angazhimin në operacionet e drejtuara nga BE-ja.

- ***Nga bashkëpunimi në integrim*** - Zbatimi e Politikës Europiane të Fqinjësisë do të sillte kalimin nga bashkëpunimi në integrim, duke përcaktuar mjetet dhe mënyrat njëpërmjet të cilave partnerët europianë do të mund të përfshiheshin në politikat dhe programet e zbatuara nga BE-ja.
- ***Bashkëpunim efektiv*** - Politika Europiane e Fqinjësisë do të forconte intensitetin e bashkëpunimit me partnerët, duke e bërë atë më efektiv.
- ***Rritje ekonomike dhe zhvillim social*** - Politika Europiane e Fqinjësisë nxiste ndërmarrjen e reformave, zbatimi i së cilave do të sillte përfitime ekonomike dhe sociale. Përafrimi i legjislacionit në fushën e financave, hapja e ekonomisë së partnerëve ndaj njëri tjetrit dhe ulja e tarifave doganore do të nxiste investimet dhe të ulte papunësinë.

Politika Europiane e Fqinjësisë ka ndikuar dhe në forcimin e komponentit të bashkëpunimit rajonal njëpërmjet krijimit të Bashkimit për Mesdheun në 2008 dhe të Partneritetit Lindor në 2009⁵²². Përsa i përket raportit midis Politikës Europiane të Fqinjësisë dhe Partneritetit Euro-Mesdhetar/Bashkimi për Mesdheun mund të themi se: i.) *acquis* i Partneritetit Euro-Mesdhetar/Bashkimi për Mesdheun përbën bazën për çfarëdo bashkëpunimi në Mesdhe; ii.) Politika Europiane e Fqinjësisë përqëndrohet më tepër në çështje të natyrës politike; iii.) Politika Europiane e Fqinjësisë bazohet në bashkëpunimin dypalësh, ndërsa Partneritetit Euro-Mesdhetar/Bashkimi për Mesdheun më tepër në atë rajonal; iv.) Partneritetit Euro-Mesdhetar/Bashkimi për Mesdheun bazohet mbi parimet dhe vlerat e gjithëpranuara, ndërsa Politika Europiane e Fqinjësisë pasqyron interesat e Bashkimit.

Pas zgjerimit të vitit 2004 BE-ja, në kushtet kur nuk mund të vazhdonte më tej me politikën e zgjerimit, filloi të ndërmerre politika për të forcuar sigurinë e kufinjve të saj ku një ndër to ishte Partneriteti Lindor, i cili përfshinte gjashtë shtete Armeninë, Azerbajxhanin, Bjellrusinë, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën dhe përbënte një anë të Politikës Europiane të Fqinjësisë. Prioritet i këtij bashkëpunimi, i cili është bazuar në respektimin e normave të së drejtës ndërkombëtare dhe të parimeve të gjithëpranuara, si demokracia, shteti i së drejtës,

⁵²² <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut, ishin mirëqeverisja dhe ekonomia e tregut, përafrimi i legjislacionit dhe i politikave mjedisore.

Objektivat të tjera të këtij bashkëpunimi ishin i.) Nxitja e bashkëpunimit politik dhe të thellojë integrimin ekonomik ndërmjet Bashkimit dhe fqinjëve të tij lindorë. ii.) Promovimi i demokracisë, forcimi i institucioneve dhe të mirëqeverisjes, të cilat janë parakushte për zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim Bashkimi angazhohet në garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe mbështetjen e misionëve për parandalimin dhe zgjidhjen e krizave. iii.) Forcimi i sigurisë së burimeve energjitike dhe adresimi i ndryshimeve klimaterike. iv.) Forcimi i shoqërisë, nëpërmjet nxitjes së lëvizjes së lirë të njerëzve. v.) Nxitja e ndërmarrjes së reformave sektoriale, përfshirë dhe ato për mbrojtjen e mjedisit, të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe të financojë projektet që synojnë të ulin dallimet socialo-ekonomike dhe që rrisin stabilitetin e vendit⁵²³.

Organizimi i bashkëpunimit në kuadër të Partneritetit Lindor realizohej nëpërmjet platformave dhe seminareve ku më kryesoret ishin⁵²⁴:

- *Forcimi i institucioneve dhe mirëqeverisjes* – Përmirësimi i qeverisjes, forcimi i sistemit elektoral, reformimi i sistemit gjyqësor, lufta kundër korrupsionit, forcimi i bashkëpunimit për çështje të sigurisë, mbështetja e operacioneve për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve janë thelbësore për rritjen e besimit të shoqërisë tek institucionet e shtetit dhe për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë.
- *Integrimi ekonomik, mjedisi dhe përafrimi i legjislacionit me politikën e BE-së* – bashkëpunimi në këtë fushë synonte të përmirësonte klimën e investimeve, e cila do të sillte dhe rritjen e vendeve të punës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.
- *Siguria energjitike dhe ndryshimet klimatike* – Administrimi me kujdes i burimeve energjitike dhe nxitja e kërkimeve për përdorimin e burimeve alternative të energjisë;
- *Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe qarkullimi i lirë* – bashkëpunimi në këtë platformë synonte zhvillimin e dialogëve për liberalizimin e vizave, forcimin e investimeve dhe nxitjen e iniciativave të të rinjve.

Pavarësisht zhvillimeve të rëndësishme të kësaj politike, sot mund të themi që zonat fqinje janë më pak të qëndrueshme se në fillimin e krijimit të kësaj politike. Partneriteti me vendet e lindjes kërcënohet nga kriza në Gjeorgji dhe nga konflikti në Ukrainë, të shkaktuara nga “ashpërsimi” i politikës së jashtme të Rusisë, e cila gjithashtu ka shkaktuar krisje të marrëdhënieve me Bashkimin. Në jug, rendi dhe siguria në Siri që prej 2011 kërcënohet nga lufta civile, e cila ka pasur ndikim në sigurinë e vendeve fqinje. Ndërsa Libia është akoma një vend në konflikt. E komplikuar paraqitet dhe situata në Egjipt për shkak të situatës jo të qetë politike dhe ndryshimeve që po ndodhin aty. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të Bashkimit për rivendosjen e paqes dhe të stabilitetit në Lindjen e Mesme edhe aty ka pasur shpërthime të herëpashershme të konfliktit. Së fundmi, problematike paraqitet dhe situata në Mesdhe për shkak të piraterisë dhe rritjes së numrit të imigrantëve nga zonat e konfliktit.

⁵²³ <https://eeas.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 5 Nëntor 2017).

⁵²⁴ <http://ec.europa.eu/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Që nga çasti i lançimit të saj aspiratat dhe interesat e vendeve fqinje kanë ndryshuar dhe ato po shfaqin dallime në lidhje me angazhimet e tyre ndaj Bashkimit. Zbatimi i kësaj politike nuk i ka shërbyer plotësisht interesave të Bashkimit dhe pavarësisht disa zonave në të cilat ai ka zgjeruar influencën e tij, në disa të tjera për shkak të interesave të kundërta të shteteve të përfshira në të, axhenda e përcaktuar nga Bashkimi është në vend numëro. Gjithashtu, dhe kriza ekonomike me të cilat po përballet Bashkimi ka pasur ndikim dhe tek fqinjët.

Në kushtet ku efektiviteti i Politikës Europiane të Fqinjësisë ndikon në sigurinë e BE-së, mendoj se si pjesë e kësaj politike Bashkimi duhet të marrë në konsideratë se kush është mënyra më e mirë për të reaguar në rast krizash apo konfliktesh dhe të përcaktojë instrumentat nëpërmjet të cilave ai do të influencojë dhe bëjë presion mbi fqinjët duke përcaktuar dhe qëndrimet e tyre politike, madje edhe ndaj tij. Një Politikë Europiane e Fqinjësisë efektive nënkupton që ajo të jetë pjesë e Politikës së Jashtme të Bashkimit dhe të drejtohet nga Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme. Në ndihmë të zbatueshmërisë së saj të jenë jo vetëm instrumentat e BE-së por edhe ato të Shteteve Anëtare. Bashkimi duhet të mbajë parasysh nevojat që ka secili shtet, sfidat me të cilat ato përballet dhe aspiratat që ato kanë. Qënia në të njëjtin pozicion gjeografik të këtyre shteteve, nuk nënkupton domosdoshmërisht që stabiliteti dhe rendi i tyre mund të kërcënohet nga të njëjtët faktorë.

b. Brexit dhe forcimi i lëvizjeve kundër Bashkimit Europian

Largimi i Britanisë së Madhe po ndodh në një kohë kur pozicioni strategjik në ekonomi i BE-së po pëson rënie dhe kur stabiliteti dhe siguria e saj po kërcënohet nga rreziku që vjen nga nacionalizmi në rritje, nga ekspansionizmi në lindje i Rusisë, nga konfliktet e vazhdueshme në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë dhe nga zgjerimi i Kinës drejt Europës dhe Afrikës Veriore. Situata bëhet edhe më e vështirë për BE-në pas zgjedhjes së Donald Trump si President i SHBA-së, i cili deklaroi se nuk dëshiron të jetë i angazhuar në alenacat e së shkuarës, Kjo u pasqyrua dhe në rregullat e reja për tregtinë të vendosura nga SHBA-ja dhe dëshira e saj për t'u tërhequr nga marrëveshja nukleare me Iranin. Në një kohë ku interesat gjeopolitike dhe ato të sigurisë së Britanisë janë më të përafërta me ato të Bashkimit sesa me SHBA-në, vota e Britanisë së Madhe pro largimit nga BE-ja, do të kishte ndikim dhe në çështjet që lidheshin me mbrojtjen dhe sigurinë. Për këtë arsye, palët duhet të punonin sëbashku për të gjetur një mënyrë për të vazhduar bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Brexit do të cënonte sigurinë Europiane në këto drejtime⁵²⁵:

- *Marrëveshjet e tregëtisë* – Ekonomia e Britanisë ka një vlerë rreth 3 trilion dollarë, e cila është më e madhe se ajo e njëzet Shtete Anëtare sëbashku dhe ka ritmin më të lartë të rritjes ekonomike. Largimi i Britanisë nga tregu i përbashkët dhe nga bashkimi doganor do të ndikojë në pakësimin e tregëtisë, në uljen e sasisë së të ardhurave nga ajo dhe mund të ndikojë në rënien e ekonomisë së Eurozonës. Nga ana tjetër rënia ekonomike e Bashkimit do të nxisë aktivizimin e lëvizjeve nacionaliste.
- *Mospjesëmarrja e Britanisë në politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit* – Me largimin e saj Britania nuk do të ketë më të drejtë vote në Këshillin e

⁵²⁵ <https://www.parliament.uk/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

Punëve të Jashtme dhe në grupet e tjera të punës të ngritura për të diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen dhe për hartimin e politikave të përbashkëta.

- *Bashkëpunimi ndërkuftar në luftën ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar* – Institucionet e Bashkimit (Europol, Eurojust, Urdhër Arresti Europian) dhe mekanizmat e krijuara për shkëmbimin e informacionit (Sistemi i Informacionit Shengen, sistemi për regjistrimin e shenjave të gishtërinjve dhe të mjeteve të transportit etj) luajnë një rol të rëndësishëm në bashkëpunimin në luftën ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit. Nga ana tjetër informacioni që Britania nëpërmjet Shërbimit për Veprime me Jashtë i jep BE-së e ndihmon atë në zbatimin e sanksioneve politike. Marrëveshjet për bashkëpunim në çështje të sigurisë, për shkak të parimit të supremacisë, i mundësojnë Shteteve Anëtare të ruajnë të paprekur bashkëpunimin policor dhe atë për çështje të drejtësisë, nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave sensitive për qytetarët e saj. Dhe nëse Britania largohet nga ky sistem shkëmbimi të dhënash, ajo duhet të ndërtojë me Bashkimin mekanizma të rinj bashkëpunimi me qëllim ruajtjen e sigurisë së saj.
- *Bashkëpunimi ndërmjet Britanisë dhe BE-së në fushën e mbrojtjes* – Pas largimit të saj, Britania e Madhe nuk mund të jetë më pjesë e vendimmarrjes për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes. Problem paraqesin dhe misionet e operacionet në të cilat Britania është angazhuar, të cilat janë një nga mjetet me të cilat ajo vendos ndikimin e saj. Në planifikimin apo në drejtimin e forcave të Bashkimit, siç është rasti i operacionit Atlanta ku njësitë e drejtimit ndodhen në Britaninë e Madhe apo operacionet kundër piraterisë në brigjet e Afrikës Veriore. Gjithashtu, ky largim do të ndikojë jo vetëm në kontributin në trupa të ofruar nga Britania, por edhe në efektivitetin dhe besueshmërinë e një misioni, të ofruar nëpërmjet komandës së saj dhe njësitëve të inteligjencës në shkëmbimin e informacionit.
- *Fondi Europian i Mbrojtjes* - Brexit do të ndikojë dhe në pakësimin e fondit të Bashkimit të programuar për t'u shpenzuar për programe zhvillimi dhe për kërkime.

Në përfundim mund të themi se pavarësisht votës për t'u larguar nga Bashkimi, Britania e Madhe duhet të vijojë të jetë e angazhuar në sigurinë e Europës, si në aspektin ekonomik dhe në atë ushtarak. Është në interesat e të dy palëve që Britania të vijojë të ofrojë kontributin e saj në trupa, të cilat do të veprojnë nën komandën e BE-së, sidomos në ato zona ku ajo ka dhe interesat e saj. Kapacitetet dhe aftësitë e Britanisë janë të rëndësishme në drejtim të trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të lëndëve narkotike, sigurisë energjitime dhe luftës kundër terrorizmit. Për sigurinë dhe mbrojtjen e BE-së rëndësi paraqesin dhe aftësitë e Britanisë së Madhe për të drejtuar operacionet dhe shërbimet e saj të inteligjencës. Misionet dhe operacionet e PJSP-së kanë përfituar nga kontributi i Britanisë dhe politika e jashtme e kësaj të fundit ka përfituar nga to. Nëse ajo do të vijojë të jetë aktive në sigurinë e Bashkimit me cilësinë e shtetit të tretë, ajo do t'a humbasë pozicionin e saj. Për këtë arsye ajo duhet të ruajë statusin e vëzhguesit në institucionet vendimmarrëse dhe planifikuese të BE-së.

Pas Brexit siguria dhe stabiliteti i BE-së kërcënohet nga rritja dhe forcimi i lëvizjeve kundër tij, të cilat pasqyrohen nëpërmjet partive politike të vendeve të ndryshme. Të tilla janë:

a.) Fronti Kombëtar në Francë, e cila ishte kundër emigrantëve dhe politikës së lëvizjes së lirë në kuadër të Shengenit; b.) Partia për Liri në Austri, e cila ka qenë aktive në ndërmarrjen e politikave kundër islamizimit të Europës dhe anëtarësimit të Turqisë në BE. Nëse kjo do të ndodhte ajo do të kërkonte zhvillimin e një referendumi për të vendosur për qëndrimin ose jo në BE; c.) Lëvizja Pesë Yjet në Itali, e cila është kundër monedhës së përbashkët euro, për shkak të vështirësive që ajo ka shkaktuar në ekonominë e vendit; d.) Alternativa për Gjermaninë, e cila është kundër politikës së dyerve të hapura të BE-së, dyndjes masive të imigrantëve dhe të islamizimit të perëndimit; e.) Partia për Liri në Hollandë, e cila ka shprehur frikën e saj ndaj dyndjeve masive të imigrantëve nga vendet islamike, të cilët mund të rrezikojnë sigurinë e Europës; f.) Partia Popullore Daneze, e cila ka shprehur pakënaqësinë e saj ndaj politikave të BE-së për emigracionin⁵²⁶.

Lëvizjet kundër BE-së mund të klasifikohen në të “forta”, e cila nënkupon kundërshtimin e idesë së BE-së në tërësi, dhe e “butë”, e cila manifestohet në kundërshtimin e idesë së integritimit për shkak të interesave të ndryshme të Shteteve Anëtare. Në lidhje me BE-në mund të themi se shkak i këtyre qëndrimeve është: *së pari*, rritja e fluksit të emigrantëve – tregu i lirë i punës ka penguar përpjekjet e qeverive kombëtare për të kontrolluar dyndjet e emigrantëve të cilët nga ana e qytetarëve europianë barazohen me aktet ekstremiste; *së dyti*, kriza ekonomike – për të cilën qytetarët e vendeve të BE-së akuzojnë njëri tjetrin.

Për të rivendosur stabilitetin brenda Bashkimit dhe për të forcuar pozitat e tij dhe të Shteteve Anëtare, ai duhet të vazhdojë rrugën drejt integritimit, të zbatojë politikat e përbashkëta dhe të forcojë marrëdhëniet transatlantike. BE-ja duhet të përmirësojë politikat ekonomiko – financiare, forcimin e bashkëpunimit për çështje të emigracionit dhe luftës kundër terrorizmit dhe mbajtjen e një qëndrimi të unifikuar ndaj rrezikut rus. Për disa nga këto çështje BE-ja ka reaguar, si përcaktimi i kuotave për pranimin e refugjatëve, por për shkak të mos arritjes së një marrëveshje, për shkak të interesave të ndryshme, përfaqësuesit e shteteve nuk kanë arritur në hartimin e politikave të përbashkëta.

⁵²⁶ <https://www.express.co.uk/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2018).

KONKLUZIONE

- Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës shënoi një fazë të re në politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së, tashmë e quajtur PESMP, e cila nuk u shoqërua me krijimin e strukturës së duhur institucionale. Pavarësisht shkrirjes së strukturës së “tre shtyllave”, PESMP-ja mbetet një fushë e veçantë e cila ka rregullat dhe procedurat e saj.
- Votimi me unanimitet u ruajt në pjesën më të madhe të çështjeve që kanë të bëjnë me PESMP-në. PESMP-ja ruajti natyrën “ndërqeveritare” dhe roli i institucioneve “mbikombëtare” si i Komisionit, GJED-ja dhe Parlamentit European ishte mjaft i kufizuar.
- Instrumentat ligjore në dispozicion të PESMP-së nuk ishin drejtpërdrejtë të zbatueshëm, nuk karakterizoheshin nga supremacia dhe nuk kishin fuqi detyruese mbi Shtetet Anëtare. Miratimi i akteve legjislative ishte i përjashtuar për çështje që kishin të bënin me PESMP-në.
- Me Traktatin e Lisbonës, PESMP-ja mbetet e ndikuar nga politikat e kombëtare të Shteteve Anëtare, të cilët ruajnë të drejtën e vetos.
- Krijimi i postit të Përfaqësuesit të Lartë, të mbështetur nga Shërbimi për Veprimet me Jashtë, rriti efektivitetin e përfaqësimit të BE-së në arenën ndërkombëtare dhe ndihmoi në koordinimin dhe zbatimin e vendimeve të marra në kuadër të PESMP-së.
- Krijimi i mekanizmit të “bashkëpunimit të përforcuar” dhe të “bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar” i ofruan mundësi të reja veprimi BE-së në fushën e PESMP-së, ku votimi në unanimitet ishte pengesë për një vendimmarrje efektive. Gjithashtu, bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar paraqet mundësinë për ngritjen e strukturave të përhershme të mbrojtjes, të cilat do të shërbejnë si bazë për krijimin e një ushtrie Europiane.
- Klauzola e mbrojtjes së ndërsjelltë dhe solidaritetit përbëjnë bazën për një mbrojtje të përbashkët Europiane.
- Traktati i Lisbonës parashikon mekanizmat për të garantuar një financim të shpejtë të veprimeve përgatitore për operacionet dhe misionet. Mundësia e miratimit të procedurave që garantojnë një akses të shpejtë në buxhetin e BE-së për financimin e operacioneve civile dhe krijimi i fondin bazë për operacionet ushtarake, janë thelbësore në rastet e menaxhimit të krizave.
- Megjithë ndryshimet e prezantuara në Traktatin e Lisbonës BE-ja nuk arriti të flasë në një zë të vetëm në botën e jashtme dhe është akoma larg ndërtimit të një PJSP të vërtetë për të gjithë Bashkimin.
- BE-ja gëzon personalitet juridik të veçantë nga ai i Shteteve Anëtare, i cili pasqyrohet në të drejtën për të nënshkruar marrëveshje me organizatat ndërkombëtare ose me shtetet e treta dhe në të drejtën për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me to. Zbatueshmëria e

normave të së drejtës ndërkombëtare kufizohet nga natyra dhe veprimtaria e kësaj organizate.

- Pavarësisht masave të marra nga BE-ja për forcimin e aftësive dhe kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe nëpërmjet krijimit të strukturave të posaçme të reagimit si Trupat Europiane, Grupet e Betejave, Forcat e Xhandarmërisë dhe kapacitetet ajrore dhe detare, angazhimi i tyre në terren ka treguar që janë të pamjaftueshme, përsa kohë ato janë peng i pëlqimeve dhe dëshirave të Shteteve Anëtare. Për të qenë një aktor kyç në rendin botëror BE-ja ka nevojë për një forcë ushtarake “mbikombëtare”, e cila do të ishte një mjet i fuqishëm për politikën e jashtme të BE-së dhe do t’i shërbente përbushjes së objektivës për të qenë aktor ndërkombëtar nëpërmjet reagimit shpejt dhe me efektivitet ndaj sfidave të së ardhmes. Me qëllim pasjen e një ushtrie të përbashkët Europiane, fillimisht Bashkimi duhet të ketë një politikë të jashtme efektive. Në kushtet kur Shtetet Anëtare kanë vështirësi për të arritur në një marrëveshje sesi do të reagojnë ndaj një situatë të caktuar konfliktit, së fundmi rasti i Ukrainës, aneksimi i Krimesë apo luftimet në Dondas, funksionimi i një ushtrie Europiane do të ishte i pamundur dhe jo efektiv.
- Ligji për Konfliktet e Armatosura gjen zbatim në rastin e ekzistencës së një konflikti të armatosur ose të një situatë pushtimi, ku nuk është gjithmonë rasti i operacione paqeruajtëse.
- Në rastin e operacioneve për menaxhimin e krizës, Ligji për Konfliktet e Armatosura do të zbatohet ndaj forcave të BE-së kur ato janë të përfshira në luftime aktive dhe jo në rast kur përdorimi i forcës është i nevojshëm për vetëmbrojtje apo për të përbushur misionin. Në rast të kundërt këto forca do të gëzojnë të njëjtën mbrojtje si civilët dhe nuk mund të jenë objekt sulmi.
- Në rastin e operacioneve paqeruajtëse, përfshirë dhe ato të drejtuara nga BE-ja, forcat ushtarake mund të bëhen forcë pushtuese kur ato ushtrojnë pushtet efektiv në një territor të caktuar, pa pëlqimin e shtetit pritës.
- Këshilli i Sigurimit i OKB-së mund të autorizojë shmangien nga zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për Konfliktet e Armatosura dhe nga zakonet ndërkombëtare humanitare, me përjashtim të rastit kur këto detyrime kanë fituar statusin e *ius cogens*.
- Dispozitat e Ligjit të Konflikteve të Armatosur do të gjejnë zbatim edhe në rastin e operacioneve të drejtuara nga BE-ja në kuadër të PESMP-së.
- Shtetet Anëtare, të cilat janë njëkohësisht nënshkruese të Traktateve të Gjenevës dhe të Protokolleve shtesë, kanë përgjegjësinë për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga Ligji për Konfliktet e Armatosura, edhe në rast se marrin pjesë në operacionet e drejtuara nga BE-ja.
- Shtetet e treta, që marrin pjesë në operacionet e zhvilluara në kuadër të PESMP-së, për shkak se kanë transferuar autoritetin për drejtimin e tyre tek BE-ja ato do të jenë përgjegjëse për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për Konfliktet e Armatosura, njësoj si Shtetet Anëtare.

- Zbatimi i të drejtave të njeriut në rast lufte ose çdo rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit do të shtrihet jo vetëm në teritorin që është brenda juridiksionit të një shteti, por edhe në ato pjesë ku ai ushtron kontroll efektiv.
- Të drejtat e njeriut të parashikuara në akte ndërkombëtare, mund të jenë subjekt derogimesh, të cilat duhet të jenë të qarta dhe të paralajmëruara.
- Në rast kur Shtetet Anëtare janë angazhuar në operacionet e drejtuara nga BE-ja në kuadër të PESMP-së, ato kanë detyrimin të respektojnë si LKA-në dhe të drejtat e njeriut. Detyrimi për të zbatuar dhe për të garantuar zbatimin e të drejtave të njeriut rëndon jo vetëm mbi Shtetet Anëtare, por edhe mbi vetë Bashkimin (neni 21 i TBE-së), për sa kohë të drejtave themelore të parashikuara në KEDNJ ai u ka njohur statusin e parimeve të përgjithshme të së drejtës mbi të cilat mbështetet dhe e drejta e komunitare (neni 6.2 i TBE-së).
- GJED-ja nëpërmjet jurisprudencës së saj i ka njohur një status të veçantë Konventës, ku dispozitat e saj dhe të drejtat që ato parashikojnë shërbejnë si parime të përgjithshme mbi të cilat ajo mbështetet vendimmarrjen e saj. Kontrolli i zbatueshmërisë së të drejtave të njeriut në operacionet e BE-së në kuadër të PESMP-së nuk është pjesë e juridiksionit të saj.
- Në lidhje me PESMP-së, Shtetet Anëtare kanë detyrimin të respektojnë të drejtat e njeriut, të njohura si pjesë e së drejtës së BE-së, edhe kur ato veprojnë në emër dhe për llogari të Bashkimit. Në rastin e operacioneve të drejtuara nga BE-ja, ajo do të jetë përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga forcat e Shteteve Anëtare, për shkak të komandës dhe të mënyrës së organizimit të këtyre operacioneve në terren. Në këtë rast kontrolli efektiv i përket Bashkimit dhe jo Shteteve Anëtare.
- Përcaktimi i përgjegjësisë së BE-së në një operacion paqeruajtës, në të cilin përfshihen institucionet e saj, Shtetet Anëtare, forca nga shtete të treta dhe organizata të tjera ndërkombëtare, është i vështirë. Në një operacion me shumë pjesëmarrës është e vështirë që një veprim i caktuar t'i atribuohet një pale të caktuar dhe të identifikohet ligji i zbatueshëm.
- Konfliktet në ish Jugosllavi e gjetën BE-në të papërgatitur nga pikëpamja e kapaciteteve për të përballuar një konflikt të përmasave të tilla, jo vetëm për sa i përket shtrirjes gjeografike por edhe kompleksitetit të çështjeve. BE-ja dështoi të fliste nën një zë të vetëm dhe rruga që ajo dinte më mirë të adresonte konfliktet ishte ajo diplomatike, duke ia lënë barrën më të madhe në vendimmarrje OKB-së dhe NATO-s. Mekanizmat që BE-ja kishte në dispozicion për menaxhimin e situatës pas konfliktit ishin të papërshtatshme, joefektive dhe karakterizoheshin nga shkalla e lartë e burokracisë. BE-ja nuk ishte e pranishme në terren, në vendin e konfliktit, dhe pse shpenzonte më tepër se SHBA-ja në programet për rindërtimin e vendit. Ndërsa NATO ishte e fokusuar në misionet për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, BE-ja, e cila fillimisht duhet t'i kushtonte më tepër rëndësi forcimit të kapaciteteve të saj civile, ishte e angazhuar në misione të një intensiteti më të ulët, siç ishin ato për rindërtimin e vendit pas konfliktit.

- Më shumë sesa kontribuese në misionin ushtarak ISAF të NATO-s në Afganistan, BE-ja më tepër ka qenë e angazhuar me misionin policor EUPOL Afghanistan, i cili ishte i natyrës civile. Kontributi në trupa dhe pjesëmarrja në ndarjen e përgjegjësive për Shtetet Anëtare ka qenë shumë më i ulët se ai i partnerëve të tjerë transatlantik. Pra, ndërkohë që BE-ja ishte angazhuar në misionet paqeruajtëse dhe ato për rindërtimin e vendit, NATO ishte e angazhuar në misionet paqebërëse.
- Angazhimi i BE-së në Afganistan, EUPOL Afghanistan, mund të konsiderohet larg së qënuri i suksesshëm dhe gjatë misionit u evidentuan një sëri mangësish si: pamjaftueshmëria në staf dhe në asete, mungesa e financimeve, mungesa e një strukture të qartë organizative dhe drejtuese e operacionit si dhe vështirësitë në koordinimin e veprimeve në terren me organizatat e tjera ndërkombëtare. Të gjitha këto elementë vënë në pikëpyetje besueshmërinë e BE-së si një aktor ndërkombëtar për menaxhimin e krizave.
- Angazhimi i NATO-s dhe BE-së në Gadishullin e Somalisë dhe në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian paraqet rëndësi të veçantë për marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy organizatave. Edhe pse operacioni ATALANTA i BE-së dhe Ocean Shield i NATO-s janë aktivë në të njëjtin territor dhe kanë mandat të ngjashëm ndërmjet tyre ato nuk ka asnjë plan të përbashkët për veprim apo ndarje të zonave të veprimit. Operacioni ATALANTA është nën drejtimin politik dhe strategjik të BE-së dhe nuk zhvillohet në kuadër të Marrëveshjes së Berlin Plus, ndërsa NATO ka qenë e angazhuar në rajon atëhere kur asnjë organizatë tjetër nuk ishte e gatshme. Por megjithëatë këto organizata kanë arritur të zhvillojnë një *modus operandi*, i cili i mundëson një koordinim mjaft të mirë të veprimeve në terren, pavarësisht mungesës së vullnetit politik. Këto operacione janë plotësues të njëri tjetrit dhe mekanizmat që NATO disponon i mundësojë asaj të reagojë me efektivitet ndaj çfarëdolloj situatë krize të hasur në brigjet detare të Somalisë, në Gjirin e Adenit dhe në pjesën perëndimore të Oqeanit Indian. Gjithashtu, angazhimi i NATO-s në rajon nxorri në pah dhe rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin privat, pasi gjatë zhvillimit të operacioneve ajo bashkëpunoi me aktorët që ishin aktivë në industrinë detare duke i informuar për format e reja të piraterisë dhe për pasojat shkatërruese që ajo kishte në ekonomi dhe industri. Mësimet e nxjerra nga operacionet e NATO-s, sidomos operacioni Ocean Shields, shkojnë përtej atyre operacione thjesht të natyrës detare porse janë tregues i mënyrës sesi duhet të ndërtohet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë jo vetëm elementin ushtarak por edhe atë civil.
- Bashkëpunimi midis BE-së dhe OKB-së në fushën e menaxhimit të krizave paraqet rëndësi të veçantë për të dy këto organizata, pasi BE-ja përfiton nga legjitimiteti që i garanton mandati i KS të OKB-së dhe OKB-ja përfiton nga besueshmëria dhe aftësia operacionale e BE-së, sidomos në rastin e misioneve komplekse. Megjithëatë, BE-ja dhe OKB-ja janë akoma larg të qënurit partnerë strategjikë. Shtetet Anëtare të BE-së janë skeptike për të pranuar komandën dhe kontrollin e OKB-së mbi forcat e tyre.

- Sfida e së ardhmes për këto organizata është optimizimi i potencialit të secilës prej tyre dhe kalimi i pengesave të brenshme. BE-ja duhet të luajë një rol më aktiv me qëllim realizimin e objektivave të saj, duke zgjeruar kapacitetet e saj ushtarake dhe civile dhe përmirësimin e diplomacisë e saj. Gjithashtu ajo duhet të jetë më koherente në përdorimin e strukturave të saj dhe më e gatshme për të bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë me qëllim për të garantuar një zonë sigurie dhe paqe. Përkrahja e një bashkëpunimi shumëpalësh do të ndihmonte në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe në forcimin e pozitës së saj në arenën ndërkombëtare.
- Marrëdhëniet BE-OSBE janë larg të qënurit aleatë. Në vend të kontributit në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata të bashkëpunimit, BE-ja është më përzgjedhëse në misionet të cilat merr pjesë. Ambicia e BE-së është të jetë një aktor global në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke marrë kështu operacione dhe përtej kufinjve të saj, ndërsa OSBE-ja është më aktive me operacione të ndërmarrja kryesisht brenda zonës së saj si në Europën Juglindore, Europën Lindore, në Kaukaz dhe Azinë Qëndrore.
- Krijimi i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, në tërësi dhe Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes në veçanti, i mundëson BE-së të vërë në dispozicion të misioneve kapacitetet e saj ushtarake dhe civile. Gjithashtu fuqia e saj ekonomike dhe natyra mbinacionale për disa nga institucionet e BE-së i jep asaj një fleksibilitet më të madh.
- Ndonëse mekanizmat *ad hoc* të bashkëpunimit mund t'i përshtaten më së miri çdo situatë konflikti, krijimi i strukturave të përhershme të bashkëpunimit është një domosdoshëri.
- Miratimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë dhe drejtimi i fokusit të BE-së në operacionet humanitare, solli një mbivendosje me dimensionin humanitar të operacioneve të OSBE-së. Për shkak të objektivave të ngashme, në fushën operacionale këto organizata rrezikojnë të duplikojnë njëra tjetrën. Me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe rritjen e efektivitetit të operacioneve do ishte e domosdoshme krijimi i një mekanizmi për koordinimin e operacioneve, përfshirë këtu dhe programet e trajnimit.
- PESMP-ja është përdorur në Afrikë në dy mënyra. *Së pari*, në mënyrë *ad hoc*, duke shërbyer si një mekanizëm për të reaguar në mënyrë të menjëhershme në rastet e menaxhimit të krizave (si në RDK, Çad, Afrikën qendrore, Somali, Sudan). *Së dyti*, nëpërmjet Strategjisë së Përbashkët UA-BE ajo ndërmori angazhime afatgjate për të ndihmuar vendet afrikane në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve dhe strukturave të reagimit ndaj krizave.
- Bashkëpunimi rajonal me organizatën e UA paraqet rëndësi pasi ruajtja e një paqe dhe sigurie të qëndrueshme në Afrikë është thelbësore për sigurinë Europiane, sidomos në fusha si terrorizmi, trafikimi i narkotikëve dhe i qënieve njerëzore dhe emigracioni. Adoptimi i Arkitekturës Afrikane të Paqes dhe të Sigurisë çoi më tej angazhimin e BE-së dhe të UA për forcimin e paqes, sigurisë dhe të stabilitetit në rajon.

- Mekanizmi për Paqen në Afrikë i dha BE-së mundësinë për të adresuar shpërndarjen e fondeve të saj për çështje që kishin të bënin me paqen dhe sigurinë në mënyrë më efektive. Ky mekanizëm i dha BE-së dhe UA më fleksibilitet për të reaguar ndaj krizave.
- Krijimi i mekanizmave financiar, si Fondi Europian për Zhvillim, i cili financohej direkt nga Shtetet Anëtare, funksionimi i tij rregullohej nga dispozita të mëvetësishme dhe që funksiononin jashtë kornizës së buxhetit të BE-së, ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së BE-së në operacionet e drejtuara nga vendet Afrikane.
- Nëpërmjet PESMP-së, BE-ja ka qenë aktive në Afrikë në dy mënyra: *së pari*, në mënyrë *ad hoc*, nëpërmjet mekanizmit të reagimit të menjëhershëm në rastet e menaxhimit të krizave (si në RDK, Çad, Afrikën qendrore, Somali, Sudan), dhe *së dyti*, nëpërmjet Strategjisë së Përbashkët UA-BE, duke ndërmarrë angazhime afatgjate për të ndihmuar vendet afrikane në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve dhe strukturave të reagimit ndaj krizave. Pavarësisht rezultateve pozitive, për shkak të mungesës së një strukture të qartë të politikës së jashtme të Bashkimit, bashkëpunimi me UA është karakterizuar nga natyra e tij dypalëshe me Shtetet Anëtare sesa nëpërmjet mekanizmave të BE-së.
- Numri i misioneve që BE-ja në ka ndërmarrë në Afrikë, në kuadër të PEMSP-së, janë më të shumta në numër krahasuar me misionet në Ballkan, Gjeorgji, Lindjen e Mesme etj, fakt që tregon se Afrika përbën një shqetësim për sigurinë Europiane.
- Bashkëpunimi BE-ShKAJL shtrihet në këto fusha: a.) tregëtia dhe investimet; b.) edukim, kërkim shkencor dhe kulturë; c.) bashkëpunim politik; d.) bashkëpunim nëfushën e sigurisë dhe të mbrojtjes; e.) integrimi dhe ndërlidhja; dhe f.) bashkëpunimi sektorial.
- Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe ShKAJL kanë përparuar së tepërmi duke u bërë më sistematike, më koherente dhe më gjithëpërfshirëse. Tashmë Azia është pjesë e axhendës ndërkombëtare të BE-së dhe bashkëpunimi nuk shtrihet ngushtësisht vetëm në fushën e sigurisë, por edhe në fusha si tregëtia, ndryshimet klimaterike, transporti dhe ndërlidhja të cilat ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në stabilitetin e rajonit dhe më gjerë të Europës.
- BE-ja dhe ShKAJL-ja janë partnerë strategjikë në integrimin e tyre, por ndërmjet tyre ka dallime të mëdha si përsa i përket zhvillimit ekonomik, sistemit të tyre politik dhe institucional. Për shkak të natyrës ndërqeveritare ShKAJL-së, sistemit të vendimarrjes mbi bazë konsensusin, buxhetit të ulët (vetëm 16 milion dollarë në vit dhe kontribut i barabartë nga të gjitha shtetet) dhe pozitës së dobët politike të Sekretariatit, realizimi i objektivave të vendosura nga aktet e themelimit dhe krijimi i një rajoni të sigurtë për qytetarët e saj paraqitet mjaft sfidues. Ndikim në këtë drejtim ka pasur dhe fakti që tradicionalisht BE-ja e ka konsideruar veten si “soft power”, duke mos u përpjekur për të vendosur dominancën e saj në rajon, siç po veprojnë aleatët e saj SHBA dhe Kina. Problem tjetër për bashkëpunimin BE-ShKAJL është edhe rritja e problemeve politike në Mianmar, Tajlandë dhe në Indonezi.
- Angazhimi i BE-së në Azi ka rëndësi për tre arsye: *Së pari*, pozicioni gjeografik, ndryshimet demografike, rritja ekonomike janë elementë të cilat duhet të merren parasysh

nga Bashkimi, pasi po ndryshojnë në mënyrë të menjëhershme. *Së dyti*, natyra globale e rreziqeve me të cilat po përballlet rendi botëror si krizat ekonomike, pasurimi i armëve të shkatërrimit në masë, pandemitë, ndryshimet klimaterike, lëvizjet migratore dhe aktet terroriste kërkojnë një bashkëpunim dhe koordinim të veprimeve jo vetëm në nivel rajonal por edhe global. *Së treti*, marrëdhënia e BE-së me Azinë i jep përgjigje pyetjeve që lidhen me rëndësinë e BE-së si aktor ndërkombëtar.

- Politikat e parandalimit të konflikteve kanë për objekt një gamë të gjerë veprimesh e ndërveprimesh si dhe dhe iniciativash. Qëllimi i saj është të shmangë përshkallëzimin e dhunshëm të një mosmarrëveshjeje. NATO dhe BE, në mënyrë të ndjeshme kanë vepruar si mekanizma të ndërthurur, duke dhënë maksimumin e tyre në ato situata ku qartësisht njëra nga palët ishte jo në anën e së drejtës. Por mes të thënës dhe të bërës, ashtu si dhe vetë opinionin publik, duhet të kalojë në disa faza ndërgjegjësimi. Në kohën e “fshatit global” një rol po aq të rëndësishëm sa dhe vetë aktorët primarë luan dhe media, me gjithë kufizimet e saja, nevojën e sjelljes së lajmit sa më sencacional dhe mbingopjes së opinionit me skenat e konfliktit, aq sa bëhen diçka normale dhe e përtypshme. Me dijeni apo si pasojë e lëvizjeve globale, NATO dhe BE, po përpiqen të bashkërendojnë me më shumë efektivitet burimet e tyre, për tju përshtatur sfidave të së ardhmes. Politikat e tyre, po përpiqen të përqendrohen qartazi në tre faktorë; lokalë, rajonalë dhe botërorë.
- NATO dhe BE, me anë të mekanizmave të tyre dhe politikave lokale, janë përpjekur shpeshherë, në disa raste më me efektivitet se disa të tjera, të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve (të shteteve të tyre dhe atyre në konflikt), me disa mekanizma si: a. *Edukimi për çështjet dhe konfliktet*; b. *Zhvillimi i një marrëdhënie më të afërt dhe më të respektueshme me muslimanët dhe botën islame*; c. *Komunikimi nga poshtë lart*
- Për të ndaluar terrorin dhe për të shmangur luftën, BE dhe NATO i duhet së pari të kuptojë se çfarë e shkakton dhe cilat qasje kanë dhe nuk kanë qenë të suksesshme në të kaluarën. Deri tani, "Lufta mbi Terrorizmin" e Amerikës duket të jetë e përqendruar ekskluzivisht në lëvizjen që ka nxjerrë në pah autorët e sulmeve të 11 Shtatorit: muslimanë Sunitë konservator radikal, të dhunshëm, nga një zonë që shtrihet gjeografikisht nga Afrika Veri-Perëndimore në Azinë Juglindore. BE dhe NATO ka qenë një faktor vendimtar që ka tërhequr më pas të gjithë faktorët e tjerë duke na dhënë mjetet të mësojmë më shumë për historinë, kulturën, fetë dhe ekonominë e atyre pjesëve të botës, marrëdhëniet historike dhe aktuale fetare, ushtarake, politike dhe ekonomike të Perëndimit me ta dhe me Islamin si shembull; Dhe si këto kushte, nga kolonializmi nëpërmjet ndryshimeve ekonomike globale dhe rivaliteteve gjeopolitike, kanë kontribuar në varfëri, dëshpërim, urrejtje dhe, ndonjëherë, fanatizëm fetar. Popujt tashmë janë më të vetëdijshëm se një nga arsye pse zona të caktuara knë më tepër tendencë të shpërthejnë në konflikte është dhe tendenca e Perëndimit për të imponuar kulturat, vlerat dhe pritjet e tyre në këto rajone pa marrë kohë për të kuptuar tabanin historik, etnologjik e kulturor të kytyre zonave. Organizmat e interesuar për ndalimin e terrorizmit dhe shmangien e luftës

nuk mund të lejojnë përsëritjen e këtij gabimi dhe dalëngadalë dhe NATO e BE po kuptojmë se konflikti është dhe çështje mendimi e jo vetëm ushtrim force.

- Ndërsa bota zvogëlohet, kjo është në të vërtetë diçka që duhet të bëjmë me të gjitha kulturat dhe fetë, por për qëllimet e Luftës aktuale kundër Terrorizmit, është veçanërisht e rëndësishme që, ashtu si krishterimi dhe judaizmi kanë mësuar të jetojnë në harmoni më të madhe (edhe pse akoma jo siç duhet) pas dy mijëvjeçarë e tensionit, kulturat perëndimore dhe fetë duhet të gjejnë dhe zhvillojnë interesat tona të përbashkëta me botën islame. Ashtu si me çdo pakicë apo "tjetër", aq më shumë ne punojmë me dhe kuptojmë njerëzit e besimit islam, aq më pak do të duken të çuditshme dhe kërcënuese dhe më shumë do t'a njohim njëri-tjetrin si individë dhe si qenie njerëzore.
- Kohët e fundit, në vazhden e populizmit si shtysë fillestare, por edhe nevoja për transferimin e kopetencave (*soft power delegation*) NATO dhe BE kanë nisur apo investojnë në programe nga më të ndryshmet, për ti dhënë një shtysë vendimmarrjes së masës së popullsisë apo presionit që këta mund të ushtrojnë ndaj liderave të papërgjegjshëm apo aventurierë. Ngritja e forumeve të komunitetit, mësimdhënies dhe paneleve, për të edukuar publikun, për të nxjerrë mendime të ndryshme dhe për të detyruar politikanët të shprehin qartë bindjet dhe synimet e tyre.
- Për sa i përket politikave rajonale dhe globale në vendet në konflikt apo me mundësi të lartë konflikti, NATO dhe BE kanë ndërmarrë një sërë iniciativash, ku ndër më kryesoret përmendim: *së pari*, monitorimi dhe/ose ndërhyrja për të stabilizuar një konflikt potencialisht të dhunshëm përpara shpërthimit të tij, duke iniciuar aktivitete që adresojnë shkaqet rrënjësore si dhe shkaktarët e mosmarrëveshjes; *së dyti*, themelimi i mekanizmave që zbulojnë shenjat e paralajmërimit të hershëm dhe shërbejnë si këmbana alarmi e si tregues të veçantë që mund të ndihmojnë në parashikimin e dhunës së afërt; *së treti*, përdorimi i koordinimit të planifikuar për të parandaluar krijimin e konfliktit gjatë dhënies së ndihmës humanitare dhe në procesin e zhvillimit; *së katërti*, institucionalizimi i idesë për parandalimin e konfliktit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Pavarësisht nga ritmi i ethshëm dhe rrjedhshmëria e jetës moderne, ekzistojnë burime të stabilitetit. NATO dhe BE, natyrisht, janë një burim i tillë, por po kështu është edhe rrjeti i gjerë i lidhjeve ekonomike dhe politike që lidhin fuqitë e mëdha botërore. Disa nga institucionet globale që u krijuan në dekadat e mëparshme mund të tregojnë shenja të moshës, por ato ende sigurojnë mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në harmoni me sundimin e ligjit. Fuqitë globale në zhvillim si Kina, India dhe Brazili po e përdorin influencën e tyre në rritje në mënyrë paqësore. Ndërsa NATO dhe BE planifikojnë për rreziqet e një dekade të re, kjo mund ta bëjë këtë me dijeninë se dëshira e tyre për të jetuar në harmoni me të tjerët është gjerësisht (nëse jo universalisht) e përbashkët. Është e vështirë të ofrosh parashikime të detajuara për vitet e ardhshme dhe për më tepër të bësh rekomandime mbi to dhe kjo nuk duhet të jetë e habitshme. Edhe gjatë kushteve relativisht të ngurta të Luftës së Ftohtë, ndodhën ngjarje të paparashikuara

me rëndësi të madhe gjeopolitike. Në ditët e sotme, pasiguria zmadhohet nga faktorë të tillë si:

- *Përhapja e armëve bërthamore dhe të tjera të shkatërrimit në masë;*
 - *Ambicinet e grupeve terroriste ndërkombëtare;*
 - *Qëndresa e rivaliteteve të dëmshme rajonale, kombëtare, etnike dhe fetare;*
 - *Varësia në rritje e botës nga sistemet e informacionit potencialisht të pambrojtura;*
 - *Konkurrenca për naftën dhe burime të tjera strategjike (duke theksuar kështu rëndësinë e sigurisë detare);*
 - *Ndryshimet demografike që mund të përkeqësojnë probleme të tilla globale si varfëria, uria, emigracioni i paligjshëm dhe sëmundjet pandemike; dhe*
 - *Pasojat akumuluese të degradimit të mjedisit, duke përfshirë ndryshimet klimatike.*
- Agresioni ushtarak konvencional kundër Aleancës ose anëtarëve të saj nuk ka gjasa të larta të ndodhë, por mundësia nuk mund të shpërfilllet. Kërcënimet më të mundshme ndaj aleatëve në dekadën e ardhshme janë jokonvencionale. Tre në veçanti dallojnë: i.) një sulm nga raketat balistike (pavarësisht nëse janë apo jo me armë bërthamore); ii.) sulme nga grupet terroriste ndërkombëtare; iii.) sulmeve kibernetike me shkallë të ndryshme të ashpërsisë.
 - Një mori kërcënimesh gjithashtu paraqesin rrezik, duke përfshirë ndërprerjet në linjat e furnizimit me energji dhe tregtia detare, pasojat e dëmshme të ndryshimeve klimatike globale dhe krizës financiare.
 - Rreziku i kërcënimeve të pazakonta ka implikime të dukshme për gatishmërinë e NATO-s, duke përfshirë përcaktimin e saj të sigurisë, konceptimin e tij se çfarë përbën një çenim të Nenit 5, strategjinë e saj për parandalimin, nevojën për transformim ushtarak, aftësinë e tij për të marrë vendime me shpejtësi dhe mbështetjen e saj për ndihmë në vende dhe organizata jashtë Aleancës.
 - Mesdheu për shkak të pozicionit gjeografik të tij, nyje e rrugëve të tregtisë ndërkombëtare, ka zënë një vend të rëndësishëm në procesin e integrimit Europian. Partneriteti Euro-Mesdhetar i angazhuar për të garantuar paqen dhe stabilitetin në rajon, nuk është përfshirë direkt në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Aftësitë dhe kapacitetet e BE-së për menaxhimin e krizave dhe parandalimin e konflikteve, si promovimi i integrimit rajonal, forcimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, ishin të pamjaftueshme dhe joeficente për të reaguar në situata komplekse.
 - Pas më shumë se 20 vitesh të Procesit të Barcelonës mund të themi se BE-ja dhe Shtetet Anëtare dështuan në krijimin e mekanizmave efektivë për të adresuar një konflikt rajonal. Për shtetet anëtare ishte më i lehtë bashkëpunimi në çështje të cilat kishin më pak ndjeshmëri politike, në të cilat komponenti i sigurisë ishte më pak i pranishëm.
 - Krijimi i Partneritetit Euro-Mesdhetar, pas lancimit të Politikës Globale për Mesdheun, shënoi nisjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe vendeve të

Mesdheut. Ndonëse për këto vite që ai ka vepruar janë shënuar arritje pozitive, efica dhe sukse i këtij partneriteti është mjegulluar nga disa shkaqe si: *së pari*, dështimi i procesit të paqes në Lindjen e Mesme; *së dyti*, bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe vendeve në jug të Mesdheut nuk ishte ndërtuar mbi pozita të barabarta, por është karakterizuar nga superioriteti i Bashkimit; *së treti*, mungesa demokracisë, mosekzistenca e shtetit të së drejtës dhe kontrolli i veprimtarisë së shoqërisë civile; *së katërti*, rritja e radikalizmit dhe servirja e mesazheve anti islam nga media dhe nga botues europianë; dhe *së pesti*, pamjaftueshmëria e financimeve.

- Politika Europiane e Fqinjësisë vepronte paralelisht me Procesin e Barcelonës. Nëpërmjet saj Bashkimi synonte të nxiste bashkëpunim politik - duke forcuar dialogun politik, integrim ekonomik - duke pasur akses më të madh në programet dhe politikat e BE-së, përfshirë dhe atë të tregut të Përbashkët, rritjen e qarkullimit të mallrave, forcimin e bashkëpunimit për çështje të drejtësisë dhe të punëve të brendshme si shteti i së drejtës, mirëqeverisja, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoritetetve, promovimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët.
- Vlera e shtuar e Politikës Europiane e Fqinjësisë qëndron në faktin se ajo vendosi një dialog politik më efektiv, nxiti shtetet nga bashkëpunimi në integrim, rriti efektivitetin e bashkëpunimit, ndihmoi vendet e angazhuara të përmirësojnë ekonominë e tyre dhe të nxisin zhvillimin social dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal nëpërmjet krijimit të Bashkimit për Mesdheun në 2008 dhe të Partneritetit Lindor në 2009.
- Një Politikë Europiane e Fqinjësisë efektive ndikon në sigurinë e BE-së dhe duhet të jetë pjesë e Politikës së Jashtme të Bashkimit. Në ndihmë të zbatueshmërisë së saj të jenë jo vetëm instrumentat e BE-së por edhe ato të Shteteve Anëtare. Bashkimi duhet të mbajë parasysh nevojat që ka secili shtet, sfidat me të cilat ato përballen dhe aspiratat që ato kanë. Qënia në të njëjtin pozicion gjeografik të këtyre shteteve, nuk nënkupton domosdoshmërisht që stabiliteti dhe rendi i tyre mund të kërcënohet nga të njëjtët faktorë.
- Brexit çënon sigurinë Europiane në drejtim të marrëveshjeve të tregëtisë, mospjesëmarrjen e Britanisë së Madhe në politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit, të bashkëpunimit ndërkufitar në luftën ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar dhe fondit European të mbrojtjes.
- Përveç Brexit siguria dhe stabiliteti i BE-së kërcënohet nga rritja dhe forcimi i lëvizjeve kundër tij, të cilat pasqyrohen nëpërmjet partive politike të vendeve të ndryshme.

TABELA DHE FIGURA

Tabela 1: Traktati i Lisbonës: Ndryshimet kryesore lidhur me Politikën Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët

Neni	Objekti	Natyra
9E, 13A, 14, 19	Përfaqësuesi i Lartë i Punëve të Jashtme dhe i Politikës së Sigurisë	Dispozita të reja
27	Dispozita të përgjithshme për zbatimin e PMSP	Ndryshime të rëndësishme
188 R	Klauzola e Solidaritetit	Dispozitë e re
28 A/7	Klauzola e Mbrojtjes së Ndërsjelltë	Dispozitë e re
28 A/1, 28 B	Detyrat e Petërshburgut	E ndryshuar
28 A/5, 28 C	Zabtimi i një detyre nga një grup Shtetesh Anëtare	Dispozitë e re
28 D	AEM	Dispozitë e re
27/6. 31, Protokolle mbi Bashkëpunimin e Përhershëm të Strukturuar	Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar	Dispozitë e re

*Marrë nga CSS Analyses in Security Policy, Vol. 3 Nr. 23, Shkurt 2008

Tabela 2: Shpenzimet në fushën e mbrojtjes për BE-në

*Burimi: European Defence Agency 2013⁵²⁷





Tabela 3: Shpenzimet në fushën e mbrojtjes për SHBA-në




*Burimi: European Defence Agency 2013⁵²⁸

⁵²⁷ Silvija Guzelyte, *EU-US Defence Data 2011* (Bruksel, Shtator 2013), <http://www.eda.europa.eu/docs/default-source/news/eu-us-defence-data-2011.pdf> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).

⁵²⁸ Po aty.

Tabela 4: Përqindja e trupave të vëna në dispozicion nga shtetet e Europës Perëndimore në Misionet Paqeruajtëse të OKB-së



*burimi UN Dispatch⁵²⁹


Tabela 5: Kontributi në trupa të Shteteve Anëtare të BE-së në operacionet e OKB-së



* Grafiku është bërë nga autori duke përdorur të dhënat në faqen zyrtare të OKB-së.


⁵²⁹ <http://www.undispatch.com/ambassador-power-europeans-come-back-un-peacekeeping/>(hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).

Figura 1: Vendimmarrja në PJSP sipas Traktatit të Lisbonës




*Marrë nga Wolfgang Wessel dhe Franziska Bopp, *The Institutional Architecture of CFSP after the Lisbon Treaty: Constitutional breakthrough or challenges ahead?*, Research Paper Nr. 10 (Qershor 2008)

Figura 2: PJSP/PMSP dhe fusha të tjera të veprimeve të jashtme në Traktatin e Lisbonës



**Traktati i Bashkimit European
Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European**



*Burimi: Marrë nga Wolfgang Wessel dhe Franziska Bopp, "The Institutional Architecture of CFSP after the Lisbon Treaty: Constitutional breakthrough or challenges ahead?", Research Paper No. 10, June 2008

LITERATURA

I. Bibliografi

1. **A. Bloed dhe R.A. Wessel**, eds, *The Changing Functions of the Western European Union (WEU): Introduction and Basic Documents* (Dordrecht, Nijhoff, 1994), fq. 14-18, 24-30.
2. **A. Collet**, *Le Traite de Maastricht et la défense*, (29 R.T.D.E., 1993), fq. 229.
3. **A. Dumoulin dhe E. Remacle**, *L'Union de l'Europe occidentale. Phénix de la défense européenne* (Bruksel, Bruylant, 1998), fq. 3-12, 55-85, 194-199, 261-328, 304-315.
4. **A. Gianelli**, *Unione Europea e diritto internazionale consuetudinario* (Giappichelli, 2004).
5. **Antonio Missiroli**, *The Impact of the Lisbon Treaty on ESDP* (European Parliament, 2008), fq. 9, www.statewatch.org/ (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).
6. **C. Greenwood**, "Scope of Application of Humanitarian Law", në *The Handbook of Humanitarian Law in Armed Conflict*, ed. D. Fleck (Oxford, Oxford University Press, 1995), fq. 46.
7. **D. Verwey**, *The European Community, the European Union and the Law of Treaties* (The Hague, TMC Asser Press, 2004), fq. 96.
8. **Enzo Cannizzaro**, eds, *The European Union as an Actor in International Relations* (Hague, Kluwer Law International, 2002), fq. 44-48.
9. **E. Denza**, *The Intergovernmental Pillars of the European Union* (Oxford, Oxford University Press, 2002), fq. 33-61.
10. **E. Fursdon**, *The European Defence Community: A History* (London and Basingstoke, MacMillan Press, 1980), fq. 150-188.
11. **Frederik Naert**, *International Law Aspects of the EU's Security and Defence Policy: With a Particular focus on the Law of Armed Conflicts and Human Rights*, Catholic University of Leuven (2008), fq. 222-223.
12. **F. Pagani**, *A New Gear in the CFSP Machinery: Integration of the Petersberg Tasks in the Treaty on European Union*, (9 E.J.I.L. 1998), fq. 737-749.
13. **Fu-chang Chang**, *EU as Military Actor—The Role of the European Defence Agency*, "European Foreign affairs Review", Volumi 16, (Kluwer Law International, 2011).
14. **Joan F. Hartman**, *Derogation from Human Rights Treaties in Public Emergencies - A Critique of Implementation by the European Commission and Court of Human Rights and the Human Rights Committee of the United Nations* (Harvard I.L.J. 1980), fq. 3.
15. **Jordan Paust**, *The US as Occupying Power Over Portions of Iraq and Relevant Responsibilities Under the Laws of War* (Prill 2003).
16. **H. Montealegre**, *The Compatibility of a State Party's Derogation under Human Rights Conventions with Its Obligations under Protocol II and Common Article 3*, (1983), fq. 43-44.

17. **H. Schöllhorn**, *Der sicherheitspolitische Handlungsrahmen der Europäischen Union: eine Darstellung der rechtlichen und tatsächlichen Möglichkeiten für operative Maßnahmen der Krisenbewältigung*, (Baden-Baden, Nomos, 1996), fq. 49-54.
18. **Gareth Stansfield**, 'The Fall of Ramadi: Daesh' Next Move', *RUSI Analysis* (19 Maj 2015), www.rusi.org (hyrë për herë të fundit më 14 Qershor 2017).
19. **G. Amato et. al.**, *Genesis and Destiny of the European Constitution* (Bruylant 2007), fq. 202-204.
20. **G. Dattilo**, *Politica estera e sicurezza comune nell'Unione europea* (Torino, Giappichelli, 1996).
21. **General Valery Gerasimov**, "The Value of Science in Prediction", *Military-Industrial Courier* (27 Shkurt 2013).
22. **G. Milton dhe J. Keller-Noëllet**, *The European Constitution* (John Harper Publishing, 2005), fq. 22.
23. **I. Brownlie**, *Principles of Public International Law*, 6th edition (Oxford University Press, 2003), fq. 649.
24. **Islam Yusufi**, *Mission Essential Harvest* (2001), <http://www.policy.hu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).
25. **Li Ashan**, "China and Africa: Policy and Challenges", *China Security*, Vol. 3, No. 3 (2007), fq. 70.
26. **M. Berdal dhe S. Economides**, *United Nations Interventionism, 1991–2004*, Cambridge, Cambridge University Press, 2007.
27. **M. Trybus**, *The Vision of the European Defence Community and a Common Defence for the European Union* (TRYBUS & WHITE), fq. 13-42.
28. **M. Trybus**, *European Union Law and Defence Integration* (Oxford, Hart, 2005), fq. 22-43.
29. **R.A. Wessel**, *Afscheid van de West-Europese Unie* (28 Transaktie 1999), fq. 559-568.
30. **R.A. Wessel**, "De Europese Unie in de internationale rechtsorde", në *De plaats van de Europese Unie in het veranderende bestel van devolkenrechtelijke organisatie* ed., (The Hague, TMC Asser Press), fq. 49 – 50.
31. **R. Passos dhe S. Marquardt**, *Genesis and Destiny of the European Constitution* (Bruylant, Bruksel, 2007), fq. 883. **R. Wessel**, *Differentiation in EU Foreign, Security and Defence Policy: Between Coherence and Flexibility* (TRYBUS & WHITE), fq. 223-248.
- 45 **Ugo Caruso**, *Interplay between the Council of Europe, OSCE, EU and NATO*, (2007), <http://www.eurac.edu/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).
46. **Vincent Kronenberger**, eds, *The European Union and the International Legal Order: Discord or Harmony?*, (Asser Press, 2001), fq.405-434.

II. Bibliografi nga interneti

1. **Antonio Missiroli**, *The Impact of the Lisbon Treaty on ESDP* (European Parliament, 2008), fq. 9, www.statewatch.org/ (hyrë për herë të fundit më 20 Prill 2017).
2. **David Owen**, eds., *Bosnia – Hercegovina: The Vance/Owen Peace Plan* (Liverpool University Press, (2013), <https://www.google.al/> (hyrë për herë të fundit më 06 Dhjetor 2015).
3. **Derek Mix**, *The European Union: Foreign and security policy*, (Congressional Research Service 08 Prill 2013), <https://www.fas.org/> (hyrë për herë të fundit më 25 Prill 2017).
4. **Didier Bigo**, *When two become one, internal and external securitisations in Europe*, <http://citeseerx.ist.psu.edu/> (hyrë për herë të fundit më 30 Prill 2017).
5. **Gareth Stansfield**, 'The Fall of Ramadi: Daesh' Next Move', *RUSI Analysis* (19 Maj 2015), www.rusi.org (hyrë për herë të fundit më 14 Qershor 2017).
6. **Gilles Combarieu**, *Security and Defence Aspects of the Lisbon Reform Treaty* (Paris 2008), fq. 4-5 <http://europavarietas.visuarta.eu/> (hyrë për herë të fundit më 12 Mars 2014).
7. **Islam Yusufi**, *Mission Essential Harvest* (2001), <http://www.policy.hu/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).
8. **J. Arloth dhe F. Seidensticker**, *The ESDP Crisis Management Operations of the European Union and Human Rights*, (Deutsches Institut für Menschenrechte, Prill 2007), fq. 15, <https://core.ac.uk/> (hyrë për herë të fundit më 22 Prill 2017).
9. **Javier Solana**, *The European Union and the Organisation for Security and Cooperation in Europe: The shape of future cooperation* (Vjenë, 25 Shtator 2002), <http://www.osce.org/> (hyrë për herë të fundit më 22 Maj 2017).
10. **Lord Robertson of Port Ellen**, *Kosovo one year on: Achievement and Challenge* (2000), <http://www.nato.int/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).
11. **M. Schmitt** et.al, *The Manual on the Law of Non-International Armed Conflict: With Commentary* (International Institute of Humanitarian Law, Sanremo 2006), pg. 1.1.1, <http://www.michaelschmitt.org/> (hyrë për herë të fundit më 23 Prill 2017).
12. **Oxford Public Interest Lawyers**, *Legal Consequences of Israel's Construction of a Separation Barrier in the Occupied Territories* (Oxford, Shkurt 2004), <http://www.law.ox.ac.uk/> (hyrë për herë të fundit më 16 Tetor 2015).
13. **Robert C. Owen**, *Deliberate Force: A Case Study in Effective Air Campaigning* (Air University Press, 2000), <http://www.au.af.mil/> (hyrë për herë të fundit më 07 Qershor 2017).
